

TAKVIM
1442-1443

KALENDAR
2021

Boton:

KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prishtinë, rr. “Bajram Kelmendi” (Ish-Vellusha) nr. 84

Tel & fax: 038 / 224-001

www.bislame.net

e-mail: takvimi@hotmail.com

Për botuesin:

Myftiu, Naim ef. Tërnavë

Kryeredaktor:

Ahmet Sadriu

Redaksia:

Hajrullah Hoxha

Resul Rexhepi

Sabri Bajgora

Ramadan Shkodra

Lektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor teknik &

Realizimi kompjuterik:

Nuhi Simnica

Shtypi:

“Iliri” - Prishtinë

© Copyright:

Të gjitha të drejtat e botimit, ribotimit, fotokopjimit a përkthimit i përkasin Kryesisë së BI-së të Kosovës.

Ndalohet me ligj riprodhimi i plotë apo i pjesshëm pa lejen e botuesit

**TAKVIM
1442-1443**

**KALENDAR
2021**

Prishtinë



Me Emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

NË VEND TË PARATHËNIES

Falënderimet dhe lëvdatat janë vetëm për Allahun, Krijuesin e gjithësisë. Vetëm Atë e falënderojmë dhe vetëm nga Ai ndihmë dhe mbrojtje kërkojmë. Përshëndetjet më të përziemërta, salavatet dhe selamet qofshin mbi më të dashurin e Allahut xh.sh., Muhamed Mustafanë, vulën e pejgamberisë, mbi familjen e tij të pastër, shokët e tij besnikë dhe mbi gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në ditën e fundit të kësaj bote.

Lexues të nderuar!

Këtë vit, botimi i “Takvimit” na vjen në një situatë të pazakontë, ku e gjithë bota mbarë po ballafaqohet me pandeminë Covid-19, e cila nuk na ka kursyer as ne. Mirëpo, duke pasur parasysh rëndësinë e revistës dhe kërkesën e lexuesit, redaksia ka bërë një angazhim maksimal që edhe këtë vit të dalë me revistën “Takvimi”, dhe kështu të ruhet tradita e daljes së saj për më shumë se pesë dekada. Vërtet një situatë jo e lehtë, por falë përpjekjeve dhe angazhimit së pari të themeluesit të kësaj reviste, pastaj të redaksisë dhe të bashkëpunëtorëve, ia kemi arrit që edhe në këtë vit lexuesit t’ia sjellim revistën në dorën e tij. Kemi bërë përpjekje maksimale që lexuesit të nderuar t’i sjellim sa më shumë punime nga fusha të dijes dhe të shkencës, e si gjithëherë, duke ia bashkëngjitur

në fund edhe pjesën kalendarike e cila është e veçantë nga pjesa tematike e saj.

Pra, edhe këtë vit, me rastin e botimit të “Takvimit” jemi munduar që për lexuesin të sjellim materiale me tematika të ndryshme, duke mbuluar edhe fusha të ndryshme. Si zakonisht, temat të cilat i kemi trajtuar në botimin e këtij viti janë nga fushat e akaidit, tefsirit, fikhut-jurisprudencës islame, trashëgimisë, si dhe fusha të tjera. Si specifikë e këtij numri është edhe trajtimi i një teme që ka të bëjë me virusin Korona dhe me pandemitë në përgjithësi, për mënyrën se si e trajton Islami pandeminë, çka na rekomandon, si duhet të sillemi në situata të tilla, çfarë masash duhen ndërmarrë, e kështu me radhë.

Të nderuar lexues!

Siç edhe do ta vëreni, revistën “Takvimi” këtë vit e kemi filluar me temat nga akaidi, për të vazhduar me rubrikën e tefsirit, më pastaj me trajtesën rreth bindjes dhe dashurisë ndaj Krijuesit tonë dhe më të dashurit të Tij, Muhamedit a.s., rëndësia e Ramazanit, pritja dhe përcjellja e tij si muaj i bekuar, pastaj manifestimi i dy Bajrameve në ruajtjen e traditës sonë është tema në vijim. Tema tjetër e radhës ka të bëjë me Kuranin, shkencën dhe gjithësinë, një temë e cila në mënyrë të thuktë shpjegon lidhjen e Librit të shenjtë, Kuranit me shkencën, pastaj me fenomenet dhe me zhvillimet në gjithësi. Një trajtesë shumë me rëndësi në këtë numër është edhe tema që flet për jetën dhe vdekjen, për mënyrën e trajtimit të Kuranit dhe të shkencës rreth këtyre dy fenomeneve. Më pas, janë tri tema të ndryshme të cilat flasin për arsimin, vlerën e

tij, pozitën dhe vlerën e dijetarëve në Islam, zhvillimin e shkollave-mektebeve të ne, e kështu me radhë. Një temë e veçantë në këtë numër trajton sistemin financiar islam dhe kontratat hibrit në këtë sistem, një tematikë pak e njohur të ne. Për familjen dhe sfidat e saj në kohën bashkëkohore, bazazinë gjinore dhe marrëdhëniet pasurore bashkëshortore flasin temat në vijim, e me të cilat edhe e përmbylлим këtë numër të “Takvimit”.

Revista “Takvimi” këtë vit ka bërë një përjashtim, ku si temë të veçantë ka trajtuar personalitetin e Hajrullah efendi Hoxhës, autorit të “Takvimit” që nga fillimi i daljes së tij, i cili para pak ditësh kaloi në Ahiret. Rahmetliu është edhe autor i pjesës kalendarike të “Takvimit” të këtij viti. Hajrullah efendi Hoxha ishte nismëtari i daljes së “Takvimit” në gjuhën shqipe, si dhe për pesë dekada rresht dha një kontribut të çmuar në daljen e tij, por jo vetëm, ai dha një kontribut shumë të madh në përgjithësi në publicistikën islame shqiptare. Me këtë rast, lusim Allahun xh.sh., që rahmetliun ta marrë në mëshirën e Tij dhe ta shpërblejë me Xhenetul Firdeus.

Redaksia e “Takvimit” jo domosdoshmërisht pajtohet me opinionet e autorëve të shkrimeve që boton.

Në fund, ua rikujtojmë lexuesve të nderuar që, revista “Takvimi” përmban ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit a.s., andaj luten që të kenë kujdes gjatë përdorimit të tij.

Vetëm me ndihmën e Zotit arrihen qëllimet dhe ia dilet mbanë.

*Prishtinë,
dhjetor 2020*

Ahmet Sadriu

Naim ef. TËRNAVA

ARGUMENTE QË VËRTETOJNË EKZISTIMIN E ALLAHUT, XH.SH.

Gjithësia argumenton ekzistimin e Zotit, xh.sh.

Besimtari mysliman beson në Zotin Një: se Ai (Zoti) është Krijues i qiejve dhe Tokës, se Ai i di të fshehtat dhe të dukshmet, se Ai dërgoi peygamberë dhe libra të shpallur, se Ai është Zot dhe Sundues i çdo gjëje, se nuk ka zot, përveç Atij dhe se vetëm Ai meriton të adhurohet. Myslimani beson se Qenia e Tij është e përsosur, është larg çdo mangësie, ngjashmërie a përngjasimi, se Ai e udhëheq universin, se çdo gjë është nën sundimin, kontrollin, urdhrin dhe kompetencën e Tij dhe se tek Ai do të rikthehemi, kur kjo gjithësi, me urdhrin e Tij, ashtu siç u krijua, do të shkatërrohet dhe do të marrë fund.

Allahu, xh.sh., në shenjë të kësaj Njëshmërie dhe adhurimi, në Kuran thotë:

﴿إِنِّي أَنَا اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا أَنَا فَاعْبُدْنِي وَأَقِمِ الصَّلَاةَ لِذِكْرِي﴾

“Vërtet vetëm Unë jam Allahu, dhe nuk ka zot, përveç Meje, prandaj më adhuro Mua, si dhe fal namazin për të më kujtuar Mua!” (Taha: 14)

Para se të flasim për krijimin e kësaj gjithësie, mënyrën e funksionimit të saj, mënyrën e krijimit, kompaktësinë, rregullin, harmoninë që ekziston, argumentet që vërtetojnë për Krijuesin e saj, e shoh të udhës të flasim për njeriun, pa të cilin kjo ekzistencë nuk do ta kishte kuptimin dhe vlerën që ka.

Krahasuar me të gjitha krijesat që jetojnë mbi sipërfaqen e Tokës: në brendinë e saj, në ujë, pastaj në qiej dhe kudo në këtë univers, mund të themi se njeriu ka nevojë të madhe për ta besuar Krijuesin e kësaj gjithësie. Ai ka nevojë të madhe për ta njohur e kuptuar këtë ekzistencë që i Madhi Zot, xh.sh., e krijoi nga asgjëja, si edhe ka nevojë për ta njohur veten, ngase Allahu e krijoi atë si krijesë të kësaj bote dhe e bëri mëkëmbës mbi sipërfaqen e Tokës. Se është thirrje e të Madhit Zot, xh.sh., për ta besuar këtë, e mësojmë edhe nga ajetet kuranore. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اذْكُرُوا اللَّهَ عَلَيْكُمْ ۚ هَلْ مِنْ خَالِقٍ غَيْرِ

اللَّهِ يَرْزُقُكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ وَالْأَرْضِ ۚ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۚ فَآَنَىٰ تُفَكُّونَ﴾

“O ju njerëz, ruajini me mirënjohje të mirat që Allahu jua dhuroi! A ka ndonjë zot tjetër që ju furnizon nga qielli e Toka?! Nuk ka zot, përveç Tij, e pra, si ia ktheni shpinën?!” (Fatir: 3)

S’ka dyshim se Allahu, xh.sh., është burimi i të gjitha dhuntive në këtë botë, ngase askush tjetër përveç Tij nuk e ka mundësinë e dhurimit dhe furnizimit nga Toka e qielli. E këtu qëndron edhe arsyeja e besimit dhe e adhurimit vetëm të Zotit Një. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿وَلَهُ مَا سَكَنَ فِي اللَّيْلِ وَالنَّهَارِ ۚ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ﴾

“Vetëm e Tij është gjithçka që pushon e lëviz natën e ditën. Ai gjithçka dëgjon dhe gjithçka di.” (En’amë: 13)

Megjithatë, ka shumë njerëz që nuk e përfillin këtë realitet, prandaj edhe shohim besime të devijuara e që janë larg nga besimi i shëndoshë dhe i drejtë islam.

I Madhi Zot, xh.sh., posedon gjithë ç’ka në qiej dhe në Tokë dhe çdo gjë është në kompetencën e Tij. Ai mbikëqyr çdo gjë, në çdo çast, pa ndërprerje, ditën e natën. Në kaptinën “Fatir”, Zoti, xh.sh., i drejtohet njeriut dhe mendjes së tij që t’u kushtojë vëmendje këtyre gjërave. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنَّ وَعْدَ اللَّهِ حَقٌّ فَلَا تَغُرَّنَّكُمُ الْحَيَاةُ الدُّنْيَا ۚ وَلَا يَغُرَّنَّكُم بِاللَّهِ الْغُرُورُ ۝ إِنَّ الشَّيْطَانَ لَكُمْ عَدُوٌّ فَاتَّخِذُوهُ عَدُوًّا ۚ إِنَّمَا يَدْعُو حِزْبَهُ لِيَكُونُوا مِنْ أَصْحَابِ السَّعِيرِ﴾

“O ju njerëz, s’ka dyshim se premtimi i Allahut është i vërtetë, prandaj të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote, dhe ndaj Allahut të mos ju mashtrojë ai i mashtruari (shejtani)! Djalli është armiku juaj, prandaj edhe ju konsiderojeni armik! Ai e thërret atë grupin e vet, vetëm për t’i bërë banues të Zjarrit.” (Fatir: 5-6)

Edhe pse Allahu, xh.sh., përmes këtyre ajeteve i bën thirrje njeriut për të besuar, ai prapë, në shumicën e rasteve kundërshton. Të gjithë pejgamberët e Allahut, xh.sh., ishin të shqetësuar dhe të dëshpëruar për popujt që nuk i dëgjonin thirrjet e tyre për ta besuar fjalën e zbritur prej të Madhit Zot, xh.sh. Thirrjet e tyre ishin të vazhdueshme dhe të mundim-

shme, sepse gjatë ballafaqimit me ata që nuk ishin gati për ta pranuar fjalën e të Madhit Zot, pejgamberët e Allahut hasën në shumë vështirësi. Disa pejgamberë u rrahën, disa u torturuan, e disa edhe u mbytën-vranë.

Muhamedi, a.s., derdhi tërë mundin e vet vetëm e vetëm që t'ua bënte të qartë të gjithë njerëzve misionin e vet të ngarkuar prej Zotit. Ai e arriti këtë duke e ditur se Islami është fe që mbështetet në shqyrtimin dhe vërtetimin e argumenteve që janë në gjithësi, mirëpo edhe në vëzhgimin shkencor të jetës dhe të botës fizike e cila na rrethon. Islami është thirrje e gjallë, aktive dhe serioze në vërtetimin dhe hulumtimin e jetës në përgjithësi, e natyrës, e ligjeve, e fuqive dhe e fshehtësive të saj, të cilat më pas reflektohen në vetë shpirtin e gjallë të njeriut, besimin (imanin).

Nuk ekziston rrugë tjetër, e as mundësi tjetër, që të shtyn në njohjen e të Madhit Zot, xh.sh., pos rrugës që Ai e ka sqaruar në Kuran, që nëpërmjet fakteve dhe argumenteve që janë të pranishme në këtë gjithësi të besojmë e të bindemi në ekzistencën e Zotit (Krijuesit). Universi është libri i hapur në të cilin mund të lexohet madhështia, fuqia dhe dija e Fuqiploetit, dhe në të cilin bindemi se e tërë kjo ekzistencë është krijuar nga “hiçi (nga asgjëja)”, me dëshirën dhe vullnetin e Allahut, xh.sh., që është pa fillim dhe pa mbarim. Çdo gjë që na rrethon dëshmon në Zotin Një. Njerëzit dhe të gjitha gjallesat e tjera që jetojnë në Tokë, e cila është e zbukuruar me lisa, lule, pemë e perime, të cilat mbijnë nga i njëjti dhé e uji-ten me të njëjtin ujë, mirëpo japin aromë, formë, ngjyrë e frute të ndryshme, dëshmojnë për ekzistencën e Allahut, xh.sh., që thotë:

﴿أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجْنَا بِهِ ثَمَرَاتٍ مُخْتَلِفًا أَلْوَانُهَا ۚ وَمِنَ الْجِبَالِ جُدَدٌ بَيَضٌ وَحُمْرٌ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهَا وَعَرَايِبُ سُودٌ﴾ ﴿٢٧﴾ وَمِنَ النَّاسِ وَالْدَّوَابِّ وَالْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ كَذَلِكَ ۚ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ ۚ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ ﴿٢٨﴾

“A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli; Ne me të nxjerrim fruta ngjyrash të ndryshme?! E edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe prej njerëzve, gjallesave, dhe kafshëve po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Mirëpo Allahut, prej robërve të Tij, ia kanë frikën vetëm dijetarët. Allahu është mbi gjithçka, është Mëkatfalës.” (Fatir: 27-28)

Të gjitha këto argumente iu drejtuan njeriut, duke kërkuar prej tij të besojë në Zotin Një, ngase Allahu, xh.sh., e krijoi të tillë, duke e veçuar nga gjallesat e tjera, duke i dhënë attribute e cilësi që nuk iu dhuruan krijesave të tjera, e nëpërmjet të cilave njeriu është në gjendje të dallojë të mirën nga e keqja, të marrë përgjegjësinë dhe të përgjigjet për të, t'i pranojë urdhrat e të Madhit Zot, xh.sh., duke i zbatuar ato me përpikëri dhe duke u ndaluar nga haramet (të ndaluarat), gjithëherë me ndjenjën dhe bindjen se për angazhimet e tij do të përgjigjet para Zotit në Ditën e Gjykimit. Nisur nga këto përparësi në raport me krijesat e tjera, Zoti, xh.sh., ia besoi edhe mëkëmbësinë mbi sipërfaqen e Tokës. Prandaj, me të drejtë duhet të mendojmë për rolin, përgjegjësinë dhe obligimet e njeriut, si edhe për urtësinë e krijimit të tij.

Dihet mirëfilli se Zoti, xh.sh., e krijoi njeriun me mundësinë dhe potencialin që ai të jetojë dhe të punojë punë të mira, duke besuar në Zotin Një, duke u larguar nga besimi në shumë zota etj. Pra, Allahu, xh.sh., ia bëri me dije njeriut, në vazhdimësi, se ekziston vetëm një Zot. Allahu, xh.sh., prej të gjitha krijesave në këtë botë, e veçoi njeriun me intelektin e dhuruar, me aftësinë për të gjykuar e perceptuar. Për ta kuptuar këtë më mirë, do të përmendim disa nga ajetet kuranore që flasin rreth kësaj çështjeje. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ﴾

“Vërtet Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.”

(Tinë: 4)

Pastaj ajeti:

﴿أَلَمْ تَرَوْا أَنَّ اللَّهَ سَخَّرَ لَكُمْ مَّا فِي السَّمَاوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ وَأَسْبَغَ عَلَيْكُمْ نِعَمَهُ ظَاهِرَةً وَبَاطِنَةً ۚ وَمِنَ النَّاسِ مَن يُجَادِلُ فِي اللَّهِ بِغَيْرِ عِلْمٍ وَلَا هُدًى وَلَا كِتَابٍ مُّبِينٍ﴾

“A nuk e dini ju se Allahu për të mirën tuaj nënshtroi ç’ka në qiej e ç’ka në Tokë, dhe ndaj jush plotësoi të mirat e Tij të dukshme dhe të fshehta?! E, megjithatë, ka prej njerëzve që polemizojnë çështjen e Allahut duke mos pasur dituri, duke mos qenë të udhëzuar, dhe duke mos pasur libër të ndritshëm.” (Llukman: 20)

Duhet ditur se krijimi është kompetencë vetëm e të Madhit Zot, xh.sh. Ai është Krijuesi i çdo gjëje. Krijimi asnjëherë nuk mund të përkufizohet për Zotin vetëm me krijimin e gjithësisë, por ka të bëjë edhe me të gjitha krijesat që gjenden në të, në qiej, në tokë, në ujë, në ajër etj., duke ditur se në

këtë gjithësi asgjë nuk u krijua pa një qëllim të caktuar. Çdo gjë në krijim i takon Krijuesit të vetëm, Allahut, xh.sh., dhe duhet kuptuar gjithashtu se krijimi nuk guxon të përkufizohet vetëm me krijimin e këtij universi dhe çfarë ka në të, por edhe përtej tij.

Njeriu është krijesë e Zotit, xh.sh., që për dallim prej krijesave të tjera Allahu e veçoi me cilësi, attribute e veçori të shumta të cilat krijesat e tjera nuk i posedojnë. Njeriu me të drejtë konsiderohet se është krijesa më e ditur dhe më e ngritur në Tokë, të cilën Allahu, xh.sh., e krijoi dhe i dhuroi formën më të bukur.

Pra, prej Allahut, xh.sh., asgjë nuk është krijuar shkel e shko, rastësisht a pa qëllim. Çdo gjë ka qëllimin dhe rolin e vet të krijimit. Në pamundësi që t'i kuptojmë këto role e qëllime, kjo nuk na jep assesi të drejtën të refuzojmë, të mos besojmë apo të mos respektojmë tërë atë që i Madhi Zot, xh.sh., ka thënë në Kuranin famëlartë, në lidhje me krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe ç'ka mes tyre. Edhe pse një pjesë e madhe e njerëzve nuk besojnë atë që urdhëron Zoti dhe nuk janë të gatshëm të ndalen e të lexojnë librin e Allahut, xh.sh., për të kuptuar atë që thotë dhe porosit Allahu, kjo assesi nuk e humb apo zbeh vlerën e asaj që porosit dhe na mëson Kurani. Vetë Allahu, xh.sh., përmes Kuranit, na e bën me dije se shumica e njerëzve nuk dinë, nuk besojnë dhe nuk janë të gatshëm ta kthejnë shikimin nga ajo që porosit Ai. Këtë më së miri e përshkruan edhe ajeti në vijim:

﴿وَمَا خَلَقْنَا السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لَاعِبِينَ ﴿٣٨﴾
مَا خَلَقْنَاهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَلَكِنَّ أَكْثَرَهُمْ لَا يَعْلَمُونَ﴾

“Ne nuk i krijuam qiejt dhe Tokën, dhe ç’ka ndërmjet tyre, pa ndonjë qëllim. Por, Ne i krijuam të dyja me qëllim të caktuar, mirëpo shumica e tyre nuk dinë.” (Duhane: 38-39)

Sikur të mos besonim në ringjallje, në dhënien e llogarisë, në shpërblimin dhe ndëshkimin e Zotit, xh.sh., për punën dhe angazhimin tonë në këtë botë, sigurisht se jeta do të ishte e pakuptimtë, dhe një lloj loje dhe zbavitje për njeriun. Mirëpo, i Madhi Zot, xh.sh., çdo gjë e ka krijuar me qëllim, rol dhe përgjegjësi të caktuar.

Krijimi i njeriut të parë, Ademit, a.s.

Nuk ka dyshim se Krijuesi i tërë kësaj ekzistence-gjithësie është i Madhi Zot, xh.sh., i Cili e krijoi atë nga asgjëja. Me këtë kuptojmë se kësaj gjithësie i ka paraprirë mosekzistenca, dhe kjo gjithësi, me tërë çfarë ka në të, bën pjesë në ekzistencën e mundshme, ngase e ka pikënisjen e vet të krijimit, mirëpo edhe të marrjes fund-shkatërrimit të saj.

Allahu, xh.sh., brenda këtij universi krijoi edhe njeriun e parë, apo babanë e njerëzimit, Ademin, a.s., të cilit i ka paraprirë mosekzistenca. Allahu, xh.sh., e ngarkoi Ademin, a.s., me detyrën e pejgamberisë, prandaj Ademi, a.s., është njeriu dhe pejgamberi i parë i Allahut, xh.sh., që frymoi si njeri mbi sipërfaqen e Tokës dhe u ushqye me të mirat e saj.

Ademit, a.s., po edhe të gjithë peygamberëve të tjerë, si dhe popujve të tyre, deri te Muhamedi, a.s., Allahu, xh.sh., u kërkoi që ta besonin dhe ta adhuronin vetëm Atë, ngase askush pos Tij nuk meriton të besohet e të adhurohet. Kjo kërkesë a porosi e Allahut, xh.sh., i shoqëroi të gjithë peygamberët. Kjo porosi ishte edhe e peygamberit të fundit, Muhamedit, a.s., e këtë e kuptojmë përmes librit të shenjtë, Kuranit, që është kryemrekullia e të gjitha mrekullive që Zoti, xh.sh., ua dhuroi peygamberëve të Tij. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿ذَلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ ۖ خَالِقُ كُلِّ شَيْءٍ فَاعْبُدُوهُ ۚ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ وَكِيلٌ﴾

“Ky është Allahu, Zoti juaj. Nuk ka të adhuroar përveç Tij. Krijues i çdo gjëje. Pra, adhurojeni Atë! Ai është Mbikëqyrës ndaj çdo gjëje.” (En’amë: 102)

Pra, i vetmi që meriton të besohet e të adhurohet është Allahu, xh.sh. Ai është Krijuesi i çdo gjëje në këtë univers dhe jashtë tij. Zoti është Krijues edhe i ligjeve që mbretërojnë në këtë gjithësi, ligje që përcaktojnë për çdo krijim (krijesë) hapësirën e veprimit dhe kushteve a ligjeve që Allahu i ka krijuar në mënyrë që të funksionalizohet qëllimi i krijimit.

Këto ligje e rregulla përfshijnë qiejt dhe Tokën, Hënën e Diellin dhe çdo gjë të krijuar, ngase asnjë krijim apo krijesë nuk mund të largohet nga qëllimi dhe roli i krijimit, edhe nëse dëshiron. Edhe njeriu, si krijesa më e përsosur që krijoi Allahu, xh.sh., ka qëllimin e ardhjes së tij në këtë jetë dhe nuk mundet të veprojë jashtë ligjeve të krijuara prej Allahut, xh.sh., edhe nëse dëshiron. Le të mësojmë se kush është njeriu, si u krijuar ai dhe cilat janë detyrat e tij gjatë jetës në këtë

botë! Këtë më së miri mund ta mësojmë përmes ajeteve kur-anore dhe haditheve të Muhamedit, a.s.

Nëse njeriu ndalet dhe i shikon gjërat me syrin e mendjes, angazhon logjikën për të parë e besuar të vërtetën, ai këtë do ta shohë më së miri në veten e tij. Vetë përbërja, roli dhe jeta organike e shpirtërore e njeriut në këtë botë dëshmojnë në vazhdimësi prezencën e Allahut, xh.sh., te vetë njeriu, mirëpo edhe përkujdesjen e Tij të vazhdueshme për këtë gjithësi. Këto vrojtime ia forcojnë njeriut edhe më tepër bindjen se Allahu, xh.sh., është Një, se nuk ka tjetër si Ai, dhe se çdo gjë që ndodh në këtë univers ndodh me lejen dhe vullnetin e Tij absolut.

Kur e kemi parasysh këtë ajet, mësojmë se Allahu, xh.sh., është Krijuesi i çdo gjëje (sendi) në gjithësi, se nuk ka tjetër si Ai, dhe se vetëm Ai meriton të besohet e të adhurohet.

Siç thamë edhe më herët, Allahu, xh.sh., e krijoi njeriun e parë Ademin, a.s., nga dheu (toka), e për këtë argumenton edhe ky ajet kuranor:

﴿وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ سُلَالَةٍ مِّن طِينٍ﴾

“Vërtetë, Ne e krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), dhe një balte!” (Mu’minunë: 12)

Pra, edhe nga ky ajet mësojmë se Zoti, xh.sh., është Krijuesi i njeriut të parë, Ademit, a.s. Vetë krijimi i njeriut, përbërja e tij fiziko-shpirtërore, është argumenti më bindës që njeriu, përmes meditimit të krijimit të vet, të shohë madhështinë, fuqinë dhe dijen e të Madhit Zot. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿وَفِي أَنْفُسِكُمْ أَفَلَا تُبْصِرُونَ﴾

“E edhe në veten tuaj. A nuk po e shihni?!” (Dharijat:

21)

Nëse fillojmë të shkoqisim ajetet 12-14 të kaptinës Mu’minunë, do të shohim se Ai përmend në radhë të parë krijimin e njeriut prej dheut, që do të thotë se është përkufizuar edhe materia prej së cilës është krijuar njeriu, pra balta (dheu).

Dihet se baltë ka gjithkund në Tokë dhe mu kjo i shtyri shkencëtarët që ta analizojnë këtë “baltë”. Pas një analize të thuktë, ata konstatuan se balta përbëhet prej 18 elementeve, e prej tyre: hekur, magnez, fosfor etj. Pastaj u bënë edhe analizat e trupit të njeriut, dhe për habinë e tyre të madhe u konstatua se edhe ai po ashtu përbëhej prej të njëjtave elemente! Ja, kështu erdhi e vërteta e parë, e vërteta që shihet konkretisht, dhe s’mund të ketë më kurrfarë polemike rreth saj.

Këtë madhështi të Zotit, xh.sh., njeriu mund ta shohë në veten e tij, nëse ndalet dhe vështrohet apo analizon vetveten. Në veten tonë do të gjejmë shumë argumente që flasin se asgjë nuk është e krijuar rastësisht, se çdo pjesë e trupit të njeriut i thërret fuqishëm ndërgjegjes së njeriut, që ai ta shohë veten, dhe përmes saj edhe praninë e vazhdueshme të Allahut, xh.sh., të çdo gjë e krijuar. Edhe brendia e trupit tonë, përmbajtja dhe funksionimi, po edhe pamja jonë e jashtme, flet dhe dëshmon në vazhdimësi për Allahun Krijues.

Allahu, xh.sh., e krijoi njeriun, dhe nuk e la atë të vetmuar dhe pa përkujdesje, por bëri që njeriu në vazhdimësi të kënaqet me bindjen dhe adhurimin që i bën Allahut, xh.sh.,

duke gjetur prehje shpirtërore në porositë e Krijuesit Fuqiplotë. Pas kësaj, Kurani fillon përshkrimin e krijimit të njeriut në barkun e nënës:

﴿ثُمَّ جَعَلْنَاهُ نُطْفَةً فِي قَرَارٍ مَّكِينٍ﴾ ﴿١٣﴾ ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا الْمُضْغَةَ عِظَامًا فَكَسَوْنَا الْعِظَامَ لَحْمًا ثُمَّ أَنْشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ ۚ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ﴾

”Pastaj atë (ajkë - baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (farë) në vend të sigurt. Më pas atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, dhe atë copë mishi e shndërruam në eshtra, dhe eshtrave ua veshëm mishin, e pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I Lartë është Allahu, Krijuesi më i mirë!”
(Mu'minunë: 13-14)


Nga ajeti i sipërpërmendur kuptojmë se “*kararin mekin - قرار مكين*”, vend i sigurt, është mitra e nënës, e pastaj vjen çështja e “*alekaten - علقه*” - (copë gjaku). Tani do t’ia lëmë fjalën profesorit të nderuar kanadez Keethy Moor, njërit prej shkencëtarëve më eminentë botërorë në shkencat embriologjike, i cili njëherësh është edhe kryetar i Katedrës së Anatomisë dhe Embriologjisë në Universitetin e Torontos në Kanada, si dhe kryetar i Shoqatës Kanadeze-Amerikane për Hulumtime Embriologjike. (Sharavi: 1997: 155)

Librat e Keethy Moor-it janë përkthyer në më se tetë gjuhë të ndryshme të botës. Është laureat i shpërblimit të parë për librin më të kompletuar në botë rreth shkencës së embriologjisë, “*The developing Human-Zhvillimi i njeriut*”. Ky shpërblim u jepet vetëm atyre njerëzve që vërtet kanë merita

të mëdha dhe kanë arritur rezultate kulminante shkencore. (Sharavi: 1997: 156)

Dr. Keethy Moor thotë: *“Kur embrioni fillon rritjen dhe zhvillimin e tij në barkun e nënës, i përngjan plotësisht shushunjës moçalike.”* Ai këtë e demonstroi edhe praktikisht, duke krahasuar fotografinë e fillimit të zhvillimit të embrionit me shushunjën moçalike, dhe konstatoi se ngjashmëria në mes tyre është fascionuese. (Sharavi: 1997: 156) Kur i thanë prof. Moor-it se në gjuhën arabe fjala *“alekaten - علقه”* do të thotë *“Gjak i ngjizur”* ai mbeti i mahnitur, dhe tha: *“Përshkrimi kuranor i kësaj etape embriologjike, pos saktësisë dhe përshkrimit preciz të formës së jashtme të embrionit, përshkruan po ashtu me një saktësi të pashoqe edhe përbërjen e brendshme të embrionit, ngase në etapën - “alekaten - علقه - gjak i ngjizur (ngurtë)” gjaku mbetet i “robëruar” nëpër dej (damarë) të imtë në formën e gjakut të ngjizur (ngurtë).”* (Sharavi: 1997: 156)

Pastaj, kur vijmë tek etapa e dytë, në fjalët hyjnore Allahu, xh.sh., thotë:



“...e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi...” (Mu'minunë: 14)

Shohim se Kurani edhe këtë etapë e ka përshkruar në mënyrë tejet precize. Kur u krahasua fotografia e bërë në ultrazë e embrionit në etapën *“copë mishi – مضغة - mudgah”*, me një copë balte të ngjeshur dhe me çamçakëzin e përtypur (*mudgah*), ngjashmëria ishte shumë e madhe. Edhe në fotografinë e embrionit, në këtë etapë shiheshin zbrazësi, sikur të ishte

përtypur me dhëmbë. Madje-madje, Allahu, xh.sh., shkoi edhe më larg në përshkrim, kur bëri dallimin ndërmjet pamjes së jashtme të embrionit dhe përbërjes së brendshme të tij. (Sharavi: 1997: 157). Allahu, xh.sh., thotë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِن كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّنَ الْبَيْتِ فَإِنَّا خَلَقْنَاكُمْ مِّن تُرَابٍ ثُمَّ مِّن نُّطْقَةٍ ثُمَّ مِّن عُلُقَةٍ ثُمَّ مِّن مُّضْغَةٍ مُّخَلَّقَةٍ وَغَيْرِ مُخَلَّقَةٍ لِّنَبِّئَنَّ لَكُمْ ۖ وَنُقَرُّ فِي الْأَرْحَامِ مَا نَشَاءُ إِلَىٰ أَجَلٍ مُّسَمًّى ثُمَّ نُخْرِجُكُمْ طِفْلًا ثُمَّ لَتَبْلُغُوا أَشُدَّكُمْ ۖ وَمِنْكُمْ مَّن يُّتَوَفَّىٰ وَمِنْكُمْ مَّن يُّرَدُّ إِلَىٰ أَرْدَلِ الْعُمُرِ لِكَيْلَا يَعْلَمَ مِن بَعْدِ عِلْمٍ شَيْئًا ۚ وَتَرَىٰ الْأَرْضَ هَامِدَةً فَإِذَا أَنزَلْنَا عَلَيْهَا الْمَاءَ اهْتَزَّتْ وَرَبَتْ وَأَنْبَتَتْ مِن كُلِّ زَوْجٍ بَّهِيحٍ ۝

“O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë (mendoni krijimin tuaj qe) Ne ju krijuam nga dheu, pastaj nga uji, pastaj nga një gjak i ngjizur, pastaj nga një si kafshatë mishi, që është krijesë e formuar ose e paformuar, në mënyrë që t’ju sqarojmë. Ndërsa atë që e dëshirojmë Ne, e përqendrojmë në mitër deri në një afat të caktuar, e mandej ju nxjerrim foshnje, dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj. Ka prej jush që vdesin herët, e dikush jeton deri në pleqëri të thellë, sa të mos dijë asgjë nga dija që ka pasur. E ti e sheh tokën e tharë - të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin, ajo gjallërohet, shtohet, dhe nga të gjitha llojet rrit bimë të këndshme.” (Haxh: 5)

Kur embrioni i gjatë 1 cm në barkun e nënës, në këtë etapë مضغة - “mudgah - copë mishi”, analizohet nën thjerrëzën e mikroskopit elektronik, vërehet shumë qartë se disa gjymtyrë

të embrionit kanë filluar të formësohen, e disa të tjera ende jo. Po të thoshte Kurani fisnik vetëm “krijesë e formësuar”, kjo nuk do t’i përgjigjej realitetit, ngase disa pjesë (gjymtyrë) veçse janë të formësuar. Mirëpo përshkrimi kuranor është përshkrimi i vetëm dhe i saktë i kësaj etape. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿ثُمَّ مِنْ عَلَقَةٍ ثُمَّ مِنْ مُضْغَةٍ مُخَلَّقَةٍ وَغَيْرِ مُخَلَّقَةٍ﴾

“...pastaj nga një gjak i ngjizur, pastaj nga një si kafshatë mishi, që është krijesë e formuar ose e paformuar...” (Haxh: 5)

Shkencëtari i mirënjohur kanadez i paraqiti fotografitë e embrionit në të gjitha etapat, fotografi të bëra me aparaturat më bashkëkohore, të cilat u përgjigjeshin plotësisht atyre formave që janë përmendur në Kuran, qysh prej etapave të formësimit të eshtrave dhe mishit, e deri në etapën e fundit - lindjen e foshnjës. (Sharavi: 1997: 158)

Kur profesori Keethy Moor është pyetur se a ka mundësi që i Dërguari i Allahut, xh.sh., t’i ketë njohur këto etapa embriologjike në detaje kaq të imëta, pa ndihmën e mikroskopleve elektronike, tha: “E pamundur dhe e parealizueshme, ngase njerëzimi në atë kohë s’dinte asgjë rreth faktit se embrioni krijohet etapë pas etape”. Madhështia e Kuranit shihet edhe në faktin se të gjitha këto etapa embriologjike i emërtoi me emra të veçantë, të thjeshtë, të kuptueshëm dhe të saktë. Ndërsa, shkenca edhe sot e kësaj dite nuk i ka emrat e përshtatshëm për këto etapa, por ato i ka klasifikuar (përshkruar) me numra të komplikuar dhe mjaft konfuzë. (Sharavi: 1997: 158)

Pas të gjitha këtyre, profesor Moor tha: “Është më se e qartë se këto argumente i kanë ardhur Muhamedit prej Allahut, e kjo edhe më tepër ma përforcon bindjen se Muhamedi është i dërguar i Zotit.”

Profesor Keethy Moor tha: “Unë jam i gatshëm që këto të dhëna kuranore t’i publikoj në botimet e ardhshme të librave të mia”. Kuptimi i ajeteve kuranore, në lidhje me etapat e embriologjike, iu lexua dijetarëve më eminentë botërorë të embriologjisë, dhe asnjëri nuk pati (mori) guximin që t’i mohojë këto të vërteta kuranore, e as të thotë se ka kundërtënie në mes Kuranit dhe të arriturave të fundit shkencore në lëmin e embriologjisë. (Sharavi: 1997: 159)

Ka edhe prej dijetarëve që menduan dhe thanë: “Karakteristikat e trashëgimisë, apo specifikat e programit trashëgimor, gjenden në pikën e spermës së mashkullit, pikë në të cilën përcaktohen detajet se a do të lindë mashkull apo femër, çfarë ngjyre do të kenë sytë e tij, çfarë do të jetë ngjyra e lëkurës, ngjyra e flokëve etj. Pra, karakteristikat dhe cilësitë e njeriut gjenden në pikën e spermës së mashkullit, në një shifër të veçantë e sekrete”. (Sharavi: 1997: 159)

Kur këtyre shkencëtarëve iu lexuan këto ajete, ata mbetën të mahnitur nga ky përshkrim kuranor. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿قُلِّلَ الْإِنْسَانُ مَا أَكْفَرَهُ﴾ ﴿١٧﴾ ﴿مِنْ أَيِّ شَيْءٍ خَلَقَهُ﴾ ﴿١٨﴾
 مِنْ نُطْفَةٍ خَلَقَهُ فَقَدَّرَهُ

***“Qoftë mallkuar njeriu, sa mohues i fortë që është ai!
 Po nga çka e krijoi Ai atë?! Atë e krijoi nga një pikë
 uji, dhe e përgatiti.” (Abese: 17-19)***

Katër mënyrat e krijimit të njeriut

1) Krijimi i Ademit, a.s., njeriut dhe peygamberit të parë, pa baba dhe pa nënë, nga përzierja e dheut të Tokës. Pra, pa bashkimin e gjinisë mashkullore dhe femërore.

2) Krijimi i gjinisë së kundërt, femrës - Havasë, nënës së njerëzimit, nga Ademi, a.s. (nga e njëjta materie që u krijua Ademi, a.s.). Për këtë na tregon edhe Kurani famëlartë:

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً ۚ وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا﴾

“O ju njerëz, kini frikë Zotin tuaj, që ju krijoi prej një vete (njeriu), dhe prej saj krijoi palën (shogën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra! Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përбетoheni; ruajeni farefisën (akraballëkun), se Allahu është Mbikëqyrës mbi ju!” (Nisa: 1)

3) Krijimi i njeriut (lindja) prej femrës, pa bashkimin e gjinive, siç ishte rasti i lindjes së Isait, a.s., prej Merjemes.

4) Krijimi nga bashkimi i dy gjinive, që është edhe ligj i Allahut, xh.sh., dhe mënyra se si të gjithë njerëzit vijnë (lindin) në këtë botë.

Allahu, xh.sh., është Krijuesi i gjithësisë, i njeriut, i gjallesave të llojllojshme, i pemëve, i perimeve, i kafshëve dhe i

çdo lloj krijese. Edhe ligjet që mbretërojnë në këtë ekzistencë janë krijim i Tij. Çdo gjë që ne e shohim apo nuk e shohim, funksionon sipas një rregulli të përcaktuar prej të Madhit Zot, prandaj edhe mbretëron kjo harmoni e pashembullt në këtë gjithësi, harmoni që argumenton dhe flet për Krijuesin Fuqiplotë. Dielli, Hëna, yjet, Toka etj., absolutisht nuk iu nënshtrohen rregullave të njeriut, por ligjeve dhe rregullave që Zoti i krijoi dhe ua caktoi rolin dhe mënyrën e funksionimit, duke mos pasur mundësi asnjëherë të devijojnë rrugën e caktuar.

Njeriu me punën dhe angazhimin e tij ka arritur që t'ia lehtësojë vetes mënyrën e jetesës gjithnjë e më shumë, përmes studimeve dhe zbulimeve shkencore në fushën e teknologjisë etj. Disa shkencëtarë gabojnë rëndë kur pretendojnë se kanë arritur të depërtojnë deri në sekretet më të thella të gjithësisë. E vërteta është se njeriu nuk ka arritur t'i njohë as sekretet e vetvetes, e lëre më të gjithësisë (universit). Për ta vërtetuar këtë, po sjellim një shembull të përditshëm me të cilin ballafaqohet çdo njeri.

Të gjithë jemi dëshmitarë se njeriu sheh kur është në gjumë, edhe pse sytë i ka të mbyllur. Ecën dhe vrapon edhe pse këmbët as që i lëviz në shtrat, flet edhe pse gjuha nuk i lëviz fare, sheh dhe flet me njerëz që kanë vdekur me dhjetëra vite më herët, ose me njerëz që nuk i njeh fare. Shkenca, në këtë kontekst, është plotësisht e heshtur. Asnjë shkencëtar nuk mund të na informojë se në ç'mënyrë njeriu sheh duke qenë fjetur, apo si mund të lëvizë, të flasë e të takohet me njerëz që qysh moti janë shpërngulur në botën tjetër?! (Sharavi: 1997: 114)

Prandaj, edhe çdo përpjekje e shkencëtarëve në këtë aspekt mbetet vetëm supozim.

Gjithësia argumenton ekzistencën dhe besimin në Allahun, xh.sh.

Rreth krijimit të kësaj gjithësie u dhanë mendime të shumta nga hulumtues, shkencëtarë e dijetarë të cilët nuk deshin ta dëgjojnë e as ta besojnë atë që Allahu, xh.sh., shpalli përmes të dërguarve të Tij dhe librave të Tij. Megjithatë, gjatë historisë njerëzore hasim edhe dijetarë e filozofë që kanë studiuar dhe janë mbështetur te logjika dhe arsyeja, duke konstatuar se gjithçka që e rrethon njeriun, me tërë këtë harmoni e kompaktësi, nuk mund të jetë e rastësishme. Të njëjtën gjë na mëson edhe Kurani, pra krijimin e universit nga mosekzistenca, me tërë këtë ekuilibër që mundëson jetën njerëzore mbi sipërfaqen e Tokës, si edhe jetesën e gjallesave të tjera. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿لَا الشَّمْسُ يَنْبَغِي لَهَا أَنْ تُدْرِكَ الْقَمَرَ وَلَا اللَّيْلُ سَابِقُ النَّهَارِ ۚ وَكُلٌّ فِي فَلَكٍ يَسْبَحُونَ﴾

“As Dielli nuk mund ta arrijë Hënë, e as nata para-diten, mirëpo secili noton në orbitën e vet.” (Jasin: 40)

Pra, i gjithë ky precizitet dhe stabilitet në gjithësi argumenton për fuqinë e Allahut, xh.sh.

Allahu i mësoi njeriut Kuranin, i mësoi se ai është libër i shpallur prej Tij dhe ia bëri me dije se Ai është edhe Krijuesi i njeriut, të cilit ia mësoi edhe të folurit. Hëna, Dielli, njeriu, qiejt, toka, uji, bimët, me kryerjen e funksionit për çka janë

krijuar, i bëjnë sexhde (i përulen) vetëm Krijuesit të gjithësisë. Sikur njeriu t'i kthehej vetes, ta shikonte veten e vet, do të bindej në atë që thotë Zoti, xh.sh.

Dielli edhe Hëna, po edhe çdo gjë e krijuar, udhëton drejt caktut që është krijuar, brenda kufirit të vet, duke e kryer detyrën e marrë prej Zotit. As Dielli nuk mund ta arrijë Hënën, e as Hëna Diellin. Assesi nuk mund të takohen, dhe asnjëra nuk mund ta tejkalojë tjetrën. Çdo gjë shkon sipas një llogaritjeje të parapërcaktuar prej Krijuesit të tyre.

Me një fjalë, Kurani na mëson se çdo gjë në këtë gjithësi e kryen detyrën e vet, brenda mundësisë dhe hapësirës që ia ka dhënë Zoti, xh.sh. Pra, çdo gjë në këtë univers udhëton sipas një rregulli të caktuar prej Allahut, xh.sh., dhe çdo gjë e kryen detyrën për çka është krijuar. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿الرَّحْمَنُ﴾ ١ ﴿عَلَّمَ الْقُرْآنَ﴾ ٢ ﴿خَلَقَ الْإِنْسَانَ﴾ ٣ ﴿عَلَّمَهُ﴾
 ﴿الْبَيَانَ﴾ ٤ ﴿الشَّمْسُ وَالْقَمَرُ بِحُسْبَانٍ﴾ ٥ ﴿وَالنَّجْمُ وَالشَّجَرُ﴾
 ﴿يَسْجُدَانِ﴾ ٦ ﴿وَالسَّمَاءَ رَفَعَهَا وَوَضَعَ الْمِيزَانَ﴾

“Rrahmani (Mëshiruesi - Zoti ynë). Ai ia mësoi Kuranin. E krijoi njeriun. Ia mësoi atij të folurit (të shprehurit, të shqiptuarit). Dielli dhe Hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë. Edhe yjet, edhe bimët, i bëjnë përulje (dëshirës së Rrahmanit). Ai e ngriti edhe qiellin, dhe Ai vuri drejtësi.” (Rahman: 1-7)

Allahu e krijoi njeriun dhe ia mësoi Kuranin, duke e dalluar prej krijesave të tjera, ngase vetëm njeriut i ka folur dhe ia ka zbritur shpalljen. Atij ia mësoi të folurit dhe elokuencën e të shprehurit. Dielli dhe Hëna udhëtojnë në vazhdimësi

sipas një rregulli të paracaktuar e shumë preciz, sipas një llogaritjeje të përsosur më herët. Bazuar në këtë udhëtim, njeriut i është mundësuar llogaritja e kohës: ditët, muajt, vitet, e kështu me radhë. Pra, janë vendosur ligje e rregulla sipas të cilave njerëzit do të veprojnë në këtë jetë, po ashtu edhe yjet dhe bimët, si dhe çdo gjë tjetër, i përlënë Allahut, xh.sh. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿لَا الشَّمْسُ يَنْبَغِي لَهَا أَنْ تُدْرِكَ الْقَمَرَ وَلَا اللَّيْلُ سَابِقُ النَّهَارِ ۚ وَكُلٌّ فِي فَلَكٍ يَسْبَحُونَ﴾

“As Dielli nuk mund ta arrijë Hënë, e as nata para-diten, mirëpo secili noton në orbitën e vet.” (Jasin: 40)

Argumente të shumta lëndore flasin mbi ekzistimin e Zotit, mënyrën e krijimit të kësaj gjithësie, kompaktësinë, harmoninë e rregullin e përkryer në mes trupave qiellorë në mbarë universin. Pra, asnjë trup qiellor nuk mund të dalë jashtë rregullit apo udhës që i është caktuar prej Allahut, xh.sh.

Ky rregull i krijuar prej Allahut, xh.sh., do të vazhdojë deri në shkatërrimin e kësaj gjithësie, deri atëherë kur Dielli do të lindë nga perëndimi. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿أَفَلَمْ يَنْظُرُوا إِلَى السَّمَاءِ فَوْقَهُمْ كَيْفَ بَنَيْنَاهَا وَزَيَّنَّاهَا وَمَا لَهَا مِنْ فُرُوجٍ ۖ﴾ ﴿٦﴾ ﴿وَالْأَرْضَ مَدَدْنَاهَا وَأَلْقَيْنَا فِيهَا رَوَاسِيَ وَأَنْبَتْنَا فِيهَا مِنْ كُلِّ زَوْجٍ بَهِيجٍ ۖ﴾ ﴿٧﴾ ﴿تَبَصَّرْهُ وَذَكَرْهُ لِكُلِّ عَبْدٍ مُنِيبٍ﴾

“A nuk shikojnë ata me vëmendje drejt qiellit, se si e kemi ndërtuar atë mbi ta, dhe se si e kemi zbukuruar atë; në të nuk ka ndonjë zbrazëti?! Edhe tokën e kemi shtrirë, dhe në të kemi vendosur kodra përforcuese, si

dhe kemi bërë që në të të mbijnë gjithfarë bimësh të bukura. (I bëmë ashtu) Dëshmi të dukshme, dhe për-kujtuese për secilin njeri që e ka drejtuar mendjen (te Zoti).” (Kaf: 6-8)

Si është e mundur që ata, që nuk i besojnë porositë e Allahut, xh.sh., nuk shohin nga qielli e nuk binden në Zotin Një?! Si nuk e shohin qiellin se si është ndërtuar mbi ta, pa shtylla, pa të çara (zbrazësi), si është zbukuruar qielli me yje të krijuar, që në veçanti shihen natën, dhe që ia shtojnë edhe më bukurinë e madhështinë këtij universi që në vazhdimësi është i hapur për ta lexuar e kuptuar Allahun Krijues?!

Allahu, xh.sh., thotë se edhe tokën, mbi të cilën jetojnë njerëzit, e ka shtruar para syve të tyre, e në të ka male e kodra të shumta, toka të pëlleshme nga e cila mbijnë lloj-lloj bimësh të bukura e të ndryshme, në formë, aromë, ngjyra të ndryshme. Krejt kjo që çdonjëri prej njerëzve të shohë dhe të besojë në Allahun Një. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿أَأَنْتُمْ أَشَدُّ خُلُقًا أَمْ السَّمَاءُ ۚ بَنَاهَا﴾ ﴿٢٧﴾ رَفَعَ سَمَكَهَا فَسَوَّاهَا
﴿٢٨﴾ وَأَعْطَشَ لَيْلَهَا وَأَخْرَجَ ضُحَاهَا ﴿٢٩﴾ وَالْأَرْضَ بَعْدَ
ذَلِكَ دَحَاهَا ﴿٣٠﴾

“A është më i rëndë krijimi juaj, apo ai i qiellit?! E Ai e ngriti atë. E ngriti kupën e tij, dhe e përsosi atë. Natën ia errësoi, e ditën ia ndriçoi. E pastaj tokën e she-shoi.” (Naziat: 27-30)

Kur njeriu e krahason veten me qiellin apo universin, kuptohet se kjo nuk do koment, si nga madhësia, roli, pozita, ndërlikshmëria etj. Duhet ditur dhe kuptuar se për Zotin nuk

ka asgjë të vështirë, por logjikisht për ne është në pyetje se, a thua cila është më e vështirë: krijimi, apo rikrijimi i njeriut, ringjallja e tij, apo krijimi i qiejve dhe Tokës?! Çdo ditë e shohim se si Allahu, xh.sh., e ka ngritur qiellin lart, dhe si e ka ngritur dhe e ka përsosur kupën e tij. Derisa netët i ka bërë të errëta, ditët i ka bërë të ndritshme!

Këtë të vërtetë që e mësojmë nga Kurani famëlartë e pranojnë edhe shumë shkencëtarë të njohur, themelues të astronomisë moderne. Emrat si Galileu, Kepler, Njutoni etj., duke zbuluar strukturën e ndërtimit të universit, projektimin e sistemit diellor, ligjet e fizikës, e kanë kuptuar më së miri se të gjitha këto janë të krijuara prej Zotit. (Jahja: 2007: 10)

Disa studiues dhe dijetarë të tjerë, që mohojnë mundësinë e krijimit të kësaj gjithësie prej Zotit nga mosekzistenca, thonë se materia ekziston qysh në infinit. Kështu ata mohojnë mundësinë se gjithësia është krijuar me një qëllim apo program të caktuar, dhe përpiqen të dëshmojnë se edhe harmonia dhe kompaktësia në këtë univers janë të rastësishme, dhe se materia është shpikëse e çdo gjëje.

Kurani e thërret mendjen e njeriut që të bindet në Njëshmërinë e Allahut, xh.sh., edhe përmes shikimit e studimit të qiejve dhe të Tokës, dhe të gjithçkaje që gjendet në këtë gjithësi. Nga kjo mësojmë se Islami nuk është fe dogmatike e as mitologjike, por fe e shpallur prej Allahut, xh.sh., tek të zgjedhurit e Tij. Kurani thërret që të hulumtohet gjithësia, toka e nëntoka, detet e lumenjtë, sepse duke i studiuar këto për të cilat na fton Allahu, xh.sh., bindemi edhe më shumë në Njëshmërinë e Tij, bindemi se Ai është Krijuesi i Vetëm i çdo gjëje në këtë gjithësi, pra edhe i njeriut. Megjithatë materiali-

zmi, apo teoria e mendimit materialist mbi krijimin e kësaj gjithësie, që deri në shekullin XIX ishte tezë (vizion shkencor), në shekullin XX pësoi rënien e saj përfundimtare, duke u bazuar në të arriturat shkencore.

Në vijim po paraqesim mendimin e materialistëve, të cilët thonë:

Universi (gjithësia) ekziston që nga pafundësia, pra nuk ka as fillim as fund, dhe ai nuk është i krijuar. Çdo gjë në univers, thjesht, është fryt i rastësisë, dhe jo plan apo projektim me një vizion të qëllimtë. (Jahja: 2007: 11)

Kurani, libri i fundit i zbritur prej të Madhit Zot, xh.sh., te Muhamedi, a.s., drejtuar mbarë njerëzimit, nuk ka pësuar kurrfarë ndryshimi qysh prej 14 shekujve. Po, Kurani na mëson për krijimin e kësaj ekzistence nga mosekzistenca, mësim që është në përputhshmëri të plotë me zbulimet shkencore të shekullit XX. Allahu, xh.sh., në Kuran thotë:

﴿بَدِيعُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ أَلَيْسَ يَكُونُ لَهُ وَلَدٌ وَلَمْ تَكُنْ لَهُ صَاحِبَةٌ ۚ وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ ۚ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ﴾

“Ai (Allahu) është që krijoi (pa kurrfarë shembulli) qiejt dhe Tokën, e si do të ketë Ai fëmijë kur nuk pati bashkëshorte?! Çdo gjë e krijoi Ai, dhe është më i Dijshmi për të gjitha gjërat e krijuara.” (En’amë: 101)

Nga kjo mësojmë se universi u krijua nga asgjëja, dhe se teoria apo mendimi materialist përjashtohet përfundimisht përmes shpalljes dhe librave të shenjtë. Kjo teori përjashtuese dhe e pabazuar hidhet edhe nga vetë shkenca. Këtë e vërteton edhe Gai Marci, shkencëtari amerikan që në raport me materien thotë: “...*Mbas materies fshihet diçka tjetër, që në*

një mënyrë e kontrollon atë. Dhe kjo mund të thuhet se është një lloj argumenti i shkencës matematikore të një krijuesi”.

Para fillimit, para krijimit të Tokës e të qiejve, para krijimit të melekëve, të xhindeve, dhe të njerëzve, atëherë kur nuk ekzistonte koha dhe asgjë tjetër përveç Allahut, ishte dëshira e Tij që ta krijonte këtë gjithësi që ne sot e shohim. Është Allahu Ai që, me dëshirën, diturinë dhe forcën e Tij, e krijoi këtë ekzistencë nga asgjëja, pa kurrfarë modeli para-prak. Pra, Allahu, xh.sh., me fjalën e Tij “Bëhu!”, është shpikës i kësaj gjithësie, dhe Ai do ta mbikëqyrë e do ta sundojë atë në mënyrë precize, deri në ditën kur do ta shkatërrojë. (Gërguri: 2015: 115)

Siç po shihet edhe nga kjo, Allahu, xh.sh., nuk krijoi asgjë të rastësishme, por me kompetencë absolute e mbikëqyr dhe e drejton çdo proces në këtë ekzistencë. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿وَمَا خَلَقْنَا السَّمَاءَ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لَاعِبِينَ ﴿١٦﴾ لَوْ أَرَدْنَا أَنْ نَتَّخِذَ لَهُوًا لَاتَّخَذْنَاهُ مِنْ لَدُنَّا إِنْ كُنَّا فَاعِلِينَ ﴿١٧﴾ بَلْ نَقْذِفُ بِالْحَقِّ عَلَى الْبَاطِلِ فَيَدْمَغُهُ فَإِذَا هُوَ زَاهِقٌ وَلَكُمْ الْوَيْلُ مِمَّا تَصِفُونَ ﴿١٨﴾ وَلَهُ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۚ وَمَنْ عِنْدَهُ لَا يَسْتَكْبِرُونَ عَنْ عِبَادَتِهِ وَلَا يَسْتَحْسِرُونَ ﴿١٩﴾ يُسَبِّحُونَ اللَّيْلَ وَالنَّهَارَ لَا يَفْتُرُونَ ﴿٢٠﴾ أَمْ اتَّخَذُوا آلِهَةً مِنَ الْأَرْضِ هُمْ يُنْشِرُونَ ﴿٢١﴾ لَوْ كَانَ فِيهِمَا آلِهَةٌ إِلَّا اللَّهُ لَفَسَدَتَا ۚ فَسُبْحَانَ

اللَّهُ رَبُّ الْعَرْشِ عَمَّا يَصِفُونَ ﴿٢٢﴾ لَا يُسْأَلُ عَمَّا يَفْعَلُ وَهُمْ يُسْأَلُونَ ﴿٢٣﴾

“Ne nuk e krijuam qiellin, Tokën dhe çdo gjë që është mes tyre shkel e shko (pa qëllim të caktuar). Sikur të kishim dashur të zbavitemi, dhe sikur të donim ta bënim atë, Ne do të zbaviteshim në kompetencën Tonë, mirëpo nuk e bëmë. Përkundrazi, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën, dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të, dhe ajo (gënjeshtria) zhduket. E juve (jobesimtarëve) për shkak të asaj që ia përshkruani (Zotit, pra fëmijë etj.), ju takon shkatërrimi. Vetëm e Tij është çdo gjë që është në qiej e në Tokë! E ata që janë pranë Tij (melekët), nuk shprehin mendjemadhësi në adhurimin ndaj Tij, e as nuk u bëhet monoton (ibadeti). Ata e lartësojnë (Allahun) natën e ditën, dhe nuk mërzhiten. A mos morën ata zota nga Toka, e që mund t’i ringjallin (të vdekurit)?! Sikur të kishte në to (në qiej e në Tokë) zota përveç Allahut, ato të dyja do të shkatërroheshin. Larg asaj që ia përshkruajnë është Allahu, Zoti i Arshit. Ai nuk pyetet se çka punon, mirëpo ata (njerëzit) pyeten.” (Enbija: 16-23)

Allahu, xh.sh., me të drejtë kërkon prej njeriut që ta kthejë shikimin nga vetja e tij dhe nga universi, ta përdorë intelektin dhe të menduarit në mënyrën më të drejtë, për t’i parë të gjitha ato argumente të shumta që flasin mbi Allahun Krijues. Njeriu, duke studiuar edhe vetë konstruktin e tij fizik, do të bindet në ekzistencën e Krijuesit Fuqiplotë. Po të nise mi nga vetja, në çdo hap do ta vërejmë prezencën e Fuqiplotë

otit në veten tonë, argumentet e Allahut, xh.sh., krijimet e mrekullueshme, llojlojshmërinë në krijim, përmbajtje, formë, sasi, ngjyrë etj.

Po ta shikojmë tokën nga e cila mbijnë bimët, pemët dhe perimet me forma, pamje e ngjyra të shumta e të ndryshme, do të bindemi se edhe ky është një prej argumenteve lëndore që argumentojnë mbi Krijuesin e kësaj gjithësie.

Ngjyra e një luleje, apo zëri i një zogu, apo i çfarëdo krijese tjetër, harmonia, ndërthurja delikate e tyre, ngjyrat e gjallesave në brendësinë e detit, kupa e qiellit, aroma e pemëve, shijet e tyre, format etj., të cilat kur i shikojmë na japin kënaqësi, qetësi shpirtërore, pushim të mendjes, të shqisave, që të gjitha këto, dhe shumë argumente të tjera flasin për përsosmërinë e Krijuesit.

Në Kuran Allahu, xh.sh., na njofton për krijimin mahnitës të ekzistencës, duke na bërë me dije se besimtari përmes këtyre mrekullive vazhdimisht nxjerr apo reflekton ndjenjën e të menduarit drejt në raport me krijesat në këtë univers.

Asgjë nuk u krijua shkel e shko, dhe çdo gjë, pavarësisht formës, llojit, rolit, madhësisë, obligimit, kohës, është e krijuar dhe kryen funksionin për qëllimin që është krijuar, dhe asgjë nuk mund të dalë jashtë rolit dhe qëllimit për çka është krijuar.

Manifestimin e fuqisë absolute të Allahut, xh.sh., mund ta shohim, prekim, nuhasim, studiojmë te çdo krijesë e Allahut, xh.sh. Këtë manifestim, me theks të veçantë, e gjejmë në veten tonë, si dhe për çdo ditë e hasim edhe në proceset natyrore. Ne shohim dhe dëgjojmë për kushte të ndryshme klimatike nëpër botë. Diku bie shi, diku bie borë, diku nxeh

dielli, diku fryn erë, diku është ftohtë dhe ka ngrica etj. Këto procese i vërejmë edhe te bimët që mbijnë nga toka, me ngjyrën, aromën dhe formën specifike. Të gjitha këto flasin për prezencën e vazhdueshme të fuqisë, të dijes e të dëshirës absolute të Allahut, xh.sh., në këto procese natyrore, duke përfshirë këtu edhe çdo gjallesë që jeton në këtë gjithësi, me rolin, formën, madhësinë dhe fuqinë që posedon. Kjo na vë në dijeni se vetëm Allahu, xh.sh., është kompetent, dhe se Ai përkujdeset dhe vështrohet me kompetencë absolute çdo gjë në këtë gjithësi. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿أَلَمْ تَرَ أَنَّ اللَّهَ أَنْزَلَ مِنَ السَّمَاءِ مَاءً فَأَخْرَجْنَا بِهِ ثَمَرَاتٍ مُخْتَلِفًا
أَلْوَانُهَا ۚ وَمِنَ الْجِبَالِ جُدَدٌ بَيَضٌ وَحُمْرٌ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهَا وَغَرَابِيبُ
سُودٌ﴾ ﴿٢٧﴾ وَمِنَ النَّاسِ وَالْدَّوَابِّ وَالْأَنْعَامِ مُخْتَلِفٌ أَلْوَانُهُ
كَذَلِكَ ۚ إِنَّمَا يَخْشَى اللَّهَ مِنْ عِبَادِهِ الْعُلَمَاءُ ۗ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ غَفُورٌ
﴿٢٨﴾ إِنَّ الَّذِينَ يَتْلُونَ كِتَابَ اللَّهِ وَأَقَامُوا الصَّلَاةَ وَأَنْفَقُوا مِمَّا
رَزَقْنَاهُمْ سِرًّا وَعَلَانِيَةً يَرْجُونَ تِجَارَةً لَّنْ تَبُورَ﴾

“A nuk e sheh se Allahu lëshon ujë nga qielli; Ne me të nxjerrim fruta ngjyrash të ndryshme?! E edhe nëpër kodra ka vija të bardha e të kuqe ngjyrash të ndryshme, e ka edhe shumë të zeza. Edhe prej njerëzve, gjallesave, dhe kafshëve po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Mirëpo Allahut, prej robërve të Tij, ia kanë frikën vetëm dijetarët. Allahu është mbi gjithçka, është Mëkatfalës. Ata që e lexojnë Librin e Allahut, e falin namazin, dhe nga begatitë që ua kemi dhënë japin

fshehtazi dhe haptazi, ata e shpresojnë një fitim që kurrë nuk humbet.” (Fatir: 27-29)

Fuqia dhe përpikëria e Krijuesit duket në çdo krijesë në gjithësi, siç është uji që i jep jetë çdo bime a gjallese. Bimët ujiten me të njëjtin ujë që bie nga qielli, mirëpo neve na ofrojnë ngjyra, aroma, e shije të ndryshme. Ky ndryshim vërehet edhe te njerëzit, te kafshët, te gjallesat e tjera, si edhe te shtresat e tokës.

Llojllojshmëria e ushqimit si argument mbi ekzistimin e Zotit, xh.sh.

Edhe më herët përmendëm se njeriu është krijesa më e ngritur, më e ndritur dhe më e ditur. I Madhi Zot, xh.sh., ia dhuroi jetën njeriut duke i dhënë shpirt dhe e bëri atë një krijesë organike, që ka nevojë për ushqim e pije për të jetuar. Allahu, xh.sh., krijoi edhe për njeriun lloje të shumta ushqimesh e pijesh, që janë të domosdoshme për mbijetesën e njeriut dhe të gjallesave të tjera. Pa dyshim se llojllojshmëria e ushqimeve dhe e frutave, me shije e aroma të ndryshme, është shenjë e mëshirës së Allahut, xh.sh., për krijesat në përgjithësi, e sidomos për krijesën më të përsosur në veçanti, e cila mban edhe përgjegjësinë dhe së cilës i takon mëkëmbësia mbi sipërfaqen e Tokës. Pra, nga dheu mbijnë fruta me ngjyra të ndryshme dhe aroma të llojllojshme, të pastra e të gatshme për t’u ushqyer me to, dhe secila prej tyre është me shije të veçantë. Kjo është një mirësi që Allahu, xh.sh., ua ka dhuruar njerëzve. Prandaj, njeriu është i thirrur të mendojë për këtë dhe të bindet në Zotin Një. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿اللَّهُ الَّذِي جَعَلَ لَكُمُ الْأَرْضَ قَرَارًا وَالسَّمَاءَ بِنَاءً وَصَوَّرَكُمُ
فَأَحْسَنَ صُورَكُمْ وَرَزَقَكُم مِّنَ الطَّيِّبَاتِ ۚ ذَلِكُمُ اللَّهُ رَبُّكُمْ ۖ فَتَبَارَكَ
اللَّهُ رَبُّ الْعَالَمِينَ﴾

***“Allahu është Ai që jua bëri tokën vendbanim e qiellin
kulm, si dhe ju formësoi, e formën tuaj e bëri më të
mirën, dhe ju pajisi me të mira. Ky është Allahu, Zoti
juaj. I Lartë është Allahu, Zoti i botëve!” (Gafir: 64)***

Nga e tërë kjo që u përmend deri më tash, mësojmë se Allahu, xh.sh., ka sjellë, si në qiej ashtu edhe në Tokë, argumente të shumta që vërtetojnë Njeshmërinë e Tij. Disa prej këtyre argumenteve i shohim, i prekim dhe i kuptojmë, e disa i shohim po nuk kemi mundësi t’i kuptojmë tërësisht, kështu që shumë argumente që vërtetojnë mbi Krijuesin e kësaj gjithësie mbesin jashtë perimetrit të njohurive tona.

Nuk mund të ketë kundërthënie mes Kuranit dhe shkencës

Kurani është libri i fundit hyjnor i zbritur prej të Madhit Zot, xh.sh., përmes melekut të shpalljeve, Xhibrilit, deri te pejgamberi i fundit, Muhamedi, a.s., dhe është përfshirës apo përmbledhës i tërë shpalljeve hyjnore të të gjithë pejgamberëve. Me zbritjen e tij pushuan së vlejture urdhrat apo ligjet e librave të tjerë të zbritur te pejgamberët e mëparshëm.

Kurani, që i është dedikuar mbarë njerëzimit, assesi nuk bie ndesh me të arriturat shkencore. Kundërthënia mund të vijë në shprehje vetëm atëherë kur nuk studiohet e shpjegohet siç duhet e vërteta kuranore, apo kur ajo qëllimisht devi-

johet prej kundërshtarëve të Islamit, apo kur ajo komentohet jo drejt prej disa besimtarëve islamë të cilët nuk janë kompetentë për ta shpjeguar e komentuar Kuranin. Urdhrat dhe porositë kuranore mund të bien ndesh me të arriturat shkencore edhe atëherë kur teoritë shkencore, që janë prodhim i angazhimit të mendjes njerëzore, nuk janë të sakta. Për të kuptuar sa më mirë porositë e Allahut, xh.sh., po sjellim argumentin mbi rrotullimin dhe lëvizjen e Tokës.

Toka, ndryshe nga gjithë trupat e tjerë qiellorë që njihen, zotëron një atmosferë, temperaturë dhe sipërfaqe të përshtatshme për jetën. Në trupat e tjerë qiellorë, të paktën deri më sot të njohur, nuk ka shenja uji, element parësor për jetën. Ndërsa në Tokë $\frac{3}{4}$ e saj janë të mbuluara me ujë. (Jahja, 2007: 84)

Toka është e krijuar me të gjitha paramasat programore të saj për të kryer misionin për të cilin është krijuar. Toka, po të ishte pak më e madhe apo më e vogël, apo paksa më ndryshe nga relievi që ka, nuk do të mund ta kryente misionin që ia ka caktuar i Madhi Zot, xh.sh. Mirëpo, krijimi i Tokës, si edhe krijimi i planetëve e i trupave të tjerë qiellorë, është i përkryer prej Allahut, xh.sh., prandaj edhe ekziston kjo harmoni mes tyre. Nëse dëshirojmë të mësojmë mbi rrotullimin dhe lëvizjen e Tokës rreth boshtit të saj, patjetër duhet të shërbehemi me fjalët e të Madhit Zot, të zbritura në Kuranin famëlartë. Allahu, xh.sh., thotë:

﴿وَتَرَى الْجِبَالَ تَحْسِبُهَا جَامِدَةً وَهِيَ تَمُرُّ مَرَّ السَّحَابِ ۖ صُنْعَ اللَّهِ الَّذِي أَتَقَنَ كُلَّ شَيْءٍ ۖ إِنَّهُ خَبِيرٌ بِمَا تَفْعَلُونَ﴾

“E i sheh kodrat, dhe mendon se ato janë të palëvizshme, ndërsa ato lëvizin si retë. (Kjo është) Mjeshtëri e

Allahut që përsosi çdo send, e Ai është hollësisht i in-formuar se çka punoni.” (Neml: 88)


Sa e sa dijetarë e njerëz të pafajshëm u ekzekutuan, u keqtrajtuan dhe u burgosën në Mesjetë prej prijatarëve kish-tarë, të cilët nga kryeneçësia e tyre nuk dëshironin të merrnin mësim nga Kurani, në të cilin çdo gjë ishte e qartësuar lidhur me lëvizjen e Tokës. Sikur ta kishin lexuar me kohë, do ta kishin kuptuar se Toka sillet rreth Diellit dhe rreth bo-shtit të saj. Këtë e kuptojmë edhe nga ajeti që cituam më he-rët, si dhe nga shumë ajete të tjera.

Dija e të Madhit Zot, xh.sh., është e pakufishme dhe e pa-arritshme. Ajo është e përsosur dhe e pakufizuar. I Madhi Zot, xh.sh., ia dhuroi njeriut mundësinë e të mësuarit, e të ar-simuarit. Allahu, xh.sh., para 14 shekujve na ka treguar se kur i shikojmë kodrat që gjenden para nesh, ato na duken të palëvizshme dhe stabile. Këtë na e thotë ajeti kuranor nga su-reja Neml, ku Allahu, xh.sh., thotë:

﴿وَتَرَى الْجِبَالَ تَحْسَبُهَا جَامِدًا﴾

“i sheh kodrat dhe mendon se ato janë të palëvizsh-me...” (Neml: 88)

Nga kjo mësojmë se ne i shohim kodrat me një pamje joreale. Këtu ekziston diçka që Allahu, xh.sh., e ka krijuar mirëpo ne nuk e shohim me sytë tanë, e kjo është lëvizja e tyre. Ashtu siç nuk e shohim se si sillet Toka rreth boshtit të vet. Pra, Allahu, xh.sh., na e ka bërë të mundur që të shohim diçka në formën e saj joreale. Në anën tjetër, Allahu, xh.sh., na e bën me dije se këto kodra stabile lëvizin ashtu siç lëvi-zin retë:



“....ndërsa ato lëvizin si retë.” (Neml: 88)

Me këtë ajet Allahu, xh.sh., na bën me dije se as kodrat, sikurse edhe retë, nuk kanë forcë vetjake lëvizëse. Është e ditur se kodrat gjenden mbi sipërfaqen e Tokës, dhe nuk ka kurrfarë force që mund t’i lëvizë ato, përpos nëse Toka lëviz, e me të lëvizin edhe kodrat që gjenden mbi të. Kështu, kodrat që ne i shohim si stabile e të palëvizshme, në realitet lëvizin, ngase Toka lëviz rreth boshtit të vet. E, kodrat janë pjesë e Tokës, dhe lëvizin gjithashtu së bashku me të, mu ashtu siç lëvizin edhe retë nga erërat.

Si përfundim mund të themi se kjo gjithësi është përplot me argumente shkencore që argumentojnë për ekzistimin e Zotit, xh.sh. Shkenca nuk është gjë tjetër përveçse zbuluese e fuqisë së Allahut, xh.sh., në këtë univers.

H. Sherif ef. AHMETI

FE DO TË THOTË: BESIM DHE VEPRIM*

Në themel, feja bazohet në besimin ndaj çështjeve sekrete. Besimi, sipas mësimave të Pejgamberit, përqendrohet në këto gjatë të vërteta: në Zotin, melaiket, librat, pejgamberët, Ditën e Mbramë dhe në kader.

Kur mendja është e bindur, zemra i përvetëson dhe ndërgjegjja i pranon këto gashtë shtylla kryesore, atëherë për këtë lidhshmëri të ruajtur në zemrën e njeriut, rrjedhë shprehja: “el akidetu, akaïd”, ideologji, dogmatikë etj.. Nëse vërtetimi i këtyre gjashtë shtyllave është bindje e fortë dhe në mënyrë të prerë, bindje në të cilën nuk i mbetet vend kurrfarë dyshimi a luhatjeje, ai është *besim - iman*. E nëse vërtetimi ndaj këtyre shtyllave është në mënyrën sipërfaqësore, ai nuk është besim dhe nuk mund të quhet iman. Mirëpo, për besimin, ose për atë se çka i fle njeriut në gjoksin e tij, është e pamundur të di dikush tjetër përveç Zotit xh. sh., andaj besimi i tjetrit, për ne si njerëz, është çështje sekrete.

* Marrë nga “Takvim 1400, Kaledari 1980”.

Besimi - imani pra, është tërësi e pandarë, që do të thotë: *besim në tërësi ose mosbesim*. Ai që beson Zotin, melaiket, librat, kaderin dhe nuk beson Ditën e Mbramë ose nuk beson një nga peygamberët, nuk është besimtar. Në këto çështje të besimit nuk ka ndonjë mes, nuk ka hamendje, luhatje a dyshim, në cilëndo qoftë prej tyre. Ai ose është besim i plotë dhe i pa luhatur ose nuk është fare besim.

Rrugët për pranimin ose vërtetimin e një çështjeje a sendi në mënyrë të bindshme kanë burimet e tyre të caktuara, të cilat meritojnë respekt dhe nuk duhet kaluar përtej atyre burimeve.

Kur njeriu është burim i njohurive, ato duhet të burojnë prej logjikës dhe arsyes së provuar, janë të pranuar pas një vërtetimi të provuar në mënyrë konkrete, f. v. njohuritë e përfituara nga studimi ndaj gjithësisë, jetës dhe çështjeve të një-rëzve, ndaj botës materiale në përgjithësi. Këto njohuri të vërtetuara, duhet respektuar dhe nuk ka nevojë të kërkohet ndonjë burim tjetër jashtë logjikës dhe arsyes së provuar të njeriut.

E kur njohuritë kanë të bëjnë me çështjet jashtë botës materiale - çështje të cilat nuk i arrin logjika dhe arsyeja e provuar, e vetmja rrugë dhe i vetmi burim për ato është *vahji i vërtetë* (shpallja) e asgjë tjetër. Nga kjo rezulton se të gjitha thëniet për Zotin, për cilësitë e Tij dhe çështjeve tjera sekrete, siç i përmendëm më lartë, nuk duhet mbështetur në tjetër, por vetëm në atë që na e solli gjuha e peygamberit.

E për këto çështje të besimit, peygamberët na lanë rrugë të ndritshme dhe të qartë.

Të gjithë pejgamberët, edhe pse në vende të largëta prej njeri-tjetrit, në kohëra të ndryshme, me fjalor të llojllojshëm, me ligje dhe rrugë të posaçme të jetës së tyre, i gjejmë të mishëruara në një ide, në një qëllim dhe në një rrugë të besimit në të cilën ata e thirrën popullin. Themelet e fesë ishin të gjithë pejgamberët dhe nuk ka mundur të lajmërohet as kundërthënia më e vogël mes tyre. Të gjithë patën një fe, e që ishte bindje e fortë dhe e plotë në këto gjashtë shtylla themele. Çdo pejgamber është dërguar për të njëjtën fe. Për këtë unitet të misionit të çdo pejgamberi na flet Kurani:

شَرَعَ لَكُمْ مِنَ الدِّينِ مَا وَصَّى بِهِ نُوحًا وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ وَمَا وَصَّيْنَا بِهِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَى وَعِيسَى أَنْ أَقِيمُوا الدِّينَ وَلَا تَتَفَرَّقُوا فِيهِ...

“Ligjet dhe rrugën e fesë e keni në porositë që ia bëmë Nuhut, në këto që të frymëzuam ty (Muhamed), në porositë që ia bëmë Ibrahimit, Musait dhe Isait që të përqendroheni në këtë fe unike e të mos ndaheni.” (Esh-Shura, 13)

Kështu qëndron puna e besimit në këto gjashtë shtylla prej pejgamberit të parë e deri tek i fundit. Ndërsa, sa i përket anës së ligjshmërisë-sheriatit dhe veprimtarive të tjera, nuk ishin të njëjta ndër gjithë ata, sepse, siç është e ditur, udhëzimet e fesë nuk janë gjë tjetër vetëm se ilaç shërues për ato sëmundje që ishin lajmëruar mes atij populli ose bashkësie, andaj edhe sheriatu duhej të jetë i tillë që të ruajë lehtësimin e atij populli të cilit i drejtohej dhe të çmojë kushtet në të cilat jetonte. Megjithatë, edhe pse duket që në ligje - sheriat kanë

pasur ndryshime, në të vërtetë baza e atyre sherieve gjithnjë ka qenë e njëjtë. Për shembull, namazi ose agjërimi kanë qenë të paraparë në çdo shariat, madje esenca e marrëdhënieve ndër njerëzore, si: besnikëria, drejtësia, mos tradhtia, bazat e moralit, si: butësia, bujaria, sakrifica për tjetrin etj., kanë ekzistuar në çdo shariat si bazë e këtyre veprimtarive, e ndryshimi ka mundur të jetë vetëm një formë, trajtë, mënyrë etj.

Edhe filozofët e dijetarët prej një kohe shumë të gjatë janë përpjekur dhe kanë dhënë kontributin e duhur në njohjen e botës materiale. Arritjet e tyre si njohuri të sakta janë pranuar vetëm pas një vërtetimi në mënyrë të provuar. Ata folën edhe për botën jo materiale, por asnjëherë nuk qenë unikë në thëniet e tyre, patën mendime e ide të llojllojshme dhe fjalët e tyre të kundërta mes njëri-tjetrit nuk u lanë tjetër pasardhësve të tyre vetëm se huti e mjegulli. Nëse lexojmë filozofinë hinduse, romake, greke etj., dhe mënyrën e filozofimit të hershëm të tyre dhe të filozofimit të tashëm, do të gjejmë se asnjëherë nuk arritën të kalojnë kufijtë e dyshimit për të arritur deri tek e vërteta. Me hipotezat e tyre iu afruan ndonjëherë të vërtetës, por ajo e vërtetë gjithnjë ishte e turbullt, e derisa ishin larg *vajit*, pasardhësve për trashëgim ju lanë vetëm kundërthënie të cilat ende vazhdojnë, kur është fjala për njohuri jashtë botës materiale.

Prandaj, për njohuritë shpirtërore nuk pranojmë asgjë tjetër nga kushdo qoftë, vetëm atë që na e sollën gjuhët e pejgamberëve të cilën me logjikën tonë materiale e vërtetojmë, e pranojmë dhe e shatojmë në mendjen dhe zemrën tonë, ose ne besuam për atë që na sollën pejgamberët se është prej Zotit, dhe çka vjen prej Zotit ajo është e vërtetë.

Besimi në Zotin xh.sh.

Kurani e konsideron besimin në Zot gjë të natyrshme dhe të lindur pasi që shpirtat janë të pajisur me këtë ndjesi.

... أَفِي اللَّهِ شَكٌّ فَاطِرِ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ...

“A ka dyshim për Zotin. krijues i qiellit dhe i tokës...”

(Ibrahim, 10)

Çështja e besimit në Zotin është një nga çështjet më të qarta, sepse nga vetë natyrshmëria e lindur njeriu është i prirë t’i drejtohet Krijuesit, kjo nuk është çështje e cila arrihet pas një mendimi e studimi të thellë. Dr Ahmet Emini, thotë: “Çdo njeri është i prirë nga vetë natyra e tij për ekzistimin e Krijuesit. Në këtë pikëpamje janë kompaktë të gjithë njerëzit edhe ose emrat dhe cilësitë e Zotit ndryshojnë ndër ta. Gjithashtu, në këtë çështje janë të barabartë ata me dituri më të ulët me ata që kanë një dituri shumë të lartë.”

Dijetari i shquar, Abas Akadi, ndërkaq, thotë: “Nëse i kthehemi historisë së njerëzimit, do të vërtetojmë se ndër njerëz ai, besimi, është me shumicë të madhe prirje natyrore, e krejt pak në bazë të një studimi mendor.”

Pra, njerëzit besuan para se t’i njohin argumentet. Filozofia thotë: ekzistenca e gjithësisë argumenton ekzistencën e shpikësit të saj.

Qëllimi i njohjes së Zotit ka ekzistuar edhe në të gjitha fetë e rrejshme, por duke mos iu përmbajtur rrugës së drejtë të cilën e trasuan pejgamberët ndër to, Zotin e gjejmë në forma të ndryshme, herë si njeri, por shumë i fuqishëm, e ndonjëherë si ndonjë gjallesë tjetër, ndonjë bimë etj. Mirë thotë një mutesavif (mistikë): “Mos me qenë që paraqitja shumë e

fortë shkakton fshehjen e atij paraqitësi dhe afrimi i tepërt paralizon shikimin, nuk do të kishte njeri që nuk do të pranonte dhe besonte.”

Çdo përpjekje për njohjen e vetë qenies, personalitetit të Zotit është e dëmshme, sepse mendja e njeriut gjithnjë do të parafytyrojë me ndonjë gjë që e ka të njohur, e Zoti nuk është ashtu, Ai nuk është i ngjashëm me asnjë send.

Të gjitha devijimet në njohjen e drejtë të Zotit, janë rezultat i përpjekjes së njeriut që ta njohë Atë fizikisht. Nga kjo përpjekje lindin idhujt, lind personifikimi i Zotit, gjë që janë gabime të mëdha në besim. Zotin duhet njohur ashtu si e ka përshkruar Ai vetë në Kuran dhe si na mëson Pejgamberi, kur thotë: “Mendoni e studioni krijesat e Zotit, e mos mendoni për qenien dhe personalitetin e Tij.” Atë duhet njohur sipas cilësive të përshkruara në Kuran, por më esenciale është që Ai të njihet si i Vetmi Krijues, e vetmja Qenie e pakufishme dhe i Vetmi që meriton adhurimin (Vahid, Halik, Ma’bud).

Melaiket

Aq sa kuptojmë prej Kuranit, bota e gjallesave të padukshme janë melaiket, xhinët, megjithëqë ka shenja po në Kuran se ka edhe gjallesa të tjera që ne nuk dimë për to (“ve jahluku ma la ta’lemunë”).

Melaiket janë krijesa të përsosura të cilat gjithnjë adhurojnë, respektojnë, i përulën Zotit dhe kur nuk thyejnë urdhrin e Tij. Janë të krijuara prej elementit të dritës, andaj edhe jetojnë në atë botë. Njeriu si qenie fizike në planetin e tokës, nuk

është në gjendje t'i njohë ose t'i kuptojë ato. Këtu nevojitet besimi në ekzistencën e tyre siç na mëson Kurani, përndryshe ato bëjnë pjesë në çështjet sekrete të cilat nuk i nënshtrohen ndonjë studimi a përvoje. Vetëm pejgamberët kanë pasur atë aftësi që t'i njohin dhe t'i shohin ato. Natyra e tyre në pikëpamje të zhvillimit mendor është tjetër nga ajo e njeriut, sepse njeriu përjeton etapa të zhvillimit si fizik gjithashtu edhe mendor. Në zhvillimin mendor, njeriu përjeton etapën e foshnjërisë, fëmijërisë, rinisë, pjekurisë dhe të pleqërisë. Njohuritë e tija i shton dhe i shumon duke mësuar, studiuar e provua. Kjo mënyrë e zhvillimit mendor nuk gjendet të melaiket, ngase atyre iu dhuron Zoti diturinë drejtpërdrejt, njohuri të plota të përsosura e complete.

Është e pamundur të dihet edhe për të gjitha detyrat e melaikëve. Kurani i përmend disa prej tyre me emër dhe detyrat e tyre, si p.sh. Xhibrilin që është bartës i të gjitha shpalljeve - vahjit prej Zotit të të gjithë pejgamberët, madje i përmend "hameletul arshi", "hazanetun" (roje e xhenetit), "zebanijetun" (ata që merren me çështjen e xhehenemit), "rekib dhe atid" (përcjellës të veprimtarive të njerëzve), "hafedha" (ata që e ruajnë njeriun gjatë jetës), "melekul mevti" (ata që marrin shpirtrat) etj. Melaiket nuk i takojnë asnjërës gjini. Nuk duhet menduar ose besuar se melaiket janë në gjendje të bëjnë mirë ose keq pa lejen e Zotit. Ato janë krijesa, edhe pse shumë të larta e të pastra, domosdo i nënshtrohen urdhrit të Zotit, pra nuk duhet adhuruar-lutur askënd tjetër përveç Zotit xh. sh.

Pejgamberët - të dërguarit e Zotit

Pejgamberët janë njerëz sikurse edhe të gjithë njerëzit tjerë sa i përket anës fizike të tyre, por shpirtërisht e mendërisht janë më të lartë se të gjithë njerëzit tjerë. Ata ishin njerëz të cilët i zgjodhi Zoti për një mision shumë të lartë, njerëz të cilët do të transmetonin në popull porosinë e Zotit. Ata, nëpërmjet vahjit-shpalljes, pranonin këshillat prej Zotit dhe ia mësonin popullit. I tërë burimi i fesë rrjedhë prej *vajit-shpalljes*. *Vahji* është bazë e besimit dhe e sheriatit dhe i vetmi burim mbi çështjet sekrete (gajb); është themel në të cilin vihet e vërteta mbi dërgesën - risalen (dërgimin e pejgamberëve). Është i vetmi dallim mes aftësisë së njeriut të cilën e arrin me anën e mësimit, studimit dhe angazhimit të tij të thellë mendor dhe njeriut i cili njohuritë i fiton direkt prej Zotit dhe ato ia transmeton popullit ashtu të sakta duke mos shtuar ose munguar asgjë. Këtu, në besim ndaj pejgamberëve duhet pasur kujdes e të mos e ngatërrojmë diturinë e pejgamberit të dhuruar prej Zotit me mprehtësinë mendore, talentin e dalluar dhe mjeshtërinë filozofike etj., sepse pejgamberi edhe pse është mjaftë i mençur, thëniet e tij nuk janë prodhim i aftësisë së tij intelektuale, i mjeshtërisë së tij filozofike etj. Shumë njerëz, me ose pa qellim të caktuar, pejgamberët i paraqesin si njerëz të aftë, të mençur, filozof etj., e paraqitja e tillë edhe pse duket në shikimin e parë si lavdërim ndaj tyre, ajo është shumë e rrezikshme, ngase me këtë anohet në asgjësimin e vahjit, në asgjësimin e relacionit Zot-pejgamber, e me këtë edhe në asgjësimin e shenjtërisë së çështjeve fetare.

Dërgimi i peygamberëve ka qenë i domosdoshëm, ngase, siç thamë edhe më parë, njeriu nga vetë natyra e tij e lindur, e njohu Krijuesin e tij, i studioi dhe i njohu të gjitha qeniet në gjithësi dhe vërejti se të gjitha ato kryejnë një detyrë dhe i shërbejnë një qëllimi të caktuar, e në mesin e tyre e vërejti edhe veten që është një ndër krijesat më të larta, është krijues me veti e cilësi të posaçme, të cilat nuk i ka asnjë krijesë tjetër dhe vetëm në bazë të kësaj pajisjeje të tij me këso aftësish e bëri edhe hafife/mëkëmbës në planetin e tokës, në duart e tij e la udhëheqjen dhe shfrytëzimin e të gjitha gjërave në këtë tokë, pra i dha detyrë të madhe që kërkon edhe përgjegjësi. Atëherë njeriu nuk mundi të qëndronte indiferent ndaj asaj se çka dhe çfarë është detyra e tij ndaj Krijuesit dhe ndaj qenieve e sendeve që e rrethojnë dhe e përcjellin gjatë tërë jetës, e për të mos u hutua dhe pështjelluar rreth detyrës dhe obligimeve që ka ndaj Krijuesit dhe ndaj krijesave të tjera, Zoti xh.sh., nga mëshira e Tij, i dërgoi peygamberët që t'i ndihmojnë dhe t'i udhëzojnë njerëzit në rrugë të vërtetë dhe të drejtë për detyrat dhe obligimet që kanë ndaj Krijuesit dhe ndaj krijesave të tjera, ashtu që me lehtësi të gjejnë shpëtimin e tyre në të dy jetët. Kështu duhet besuar të gjithë peygamberët, prej Ademit e deri në Muhamedin a.s.

Librat - Kitabet

Duke i besuar librat e Zotit, vërtetojmë *vajin - shpalljen e Zotit*, nëpërmjet të cilës i udhëzoi peygamberët, sepse librat nuk janë gjë tjetër vetëm se shpallje nga Zoti. Librat janë thënie të Zotit, të cilat peygamberi ia përcolli popullit të cilit iu

kishte dërguar. Të përmendura në Kuran janë: Tevrat - që i zbriti Musit a. s., Inxhili i Isait a. s. dhe Zeburi që i zbriti Davudit a. s. Janë të përmendura edhe suhufet e Ibrahimit a.s. Për *suhufet* nuk dimë asgjë, ngase gjuhën e tyre e ka ngrënë koha, e për sa i përket katër librave të mëdha: Tevrat, Inxhil, Zebur dhe Kuran, jemi të obliguar t'i besojmë sepse janë të shpallura prej Zotit, e për sa i përket ruajtjes së origjinalit të tyre, jemi të obliguar, si myslimanë, të besojmë në origjinalitetin e Kuranit.

Dita e Mbramë

Këtu është fjala për fundin e jetës në këtë botë dhe fillimin e saj në botën tjetër të përjetshme-Ahiretin. Për fundin e jetës së kësaj bote, përkatësisht për momentin se kur do të merr fund jeta në të, nuk di askush tjetër përveç Zotit, nuk ditën as pejgamberët, e nuk dinë as melaiket e të mos flasim për magjistarët e falltarët. Në Kuran është thënë: sado që të jetë e gjatë jeta e kësaj bote, ajo njëherë do të merr fund dhe do të fillojë jeta tjetër pas ringjalljes. Është me rëndësi që njeriu të jetë i bindur dhe të ketë besim të plotë se pas kësaj jete do të ringjallet dhe do të jetojë pandërprerë dhe se do të japë llogari para Gjykatësit suprem për të gjitha fjalët, veprat dhe bindjet që i ka shprehur, vepruar dhe ushqyer në këtë jetë, në bazë të të cilave meriton shpërblim ose ndëshkim. Duhet besuar se Zoti është mëshirues i madh, por për zullumqarët ka përgatitur edhe ndëshkime të hidhura. Besimi ndaj kësaj Dite, është një nga shtyllat më të forta të besimit.

Kaderi

Me besuar në kaderin e Zotit, do të thotë me besua se Zoti në fillim ka ditur për të gjitha veprat e njeriut dhe gjithçka rreth krijesave se si do t'i përcjelli ato në të ardhmen, e njashtu edhe që çdo ngjarje ndodhë sipas dijes së Tij. Kjo nuk do të thotë detyrim, por dije e Zotit qysh më parë. Në të vërtetë, njeriu me pjesën e tij të ngurtë, në zhvillimin e tij dhe në funksionimin e disa gjymtyrëve, siç janë zemra, lukthi etj., nuk është i lirë, është i detyruar, siç janë të detyruar trupat qiellorë në kryerjen e detyrës së caktuar pa vetëdije e dëshirë dhe siç është zhvillimi i bimëve. Mirëpo, njeriu është i lirë në lëmin e veprimtarisë mendore në të gjitha ato çështje që është e mundur të parashtrohet alternativa: po ose jo, andaj edhe është përgjegjës për këtë lëmi të veprimtarisë. Njeriu gjithnjë anon kah hairi dhe ikën prej sherrit, kjo është natyrë e tij e lindur, mirëpo kur bën ndonjë gabim, atë nuk duhet kërkuar të kaderi, por në fushë veprimtarinë e tij mendore, sepse ajo e keqe rrjedhë, ose prej mosdijes së mjaftueshme, ose nga perceptimi dhe planifikimi i gabuar prej vetë tij, ose nga ndonjë e metë e tij personale apo si rrjedhim i edukimit të keq të rrethit ose të ambientit jo të mirë.

Veprimet sipas parimeve fetare

Besimi i përmendur deri tash, domosdo duhet të jetë i shoqëruar me vepra, sepse, veprat janë ato të cilat e përforcojnë besimin, nëse ato kryhen sipas udhëzimeve të Zotit, andaj është e drejtë të thuhet, nuk vlen ai besim që nuk përputhet me veprat, siç nuk vlen vepra pa ndonjë besim ose qëllim të mirë.

Në fenë islame, çdo vepër e njeriut, edhe ajo shpirtërore, konsiderohet si rit (ibadet), nëse i shërben interesit njerëzor, sepse çdo ajet i Kuranit, direkt ose indirekt, jep për të kuptuar për rëndësinë e kësaj jete. Edhe ibadetet e parapara sipas mësimave islame, nuk janë gjë tjetër vetëm se rrugë veprimi për përmirësimin e jetës, për pastrimin e trupit, shpirtit dhe ndërgjegjes së njeriut. Në fenë islame gjejmë shumë ndalime ndaj disa veprimeve etj. Ato nuk janë kundër natyrës së njeriut, nuk janë pengesë e lirisë së tij, nuk janë barrikadë në rrugën e jetës së tij. Ato janë orientim për ta vënë njeriun në një rrugë të ndershme, në të cilën do të ruhet natyra e tij e lindur, feja e tij nga punët e këqija, shëndeti i tij nga shakatarët e dobësimit, mendja e tij nga tronditja, pasuria e tij nga keqpërdorimi dhe humbja, nderi dhe namuzi i tij nga përulja dhe personaliteti i tij nga mbytja e gjakderdhja. Njeriu faktikisht është ai, por ai të përcaktohet në bazë të aktivitetit dhe sjelljeve të tija, të cilat nuk janë gjë tjetër vetëm se rezultat i fuqive të brendshme, të cilat ne i quajmë arsye, zemër e shpirt etj. Peshorja më e mirë për t'ia matur njeriut veprimet dhe sjelljet e tij, janë këto hadithe të Pejgamberit a.s.:

“Mirësi është ajo që me lehtësi ta pranon zemra, e keqe është ajo që të tund shpirtin. Mos ua vëshin fjalëve që thonë të kundërtën.”

“Kur një punë të turbullon shpirtin, largohu prej saj.”

“Mirësi është morali i mirë, e keqe është ajo që të shqetëson përbrenda në krahërorin tënd dhe për të cilën nuk do që për të dijë bota”.

Sabri ef. BAJGORA

KOMENTIMI I KAPTINËS “ET-TIN”

وَالَّذِينَ وَالَّذِينَ وَالَّذِينَ ۖ وَطُورِ سِينِينَ ۖ وَهَذَا الْبَلَدِ الْأَمِينِ ۖ
لَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ ۖ ثُمَّ رَدَدْنَاهُ أَسْفَلَ
سَافِلِينَ ۖ إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ
مَمْنُونٍ ۖ فَمَا يُكَذِّبُكَ بَعْدُ بِالذِّينِ ۖ أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمِ
الْحَاكِمِينَ ۖ

**“Pasha fikun dhe ullirin! dhe (kodrën) Turi Sina-
në! dhe këtë Qytet të sigurt! Vërtet, Ne e krijuam
njeriun në formën më të bukur. Pastaj e kthejmë
atë (të poshtëruar) në më të ulëtën e të ulëtëve. Për-
veç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata
kanë shpërblim të pandërprerë. E, ç’të shtyri pra
të përgënjeshtrosh Ditën e Gjykimit (përgjegjë-
sisë)? A nuk është Allahu më i drejti Gjykues?” -
(Et-Tin, 1-8)**

*Kaptina “Et-Tin” është kaptinë mekase. Transmetojnë
Ibn Merduvije, Ibn Durejsi, Nehhasi dhe Bejhekiu*

nga Ibn Abasi se kaptina “*Et-Tin*” ka zbritur në Mekë. Ibn Merduvije po ashtu transmeton nga Ibn Zubejri se kjo sure ka zbritur në Mekë.¹

Ka gjithsej 8 ajete, 34 fjalë e 150 shkronja.² Ka zbritur pas sures “*El-Buruxh*” dhe para sures “*El-Ilaf* (Kurejsh)”. Në radhitjen e Mus’hafit mban numrin 95, kurse në radhitjen e zbritjes është e 28-ta.³

Emërtimi i kësaj kaptine

1. Emërtimi kryesor i kësaj kaptine, me të cilin është radhitur nëpër Mus’hafe, nëpër librat e Tefsirit dhe të Hadithit, është “**Et-Tin**”. Me po këtë emërtim e ka radhitur edhe Tirmidhiu⁴, ashtu siç e ka përmendur edhe Bukai⁵. Arsyeja e këtij emërtimi është betimi i Allahut në pemën e fikut, që në ajetin e parë të kësaj kaptine.
2. Emërtimi i dytë i kësaj kaptine është “**Ve-t-Tini**”. Në këtë emërtim, në dallim nga i kaluari, është shtuar ‘vavi’ betues. Me këtë emërtim e kanë radhitur Buharriu⁶, Sehaviu⁷, Fejruzabadi⁸, Alusiu⁹ e të tjerë.

¹ Imam Shevkaniu, *Fet’hul Kadiir, Measure, Egjipt*, 1994, vëll. V, f. 463.

² Fejruzabadi, *Besairu dhevi-t-Temjizi*, Kajro, 1996, vëll. I, f. 527.

³ Ibn Ashur *Et-Tahriru ve-t-tenviru*, Tunis, 1984, vëll. XXX, f. 419

⁴ Suneni i Tirmidhiut, Kapitulli i Tefsirit, vëll. V, f. 443.

⁵ El-Bukai, *Mesaidu-n-nedhar li-l ishrafî ala mekasidi-s-suver*, Rijad, 198, vëll. III, f. 209.

⁶ Sahihu-l-Buhari, vëll. VI, f. 87

⁷ Imam Sehaviu, *Xhemalu-l-kurra’ë ve kemalu-l ikra’ë*, Mekë, 1987, vëll. I, f. 38.

⁸ *Besairu dhevi-t-Temjizi*, vëll. I, f. 527.

⁹ Shihabuddin el Alusi, *Ruhu-l-Meani*, Bejrut, 2010, vëll. XXX, f. 173.

3. Emërtimi i tretë i kësaj sureje fisnike është **“Ve-t-Tini ve-z-Zejtuni”**. Ky emërtim ka qenë i njohur qysh në kohën e sahabëve. Transmetohet nga Abdullah bin Jezidi të ketë thënë: “I Dërguari i Allahut lexonte në namazin e akshamit: *“Ve-t-tini ve zejtuni”*”.¹⁰ Me këtë emërtim në tefsiret e tyre e kanë radhitur edhe San’ani e Nesaiu.¹¹
4. Dhe emërtimi i katërt e i fundit, me të cilin është veçuar vetëm Ibn Ashuri është **“Suretu-z-Zejtun”**, i cili përmend se këtë emërtim e ka parë në një dorëshkrim të një Mus’hafit, të vitit 1078 h.¹²

Vlera e kësaj kaptine

- Surja *“Et-Tin”* bën pjesë në grupin e sureve *“El-Mufasssal”*, me të cilat Resulullahu s.a.v.s. është nderuar ndaj të Dërguarve të tjerë. Në lidhje me këtë, transmetohet nga Vathilete ibnul Eska’ë El-Lejthi të ketë thënë: “I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: *“Më është dhënë në vend të Tevratit, shtatëshja, (suret nga “El-Bekare” e deri te “El-Enfal” ose “Et-Tevbe”); më janë dhënë në vend të Zeburit, “El-Mi’ine” - njëqindëshet, (suret që kanë mbi 100 ajete); më janë dhënë në vend të Inxhilit “El-Methanije” - (suret që kanë më*

¹⁰ Transmetojnë Ibn Ebi Shejbe (1/314) dhe Abd ibn Hamid në Musnedin e tij (1/178).

¹¹ Dr. Muhamed Abdurrahman esh-Shaji’ë, *Esmu suveri-l Kuran*, Rijad, 2011, f. 216.

¹² Dr. Munire ed-Devserij, *Esmu-s-suveri-l Kuran ve fedailuha*, Demmam, Arabi Saudite, 1426 h., f. 565.

pak se 100 ajete), *ndërsa jam mbinderuar (ndaj të dërguarve të tjerë) me suret “El-Mufassal” (nga surja “Kaf”, e është thënë nga “El-Huxhurat” e deri te “En-Nas”).*¹³

- Transmetojnë Buhariu, Muslimi dhe autorët e të gjithë Sunenëve nga Berra'ë bin Azib të ketë thënë: *“Derisa i Dërguari i Allahut ishte në një udhëtim, e fali jacinë dhe në njërën prej rekateve të saj e këndoi suren (Vet-tini ve-z-zejtuni...), dhe kurrë nuk kam dëgjuar dikë që të këndojë më bukur dhe më zë aq të mirë sesa Resulullahun s.a.v.s.”.*¹⁴

Transmetohet nga Abdullah bin Jezidi të ketë thënë: *“I Dërguari i Allahut lexonte në namazin e akshamit: “Ve-t-tini ve-z-zejtuni”.*¹⁵

Lidhja e kësaj kaptine me atë paraprake “El-Inshirah”

- Përderisa në fund të sures paraprake Allahu xh.sh. e porositi të Dërguarin a.s. që t'i binte në sexhde vetëm Atij dhe të synonte vetëm kënaqësinë e Tij, tash në fillim të kësaj sureje, Ai betohet se njeriun e ka krijuar në formën më të përsosur dhe në fizionominë më të bukur.

¹³ Transmeton Imam Ahmedi (4/107); Bejhekiu në *El-Xhamiu li shuabi-l Iman*, Rijad, 2003, (2/465).

¹⁴ Buhariu në kapitullin e tefsirit (769); Muslimi në kreun e namazit (464/175); Ebu Davudi në kreun e namazit (1221); Tirmidhiu në kreun e namazit (3100); Nesaiu në tefsir (702) dhe Ibn Maxhe në kreun e namazit (834-835).

¹⁵ Hadithi është i kategorisë ‘hasen’. Transmetojnë Ibn Ebi Shejbe (1/314) dhe Abd ibn Hamid në *Musnedin* e tij (1/178).

- Në suren paraprake “*El-Inshirah*” Allahu xh.sh. përme-
ndi mirësitë e Tij ndaj të Dërguarit të Vet, duke e përgëzuar
atë se do të ta lartësonte emrin e tij nëpër kohë, kurse tash në
këtë sure përmend gjendjen e një grupi të caktuar njerëzish të
cilët nëse nuk e pasojnë këtë të Dërguar, do ta shijojnë
ndëshkimin e Xhehenemit, ndërsa nëse e përkrahin dhe i
shkojnë pas, do të jenë të shpërblyer nga ana e Allahut xh.sh.
me mirësitë e Xhenetit.

- Surja paraprake përfundon me ftesë që t’i përulemi ve-
tëm Allahut Fuqiptotë, sepse nëpërmjet namazit dhe përkujti-
mit, njeriu arrin t’ia ndërtojë vetes të ardhmen e sigurt në
Ahiret, në kënaqësitë e amshueshme të Xhenetit, tash në
fillim të kësaj sureje nëpërmjet këtyre betimeve, vërtetohet
në mënyrë bindëse se ky Krijues i vetëm dhe i pashoq-Allahu
xh.sh. e ka krijuar njeriun në formën më të përsosur duke ia
mbjellë në zemër devotshmërinë, për të qenë vërtetë një kri-
jesë fisnike të cilës Allahu i Madhërishëm ia besoi mëkëm-
bësinë e Tij në Tokë.

Përmbajtje e shkurtër e kësaj kaptine


Ndonëse surja *Et-Tin* është prej sureve të shkurtra, do-
methënie e saj janë shumë madhështore. Së pari **ajetet (1-3)**
përmbajnë betime hyjnore, kuptimi i të cilave është po aq
madhështor, siç janë betimet në fikun, ullirin, Turi Sina-në
dhe Mekën fisnike, për të përfunduar me përgjigjen ndaj kë-
tyre betimeve me ajetin e 4-të: **“Vërtet, Ne e krijuam njeriun
në formën më të bukur”**, që paraqet fisnikërimin e qenies nje-
rëzore nga ana e Allahut xh.sh.

- **Ajeti i 5-të** i kësaj sureje vërteton faktin se nëse njeriu nuk është mirënjohës ndaj Krijuesit të tij, dhe ndjek rrugën e shejtanit të mallkuar, atëherë, ai kthehet në një krijesë të ligë që meriton përbuzjen dhe poshtërimin e përbotshëm.

- Përrjashtim nga ky nënçmim, bën vetëm ai njeri që beson dhe vepron punë të mira, të cilat e afrojnë atë drejt mëshirës së Krijuesit të tij. **(Shih ajetin: 6)**

- **Ajetet (7-8)** të kësaj sureje u drejtohen sërish jobesimtarëve me pyetjen se ç'i shtyri vallë ta mohonit Ditën e Gjykimit, kur e dini se Allahu është Gjykatësi më i drejtë, dhe askush nuk mund t'i shmanget drejtësisë së Tij.

Koment:



1. Pasha fikun dhe ullirin!

Betimet hyjnore të përmendura në Kuranin famëlartë shpërfaqin urtësinë e Allahut të Gjithëdijshtëm dhe fuqinë e Tij krijuese. Edhe në këtë sure, hasim disa prej këtyre betimeve, e betimi i parë është në dy pemë të bekuara në fikun dhe ullirin.

Në këtë ajet, padyshim fshihet një urtësi e madhe, sepse përveç që konfirmohet vlera e këtyre dy pemëve nga aspekti ushqyes për njerëzit, në mënyrë të tërthortë nëpërmjet tyre aludohet në shenjtërinë e Kudsi Sherifit, në të cilin Isai a.s. i ftoi njerëzit në besimin e pastër. Nga 114 suret kuranore, kjo është e vetmja sure që është emërtuar me emrin e një fruti apo bime, ndërkohë që fjala *Et-Tin* është përmendur vetëm njëherë në Kuran, pikërisht në ajetin e parë të kësaj sureje.

Sa i përket vlerës së pemës së fikut nga aspekti shëndetësor, s’do mend se vlera e saj tejkalon parametrat e një peme frutore, sepse fiku në të njëjtën kohë konsiderohet ushqim, pemë dhe ilaç shërues. Është ushqyes sepse është ushqim i lehtë, tretet shpejtë, nuk qëndron gjatë në lukth dhe përveç këtyre ka shumë veti shëruese. Ai pakëson këlbazën, i pastro- n veshkat, zhduk gurët në idhëz, pastron mëlçinë etj.¹⁶ Fiqtë kanë nivel të ulët të yndyrave dhe sigurojnë fibra më shumë se çdo pemë ose perime tjetër. Fiku ruan eshtrat, pasi është i pasura me kalcium dhe minerale që kanë shumë funksione, e ndër to edhe dendësia e eshtrave. Janë shumë të mirë për fëmijët në zhvillim, shtatzënat dhe gratë në menopauzë, që janë të prira për osteoporozë.

Studimet e bëra kanë vërtetuar se fiku përmban një përqindje të lartë vitaminash. Është i pasur me burime natyrale të vitaminave A, B, C dhe përmban një përqindje të pasur e të lartë të lëndëve ushqyese, sidomos elementet hekur, kalcium, bakër. Është bërë e qartë se fiku është një frutë kalorik që ekuilibron e shmang aciditetin e trupit të njeriut. Është i dobishëm për gratë shtatzëna gjidhënëse, ndërsa në aspektin kurativ fiku është i dobishëm, mbrojtës e shërues i sëmundjeve të aparatit tretës, kapsllëkut, sëmundjet e gojës e mishit të dhëmbëve.¹⁷

Në lidhje me vlerën e kësaj peme të bekuar, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ashtu siç transmetohet në disa hadithe, kur në

¹⁶ Shih më gjersisht Fahu-r-Rrazi, *Mefatihul-Gajb*, Bejrut, 1981, vëll. XXXII, f. 9.

¹⁷ Për më gjersisht lexo: <http://mjeksiaislame.com/fiku-dhe-ulliriushqim-dhe-ilac/>

një rast i qe dhuruar një shportë me fiq, kishte thënë: *“Hani”*, dhe kishte ngrënë edhe vetë dhe kishte vazhduar: *“Po të thosha se një frutë ka zbritur prej Xhenetit, do të thosha për këtë frutë, sepse frutat e Xhenetit nuk kanë bërthama.”*¹⁸

Disa nga komentatorët e Kuranit, lidhur me betimin e Allahut në fikun, që është një prej pemëve të Xhenetit, kanë thënë se kjo sure i ka tetë ajete, aq sa janë edhe dyert e Xhenetit.

Po ashtu, edhe betimi i dytë në pemën e ullirit ngërthen në vetë urtësi shumëdimensionale, sepse dihet mirë se kjo pemë e bekuar është njëkohësisht ushqyese dhe shëruese, sepse nga kokrrat e ullirit shtrydhet dhe nxirret vaji i çmueshëm. Por ajo që e bën të veçantë këtë pemë, është përshkrimi kuranor që Allahu xh.sh. ia bën kësaj peme të bekuar: ***“...që ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar të ullirit, as i lindjes e as i perëndimit”*** - (*En-Nur*, 35), dhe:

“Si dhe pemën që rritet në malin e Sinait e që u jep vaj dhe mëlmesë atyre që e hanë” (*El-Mu'minunë* 20)

Studimet shkencore kanë vërtetuar se ulliri përmban përveç tjerash edhe lëndë proteinore, karbohidrate, kripëra minerale, si: fosfor, hekur dhe kalcium. Gjithashtu në të gjenden vitamina A me sasi të mëdha dhe vitaminë B e pasur me lëndë minerale. Vaji i ullirit shërben si ilaç për mëlçinë, kuron parazitët në stomak dhe shëron kapsllëkun. Vaji ka ngjyrë të verdhë që anon nga jeshilja me erë të këndshme dhe nga as-

¹⁸ Tefsiri i Kurtubiut, vëll. 22, f. 363.

pekti mjekësor konsiderohet i butë, i lehtë dhe i dobishëm për disa sëmundje të tëmthit....¹⁹

Në lidhje më pemën e ullirit, transmetohet nga Muadhi i cili kishte marrë një degë të pemës së ullirit si misvak dhe kishte thënë: E kam dëgjuar të Dërguarin a.s. të ketë thënë: *“Misvaku më i mirë është misvaku i ullirit, sepse është nga një pemë e bekuar.... Ky është misvaku im (i preferuar) dhe ishte misvak edhe i të gjithë peygamberëve para meje.”*²⁰

I Dërguari i Allahut në lidhje me vajin e ullirit po ashtu ka thënë: *“Hani vajin e ullirit dhe lyhuni me të, sepse ai vjen nga një pemë e bekuar”*²¹

Ulliri dhe vaji i tij janë përmendur gjashtë herë në Kuran: në suret: *Et-Tin*, 1; *En-Nahl*, 11; *El-En’am*, 99 dhe 141; *En-Nur*, 35 dhe *Abese* 29.



2. Dhe (kodrën) Turi Sina-në!

Betimi në kodrën e Turi Sinasë, ka një domethënie tjetër të madhe, sepse fjala është për vendin e shenjtë ku Allahu xh.sh. i foli Musait a.s., njërit prej peygamberëve të *“Ulul-Azmit”*- *“të vendosmërisë së lartë”*. Në shumë prej sureve kuranore është përmendur casti kur Allahu i foli robit të Vet, Musait a.s.: ***“Dhe ti nuk ke qenë pranë Kodrës Tur kur Ne e***


¹⁹ Për më gjerësisht lexo: <http://mjeksiaislame.com/fiku-dhe-ulliriushqim-dhe-ilac/>

²⁰ Ibn Adil ed-Dimeshkij, *El-Lubabu fi Ulumi-l Kitabi*, Bejrut, 1998, vëll. XX, f. 406.

²¹ Et-Tefsiru-l Munir, vëll. XXX, f. 692.

thirrëm (Musain), por (tregimi ynë) është mëshirë nga Zoti yt, për t'ia tërhequr vërejtjen një populli që para teje nuk u kishte ardhur pejgamber...” – (El-Kasas, 46).

Emërtimi “Turi Sejnaë”, “Turi Sinin”. “Tur” ose “Xhebel-kodër” është përmendur në 12 ajete kuranore: *El-Bekare*: 63 dhe 93; *En-Nisaë*: 154; *El-A'raf*, 143, 171 (Në këtë sure është përmendur vetëm si kodër, kurse aludimi është pikërisht te kodra Turi Sejnaë); *Merjem*: 52; *TaHa*: 80; *El-Mu'minin*, 20; *El-Kasas*, 29, 46; *Et-Tur*: 1 dhe *Et-Tin*: 2. Ndërkohe, një sure kuranore është emërtuar me emrin “*Et-Tur*”.



3. Dhe këtë Qytet të sigurt!

Tash vjen kulminacioni i këtyre betimeve me betimin në Mekën, këtë vend të bekuar, të sigurt e të sigurisë, për të cilin Allahu xh.sh. në suren “*Ali Imran*”, ajeti 97, thotë: **“dhe kush hyn në të, ai është i sigurt”**.

Sipas shumë komentatorëve të Kuranit, Allahu i Madhërishëm, nëpërmjet këtyre ajeteve kuranore është betuar në tri vendet e shenjta, të cilat ishin vendndodhjet e zbritjeve të shpalljeve hyjnore. Betimi i parë në fikun dhe ullirin, ka të bëjë me Kudsën, përkatësisht me Isain a.s., sepse rrethina e këtij vendi të bekuar, është e njohur me pemët e fikut dhe të ullirit, pastaj pason betimi në Turi Sinanë ku për herë të parë Allahu e gradoi në pejgamber, Musain a.s., për t'i përfunduar këto betime me betimin në Mekën, si një vend të sigurt, ve-

ndi ku i zbriti shpallja e fundit hyjnore Muhamedit a.s..²² Meka që nga lashtësia, ishte vendi, kur për herë të parë në fytyrën e tokës u ngritën themelet e shtëpisë së Allahut, e cila vazhdon të jetë sot e kësaj dite kibël e mbi një miliardë e gjysmë myslimanësh. Arsyeja pse Mekën fisnike, i Madhërishmi e ka quajtur të sigurt, është se ky vend që nga kohët e lashta ka qenë i mbrojtur dhe i sigurt. Na mjafton vetëm ngjarja e Ebrehesë, për të kuptuar se ky vend ka qenë gjithmonë nën kujdesin dhe mbrojtjen e Allahut. Pastaj ishte edhe duaja e Ibrahimit a.s. kur në shkretëtirat e Mekës e la bashkëshorten Haxheren me të birin e tyre të vogël Ismailin a.s., dhe pasi u largua iu lut Allahut me lot në sy: **“O Zot, bëje këtë vend (qytet) të sigurt”** - (Ibrahim, 35) Fjala **“Beledul Emin”**, nënkupton edhe fjalën **“El-Emanetu”**, që nënkupton amanetin-Shpalljen e Kuranit që iu zbrit Muhamedit a.s., për t’i ndriçuar rrugët e njerëzimit. Dijetari bashkëkohor Dr. Fadil es-Samirrai, teksa elaboron pjesën e ajetit **“Ve hadhe-l beledi-l emin”** thotë se Shpalljen prej Allahut e zbriti Xhibrili - **“Ruhul Emin”** tek i Dërguari a.s. **“Es-Sadiku-l Emin”** në vendin më të sigurt - **“El-Beledul Emin”**²³

Është karakteristikë e veçantë se këto tri vende të shenjta, janë të përmendura edhe në Bibël. Aty thuhet: **“Dhe u tha: “Zoti erdhi nga Sinai, u ngrit mbi ta në Seir, dhe u paraqit në madhëstsinë e Tij nga mali Faran...”**²⁴

²² Tefsiri i Ibn Kethirit, Rijad, 1999, vëll. VIII, f. 434. (Redaktuar nga Sami bin Muhamed es-Selame)

²³ Dr. Fadil es-Samirrai, *Et-Ta’biru-l Kurani*, Aman, 2006, f. 340.

²⁴ Bibla Protestante, Ligji i Ripërtëritjes, kapitulli 33 sentenca 2.

Sipas shumicës së dijetarëve, edhe ng ky pasus biblik, nënkuptohet se mëshira e Allahut dhe favori i Tij për njerëzimin kanë marrë trajtë në malin e Sinait në bisedën midis Tij dhe Hz. Musait a.s.. Konkretizimi i kësaj mëshire është profetësia e dhënë Musait në atë periudhë historike. Sair është Palestina. Atje, mëshira e Providencës Hyjnore ka rrethuar me rrugën e revelacionit, Hz. Isanë dhe ata që ndodheshin në mjedisin e tij. Në të njëjtën kohë, Hz. Mesihu është një peygamber i madh, i denjë për shfaqjet e Zotit. Shumica, duke mos i dalluar dot shfaqjen nga dukja, kanë rënë në konfrontim në këtë çështje. Ajo që shfaqet tek ai, është fryma hyjnore. Kurse në malet Faran, Providenca Hyjnore është dukur me anë të enigmës së unitetit dhe të nivelit individual unik që përfshin gjithësinë. Farani është Meka, sepse në një vend tjetër të Testamentit të Vjetër tregohet se Hz. Ibrahim i vendosi në Faran të birin Ismail. Nga kjo kuptohet se në Testamentin e Vjetër, me emërtimin Faran bëhet fjalë për Mekën. Në sentencën në fjalë aludohet radhazi për tre profetë. I pari nga këta është Hz. Musai, i dyti, Hz. Isai dhe, i treti, profeti i fundit, Profeti i dy botëve, Hz. Muhamed Mustafai s.a.v.s..²⁵

Në Tevrat, këto tri vende janë përmendur sipas vlerës së njëmendtë që kanë këta peygamberë, dhe për këtë arsye Allahu xh.sh. është betuar në të ndershmin dhe të vlefshmin-Isain a.s. - (Mesihun), pastaj në më të ndershmin dhe në më të vlefshmin-Musain a.s.- (Kelimullah), dhe në fund, në më

²⁵ Për më gjerësisht shih: <http://bibladhekurani.com/profeti-i-paralajmeruar-dhe-i-pritur/>

të ndershmin prej të ndershmëve dhe në më të vlefshmin prej të vlefshmëve, Muhamedin a.s.²⁶

Ibn Ashuri në tefsirin e tij përmend një fakt shumë të rëndësishëm, i cili logjikisht është po ashtu shumë i pranuar, sepse ka një lidhmëri logjike. Ai ndër të tjera thekson, se fjala “*Ve-t-Tini*” simbolizon sheriatin e Nuhit a.s., fjala “*Zej-tun*” sheriatin e Ibrahimit a.s., fjala “*Turi Sinin*” sheriatin e Musait a.s., kurse “*Beledin emin*”, Mekën, apo sheriatin e Muhamedit a.s.. Këtu vërehet se po mungon sheriatin i Isaut a.s., meqë në fakt, ai nuk erdhi me një Ligj të ri, por erdhi vetëm për ta plotësuar sheriatin e Musait a.s., për t’i lehtësuar disa nga ngarkesat e tij për *beni israilët*, etj.²⁷

لَفَدَّ حَلَقْنَا الْإِنْسَانَ فِي أَحْسَنِ تَقْوِيمٍ

4. Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.

Pas tri betimeve të mëhershme, në ajetin 4 të kësaj sureje, vjen përgjigjja e betimeve, se njeriu vërtetë u krijua në formën më të bukur e më të përsosur. Njeriu, ishte ajo krijesë, të cilës Allahu i madhëruar ia besoi mëkëmbësinë e Tij në tokë, i dhuroi lirinë e të vepruarit, të menduarit-logjikuarit, gjë e cila e dallon prej gjallesave dhe krijesave të tjera. Njeriu është e vetmja prej krijesave që di të mendojë, të rezonojë e të marrë vendime të pavarura. Njeriu arrin qytetërim e avancim, duke vënë në veprim dhuntitë e Allahut, prandaj ai që arrin të kuptojë fshehtësinë e misionit të ardhjes së tij në këtë

²⁶ *Et-Tefsirul Munir*, vëll. XXX, f. 693.

²⁷ Shih tefsirin e Ibn Ashurit, vëll. XXX, f. 422.

botë, ai do të jetë nën hijen e mëshirës hyjnore përjetësisht, ndërsa ai që nga mendjemadhësia mohon këto të mira, duke ia atribuar vetvetes të gjitha këto të arritura, atëherë ai do të jetë i humbur në jetën e përjetshme të Ahiretit.

Po ta analizojmë njeriun nga konstrukti fizik-anatomik, do të shohim se ai vërtetë është një qenie e përkryer. Koka, sytë, hunda, balli, veshët, duart, dhe këmbët, që të gjitha këto gjymtyrë dhe organe janë në proporcion ideal me trupin, dhe të bindin se vërtetë, Allahu i Madhërishëm, e ka përsosur krimin e njeriut, nga dashuria dhe mëshira e Tij për të.

Në lidhje me kuptimin shumëdimensional të këtij ajeti, Imam Kurtubiu në tefsirin e tij sjell një ngjarje të vërtetë kur thotë: “Isa ibn Musa el Hashimij e donte aq shumë gruan e tij saqë një ditë i kishte thënë: Ti je e shkurorëzuar përfundimisht prej meje nëse nuk je më e bukur se Hëna. Ajo e pikëlluar u ngrit dhe u vetmua në një dhomë dhe i tha “Më shkurorëzove!” Isa bin Musa u pendua menjëherë për fjalët e pamatura që ia tha gruas, duke e kaluar një natë të vështirë, të përzier me emocione. Të nesërmen shkoi në pallatin e halifes Ebu Xha’fer el Mensurit, ia tregoi hallin e tij dhe dhimbjen që ndjente nga ky “shkurorëzim”. Atëherë halifi mblodhi fukahatë dhe dijetarët në pallat për t’i konsultuar lidhur me këtë rast të çuditshëm të shkurorëzimit. Të gjithë dijetarët, përveç njërit, ishin unanim në fetva se ajo tashmë llogaritej si e shkurorëzuar. Ai që heshti ishte pasues i medhhebit të Ebu Hanifes. Halifi e pyeti: Po ti pse po hesht? Atëherë ai tha: Bismil-lahi Rrahmani Rrahim-Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, dhe i lexoi katër ajetet e para të kësaj sureje deri tek ajeti: **“Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën**

më të bukur”, dhe tha: “O prijësi i besimtarëve, njeriu është krijesa më e mirë dhe nuk ka asgjë më të bukur se njeriu.”

Atëherë halifi iu drejtua Isa bin Musait dhe i tha: Çështja është si po thotë ky njeri. Shko te gruaja jote, ndërkohë që e dërgoi një lajmëtar edhe të gruaja e Isait me porosinë: Bindju burrit dhe mos e kundërshto në rikthim në bashkëshortësi, sepse ai nuk të ka shkurorëzuar.”²⁸

ثُمَّ رَدَدَتْهُ أَسْفَلَ سَفِيلَيْنِ

5. Pastaj e kthejmë atë (të poshtëruar) në më të ulëtën e të ulëtëve.

Pasi që i Madhërishmi tregoi se si e krijoi njeriun në formën më të bukur, dhe e përzgjedhi nga të gjitha krijesat duke ia besuar mëkëmbësin në Tokë, tash në këtë ajet sqaron se nëse njeriu shmanget nga rruga e drejtë, mund ta sjellë veten në pozitën e poshtërimit dhe të nënçmimit. Nuk ka gjë më të shëmtuar se kur një krijesë e privilegjuar sikurse njeriu, nga vrazhdësia dhe paturpësia, e mohon Krijuesin e vet, duke u mashtruar nga intrigat e shejtanit të mallkuar.

Kur jemi te ky ajet, dijetarët kanë dhënë dy mendime: Mendimi i parë të cilin e përkrahin Hasan el Basriu, Muxhahidi, Katadeja dhe të tjerë, është se ky ajet nënkupton mohuesit dhe mëkatarët, vendqëndrim i të cilëve do të jetë zjarri i Xhehenemit, të cilët bien në nivele shumë të ulëta si pasojë e mbrapshtive dhe mosbesimit të tyre. Madje, disa prej njerëzve, bien aq thellë në ambis dhe në greminat e degradimit, sa-

²⁸ Tefsiri i Kurtubiut, *El-Xhamiu li ahkami-l Kuran*, vëll. 22, f. 369.

që të tillët Allahu i Madhërishëm i ka krahasuar me shtazët, të cilat nuk kanë intelekt: **“...Ata (mohuesit nga njerëzit dhe xhindet) kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë, kanë sy me të cilët nuk shohin dhe kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur...”** - (*El-A'raf*. 179).

Ndërsa mendimi i dytë nënkupton kohën e pleqërisë së thellë, kur njeriu humb aftësinë e të logjikuarit, si pasojë e sëmundjeve, e harresës etj. Ky është mendim i Ibn Abasit, Ikrimes dhe i Dahhakut. Megjithatë, mendimi i parë është më i saktë dhe më i pranuar.²⁹

Madje në lidhje me këtë mendim të fundit, Ibn Kethiri thotë: “Po të ishte ky, qëllimi i synuar, Allahu nuk do t’i veçonte për të mirë besimtarët, menjëherë pas këtij ajeti, sepse pleqërinë mund ta mbërrijë çdonjëri, por këtu është synuar ajo që është thënë në suren *El-Asr*, (1-3): **“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjash-tim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira...”**³⁰

إِلَّا الَّذِينَ ءَامَنُوا وَعَمِلُوا الصَّالِحَاتِ فَلَهُمْ أَجْرٌ غَيْرُ مَمْنُونٍ ﴿١٠﴾

6. Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata kanë shpërblim të pandërprerë.

Përjashtim nga grupi i cili ka humbur devijuar nga rruga e drejtë, bëjnë pjesë besimdrejtët, të cilët për asnjë çast të jetës së tyre nuk ia kthyen shpinën udhëzimit hyjnor. Besimtarët e vërtetë, përveç besimit të paluhatshëm në Zotin e gji-

²⁹ *Et-Tefsiru-l Munir*, vël. XXX, f. 695.

³⁰ Tefsiri i Ibn Kethirit, vëll. VIII, f. 435.

thësisë, gjithmonë ishin të kujdesshëm të bënin vepra të mira, të silleshin me të tjerët, sepse kështu ishin të edukuar nga të dërguarit e Allahut dhe nga Librat e shenjtë.

فَمَا يُكَذِّبُكَ بَعْدُ بِالذِّكْرِ

7. E, ç’të shtyri pra të përgënjeshtrorsh Ditën e Gjykimit (përgjegjësisë)?

Pas përmendjes së çështjes së jobesimtarëve të cilët do të katandisen në skëterrata të Xhehenemit, për shkak të kufrit të tyre, dhe përmendjes së besimtarëve të cilët do të jenë grupi i shpëtuar, për shkak të çiltërsisë së tyre imanore, tash në vazhdim shohim qortimin e hapët të jobesimtarëve nga ana e Allahut. Ky qortim vjen në formë pyetjeje e cila përmban një lloj sarkazmi, a thua çfarë të shtyri o njeri mosmirënjohës të mohosh Zotin dhe Ditën e Gjykimit, i cili të ka krijuar në formën më të përsosur?! Forma të tilla pyetjeje kanë ardhur në shumë ajete kuranore, si f.v.: **“O ti njeri po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë? I cili të krijoi, të përsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi!”** – (El-Infitar, 6-8).

أَلَيْسَ اللَّهُ بِأَحْكَمَ الْحَاكِمِينَ

8. A nuk është Allahu më i drejti Gjykues?

Ajeti i fundit i kësaj sureje, përfundon sërish me një pyetje e cila në vete përmban edhe përgjigjen: Vallë, o mohues i mirësive të Mia, a nuk është Allahu më i drejti Gjykues? A nuk të krijoi në formën më të bukur, dhe të la të lirë në vepra, që ti të ndjekësh shtegun e dritës, me dëshirën dhe

vullnetin tënd, por fatkeqësisht pasove rrugën e djallit të mallkuar, prandaj në Ditën e Gjykimit do të ballafaqohesh me drejtësinë hyjnore, e fundi yt do të jetë zjarri i Xhehene-mit. Në këtë Ditë, askujt nuk do t'i bëhet e padrejtë, sepse Gjykues, është Absoluti dhe i Drejti i lartësuar qoftë në Ma-dhërinë e Tij.

Në lidhje me këtë ajet, është përcjellë nga Ebu Hurejra se e ka dëgjuar të Dërguarin a.s. të ketë thënë: “Kur dikush prej Jush ta lexojë *“Ve-t-Tini ve-z-Zejtuni...”* deri sa të arrijë në fund të ajetit: *“Elejse Allahu bi ahkemil Hakimin”*, le të thotë: “Po si jo, dhe unë për këtë jam një prej dëshmuesve”³¹

Porosia e kësaj sureje:

- Në tri ajetet e paratë kësaj sureje, shohim betimet e Allahut në fikun dhe ullirin, betime të cilat aludojnë në Palestinën, më saktësisht Kudsi Sherifin, vendin ku u dërgua peygamber Isai a.s.. Pastaj në Turi Sinanë, vendin e shenjtë ku Allahu ia dërgoi Musait a.s. shpalljen si dhe në Mekën, ku Allahu xh.sh. ia dërgoi shpalljen e fundit hyjnore Muhamedit a.s.. Nga këto tri ajete, shohim ndërldhjen e tri vendeve të bekuara ku Allahu xh.sh. dërgoi peygamberë nga “Ulul Azmi”.
- Allahu i Gjithëmëshirshëm na bën me dije se njeriun e ka krijuar në formën më të bukur e më të përsosur, duke i dhuruar mendjen dhe lirinë në vepra.

³¹ Imam Sujutiu, *Ed-Durru-l menthur*, Kajro, 2003, vëll. 15, f. 517.

- Ai që mohon Zotin, Ringjalljen dhe Ditën e Gjykimit, do të jetë përjetësisht në Xhehenem, duke vuajtur pasojat e kufrit të vet, përveç atyre që besuan dhe besimin e tyre e zbukuruan me vepra të mira, duke respektuar urdhrat dhe dispozitat e Allahut, të cilët do të gëzojnë begatitë e pafundme të Xhenetit.
- Surja përfundon me një porosi universale për të gjithë mohuesit dhe përgënjeshtresit e Ditës së Gjykimit, se Allahu është Gjykuesi më i drejtë. Ai nuk i bën padrejtësi askujt, por njeriu do të jetë peng i veprave të veta në këtë botë. Nëse ka qenë mëkatar dhe mohues, e pret ndëshkimi në Xhehenem, e nëse ka qenë besimtar dhe vepërmirë, atëherë shpërblimi i tij i merituar do të jetë Xheneti me bukuritë e tij përrallore.

Hajrullah ef. HOXHA

BINDJA DHE DASHURIA NDAJ ZOTIT XH.SH. DHE MUHAMEDIT A.S.*

Zoti i Madhëruar ka thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ
مِنْكُمْ فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ
تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ذَلِكَ خَيْرٌ وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا

**“O ju që keni besuar, binduni Zotit dhe binduni Pej-
gamberit dhe prijësve tuaj, në qoftë se bini në mosma-
rrëveshje për ndonjë çështje, atëherë drejtojeni te Zoti
(Kurani) dhe Pejgamberi (hadithi) nëse besoni në
Zotin dhe në Ditën e Kiametit, kjo është më e dobish-
me dhe më e miri përfundim.”** (En-Nisa’, 59)

Nga ky ajet i Kuranit a.sh., kuptohet se myslimanët janë
të obliguar që:

* Marrë nga “Takvim 1402 - Kalendar 1982”. Botohet me pak shkurtime dhe
me redakturë gjuhësore. (Redaksia).

- T'i binden dhe ta dëgjojnë Zotin e Madhëruar, duke i zbatuar urdhrat e Tij dhe duke u larguar nga ato gjëra që i ka ndaluarën Kuran;
- T'i binden dhe ta dëgjojnë Pejgamberin a.s., duke vepëruar sipas udhëzimeve dhe traditave të tij;
- T'i dëgjojnë dhe t'i respektojnë sunduesit ose prijësit fetar të tyre, nëse veprojnë sipas parimeve të shariatit islam.

Nëse bien në konflikt për ndonjë çështje, pa marrë parasysh të kësaj bote apo të Ahiretit, atëherë duhet ta zgjidhin në bazë të Kuranit dhe të traditës së Pejgamberit a.s., për arsye se kjo është mënyra më e drejtë dhe më e përsosur, derisa i besojnë Zotit dhe Ditës së Gjykimit. Bindja, respekti dhe dashuria ndaj Zotit dhe Pejgamberit a.s., merr formë të vërtetë, nëse buron nga zemra, dëshmohe me gjuhë dhe vërtetohet me vepra. Kjo do të thotë se jetën, në të gjitha pikëpamjet, duhet përputhur në bazë të Kuranit a.sh., dhe traditës së Pejgamberit a.s., të cilat janë burimet kryesore të fesë islame. Njëri është produkt i diturisë së përsosur dhe të pakufishme të Zotit xh.sh., ndërsa tjetri është produkt i Pejgamberit a.s., i cili ka qenë i pajisur nga ana e Zotit me cilësi dhe virtyte të larta morale, andaj as njëri e as tjetri nuk mund të krahasohen ose të zëvendësohen me ndonjë ligj apo sistem tjetër në botë.

Myslimani që ka bindje të plotë ndaj Zotit dhe Pejgamberit, që është i edukuar në frymën e vërtetë të fesë islame, e rikujton Zotin shpesh, e falë namazin, e agjëron muajin e Ramazanit, e jep zeqatin, shkon në Qabe (nëse ka pasuri), i ndihmon të varfërve, sillet mirë në familje dhe shoqëri, është i sinqertë, besnik, i drejtë, bujar etj., respektivisht, nuk gënjen,

nuk mashtron, nuk tradhton, nuk spiunon, nuk bën ngatërresa dhe përçarje ndërmjet njerëzve, nuk mbytë dhe nuk vjedh, nuk pinë alkool dhe nuk hanë mish derri, nuk luan kumar etj.

Respekt dhe dashuri të singertë, në radhë të parë duhet të shprehim ndaj Zotit, Pejgamberit dhe myslimanëve të mirë, për arsye se këta janë të afërm dhe dashamirë të vërtetë. Lidhur me këtë, Zoti xh.sh., ka thënë:

إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ ...

“Me të vërtetë, të afërm, dashamirë tuaj janë Allahu, Pejgamberi i Tij dhe ata që kanë besuar, të cilët falin namazin, japin zeqatin...” (El-Maide, 55)

Në zemrat tona, dashuria ndaj Zotit, Pejgamberit dhe fesë islame, duhet të jetë më e madhe sesa dashuria ndaj pasurisë, farefisit, familjes dhe vetvetes. Zoti është Krijuesi ynë, Ai është dhënësi i jetës, fëmijëve, pasurisë dhe i të gjitha begatave që i posedojmë në këtë jetë. Ai është Shpëtimtari ynë në jetën e gjithmonshme, andaj e meriton dhe e kemi obligim që në zemrat tona të kultivojmë dashuri, respekt, mirënjohje dhe falënderim ndaj Tij, më tepër se ndaj çdokujt tjetër në botë.

Muhamedi a.s. është i dërguari i Zotit dhe i dashuri i Tij. Zoti e ka dërguar atë mëshirë për mbarë botën, për t’i udhëzuar në rrugën e shpëtimit dhe të lumturisë. Nëpërmjet tij, e kemi njohur Zotin dhe fenë islame. Personaliteti i tij i pajisur me virtytet më të përsosura morale, na shërben si shembull në jetën tonë të përditshme, ai do të jetë ndihmuesi ynë për të na shpëtuar nga ndëshkimi në jetën e gjithmonshme. Në bazë të këtyre meritave dhe dobive që i kemi prej tij, ai meriton

dashurin më të madhe sesa ndaj të gjitha begative të kësaj bote. Dashuria ndaj myslimanëve duhet të jetë në emër të islamizmit dhe nuk duhet të bazohet në ndonjë interes tjetër të kësaj bote. Nëse kërkon nevoja, në emër të Zotit dhe për hir të Pejgamberit, si dhe për mbrojtjen e fesë islame, atëherë duhet ta sakrifikojmë pasurinë dhe jetën, përndryshe do të hasim në katastrofë të tmerrshme. Përkritazi me këtë, Zoti i Madhëruar ka thënë:

قُلْ إِنْ كَانَ آبَاؤُكُمْ وَأَبْنَاؤُكُمْ وَإِخْوَانُكُمْ وَأَزْوَاجُكُمْ وَعَشِيرَتُكُمْ وَأَمْوَالٌ اقْتَرَفْتُمُوهَا وَتِجَارَةٌ تَخْشَوْنَ كَسَادَهَا وَمَسَاكِينُ تَرْضَوْنَهَا أَحَبَّ إِلَيْكُمْ مِنَ اللَّهِ وَرَسُولِهِ وَجِهَادٍ فِي سَبِيلِهِ فَتَرَبَّصُوا حَتَّى يَأْتِيَ اللَّهُ بِأَمْرِهِ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الْفَاسِقِينَ (٢٤)

“Thuaj (Muhamed), në qoftë se janë prindërit tuaj, djemtë - fëmija juaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria të cilën e keni fituar, tregtia që frikësoheni se po ju mungohet dhe shtëpitë që jeni të kënaqur në to, më të dashura se Zoti, Pejgamberi i Tij dhe lufta në rrugën e Zotit, atëherë prisni derisa Zoti t’iu dërgon urdhrin (ndëshkimin) e Tij...” (Tevbe, 24)

Enes bin Maliku tregon se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që i ka tri cilësi, e ka gjetur ëmbëlsinë - kënaqësinë e besimit, ai që e donë Zotin dhe Pejgamberin e Tij më tepër se çdo gjë tjetër, ai që e donë dikë vetëm për hir të Zotit (pa interes) dhe ai që i vjen mërzi të kthehet në mosbesim (kufër), sikur që i vjen vështirë të bie në zjarr.”

Ebu Uname tregon se Pejgamberi a.s., me një rast ka thënë: “Me të vërtetë, i është plotësuar besimi atij që donë

për Zotin dhe urren për Zotin, që jep për Zotin dhe pengon - nuk jep për hir të Zotit.”

Me një rast tjetër, Pejgamberi a.s., ka thënë: “*Nuk ka besuar si duhet asnjëri prej jush, derisa të bëhem tek ai më i dashur se prindërit e tij, fëmijët e tij dhe mbarë njerëzimi.*”

Përkitazi me bindjen dhe dashurinë ndaj Zotit, Pejgamberit, fesë islame dhe dashurisë vëllazërore në mes veti, praktikisht më së miri, si shembull duhet të na shërbej veprimtaria e myslimanëve të parë. Ata, të frymëzuar dhe të edukuar nga mësimet e Kuranit dhe udhëzimet e Muhamedit, për hir të fesë islame i përballuan të gjitha vështirësitë dhe sakrifikuan pasurinë dhe jetën. Disa prej tyre përjetuan maltretime nga armiqtë, si p.sh. Bilall Habeshiu, disa ndërruan jetë nën mundimet mizore, si p.sh. prindërit e Amër bin Jasirit, por asnjë nuk pranoi që ta mohonte fenë islame. Pasi që mundimet dhe vuajtjet u bënë të padurueshme dhe përhapja e fesë islame u izolua në tërësi, myslimanët në krye me Muhamedin a.s. i lanë vatrën dhe pasuritë e tyre dhe u shpërngulën në Medinë. Myslimanët e Medinës u vëllazëruan me ta dhe treguan bujari të madhe ndaj tyre, duke ndarë pasurinë përgjysmë me ta.

Me rastin e përgatitjes së ushtrisë për luftë, disa prej myslimanëve e dhanë tërë pasurinë, si p.sh. Ebu Bekri, të cilin kur e pyeti Pejgamberi, se çka po i lë familjes, ai u përgjigj: “*Zotin e Madhëruar*”, e disa prej tyre dhanë jetën në luftë. Në Betejën e Uhudit, kur armiku e sulmoi Muhamedin a.s., nga të gjitha anët, atëherë shokët e tij e rrethuan dhe u bënë mburojë e trupit të tij, duke i pritur shigjetat dhe shpatat e armikut me trup të tyre, me ç’rast njëri pas tjetrit dhanë edhe jetën. Njërin nga myslimanët, i quajtur me emrin Hubejb, e

zunë rob armiqtë - idhujtarët e Mekës, të cilët pasi që nuk pranoi të heq dorë nga feja islame, vendosën ta hedhin në litar. Para se ta varin, iu afrua prijësi i tyre, Ebu Sufjani dhe i tha: “O Hubejb, a kishe dëshiruar që në këtë moment, në vendin tënd të ishte Muhamedi, që atij t’i hiqej koka, e ti të ishe në familjen tënde?” Hubejbi iu përgjigj: “Vallahi, nuk dëshiroj që ta shqetësoj Muhamedin goditja e një there në vendin ku gjendet, e unë të jem ulur me familjen time.”

Dashurinë e madhe të tyre ndaj Pejgamberit, na e dëshmon edhe rasti i një gruaje, të cilën kur e lajmëruan për vrasjen e burrit, vëllait dhe të babait të saj në luftë, ajo pyeti për Pejgamberin. Pasi që i thanë se është shëndosh e mirë, kërkoi që ta shihte, e kur i treguan dhe e pa, ajo tha: “O i Dërguari i Zotit, pas teje çdo fatkeqësi është e vogël.” Në saje të bindjes dhe të dashurisë ndaj Zotit, Pejgamberit dhe sakrificave që i bënë në këtë pikëpamje, myslimanët e parë, me ndihmën e Zotit ia arritën qëllimit për triumfin e Islamit dhe shpërndarjen e rrezeve të tij, brenda një kohe të shkurtër, prej Kine e deri në Spanjë. Ata jetuan dhe vdiqën me nder dhe krenari, e emri dhe veprat e tyre mbetën të pavdekshme përgjithmonë. Bindja dhe dashuria e vërtetë ndaj Zotit dhe Pejgamberit, garanton shpëtimin dhe lumturinë edhe në jetën e gjithmonshme. Tregohet se Thevban bin Maliku e kishte dashur shumë Pejgamberin a.s.. Një ditë, ai u takua me Pejgamberin me fytyrë të dëshpëruar dhe mahzun. Pasi që Pejgamberi e pyeti se përse i është zbehur fytyra, ai iu përgjigj, duke i thënë: “O i Dërguari i Zotit, nuk jam i sëmurë e as nuk kam dhimbje, por kur nuk të shohë, mërzitem dhe përmallohem shumë derisa të takohem me ty, kam menduar në jetën e Ahiretit dhe kam

frikë që nuk do të shohë, për shkak se ti do të lartësohesh me pejgamberë, ndërsa, unë edhe nëse hy në xhenet, do të jem më ultë se ti me vend, por nëse nuk hy, atëherë nuk do të shohë kurrë.” Lidhur me këtë, Zoti xh.sh. i tha Pejgamberit a.s.: *“Kush i bindet Zotit dhe Pejgamberit, ata do të jenë me ata të cilët i ka begatuar Zoti, nga pejgamberët, njerëzit e singertë, dëshmorët dhe njerëzit e mirë, e sa shokë të mirë janë këta.”*

Tregohet nga Enesi (Zoti qoftë i kënaqur me të!), se një njeri erdhi te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti: “Kur është Kiameti o i Dërguari i Zotit?” Pejgamberi a.s. i tha: *“Çka ke përgatitur për të?”* Ai tha: “Nuk ka përgatitur shumë namaz, e as agjërim, as shumë sadaka (për nafile është fjala), por me të vërtetë e dua Zotin dhe Pejgamberin e Tij.” Me këtë rast, Pejgamberi a.s. i tha: *“Ti do të jesh me atë që e do.”*

Enesi thotë se, nuk jemi gëzuar për kurrë një send më shumë, pas fesë islame, sesa kur i tha Pejgamberi a.s.: *“Ti do të jesh me atë që e do.”*

Biball Habeshiu, ka qenë myezin i Pejgamberit a.s. dhe njëri ndër shokët e tij të dashur. Në momentin kur kishte ndërruar jetë, familja e tij qante nga pikëllimi, ndërsa ai gëzohej duke i thënë: “I lumi unë, nesër takohem me të dashurit, Muhamedin dhe shokët e tij.”

Bindja dhe dashuria ndaj Zotit xh.sh. dhe Pejgamberit a.s. është e vërtetë gjithashtu në qoftë se shprehim dashuri dhe respekt ndaj atyre që i zbatojnë urdhrat e Zotit dhe të Pejgamberit, ndërsa ndaj atyre që e kundërshtojnë Zotin dhe Pejgamberin, shprehim urrejtje - mos kënaqësi. Dashuria dhe vëllazërimi i besimtarëve të fesë islame ka karakter shpirtë-

ror, andaj nuk kufizohet në përkatësinë e gjakut, kombit ose atdheut, por ka karakter internacional dhe botëror. Zoti i Madhëruar ka thënë:

إِنَّمَا الْمُؤْمِنُونَ إِخْوَةٌ

“Me të vërtetë, besimtarët-myslimanët janë vëllezër...”

(El-Huxhurat, 10)

Dashuria ndërmjet tyre, duhet të jetë në emër të Zotit xh.sh., e singertë dhe jo për ndonjë interes, si dhe duhet të manifestohet edhe me vepra të përditshme. Lidhur me këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Pasha Atë që ma shpirtin në dorë, nuk keni për të hyrë në xhenet para se të besoni dhe nuk do të besoni (si duhet) derisa të duheni mes vete.”* *“Nuk ka besuar asnjëri prej jush, derisa ta dojë për vëllanë e tij atë që e dëshiron për vete.”* *“Shembulli i myslimanëve në pikëpamje të dashurisë dhe mëshirës ndërmjet vete, është sikur një trup, i cili kur ankon një gjymtyrë e tij, vuajnë edhe gjymtyrët e tjera nga pagjumësia dhe temperatura.”* *“Ai që nuk kujdeset për çështjen e myslimanëve nuk është prej tyre.”*

Shprehja e dashurisë ndaj atyre që janë fetarë, të pajisur me cilësi të mira morale dhe që bëjnë vepra të mira, të shoqëruarit dhe të miqësuarit me ta, është një dëshmi e mirë dhe dobi e madhe për këtë jetë dhe për jetën e gjithmonshme.

Në anën tjetër, nuk duhet të shprehim dashuri, as të shoqërohem dhe të miqësohem me ata të cilët na e kundërshtojnë dhe nënçmojnë fenë, dhe me ata që janë të prishur në pikëpamje morale, të cilët merren me punë të këqija dhe që i sjellin dëme njerëzimit. Me këta njerëz, nuk duhet pasur ko-

mpromis ose tolerim, pa marrë parasysh edhe në qofshim më të afërmit tanë. Lidhur me këtë, Zoti xh.sh. ka thënë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَتَّخِذُوا الَّذِينَ اتَّخَذُوا دِينَكُمْ هُزُؤًا ...

“O ju që keni besuar, mos i merrni për miq - dashamirë, ata që e marrin fenë tuaj për lojë dhe tallje...” (El-Maide, 57)

لَا تَجِدُ قَوْمًا يُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ يُوَادُّونَ مَنْ حَادَّ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَلَوْ كَانُوا آبَاءَهُمْ أَوْ أَبْنَاءَهُمْ أَوْ إِخْوَانَهُمْ أَوْ عَشِيرَتَهُمْ ...

“Nuk mund të gjesh popull i cili e beson Zotin dhe ditën e Ahiretit, e që i donë ata të cilët e kundërshtojnë Zotin dhe Pejgamberin e Tij, edhe në qoftë se ata janë prindërit e tyre, ose djemtë e tyre, ose vëllezërit e tyre ose farefisi i tyre...” (El-Muxhadele, 22)

Myslimani nuk guxon të lejojë që të tallet dhe që t’ia nënçmojë dikush besimin dhe bindjen e tij. Ai në çdo moment dhe me çdo kusht duhet të jetë i gatshëm për ta mbrojtur fenë islame, kurse në qoftë se vjen në një situatë të atillë, që nuk është në gjendje të dominojë në polemikë, atëherë duhet të largohet, ta bojkotojë atë vend ose shoqëri, se për ndryshe mund të ndikojë negativisht në bisedat e tyre antifetare dhe të kapitullojë. Praktikisht është vërtetuar se rrethi dhe shoqëria luajnë rol me rëndësi dhe ndikojnë shumë në edukimin dhe orientimin e njeriut. Për fat të keq, shumica e njerëzve që kanë devijuar nga besimi dhe që kanë marrë rrugë të gabueshme dhe vese të këqija, janë viktimë e rrethit dhe e shoqërisë së keqe. Pejgamberi a.s. e ka krahasuar ndejën dhe shoqërimin me njeriun e mirë, sikur ndejën me atë që shet miskë

- aroma të mira, ose që blen prej tij ose sa të qëndrosh me të, ndien aromë të mirë, ndërsa shoqërimin dhe ndejën me njeriun e keq, e ka krahasuar me qëndrimin me farkëtarin, që i frynë ershiqit, ose t'i djegë rrobat, ose ndien erën e keqe sa të qëndrosh me të. Dëmet dhe fatkeqësitë nga shoqëria e keqe, përveç në këtë botë, njeriun do ta përcjellin edhe në botën e gjithmonshme. Këtë, Zoti xh.sh. në disa vende në Kuran e paralajmëron në mënyrë figurative, duke i theksuar pendimet e pavlefshme të tyre pasi që të ringjallen, grindjet ndërmjet vete dhe mallkimet që do t'iu bëjnë atyre që kanë qenë shkaktarë për t'i mashtruar dhe larguar nga rruga e vërtetë. Lidhur me këtë, po i cekim tri raste nga Kurani, të cilat na rrëfejnë çështjen e tre lloj njerëzve, se di do të jenë pas ringjalljes në Ahiret:

1. Zoti xh.sh. ka thënë:

قَالَ قَاتِلْ مِنْهُمْ إِنِّي كَانَ لِي قَرِينٌ (٥١) يَقُولُ أَأَنْتَ لِمَنْ
 الْمُصَدِّقِينَ (٥٢) أَأَنْتَ أَتَى مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا وَعِظَامًا أَأَنْتَ لِمَدِينُونَ
 (٥٣) قَالَ هَلْ أَنْتُمْ مُطَّلِعُونَ (٥٤) فَاطَّلَعَ فَرَآهُ فِي سَوَاءِ
 الْجَحِيمِ (٥٥) قَالَ تَاللَّهِ إِنْ كِدْتَ لَتُرْدِينَ (٥٦) وَلَوْلَا نِعْمَةُ رَبِّي
 لَكُنْتُ مِنَ الْمُخْضَرِّينَ (٥٧)

“Njëri prej tyre (banorëve të xhenetit) do t'iu thotë (shokëve të vet): me të vërtetë e kam pasur një shok që më thoshte, vërtet je prej atyre që besojnë. A thua kur të vdesim dhe të bëhemi dhe (pluhur) e eshtra, do të dënohemi?! Do t'iu thotë atyre, a doni ta vështroni? Ai kur ta vështroj, do ta shohë në mjedis të xhehenemit

(zjarrit), dhe thotë: vallahi për pak më ke mashtruar. Sikur të mos ishte mirësia e Zotit, edhe unë do të ishte nga prezantuesit (në xhehenem).” (Es-Saffat, 51-57)

Në këto ajete është paraqitur çështja e një personi që e ka pasur një shok, i cili nuk ka besuar. Në biseda, shpeshherë në mënyrë nënçmuese dhe mohuese e ka pyetur, duke i thënë: A po beson që pasi të vdesim dhe të bëhemi dhe e eshtra, do të ngjallemi për t'u llogaritur dhe ndëshkuar?! Ky që besonte iu është përgjigjur pozitivisht, dhe duke mos dëgjuar aspak fjalët e tij, ka qëndruar i vendosur në besim deri në vdekje. Pas ringjalljes, ky do të shkojë në xhenet, ndërsa shoku i tij që nuk besonte në xhehenem. Banorët e xhenetit duke u kënaqur me begatitë - nimetet e xhenetit, do t'i rikujtojnë edhe ngjarjet që i kanë përjetuar në këtë botë. Me këtë rast, atij do t'i kujtohet shoku i tij i cili e ka mohuar ringjalljen dhe llogarinë pas vdekjes, e me ç'rast ju tregon shokëve të vet, duke iu thënë që të shkojnë dhe ta shohin. Kur shkon dhe e sheh në mjedis të zjarrit të xhehenemit, i thotë: Vallahi, për pak ke qenë edhe mua duke më mashtruar në dynja, sikur të mos ishte mirësia e Zotit, edhe unë do të isha prezent aty me ty, në xhehenem. Nga ky shembull kuptohet se çdonjëri që beson dhe qëndron i vendosur në besimin e tij, duke mos e dëgjuar shoqërinë që përpiqet për ta larguar nga besimi, ka për të qenë i lumtur në jetën e gjithmonshme. Ndërsa, çdonjëri që mohon fenë, ka për të qenë i dënuar me zjarr të xhehenemit.

2. Në suren Furkan, Zoti xh.sh., ka thënë:

وَيَوْمَ يَعِضُ الظَّالِمُ عَلَى يَدَيْهِ يَقُولُ يَا لَيْتَنِي اتَّخَذْتُ مَعَ الرَّسُولِ سَبِيلًا (٢٧) يَا وَيْلَتَى لَيْتَنِي لَمْ أَتَّخِذْ فُلَانًا خَلِيلًا (٢٨) لَقَدْ أَضَلَّنِي عَنِ الذِّكْرِ بَعْدَ إِذْ جَاءَنِي ... (٢٩)

“Në atë ditë (në Ahiret) do t’i kafshon duart e veta zu-llumqari (që nuk ka besuar) duke thënë: i mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit. I mjeri unë fatziu, mos ta kisha pasur filanin shok-mik, se ai me të vërtetë më largoi nga besimi pasi që më erdh...” (El-Furkan, 27-29)

Ky ajet thuhet se ka zbritur në lidhje me Ukbeh bin ebi Muajtín, i cili edhe pse nuk kishte besuar, i respektonte dhe i dëgjonte me vëmendje fjalët e Muhamedit a.s. Ai e kishte zakon që pas thyerjes nga udhëtimi të përgatiste zifafet, duke i ftuar miqtë dhe dashamirët. Me një rast, e ftoi në zifafet edhe Muhamedin a.s., i cili iu përgjigj në thirrje, por kur u shtrua sofrë, ai tha se nuk e ha bukën tënde pa rënë shehadet. Ukbe ia plotësoi dëshirën Pejgamberit dhe më pas ngrënën bukë me kënaqësi. Kur dëgjoi shoku i tij i ngushtë, Ubeje bin Halefi, për këtë çështje, i cili kishte qëlluar në rrugë, u dëshpërua shumë dhe i tha të paska mashtruar Muhamedin. Ukbe iu përgjigj, duke i thënë, jo, por ai refuzoi të hante bukë pa rënë shehadet. Mua më erdhi keq të dalë prej shtëpisë sime pa ngrënë bukë, andaj ia plotësova dëshirën. Me këtë rast, Ubeje i tha se fytyra jote është e ndaluar për mua derisa që ta takosh Muhamedin dhe ta pështysh në fytyrë. Ukbe e dëgjoi shokun e tij, por nesër në Ahiret do t’i kafshoj duart e tij me

dhëmbë nga dëshpërimi dhe pikëllimi. Ai pendohet, kukat dhe mjerohet pse nuk ka ndjekur rrugën e Pejgamberit, por e ka dëgjuar shokun e tij, i cili e ka devijuar nga besimi në Zotin dhe Pejgamberin e Tij, si dhe është bërë shkaktar për t'u djegur përgjithmonë në zjarr të xhehenemit. Kështu do të jetë fati i çdonjërit që largohet për hatër të shoqërisë nga rruga e Pejgamberit - Islamit.

3. Në suren Ahzab, Zoti xh.sh., ka thënë:

يَوْمَ تُقَلَّبُ وُجُوهُهُمْ فِي النَّارِ يَقُولُونَ يَا لَيْتَنَا أَطَعْنَا اللَّهَ وَأَطَعْنَا
الرَّسُولَ (٦٦) وَقَالُوا رَبَّنَا إِنَّا أَطَعْنَا سَادَتَنَا وَكُبَرَاءَنَا فَأَصْلُونَا السَّبِيلَا
(٦٧) رَبَّنَا آتِهِمْ ضِعْفَيْنِ مِنَ الْعَذَابِ وَالْعَنُّهُمْ لَعْنًا كَبِيرًا (٦٨)

“Në atë ditë (në Ahiret), kur fytyrat e tyre (të jobesimtarëve) rrotullohen në zjarr të xhehenemit, do të thonë, të mjerët ne, ta kishim dëgjuar Zotin dhe Pejgamberin. Dhe thonë: o Zoti ynë, ne i kemi dëgjuar prijësit dhe të mëdhenjtë tanë, andaj ata na kanë larguar nga rruga e vërtetë. O Zoti ynë, jepu atyre dënim të dyfishtë dhe mallkoj me mallkim të madh.” (El-Ahzab, 66-68)

Në këtë ajet, Zoti xh.sh. na paralajmëron për gjendjen e atyre njerëzve të cilët në vend se ta dëgjojnë dhe të binden ndaj Zotit dhe Pejgamberit, përkundrazi i dëgjuan zotërinjtë, udhëheqësit dhe njerëzit me autoritet prej tyre, ku për shkak të tyre devijuan nga rruga e vërtetë. Nesër, në jetën e gjithmonshme, kur këta njerëz do të digjen në zjarr të xhehenemit, do të pendohen dhe do të thonë, mjerët ne, ta kishim ta kishim dëgjuar Zotin dhe Pejgamberin, e të mos i kishim dë-

gjuar prijësit tanë, që na larguan nga rruga e vërtetë dhe u bënë shkaktarë për t'u dënuar. Në këtë mënyrë, ata mundohen të justifikohen, por ky pendim dhe justifikim nuk do t'iu bëjë dobi, për arsye se është vonë. Nga dëshpërimi për shkak të mashtrimit, do t'i luten Zotit, së paku që prijësit e tyre t'i dënojë dyfishë dhe të lëshojë mallkim të madh mbi ta.

Nga kjo kuptohet se ai që dëshiron shpëtimin dhe lumturinë e përhershme duhet që ta dëgjojë Zotin dhe Pejgamberin e Tij, e jo ata të cilët udhëzojnë në rrugë të gabuar, e cila është në kundërshtim me dëshirën e Zotit. Lidhur me këtë, Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Nuk ka dëgjueshmëri, bindje ndaj të krijuarit (njeriut) në kundërshtim me Krijuesin (Zotin).”* Prandaj, është e paarsyeshme dhe mëkat i madh të shprehurit e bindjes dhe dëgjimit me vullnet ndaj kujtqo qoftë, për interes apo nga frika, në ato çështje të cilat janë në kundërshtim me urdhrat e Krijuesit të gjithësisë - Allahut xh.sh.. Por, për fat të keq, shumica e njerëzve, sot janë shndërruar në adhurues dhe skllav të sunduesve, të udhëheqësve të drejtimeve të ndryshme filozofike dhe bazës materiale.

Kush mund ta njohë natyrën dhe nevojat e njerëzve më mirë se Ai që i ka krijuar? Kush mund t'i zgjedh në mënyrën më të drejtë dhe më të përsosur çështjet e tyre moralo-etike, sociale, kombëtare etj., se Zoti i Cili është i barabartë për të gjithë dhe nuk është i nevojshëm për asgjë? Kuptohet, natyrisht askush, andaj sa herë që ata, të kërkojmë rrugë më të drejtë dhe ligj ë të mirë se që e ka dërguar Zoti me anë të Muhamedit a.s., kanë për të hasur gjithnjë në vështirësi më të mëdha dhe në probleme të pazgjidhura. Në porosinë e fundit, Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Po ua lë dy gjëra, nëse veproni*

sipas tyre nuk keni për të humbur kurrë, librin e Zotit (Kuranin) dhe traditën - rrugën e Pejgamberit të Tij.” Me një rast tjetër, ai ka thënë: “Ai që e qet Kuranin para (që vepron sipas tij) i prinë për në xhenet, ndërsa ai që e qet mbrapa (që nuk vepron me të) i grahë për në xhehenem.

Islami është fe e cila na mëson se si duhet ta besojmë dhe ta adhurojmë Krijuesin tonë - Zotin xh.sh., dhe si duhet t’i rregullojmë marrëdhëniet ndër-njerëzore, për të jetuar në paqe dhe në harmoni, në familje, me fqinjë, me mysliman dhe me mbarë njerëzimin, pa dallim feje apo kombi. Si i tillë, ai është i nevojshëm dhe adekuat për të gjithë njerëzit për të gjitha vendet dhe për të gjitha kohërat, andaj parimet e tij janë gjithnjë aktuale dhe bashkëkohore.

Në fund, mund të themi se, ata myslimanë që janë të bindur dhe të dëgjueshëm ndaj Zotit dhe Pejgamberit të Tij, duke vepruar sipas udhëzimeve të tyre, kanë për të qenë të lumtur në këtë botë dhe në jetën e gjithmonshme, ndërsa ata që e kundërshtojnë Zotin dhe Pejgamberin e Tij, kanë për të jetuar të brengosur në këtë jetë dhe kanë për t’u ndëshkuar në jetën tjetër.

Resul ef. REXHEPI

RUAJTJA E TRADITAVE TONA NË RAMAZAN DHE NË BAJRAME

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ
مِنْ قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ .

***“O ju që keni besuar, ju është bërë detyrim agjërimi
ashtu siç qe bërë edhe për popujt para jush, ashtu që të
jeni të devotshëm!”¹***

Sa herë që afrohet muaji i Ramazanit, besimtarët tanë sikundër edhe myslimanët e botës, me kënaqësi të madhe dhe me plotë entuziazëm e presin ardhjen e këtij muaji mubareq e të bekuar.

Ata, që herët, fillojnë përgatitjet për ta pritur këtë muaj dhe për ta kaluar atë sa më mirë dhe në mënyrë sa më manifestive, të gëzuar e të hareshëm. Përgatitjet për muajin e bekuar të Ramazanit janë nga më të ndryshmet dhe në to përfshihen jo vetëm i zoti i shtëpisë, por që të gjithë anëtarët e familjes, madje edhe gratë dhe fëmijët, sepse po vjen një

¹ Kuran, El-Bekare, 183.

mysafir i bekuar e i bereqetshëm. Këto tradita e adete të miratonat në Ramazan e në Bajrame gjithsesi kanë domethënien e vet dhe duhet kultivuar edhe në të ardhmen. Prandaj, në vazhdim, krahas shpjegimit sheriatik të normave të Ramazanit dhe Bajramit dhe krahas traditës pejgamberiane, do t'i përmendim edhe disa tradita tona në Ramazan dhe në Bajrame, të cilat, sikurse u tha, edhe ato kanë mbështetje në Sheriat.

Gratë myslimane angazhohen në pastrimin e shtëpisë, oborrit, në pastrimin e shtrojave, në përgatitjet tjera të nevojshme, ndërkaq, burrat merren me blerjet e nevojshme të artikujve ushqimor në mënyrë që në syfyr e iftar sofrë e tyre të jetë sa më e begatshme. Ata nuk i harrojnë as fëmijët dhe më të rinjtë, e po ashtu edhe prindërit, të cilëve iu blejnë dhurata e peshqeshe të ndryshme me qëllim që për Ramazan e sidomos për Bajram t'i befasojnë këndshëm.

Nga ana tjetër, vëmendje e veçantë i kushtohet rregullimit dhe pastrimit të xhamive, rregullimit të dritave deri në minare, rregullimit dhe pastrimit të varrezave. Të gjithë i gëzohen ardhjes së këtij mysafiri kaq të dashur e të çmuar. Në kohët e mëhershme, në kalatë e qyteteve (si p.sh. në kalanë e Prizrenit), ose në ndonjë vend më të lartë, iftari shënohej me krisjen e topit, e më vonë edhe me anë të tupanit që tupanxhiu i binte në kohë iftari. Në shumë mjedise, urbane e rurale, me anë të tupanit zgjoheshin njerëzit në syfyr. Fatkeqësisht, këto tradita sa po vijnë e po zbehen dhe po bëhen të harruara. Gjatë kohës së komunizmit, topat i pushuan së krisuri nga kalatë, madje i hoqën fare nga aty, për të mos i rikthyer kurrë më në vend të vetin. Tashmë sikur na ka mjaftuar ndezja e dritave në minare

teksta myezini e thirr ezanin e akshamit-iftarit. Shumë shpresojmë se aroma e ezanit dhe salavateve, e ashereve dhe mukabeleve, e jasinave dhe hatmeve, e mevludeve dhe kelimeit-teuhidit, e zijareteve dhe vazi-nasihateve, e selamit dhe istigfarit, e iftareve dhe syfyreve gjithmonë dhe në vazhdimësi do të ndjehen mirë e më mirë. Është në frymën e Ramazanit dhe të Bajrameve që të hallallshtisemi me njerëzit që na rrethojnë, qoftë për ndonjë fjalë të ultë që mund t'i kemi thënë njëri-tjetrit apo për ndonjë gjest jo të mirë që mund të kemi bërë. Duhet dhuruar vetëm përqaftim e dashuri, këtë Zoti e do nga ne. Kështu bëhemi të devotshëm, e arrijmë gradën e devotshmërisë. Kjo kërkohet nga ne.

Nga tradita pejgamberiane duhet ta përmendim faktin se Muhamedi a.s., në veçanti nga koha kur agjërimi u bë farz - i detyrueshëm, ardhjes së Ramazanit i gëzohej tej mase, madje as'habët e tij i sihariqonte duke u thënë:

قَالَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ: قَدْ جَاءَكُمْ رَمَضَانُ شَهْرٌ مُبَارَكٌ افْتَرَضَ اللَّهُ عَلَيْكُمْ صِيَامَهُ، تُفْتَحُ فِيهِ أَبْوَابُ الْجَنَّةِ، وَ يُغْلَقُ فِيهِ أَبْوَابُ الْجَحِيمِ، وَ تُعَلُّ فِيهِ الشَّيَاطِينُ، فِيهِ لَيْلَةٌ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ...

“Ju erdhi Ramazani, muaji me plotë begati, Allahu ua ka bërë detyrim agjërimin e tij, për gjatë tij hapen dyert e Xhenetit ndërkaq mbyllën ato të Xhehenemit,

në të mbyllen (lidhën) shejtanët. Në të ka një natë që është më e vlefshme sesa një mijë muaj tjerë...!”²

Ramazani është rast ideal që përmes adhurimeve dhe ibadeteve që bëjmë gjatë ditëve dhe netëve të tij, të mund të pendohemi për gabimet tona dhe të kthehemi te Zoti duke i kërkuar falje Atij. Duke qenë agjërueshëm, me bark të unët, më së miri e kuptojmë edhe atë që ka nevojë për një kafshatë goje, edhe atë që është i varfër e nevojtarë. Prandaj, pikërisht në këto ditë, solidariteti dhe bamirësia duhet të shndrisin shpirtin tonë dhe të bëhemi sa më dorëdhënës e bujarë.

Agjërimi duhet të na shtyjë që të reflektojmë për dashurinë dhe respektin ndaj prindërve, ndaj fëmijëve, ndaj familjes, ndaj të afërmeve, jetimëve, skamnorëve, të mosshuarve dhe ndaj të gjithë atyre që kanë nevojë. E në Ramazan, këto punë dhe amele të hairit, sipas fjalëve të Pejgamberit a.s., shpërblehen edhe shtatëqind fish ma shumë.

Në anën tjetër, duke u bazuar në ndërgjegjen tonë, ne nuk guxojmë që të bëjmë ndonjë veprim që është i ndaluar dhe rrjedhimisht në kundërshtim me parimet themelore islame, sepse Pejgamberi a.s. ka thënë:

مَنْ لَمْ يَدَعْ قَوْلَ الزُّورِ وَالْعَمَلَ بِهِ فَلَيْسَ لِلَّهِ حَاجَةٌ فِي أَنْ يَدَعَ طَعَامَهُ
وَشَرَابَهُ

“Kush nuk heq dorë nga thënia e gënjeshtreve dhe veprimet e këqija duke qenë agjërueshëm, le ta dijë se

² Transmetojn: Nesaiu, Bejhekiu dhe Ahmedi nga Ebu Hurejreja r.a..

Allahu nuk ka nevojë për ndenjen e tij pa ngrënë e pa pirë!”³

Allahu i Gjithëmëshirshëm në këtë muaj të Kuranit, i hap dyert e mëshirës dhe mirësisë për të gjithë ata të cilët i zbu-kurojnë ditët dhe netët e tij me agjërim, me namaz, me lexim të Kuranit, me dua, e me bamirësi. Ata këtë e bëjnë sepse janë të bindur në thënien e Pejgamberit a.s.:

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ قَالَ: قَالَ رَسُولُ اللَّهِ: مَنْ صَامَ رَمَضَانَ إِيمَانًا وَاحْتِسَابًا
عُفِّرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ

“Kush e agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe duke e pritur shpërblimin vetëm nga Allahu, i falën mëkatet e kaluara!”⁴

Ramazani, - ky muaj i amnistisë së përgjithshme të Allahut ndaj robërve të Tij, muaj i përkushtimit drejt mirë-kuptimit të mesazhit hyjnor, muaj që na ofron mundësi për të trokitur në portën e mëshirës së Allahut xh. sh., është që na shtynë që ardhjes së tij t'i gëzohet gjithkush që ka qoftë ve-tëm një zerre imani e grimcë besimi.

Prandaj, nuk duhet humbur këtë rast ideal duke iu lutur Allahut për faljen e mëkateve tona, për pranimin e ibadeteve tona, për fisnikërimin e ndjenjave tona, dhe për përkushtimin për ta fituar kënaqësinë e Allahut. Sepse, këto mirësi na i ofron vetëm Ramazani, i vetmi muaj i përmendur në Kuran.

³ Transmeton Buhariu.

⁴ Transmeton Buhariu.

Lidhur më këtë, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Sikur ta dinin ymeti im se sa mirësi ofron Ramazani, do të dëshironin që i tërë viti të jetë Ramazan!”*

Të jetë Ramazan, sepse *“vetëm agjërimi i Ramazanit mund ta largojë fytyrën e besimtarit nga zjarri i Xhehenemit për 70 vjet distancë!”* - siç na ka treguar Pejgamberi i Mëshirës.

Të mos harrojmë edhe faktin se atë që nuk i shfrytëzon begatitë, mëshirën dhe faljen e mëkateve që na i ofron Ramazani, Pejgamberi e ka konsideruar fatkeq, kur ka thënë: *“Sa fatkeq është ai që e privon vetën nga mëshira e Allahut xh.sh. në muajin e Ramazanit!”*⁵

Agjërimi i Ramazanit

Agjërimi - **“saum”**, sipas Sheriatit do të thotë: *“ndërpreje e ngrënies, pirjes dhe e marrëdhënieve seksuale nga koha e agimit të hershëm e deri në mbrëmje (në perëndim të diellit), me qëllim të bërjes adhuring - ibadet”*. Këtu do të përqendrohemi tek agjërimi i muajit të Ramazanit.

Agjërimi i Ramazanit është një nga pesë kushtet-shartet e fesë islame. Është bërë obligim-farz në vitin e dytë të hixhretit, pak para betejës së Bedrit.

Vlerën dhe rëndësinë që ka ky lloj adhuringu/ibadeti më së miri e vërejmë nga ky hadithi kudsij, ku i Madhi Zot na ka mësuar shumë kohë më parë duke thënë:

⁵ Transmeton Muslimi.

عَنْ أَبِي هُرَيْرَةَ أَنَّ رَسُولَ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَالَ: قَالَ اللَّهُ تَعَالَى فِي حَدِيثٍ قُدْسِيٍّ: كُلُّ عَمَلٍ ابْنِ آدَمَ لَهُ إِلَّا الصَّوْمُ فَإِنَّهُ لِي وَأَنَا أَجْزِي بِهِ . وَ لِلصَّائِمِ .فَرَحَتَانِ يَفْرَحُهُمَا: "إِذَا أَفْطَرَ فَرِحَ بِفِطْرِهِ وَ إِذَا لَقِيَ رَبَّهُ فَرِحَ بِصَوْمِهِ. وَ لَرِيحٍ فَمِهِ أَطْيَبُ عِنْدَ اللَّهِ مِنْ رِيحِ الْمِسْكِ..."

“Çdo vepër e njeriut është e vet atij, me përjashtim të agjërimit, sepse atë e bënë vetëm për Mua dhe Unë do e shpërblej për atë. Për agjëruesin ka dy momente gëzimi: njëri, kur gëzohet me iftarin e tij, dhe tjetri, kur e takon Zotin e tij gëzohet me agjërimitin e tij. Aroma e gojës së agjëruesit është më e lezetshme te Allahu se sa aroma e miskut.”⁶

Përmes këtij lloj ibadeti, njeriu sikur e braktis përkohësisht aspektin trupor dhe i përkushtohet më shumë atij shpirtëror. Ai e lë ushqimin, pirjen, dëshirën e shprehur dhe kështu sikur lirohet nga lidhjet materiale të kësaj bote dhe synon t'i afrohet sa më shumë Allahut xh.sh.. Në këtë mënyrë, ai synon të arrij gradë të lartë të devotshmërisë dhe të përkushtimit ndaj të Gjithëmëshirshmit. Më pastaj, duhet thënë edhe një fakt tjetër se agjërimi i Ramazanit e cilëson në masë të madhe besnikërinë e njeriut ndaj Allahut të Lartësuar, ngase kur besimtari i jep besën Allahut se do agjëroj, ai do ta bëjë këtë edhe pa e vërejtur njeri. Durimi është cilësi e besimtarit të sinqertë, e agjërimit nuk mund të bëhet pa durim të boll-

⁶ Transmeton Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu, Ibni Maxhe dhe Nesaiu.

shëm. Prandaj, kur njeriu vendos të agjëroj, ai brumoset me durim dhe me sukses e përballon agjërimin, kurse sevapet e pakrahasueshme i vijnë nga Ai për të Cilin ka agjëruar - pra nga Allahu i Gjithëmëshirshëm. Sahabiu i quajtur Ebu Uma-me r.a., thotë: “Me një rast i kërkova Pejgamberit a.s. që të më thoshte për ta bërë një punë të domosdoshme, me të cilën do të kisha shpërblime. Më tha: *“Agjëro, sepse ai nuk krahasohet me asgjë”*. Unë e pyeta së dyti, dhe Pejgamberi a.s. më dha të njëjtën përgjigje. Unë insistoja edhe për të tretën herë, e Pejgamberi a.s. prapë ma dha po atë përgjigje: *“Agjëro, sepse agjërimi nuk krahasohet me asgjë!”*”

Me një rast tjetër, përsëri për agjërimin, Pejgamberi a.s. kishte thënë: *“Tek Allahu nuk ka adhurim tjetër që të ketë shpërblim sa agjërimi”*.⁸ Madje, Pejgamberi a.s. kishte shtuar se *“Në Xhenet është një portë nga hyjnë vetëm ata që agjërojnë.”* Ajo quhet *“babu rejjan”* e dedikuar, nga i Gjithëmëshirshmi, ekskluzivisht vetëm për ata që agjërojnë.

Dobitë e agjërimit

Nuk ka dyshim se agjërimi i muajit të Ramazanit ka dobi të shumëfishta dhe nga shumë aspekte, e mbi të gjitha në atë shpirtëror dhe trupor.

Aspekti shpirtëror i njeriut ia kujton atij qëllimin e krijimit, kështu që ai e shtynë njeriun të bëjë gjëra të mëshirshme, të përshpirtshme, ta luftojë të keqën duke u larguar

⁷ Transmeton Nesaiu.

⁸ Transmeton Nesaiu.

gjithmonë nga ajo. As edhe një herë nuk ka qenë qëllimi i besimtarit vetëm si me ngrënë e me pi, dhe asgjë më shumë. Ai që e njeh Krijuesin e tij, ai që i bënë ibadet Atij, ai që e di se pse është krijuar dhe pse ka ardhur në këtë botë, rëndësi meritore i kushton edhe kënaqësisë shpirtërore e jo epshit dhe egos së tij të sëmurë. Mbi të gjitha, agjërimi i kujton njeriut takimin me Allahun e Gjithëmëshirshëm. Në të vërtetë, kjo e bënë njeriun që duke e paramenduar dhe duke shpresuar në takimin me Zotin, të harrojë vështirësitë e urisë dhe etjes, kështu që ai në fund të ditës as që e heton se është me bark të uritur ose se ka etje. Kjo mbase edhe njeriun e ngre në shkallë engjëjllore.

Qarqet mjekësore tashmë kanë vërtetuar se sistemi i tretjes, i cili fillon të funksionojë sapo foshnja të vijë në këtë botë, ka nevojë që herë pas here të pushojë, kështu që një muaj në vit do ta mundëson agjërimi. Nxënësit, pas mësimit disa mujor, shkojnë në pushim meritator. Edhe punëtorët që kanë punuar në mënyrë permanente, a nuk e meritojnë një pushim vjetor?! Gjithsesi po! Ndryshe, nuk do të mundnin gjatë që të mbanin ritmin e punës ose të mësimit. Sot në botë janë një kategori e njerëzve që kërkojnë andej-këtej shpëtim nga obeziteti, sa kohë që mjekësia e ka pranuar se obeziteti bëhet pengesë për qarkullimin e gjakut dhe funksionimin e ngadalshëm të trupit. Kurse, tashmë dihet se agjërimi është edhe shpëtim për këto sëmundje, edhe pretekst i rëndësishëm për të fituar mirësi e shpërblim. Pastaj, gjatë agjëritit ushqimet e depozituara në organizëm harxhohen, më pas zëvendësohen me të reja dhe në këtë mënyrë në tërë trupin ndodh një rinovim, gjë që vërteton se agjërimi është i dobishëm për trupin.

Gjithashtu, duhet theksuar se gjatë agjërimit sistemi nervor është në një qetësi absolute. Kënaqësia që na jep kryerja e një adhurimi, i shuan të gjitha tensionet dhe pakënaqësitë tona. Në këtë mënyrë, shmangën streset, të cilat janë problemet më të mëdha të ditëve të sotme. Agjërimi është rruga më e efektshme për të siguruar sundimin e shpirtit mbi trupin, me qëllim që njeriu të mos bëhet robi i prirjeve materiale, që të bëjë një jetë ku t'i ketë në duar frerët e nefsit. Nuk duhet harruar se “agjërimi e rrit rezistencën e trupit ndaj sëmundjeve. Këtë të vërtetë mjekësore të rëndësishme, Islami e ka zbatuar duke e bërë agjërimin të detyrueshëm, kurse mjekësia e sotme moderne e përdorë agjërimin si mbrojtës dhe ilaç kundër sëmundjeve. Megjithatë, ndonëse dobisë e agjërimit janë të shumta dhe nga shumë aspekte, e edhe për shëndetin e njeriut, ne nuk duhet të agjërojmë me qëllim të përfitimeve shëndetësore, por për të zbatuar urdhrin e Allahut, për të arritur kënaqësinë e Tij dhe për të arritur shkallë sa më të lartë të devotshmërisë.

Agjërimi, krahas dobive të përmendura më sipër, ai në veçanti e mbron njeriun nga mëkatet, sepse njeriu është i disponuar për të bërë mëkate vazhdimisht. Gjithsesi, njeriut i duhet një vullnet i fortë për ta mbrojtur nga mëkatet. Prandaj, përballë këtij rreziku të përhershëm, agjërimi e ka vlerën e një garantuesi dhe vepron si mburojë që e mbron të zotin për të mos bërë mëkat. I Dërguari i Zotit ka thënë:

يَا مَعْشَرَ الشَّبَابِ مَنْ اسْتَطَاعَ مِنْكُمُ الْبَاءَةَ فَلْيَتَزَوَّجْ فَإِنْ لَمْ يَسْتَطِعْ
فَعَلَيْهِ بِالصَّوْمِ فَإِنَّهُ لَهُ وَجَاءٌ

*“O djelmosha! Kush nga ju të ketë mundësinë për t’u martuar, le të martohet, sepse kjo (martesa) është mbrojtëse për sytë (nga shikimi i gjërave të ndaluara). E kush të mos jetë në gjendje për t’u martuar, le të agjëroj, sepse agjërimi është për të një mburojë.”*⁹

Besimtari gjatë kohës sa agjëron, përveç tjerash, fiton përvojë për t’iu kundërvënë dëshirave negative trupore. Kështu që duke arritur që t’i braktisë këto dëshira duke agjëruar, atë më lehtë do ta bëjë edhe kur nuk agjëron, sepse agjërim nuk do të thotë vetëm ta lësh stomakun e uritur, përkundrazi, do të thotë që edhe pjesët e tjera të trupit, si: sytë, veshët, zemrën, dorën, këmbën, imagjinatën, mendjen etj. t’i pengosh nga gjërat e ndaluara e mëkatore dhe secilën prej tyre ta shtysh drejtë përjetësisë sipas veçorive të secilës. Prandaj, personi që agjëron në këtë mënyrë, bënë një jetë me veprime të lejuara-hallall e të bekuara. Pejgamberi a.s. me një rast ka thënë: *“Kush më jep garanci se do ta ruaj gojën dhe nderin, edhe unë do t’ia garantoj Xhenetin!”*¹⁰

Agjërimi është rruga më e efektshme për ta mbajtur fenë nën kontroll, detyrimet fetare i kryen me kënaqësi e sinqeritet dhe nga ana tjetër e ndalon nefsin nga fjalët dhe veprimet e këqija. Prandaj, Pejgamberi a.s. ka rekomanduar: *“Në ditët*

⁹ Transmeton Buhariu, Nesaiu dhe Ibni Maxhe.

¹⁰ Transmeton Buhariu.

*kur dikush nga ju është duke agjëruar, të mos i thotë fjalë të shëmtuara tjetrit, të mos çirret e të mos bërtas. Po që se dikush e shanë ose e godet me dorë, le t'i thotë, "unë jam duke agjëruar!"*¹¹ Kjo është edhe skalitja që i bënë njeriut për të duruar. Me anë të këtij ibadeti, njeriu merr mësimë durimi, sepse po të jetë i uritur, nuk ha, po të jetë i etur nuk pi ujë, e përballë të këqijave që mund t'i bëhen, duron duke thënë:

إني صائم إني صائم *"unë jam agjërueshëm"*. Agjërimi ia mëson njeriut se si është ndjenja e skamnorit dhe të varfrit, që nuk kanë me se të ushqehen, me se të ushqejnë familjet e tyre, fëmijët dhe prindërit e tyre. Kështu që, kur njeriu agjëron, kur stomaku i tij i uritur, i zbrazët, kërkon të ushqehet, më se miri e ndjenë se sa vështirë e ka ai që në vazhdimësi e ka stomakun e uritur. Përmes agjërimit, njeriu mbase e bënë edhe një lloj solidariteti me ta.

Syfyri

Pas arritjes në shtëpi nga xhamia, pas faljes së teravisë së parë, kënaqësi dhe gëzim i veçantë është përgatitja dhe pritja e syfyrit. Fëmijët i gëzohen kësaj jashtë mase, aq sa i lusin prindërit e tyre ose ndokënd nga familja që t'i zgjojnë për syfyr. Dhe kjo është e mirë, në mënyrë që ata edhe në atë moshë të fitojnë traditë islame e kënaqësi Ramazani. Është sevap me u ngrit në syfyr, sepse aty ka bereqet. Enes bin Maliku r.a. transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: *"Ngrihuni*

¹¹ Transmeton Buhariu, Nesaiu dhe Ahmet b. Hanbeli.

në syfyr se në ngritjen dhe ngrënien e syfyrin ka bereqet!”¹²

Kurse në një hadith tjetër, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Fuqizojeni agjërimin e ditës me ngrënien e syfyrin dhe namazin e natës (tehexhud) me gjumin e pasdrekes!”* Natyrisht që ngritja në syfyr, i jep hijeshi agjërimin, dhe, nga ana tjetër, vetëm sa e fuqizon trupin që agjërimin ta përballoj ma lehtë.

Është mustehab, që ngrënia e syfyrin të shtyhet deri vonë, natyrisht, brenda limiteve të caktuara, pa e tejkaluar kohën e imsakut. Nga ana tjetër, edhe iftari duhet të bëhet sa po të hyjë koha, pra sapo të perëndoj dielli. Lidhur me këtë, Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Njerëzit do të jetojnë në mbarësi për sa kohë e shpejtojnë iftarin dhe e shtyjnë ngrënien e syfyrin (deri në limitet e lejuara)”* Prandaj, syfyri është mirë të shtyhet deri në kohën e imsakut, kurse 20 minuta më vonë mund të falët namazi i sabahut. Lidhur me këtë, Zejd bin Thabiti ka një rrëfim të tijin: *“Ne hanim syfyr bashkë me Pejgamberin a.s., e pastaj e falnim namazin e sabahut!”*. Enesi e kishte pyetur: *“Sa kohë kishte kaluar mes syfyrin dhe namazit të sabahut?”*

- Sa për t’i lexuar 50 ajete - iu kishte përgjigjur ai.

Duke u bazuar në këtë rast, disa dijetarë kanë pohuar se ky interval kohor është i mjaftueshëm sa për të lexuar suren “El-Hakka” që ka 52 ajete ose suren “El-Murselat” e që ka 50 ajete.

¹² Transmeton Buhariu.

Nijeti - qëllimi për të agjëruar

Një kusht tjetër i rëndësishëm i agjërimit është edhe *nijeti*, sepse duke qenë se agjërimi është ibadet, e ibadeti duhet të ketë edhe nijetin (qëllimin) për t'u llogaritur i saktë.

Për agjërimin e Ramazanit, agjërimin e ditëve të premtuara e të caktuara në kohë dhe ato që janë *synet* e *nafile*, nijeti bëhet nga akshami që i paraprinë ditës e deri pak para mesditës së ditës që e agjëron. Nijeti në këto raste mund të bëhet edhe para agimit, por edhe deri pak para drekës së ditës kur agjëron. Në fakt, nijeti i bërë në mbrëmje është më i pëlqyer. Në qoftë se pas imsakut personi nuk ka ngrënë, nuk ka pirë si dhe nuk ka bërë ndonjë veprim që e prish agjërimin e nuk e ka bërë nijet, i lejohet ta bëjë nijetin deri në drekë (kur dielli arrin në zenit).

Ndërkaq, për agjërimin e ditëve të prapambetura të Ramazanit, të gjitha llojet e agjërimit *kefaret*, agjërimi *nafile* i prishur dhe ai i premtuar (i përcaktuar në kohë), - për të gjitha këto nijeti bëhet natën para imsakut.

Personi që nuk dëshiron të ngritët në syfyr, nijetin duhet ta bëjë paraprakisht në mbrëmje dhe kështu nuk ka nevojë të zgjohet (në syfyr) vetëm sa për ta bërë nijetin. E mjaftueshme për të është që me zemër ta vendos se do ta agjërojë ditën e nesërme, dhe nijeti i tij është i vlefshëm. Edhe vetëm zgjimi për të ngrënë syfyr, është, në vete, nijet dhe konsiderohet i saktë dhe i mjaftueshëm.

Nijeti i agjërimit vetëm me zemër është i mjaftueshëm, e në qoftë se ai shoqërohet edhe me gjuhë, është ku e ku më i vlefshëm. Prandaj, agjëruesi duhet ta bëjë nijetin edhe me zemër edhe me gjuhë, duke thënë: "*Vendosa për hir të Allahut*

me e agjërua ditën e nesërme të Ramazanit". Këtë e bënë për çdo ditë të Ramazanit.

Iftari

Ka qenë praktikë e Pejgamberit a.s. që njëherë të bënte iftar e pastaj ta falte namazin e akshamit. Zakonisht iftar bënte me dy-tri kokrra hurme, e nëse i mungonin ato, e pinte pak ujë, më pas e falte namazin e pas tij hante iftar. Lidhur me nxitimin e bërjes iftar, Pejgamberi a.s. ka thënë edhe këtë: *"Më i dashuri i robërve të mi është ai që nxiton për të bërë iftar!"*

Deri sa jemi te etika e iftarit, le të themi edhe këtë se iftarit është mirë t'i paraprijë ndonjë lutje-dua, për faktin se është kohë kur lutja e lutësit që është duke agjëruar është e pranuar tek Allahu i Gjithëmëshirshëm. Madje, me këtë rast rekomandohet në veçanti kjo dua që e bënte edhe Pejgamberi a.s.:

اللَّهُمَّ لَكَ صُيِّمْتُ وَبِكَ آمَنْتُ وَعَلَيْكَ تَوَكَّلْتُ وَعَلَى رِزْقِكَ أَفْطَرْتُ

"Allahu ynë, për Ty agjërova, Ty të besova, tek Ti u mbështeta dhe u dorëzova dhe me atë që më ke dhënë iftar bëra!"

Sa bukur e gëzim ka qenë kur fëmijët me diç në dorë si petull, llokum, sheqerka ose shumë rrallë edhe ndonjë hurme, prisnin zërin e tupanit për të bërë iftar. Sa mirë do ishte sikur edhe sot fëmijët ta lëshojnë për pak çaste telefonin nga dora e të presin tupanin për të bërë iftar.

Është mirë që gjatë Ramazanit dikujt me i dhënë iftar, sado pak qoftë, madje pak hurme, ujë, iftar të plotë apo diçka tjetër. Pejgamberi a.s. thoshte: *"Kush i jep dikujt iftar, ai ka*

sevape sikurse agjëruesi, megjithëse agjëruesit nuk i mungohet nga sevapi tij!”¹³

Gjatë Ramazanit në veçanti, duhet spikatur aspektin human, njerëzor e besimor. Ndaj familjarëve duhet të sillemi me korrektësi e mirësi, kurse ndaj të varfërve e skamnorëve duhet treguar më shumë humanitet e bujari.

عَنْ إِبْنِ عَبَّاسٍ، قَالَ: كَانَ رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ أَجْوَدَ النَّاسِ وَكَانَ أَجْوَدَ مَا يَكُونُ فِي رَمَضَانَ حِينَ يَلْقَاهُ جَبْرِيلُ

Transmetohet nga Ibni Abasi të ketë thënë se: “*Pejgamberi a.s. ishte njeriu më bujar e bamirës, ndonëse akoma më shumë ishte gjatë Ramazanit kur dhe e takonte Xhibrili!*”¹⁴

Koha e agjërimit

Se kur fillon dhe kur mbaron një ditë e agjërimit, kjo është përcaktuar me Kuran. Allahu i Madhërishëm, lidhur me këtë, ka thënë:

... وَكُلُوا وَاشْرَبُوا حَتَّى يَتَبَيَّنَ لَكُمُ الْخَيْطُ الْأَبْيَضُ مِنَ الْخَيْطِ الْأَسْوَدِ مِنَ الْفَجْرِ ثُمَّ أَتُمُوا الصَّيَّامَ إِلَى اللَّيْلِ ...

“... dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë (bardhësia e agimit) nga peri i zi (errësira e natës)

¹³ Transmeton Termidhiu.

¹⁴ Transmeton Buhariu.

***në agim, e pastaj agjërimin plotësoni deri në mbrëm-
je...”¹⁵***

Allahu i Madhërishëm në këtë ajet kuranor në mënyrë alegorike e ka përmend *fijen e bardhë* dhe *fijen e zezë*. Pra, bardhësia e ditës dhe errësira e natës, gjegjësisht momenti kur në kushte normale ato dallohen, është koha e fillimit të agjërimit, i cili duhet të zgjas derisa të bjerë mbrëmja. Mirëpo, në kohën më të re, mjetet tekniko teknologjike aq shumë kanë avancuar saqë na e tregojnë shumë saktë, deri në sekonda, se kur duhet filluar dhe kur duhet mbaruar një ditë të agjërimit.

Mukabelja-leximi i Kuranit

Allahu xh. sh. na ka treguar se:

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنْزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنَ
الْهُدَى وَالْفُرْقَانِ

“Muaji i Ramazanit në të cilin u zbrit Kurani, që është udhërrëfyes për njerëzit dhe me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së drejtës dhe të gabuarës).”¹⁶

E pra, gjatë muajit të Ramazanit, ka zbritur Kurani, pra ndaj një nga veprimet e mira që duhet të bëjë besimtari është edhe leximi i shpeshtuar i Kuranit. Pejgamberi a.s. e kishte bërë praktikë që gjatë Ramazanit të lexonte shumë Kuran.

¹⁵ Kuran, El-Bekare: 187.

¹⁶ Kuran, El-Bekare: 185.

Ibni Abbasi kështu e përshkruan marrëdhënien e Pejgamberit me Kuranin gjatë muajit të Ramazanit:

“I Dërguari i Zotit ishte më bujari mes njerëzve. Ndërsa kulmi i bujarisë së tij ishte në muajin e Ramazanit kur takohesh shpesh me Xhibrilin. Çdo natë të Ramazanit Xhibrili takohet me Pejgamberin a.s. dhe të dy e lexonin Kuranin përballë njëri-tjetrit...!” Në fillim ia lexonte Muhamedi a.s. e kjo quhej *“ard” (paraqitje)*, e më pas të njëjtat pjesë i lexonte Xhibrili dhe kjo quhej *“mukabele” (karshillëk)*. Këto makabele gjatë ditëve dhe netëve të Ramazanit për shekuj me radhë janë lexuar tradicionalisht si një trashëgimi e bukur thuajse në të gjitha xhamitë gjithandej nëpër botë, e edhe te ne në Kosovë, saqë janë bërë të thuash pjesë e pandarë e agjërimit dhe e Ramazanit. Disa qytete si Shkodra, Prizreni, Mitrovica, Shkupi, Tetova, Tirana e shumë të tjera kanë pas një traditë madje disa shekullore për aplikimin e mukabelës. Disa edhe sot e vazhdojnë me shumë sukses. Në shumë vakëfname, vakflënësit e kanë precizuar që në xhaminë e tij “për çdo ditë të Ramazanit të lexohen nga dy xhuza nga Kurani..., e lexuesit e këtyre, pra hafëzët të shpërblehen nga vakëfi që ai ka vakufuar me nga 500 akçe...” Imagjinoje sikur në xhaminë qendrore të qytetit, pesë hafëzë çdo ditë të Ramazanit të lexonin përmendsh Kuran, kurse disa dhjetëra xhematlinjë me Mus'haf në dorë duke i përcjellë ata. Prandaj, është shumë mirë nëse ata që dinë të lexojnë Kuran, së paku të bëjnë një hatme gjatë Ramazanit, ndërkaq ata që nuk dinë të lexojnë të përcjellin leximin e Kuranit nga hafëzët që me zërin e tyre aq të ëmbël jo vetëm se bëjnë ibadet por edhe ia shtojnë aq shumë bukurinë xhamisë dhe xhematit.

Pararendësit tanë këto me dashuri i praktikuan sepse, përveç tjerash, ishin shumë të sigurt se leximi i Kuranit do të bëhet ndërmjetësues për lexuesit e tij, atë ditë kur njerëzit më së shumti do të kenë nevojë për ndërmjetësim:

إِقْرُوا الْقُرْآنَ فَإِنَّهُ يَأْتِي يَوْمَ الْقِيَامَةِ شَفِيعًا لِأَصْحَابِهِ

“Lexojeni Kuranin, se ai në ditën e Kiametit do të jetë ndërmjetësues për lexuesit e tij!”¹⁷ - ka thënë Pejgamberi a.s..

Namazi i teravisë

Ndër karakteristikat e Ramazanit dhe që është dukshëm e theksuar edhe tek ne -falë Zotit-, është edhe e falja e namazit të teravive. Namazin e teravive kanë qejf me e falë edhe fëmijët, dhe, ndonëse ndonjëherë janë më të zhurmshtëm se zakonisht, megjithatë ata ia shtojnë bukurinë xhamisë dhe xhematit. Kjo është një traditë e mirë dhe ata gjithmonë duhet afruar sa ma shumë afër xhamisë.

Përndryshe, namazi i teravisë është i kategorisë *syneti-muekkede-synet i fortë*, e edhe të falurit e këtij namazi me xhemat është i po kësaj kategorie. Koha e faljes së tij është pas faljes në namazit të jacisë e para atij të vitrit. Lum për atë mysliman që arrin që ditën e Ramazanit ta plotësojë me agjërim kurse natën e tij me namaz të teravisë. Ky namaz përbëhet nga njëzetë rekate siç e kanë falur gjithmonë *Ehli synneti* me xhemat. Rëndom selam jepet pas çdo katër rekateve. Pas

¹⁷ Transmeton Muslimi.

selamit, i tërë xhemati marrin tri tekbire ose tri salavate. Xhamitë kumbonin me salavate kështu që duke pushuar, Pejgamberit i këndonin salavateve, e kjo ka dhuruar kënaqësi të vërtetë. Te ne në Kosovë, ka qenë traditë që ky namaz të falët në xhami ose mesxhid, e në mungesë të tyre edhe në oda më të mëdha në fshatra, madje edhe në zonat më të thella.

Është edhe një traditë e cila ka zënë vend tash e gjysmë shekulli te ne në Kosovë dhe në disa vende të rajonit. Fjala është për programin që e bënë shërbimi kompetent i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, të cilin e miraton vetë Kryesia në prag të Ramazanit, sipas të cilit grupin e zgjedhur nga nëpunësit e Kryesisë, profesorët e FSI-së dhe ata të Medresesë për namazin e xhumasë dhe namazin e teravive i vizitojnë xhamitë dhe xhematët e ndryshme gjithandej nëpër Kosovë. Jo rrallëherë gjatë një Ramazani është arritur të vizitohen dhe të mbahen ligjëratat në mbi 350 xhami. Edhe kjo ka qenë fre-ski më vete për xhematin. Personalisht mendoj se kjo traditë, me pak modifikime, ndryshime e plotësime që patjetër duhet t'i bëhen, gjithsesi duhet të vazhdoj.

Dhjetë ditët e fundit të Ramazanit dhe Nata e Kadrit

Gjatë Ramazanit, kur afrohej dhjetëditëshi i fundit, ibadetet dhe veprat tjera të mira myslimanët i shtojnë ku e ku ma shumë. Janë këto ditë për të cilat Pejgamberi ka thënë se janë *“itkun minen-niran”* - *“amnisti nga zjarri i xhehenemit”*. E dinë se gjatë asaj kohe është edhe nata e madhe e Kadrit, prandaj dëshirojnë ta shfrytëzojnë maksimalisht gjithnjë duke shpresuar në rahmetin dhe faljen e Allahut të Gjithëmëshirshëm. Kanë qenë udhëzimet e hoxhallarëve vendor që iu

kanë sugjeruar myslimanëve që zekatin e tyre ta japin sidomos në këtë kohë, sadakatu 'l-fitrin ta paguajnë në këtë kohë, sadakatë tjera t'i japin sidomos në këtë kohë. Në prag të Bajramit, njerëzit i kanë vizituar dhe rregulluar edhe varrezat e të afërmeve të tyre.

Kjo e ka pas mbështetjen e fortë në pohimin e Pejgamberit a.s., se çdo vepër e mirë që e bënë besimtari në këtë kohë shpërblimin nga Zoti e ka të shumëfishtë. Dhe kështu, ibadet pas ibadeti, sevap pas sevapi, e kanë prit ditën e Bajramit.

Intensitetin e veprave të mira besimtarët tanë e kanë shtuar në veçanti në natën më të vlefshme të vitit-në natën e Kadrit. Kjo, për faktin se nata e Madhe e Kadrit është nata më e bekuar dhe më e begatshme që na ka dhuruar i madhi Zot. Këtë e konfirmon Kurani fisnik kur thotë:

حَمِّهِ. وَالْكِتَابِ الْمُبِينِ. إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةٍ مُبَارَكَةٍ إِنَّا كُنَّا مُنْذِرِينَ.
فِيهَا يُفْرَقُ كُلُّ أَمْرٍ حَكِيمٍ. أَمْرًا مِنْ عِنْدِنَا إِنَّا كُنَّا مُرْسِلِينَ. رَحْمَةً
مِنْ رَبِّكَ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ.

“Hâ, Mîm. Betohem në librin sqarues (të së drejtës nga e kota). Ne e zbritëm Kuranin në një natë të bekuar (në Natën e Kadrit). Vërtetë Ne gjithmonë u kemi tërheq vërejtjen (i kemi paralajmëruar) njerëzit. Në atë natë zgjidhet çdo çështje e urtë. Urdhër i përcaktuar nga vetë Ne, e s’ka dyshim se Ne dërguam të dërguar, si mëshirë prej Zotit tënd. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha!”¹⁸

¹⁸ Kuran, Ed-Duhan: 1-5.

Pejgamberi a.s., ndërkaq, me një rast, për këtë natë kishte thënë:

“Në Ramazan është një natë, e cila vlen më shumë se një mijë muaj. Kush nuk e shfrytëzon atë natë, kush mbetet i privuar nga mirësia e asaj nate, ai edhe më tej do të jetë i pafat!”

Fitër-Bajrami

Dita e Fitër-Bajramit është dita kur besimtarët myslimanë gjithandej globit, e edhe në vendin tonë, festojnë. Festojnë të gëzuar, të lumtur, të qetë e me maturi dhe sipas rregullave të fesë islame që i ka paraparë ajo edhe në raste gëzimi e festimi.

Namazi i Bajramit është vaxhib. Mundësitë për t’u lutur, për të bërë ibadet dhe për të bërë mirë, Zoti kurrë nuk na i ka mbyllë, sikurse që nuk na i ka ndërprerë as nimetet dhe begatitë e Tij që s’kanë të numëruar.

Edhe me vëllezërit tanë do të solidarizohemi, sikurse kemi bërë gjithmonë, dhe sofrën e tyre boshë nuk do ta lëmë. Ne duhet të vishemi, sipas traditës, me teshat tona më të mira, edhe fëmijët tanë do t’i gëzojmë me dhurata e peshqeshe, sepse Bajram është.

Para se të hyjmë në shtjellimin e disa elementeve më kryesore që kanë të bëjnë me festën e Bajramit, edhe njëherë e falënderojmë të Madhin Zot që na mundësoi që me aq lehtësi ta kryejmë agjërimin e muajit të Ramazanit. Mësimet, porositë dhe urtësitë që i kemi fituar duke e kryer këtë ibadet kaq

të çmueshëm, le të na shërbejnë edhe pas këtij muaji, kurse lutjeve ndaj Zotit mos tu ndalemi asnjë herë.

Në fenë islame, festat kryesore janë: Bajrami i Madh dhe Bajrami i Vogël.

Festa e Fitër-Bajramit bie ditën e parë e muajit Shevval, sapo të rihet Hëna, kurse ajo e Bajramit të vogël ditën e dhjetë të muajit Dhul-hixhxe. Duke qenë se festat tona lidhen me muajt hënorë, është e natyrshme se ato bien në çdo stinë të vitit, kështu që na bie t'i shijojmë edhe në verë edhe në dimër, edhe kur është dita më e gjatë edhe kur është më e shkurtër. Studiuesit e vëmendshëm të “Sîres” (Jetëshkrimit) së Resulullahut kanë vërejtur se, ndonëse këto janë normuar në vitin e parë të hixhretit, festimi i këtyre dy bajrameve ka filluar të festohet në vitin e dytë pas hixhretit.¹⁹ Bajramin e parë të cilin e ka falë Pejgamberi a.s. ka qenë Fitër-Bajrami në vitin e dytë të hixhretit. Asokohe është rregulluar si dispozitë edhe Sadakatu'l-Fitri.

Nocioni “fitr” origj. عيد الفطر e ka kuptimin “kthim në natyrshmëri”, kthim në regjimin e ushqimit etj., si zakonisht që e kemi gjatë njëmbëdhjetë muajve tjerë. E, meqë kjo ditë është ditë feste, atëherë është e udhës që gajlet, telashet, pikëllimet e të ngjashme duhet lënë anash, kurse gëzimi e hareja duhet të dominojë në ambientet myslimane. Prandaj, Pejgamberi a.s. me një rast ka thënë:

¹⁹ Grup autorësh, *Islami nëpërmjet haditheve*, vëll. 7, fq. 494.

لِكُلِّ قَوْمٍ عِيدٌ وَ هَذَا عِيدُنَا

“Çdo popull i ka festat e veta, kjo është festa jonë!”²⁰

Në të vërtetë, kur Pejgamberi a.s. qe vendosur në Medinë, kishte vërejtur se njerëzit aty i festonin dy ditë, e pasi i treguan se ç’ ishte ky manifestim, ai, sikurse tregon Enes bin Maliku, kishte thënë:

عَنْ أَنَسٍ، قَالَ قَدِمَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ الْمَدِينَةَ وَهُمْ يَوْمَانِ يَلْعَبُونَ فِيهِمَا فَقَالَ "مَا هَذَانِ الْيَوْمَانِ؟". قَالُوا كُنَّا نَلْعَبُ فِيهِمَا فِي الْجَاهِلِيَّةِ. فَقَالَ رَسُولُ اللَّهِ ﷺ "إِنَّ اللَّهَ قَدْ أَبْدَلَكُمْ بِهِمَا حَيْرًا مِنْهُمَا يَوْمَ الْأَضْحَى وَيَوْمَ الْفِطْرِ"

Enes bin Maliku ka thënë: “Në kohën që Pejgamberi erdhi në Medinë, njerëzit argëtoheshin dy ditë. Ai pyeti: Ç’farë janë këto ditë që po festoni? Ata iu përgjigjën se në kohën e injorancës argëtoheshin gjatë atyre dy ditëve. Pas kësaj Pejgamberi deklaroi: “*Pa dyshim se Allahu ato festa i ka zëvendësuar me dy festa më të mira dhe më të vlefshme, e ato janë: Kurban-Bajrami dhe Fitër-Bajrami!*”²¹

Sigurisht që veçoria më e madhe e mëngjesit të kësaj dite të Fitër-Bajramit është se dua ja e atij që i lutet Allahut është e pranuar nga Ai të Cilit i drejtohet me dua.²²

²⁰ Transmeton Buhariu dhe Muslimi. Ekipi i Studimeve Akademike, *Udhërrëfyesi i një myslimani*, Prizmi, 2010, Tiranë.

²¹ Transmeton Ebu Davudi.

²² Grup autorësh, *Hutabu'l xhum'ati ve'l idejn*, Daru'l Mearif në Egjipt, bot. i II, Kajro.

Duhet të përmendim me këtë rast se besimtarët në ditën e Bajramit duhet të zgjohen me kohë e të shkojnë në xhami ose aty ku organet kompetente kanë vendosur që të falet namazi i Bajramit. Nuk duhet harruar kurrëse se këtë ditë duhet që të pastrohemi²³ dhe t'i veshim rrobat më të mira²⁴, të parfumohemi dhe të shkojmë në xhami.

Para se të shkojmë në xhami, ditën e Fitër-Bajramit mirë është që të hamë ca kokrra hurme (mundësisht tek), kurse për Kurban -Bajram mirë është që të mos hamë asgjë deri pas faljes së namazit të Bajramit. Kjo vlen për ata që therin kurban. Në fakt, kjo ka qenë praktika e Resulullahut, sepse ai para se të shkonte për ta falur namazin e Fitër-Bajramit ëmbëlsohej me ca kokrra hurme (gjithnjë tek)²⁵, e me të drejtë është thënë se kjo praktikë më vonë është shndërruar në ëmbëlsira të cilat për këtë festë i përdorin myslimanët gjithandej globit.

²³ Me u pastrua para se me shkua në xhami ditën e Bajrameve dhe ditën e xhumasë, kjo është synet i Pejgamberit a.s., sepse ai kështu ka vepruar, ndonëse disa dijetarë këtë e llogarisin tek mendubet. Ekipi i Studimeve Akademike, *Udhërrëfytes i një myslimani*, Prizmi, 2010, Tiranë.

²⁴ Pejgamberi rëndom e vishte xhyben e tij të kuqe, më të mirën që e ka pasur dhe me të shkonte për ta falë namazin e bajrameve dhe të xhumasë. Mustafa Sibai, *Dispozitat dhe filozofia e agjërimit në dritën e Kuranit dhe synnetit*, f. 18. Bejrut, 1397.

²⁵ Transmetohet nga Burejdeja, gjegjësisht nga babai i tij (Allahu qoftë i kënaqur me ta!) se Pejgamberi a.s. nuk do të delte me e falë namazin e Bajramit pa ngrënë diç (rëndom hurme dhe atë tek) ose ka pirë diç, për dallim nga Kurban-Bajrami, kur nuk ka ngrënë deri sa është kthye nga xhamia, atëherë ka ngrënë pak nga kurban i tij. (Darekutni; ngjashëm e ka dhënë edhe Tirmidhiu; konsiderojnë se transmetimi është autentik. Hadithin e transmeton edhe Ahmed).

Gjatë rrugës për në xhami sa ma shumë duhet marrë tek-bire dhe duke e madhëruar Atë që meriton të madhërohet - Allahun e Gjithëmëshirshëm.

Gjithashtu, është synet - traditë pejgamberiane që duke shkuar në xhami (ose në vendfaljen e caktuar) të shkohet një rrugë kurse kthimin, mundësisht, ta bëjmë nga ndonjë rrugë tjetër. Këtë e ka praktikuar Pejgamberi, e po ashtu edhe as'-habët e tij, tabiinët e të tjerë. Edhe te ne në Kosovë, një praktikë e tillë jo se ka qenë e padëgjuar por varët se sa është aplikuar.

Namazi i Fitër-Bajramit

Një prej karakteristikave kryesore të festës së Bajramit është edhe falja e namazit të Bajramit, i cili falët në xhami (më mirë është sikur të falej në namazgjah ose musal-la)²⁶:

Namazi i Fitër Bajramit sipas mendimit të Ebu Hanifës r.a. është *vaxhib-i obligueshëm*.²⁷ Përbëhet prej dy rekateve. Falet ekskluzivisht me xhematë e jo individualisht në shtëpi, e vaxhib e kanë të gjithë ata që e falin namazin e xhumasë. Ky namaz, sipas praktikës së Pejgamberit nuk ka as ezan as ikamet.

²⁶ Pejgamberi a.s. vetëm një herë e ka falë Bajramin në xhami të tij, për shkak të shiut, kurse herëve të tjera e ka falur në vend-falje (musal-la). Ekipi i Studimeve Akademike, *Udhërrëfyesi i një myslimani*, Prizmi, 2010, Tiranë.

²⁷ Kjo normë është marrë nga ajeti 185 i sures “El-Bekare”. Më gjerësisht: Ibrahim El-Halebi, *Multeka'l Ebhur*, f. 211.

Në qoftë se rastësisht nuk ke arritur me e falë namazin e Bajramit me imam dhe xhemat, atë nuk mundesh që ta falësh vetëm.

Koha e faljes së namazit të Fitër-Bajramit

Koha e faljes së këtij namazi fillon kur dielli të ngrihet në gjatësi të një ose dy shtizave e zgjat deri kur ai është në zeval (në zenit të qiellit), ndonëse në kohën aktuale llogaritet më thjesht: 45 minuta pas lindjes së diellit dhe zgjat deri pak para dreke.

Në qoftë se imami ditën e parë ka pasur një arsye të justifikueshme dhe nuk ka mundur që t'i prijë xhematit në namaz, këtë do ta bëjë ditën e dytë të Bajramit, e pas kësaj dite nuk lejohet falja e namazit të Bajramit. Për dallim nga Kurban-Bajrami, i cili lejohet të falët edhe ditën e dytë dhe ditën e tretë. Ebu Umejri kishte thënë: Ka qenë vranët aq sa s'kemi mundur që ta shohim hënën e rime të muajit Shevval, kështu që kemi agjëruar. Kah mbarimi i asaj dite erdhi një grup njerëzish dhe ia treguan Pejgamberit se një ditë më herët e kishin parë hënën, kështu që Pejgamberi i urdhëroi menjëherë që të hanë, kurse të nesërmen të shkojnë për ta falur namazin e Bajramit.²⁸

²⁸ Transmeton Ahmedî, kurse Nevevîu në veprën "El-Hulasa" thotë se ky hadith është sahih; ashtu figuron në veprën "Nasbu'r-rajë", II/212. Ekipi i Studimeve Akademike, Udhërrëfyesi i një myslimani, Prizmi, 2010, Tiranë.

Mënyra e faljes së namazit të Bajramit

Në fillim bëhet nijeti, i cili mund të bëhet kështu: “E vendosa me e falë namazin e Fitër-Bajramit për Zotin e Mëshirshëm, u ktheva kah kibla, iu mbështeta këtij imami”, dhe kur imami merr tekbir, edhe xhematlinjë marrin tekbir, duke i ngritur duart te veshët dhe duke thënë “Allahu ekber”.

Në rekatin e parë imami e këndon “Subhaneken”, pastaj tri herë radhazi merr tekbire²⁹, duke i ngritur duart deri te laprat e veshëve, e pas herës së tretë i lidh duart mbi bark (nën kërthizë), pastaj me zë e lexon “Fatihanë” dhe një sure (synet është nëse e lexon suren “el- A'la”), për të vazhduar më pas në ruku dhe në sexhde.

Në rekatin e dytë, e lexon “Fatihanë” dhe një sure (synet është nëse e lexon suren “el-Gashije”), pastaj i merr tri tekbiere, duke thënë “Allahu ekber” dhe duke i ngritur duart te laprat e veshëve, kurse herën e katërt merr tekbir për të shkuar në ruku, në sexhde dhe në “tehijjat”, dhe në fund jep selam!

Pas faljes së namazit të Bajramit, pason hytbeja, e cila është sikurse ato të xhumasë, mbase duhet të jetë e shkurtë, përmbajtjesore, me këshilla konkrete dhe gjithësesi aktuale. Hytbeja e Bajramit është synet.³⁰

²⁹ Në terminologjinë e Sheriatit, këto tekbire quhen "tekbiru z-zevaid": Ali Zaimi, Resul Rexhepi dhe Jusuf Zimeri, *Ilmihal i zgjeruar*, Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2018. Ndërkaq, marrja e këtyre tekbireve është e bazuar në Kur'an: “...dhe ditët e caktuara t'i plotësoni dhe Allahun ta madhëroni, për shkak se u ka udhëzuar në rrugë të drejtë, mbase do të jeni mirënjohës!” (*El-Bekar: 185*) Ekipi i Studimeve Akademike, Udhërrëfyesi i një myslimani, Prizmi, 2010, Tiranë.

³⁰ Ibrahim El-Halebi, “Multeka'l Ebhur”, f. 211

Pas mbarimit të hytbes, e udhës është që kjo ceremoni kaq domethënëse, të përfundohet me një dua-lutje përmbajtjesore. Në fund të këtij shkrimi, propozojë një model të një duaje për këtë rast.

Krejt kjo, sepse besimtari i singertë dëshiron që gjithmonë të jetë falënderues ndaj Allahut, mirënjohës për të mirat dhe begatitë e dhuruara nga Ai. Besimtari gjithmonë, e në veçanti në këtë ditë feste, dëshiron që të jetë شَاكِرًا لِّأَنْعَمِهِ "...falënderues për begatitë e dhuruara...", sepse ai më së shumti kënaqet dhe lumturohet atëherë kur e kryen një obligim karshi Allahut të Gjithëpushtetshëm.³¹

Njëjtë falët edhe namazi i Kurban-Bajramit.

Disa tradita që meritojnë të vazhdoen

Pas kthimit nga xhamia, fillimisht urojmë të afërmit tanë, akrabanë-farefisin, dhe do të afrohem në sofrën e Bajramit, të cilën për festë e kemi zakonisht më të begatshme, siç thonë nga supa deri në bakllava.

Bajrameve iu gëzohen në veçanti fëmijët, të cilët gjatë vizitave për të uruar iu dhurohen sheqerka, çokollata të vogla, ëmbëlsira, ndonjë euro se Bajram është. Në veçanti jetimët mos me i harruar. Po edhe të varfrit e bonjakët tjerë meritojnë me i gëzuar. Prindërit tanë, ndonëse në kushte shumë të vështira, këtë gjithmonë e kanë bërë me aq dashuri e mirësi.

³¹ Ekipi i Studimeve Akademike, Udhërrëfyesi i një myslimani, Prizmi, 2010, Tiranë; Grup autorësh, *Hutabu'l xhum'ati ve'l idejn*, Daru'l Mearif në Egjipt, bot. i II, Kajro.

Nëse i vizitoni edhe varrezat, asgjë nuk keni gabuar, përkundrazi keni bërë mirë. Po nëse me atë rast keni lexuar një “Fatiha” ose “Jasin”, keni bërë ku e ku ma mirë.

Keni kujdes edhe këtë: gjatë ditëve të Bajramit është i ndaluar agjërimi, sepse këto janë ditë të ushqimit dhe pijeve!³²

Si përfundim

Në përmbyllje të këtij shpjegimi për rregullat dhe disa tradita të Ramazanit dhe të Bajramit, e shoh të nevojshme, që lexuesve të nderuar t’ua rikujtojë edhe një njoftim që na e ka bërë më i dashuri ynë Pejgamberi a.s., i cili është besniku i besueshëm, të cilit kurdoherë i kemi besuar ashtu siç na ka rrëfyer: Kjo ditë e bekuar festohet edhe ndërmjet qiellit dhe tokës, me ç’rast marrin pjesë edhe melaqet që zbresin nga lartësia si dhe njerëzit e devotshëm që janë në tokë. Agjëruetit ofrojnë agjërimin e tyre, ndërkaq nga Krijuesi i Gjithëmeshirshëm pranojnë shpërblimet.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

عن سعد بن أوس الأنصاري عن أبيه قال: قال رسول الله صلى الله عليه وسلم: "إذا كان يوم عيد الفطر وقفت الملائكة على أبواب الطرق، فنادوا: اغدوا يا معشر المسلمين إلى رب كريم، يمن بالخير، ثم يثيب عليه الجزيل، لقد أمرتم بقيام الليل فقمتم، وأمرتم بصيام

³² Këtë e ka urdhëruar Pejgamberi a.s. siç transmetojnë Ahmedit dhe Muslimi.

النهار فصمتتم، وأطعتم ربكم فاقبضوا جوائزكم، فإذا صلوا نادى
مناد: ألا إن ربكم قد غفر لكم فارجعوا راشدين إلى رحالكم، فهو
يوم الجائزة، ويسمى ذلك اليوم في السماء يوم الجائزة"

*"Ditën e Fitër-Bajramit melaqet qëndrojnë në hyrje të rrugëve dhe thërrasin: Nxitoni, o besimtarë, tek Zoti Fisnik, sepse Ai ju ofron mirësi dhe më pastaj edhe ju shpërblen me dhurata. Ju ishit urdhëruar që ta falni namazin e natës (teravitë), dhe ju atë e bëtë; ju ishit të urdhëruar që ditën të agjëroni, dhe ju agjëruat dhe kështu ju e respektuat Zotin tuaj, prandaj merrni shpërblimet tuaja. E, pasi ta falin namazin e Bajramit, një thirrës i fton: Sot, Zoti ju ka falur, prandaj kthehuni në shtëpitë tuaja të kënaqur! Kjo është dita e shpërblimeve. Edhe në qiell emërtohet si Dita e shpërblimeve!"*³³

Ndërkaq, i Madhi Zot në një hadithi kudsij ka thënë:
"Për mua agjëruat muajin e Ramazanit dhe sipas urdhrit tim falët namazin e Bajramit. Kthehuni tani në shtëpitë tuaja të falur e të pastruar nga gjynahet!"

³³ Taberaniu në "El-Kebir". Ka disa individ që e kontestojnë saktësinë e këtij hadithi por i njëjti përsëritet në shumë vende, prandaj edhe ne e shënuam.

DUA

Falënderimi dhe lavdia të takojnë Ty, o Zot i Gjithëmëshirshëm, që në formën më të mirë na ke krijuar dhe në rrugë të drejtë na ke udhëzuar!

O Zot i Gjithëmëshirshëm, na bën prej atyre që vetëm Ty të adhurojnë dhe vetëm nga Ti ndihmë kërkojnë!

O Allahu ynë, nga madhështia Jote dërgove Muhamed Mustafanë, me të shndrite Tokën, qiejt dhe e dërgove mëshirë e rahmet për botën mbarë!

O Zot i gjithësisë, me shpirt të pastër e me kokë të përulur, të lutemi që ibadetin tonë të na e pranosh, punët tona të mira të na i shpërblesh dhe mëkatet tona të na i falësh!

Sevapet e fituara me këtë rast, me kënaqësinë më të madhe ia dërgojmë Muhamed Mustafasë, familjes dhe shokëve të tij të devotshëm! I përkujtojmë edhe prindërit dhe gjyshërit tanë, ulematë dhe mësuesit tanë, vëllezërit dhe motrat tona, e në veçanti shehidët tanë.

O Zot i Lartësuar, në këtë agim të bekuar, të kësaj dite të bekuar, nga ky vend i bekuar, të lutemi që mendjet tona të na i kthjellosh, zemrat tona me dashuri vëllazërore të na i mbulosh dhe Madhërinë Tënde me respekt ta kujtojmë!

Të lutemi, o Zot, që të vërtetën të vërtetë të na tregosh e ta pasojmë atë, të keqën të keqe e të largohemi nga ajo dhe fjalën Tënde hyjnore ta lartësojmë!

O Zot i gjithësisë, për hir të Muhamed Mustafasë, Kuranit, Qabesë dhe Arshi-Alasë, na ndihmo që këtë botë me faqe të bardhë ta kalojmë, në Ahiret të na dhurosh kënaqësi dhe të lumtur ta presim takimin me Ty, o Allah!

O Zot i Gjithëmëshirshëm, të lutemi që të sëmuret tanë t'i shërosh, të vdekurit tanë t'i mëshirosh, nevojtarët t'i ndihmosh dhe na e mundëso që fjala jonë e fundit në këtë botë të jetë dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij!

(Ridaen lil-lahi El-Fatiha meas-salavat)

Literatura e shfrytëzuar:

- *Kurani i Madhërishëm*, përktheu prof. Hasan I. Nahi, botim i përkthyesit, Prishtinë, 1988.
- *Kurani Fisnik*, përktheu H. Sherif Ahmeti, botoi: “Kompleksi i Mbretit Fehd për shtypjen e Kuranit të ndershëm, Medinë, pa v. b.
- Muhammad Fu'ad 'Abdul-Bâkî, *al-Mu'ğam al-mufahras li alfâz al-Kurân al-Kerîm*”, 1987, Kajro.
- El-Imam Alauddin Ebi Bekr b. Mesud El-Kasani El-Hanefî, “*Beda'iu' s-Sanai' fi tertibi sh-Sherai*”, botoi “Daru-l-ihjai al-tourath al-arabi”, bot i tretë, 2000 (1421), Bejrut.
- Ibrahim el-Halebi, Multeka 'l-Ebhur, bot FIN- Sarajevë, 2002.
- Abdurrahman El-Xheziri, Kitabu 'l fikh alel medhahebil erbeati, “Dar u rrejan lit-turath”, bot i parë, Kairo, 1987.
- Prof. Muhammed Mustafa Esh-Shelebi, “*El-Medhal fit-tarif bil-fikhi-l-islami*”, botoi “Dar an-Nahda al-Arabijje”, 1969, Bejrut.
- Afif Abdyl-Fettah Tabbare, “*Ruhud-din el-Islami*” bot. i 10, 1973, botoi “Daru-l-ilm lil melajin”, Bejrut.
- Muhamed Ferid Vexhdi, “*El-Islamu fi asri-l-ilm*”, botoi “Daru-l-kitab el-arabij”, 1967, Bejrut.

- Dr. Subhi Es-Salih, *“En-Nudhumu-i-Islamijje”*, botoi “Daru-l-ilm’ lil melajin”, 1968, Bejrut.
- Dr. Nerkez Smailagic, *“Leksikon Islama”*, bot. Svetlost- Sarajevo, 1990, fq. 679 e tutje.
- Es-Sejid Sabik, *Fikhu s-Sunne*, bot. i pestë, 1983, Bejrut.
- Ekipi i Studimeve Akademike, Stamboll-Turqi, *Udhërrëfyesi i një myslimani* (adhurimet), botoi Prizmi- Tiranë, 2010.
- Ali Zaimi, Resul Rexhepi dhe Jusuf Zimeri, *Ilmihal i zgjeruar*, Tiranë, Prishtinë, Shkup, 1918.
- Muhamed A.I. el-Bureni, *Çështjet të fikhut sipas Kuduriut*, bot. Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2002, Prishtinë.
- Grup autorësh të përzgjedhur të “Ez’herit”, *Hutabu 'l Xhu'ati vel idejni*, “Dar el mearif”, Egjipt, bot. i dytë, Kajro.
- Mustafa Sibai, *Dispozitat e agjërimit dhe filozofia e tij në dritën e Kuranit dhe synnetit*, Bejrut, 1397.
- Grup teologësh, *Ditët dhe netët e mira në Islam*, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2008, Tiranë.

Ajni SINANI

KURANI, SHKENCA DHE GJITHËSIA

Me emrin e Allahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit!
***“Lexo në emrin e Zotit tënd, i Cili të ka krijuar. Krijoi
njeriun prej një rrecke. Lexo! Se Zoti yt është Fisnik. I
cili e mësoi me pendë, e mësoi njeriun çka nuk e kishte
ditur.” (El Alak, 1-5)***

Allahu e veçoi njeriun nga krijesat e tjera duke i dhënë mendjen. Atij i dhuroi edhe shqisat për ta njohur botën. Kështu, nëpërmjet mendjes njeriu merr perceptimet, kupton, mediton dhe nxjerr konkluzione. Mirëpo, krahas kësaj, Allahu i Madhërishëm, njeriut, nëpërmjet pejgamberëve i dërgoi shpallje, duke i furnizuar ata me dije mbi qëllimin e jetës, vlerat dhe kualitetet etike, si dhe ua besoj detyrën që Shpalljen Hyjnore t’ua komunikojnë njerëzve, duke ua tre-guar rrugën e vërtetë.¹

Kështu, përmes pesë shqisave (shikimit, dëgjimit, nuhatjes, shijimit dhe prekjës), që i ka si pesë dritare që i janë ha-

¹ Ebul Ala el Mevdudi, *Muhamedi alejhi selam dhe Kurani i Shenjtë*, Prizren, 1409/1989, f.16.

pur për të parë botën lëndore, njeriu merr ndijimet. Njeriu përdor edhe teknika të ndryshme shkencore për të njohur më shumë botën lëndore. Me përparimin e shkencave, njeriu e kupton më mirë natyrën, e studion atë dhe e njeh më shumë ndërtimin dhe funksionimin e ligjeve në të.

Mirëpo, përkufizimi i njohjes vetëm në atë që është materiale, duke e privuar nga pranimi i botës së shpirtit, shpalljes, si dhe të parit përtej botës fizike, është një përkufizim i gjymtë dhe jo i drejtë. Të deklarohet se s'mund të njihet diçka, veçse ajo që mund të kapet përmes shqisave (nëse shihet, preket, dëgjohet etj.), është një pretendim jo i saktë. Bota mund të kuptohet në saje të burimeve diturore shumëdimensionale. Dituria nuk mund të reduktohet në një burim të vetëm. "Mendja, pesë shqisat dhe vrojtimi janë konsideruar burime të dijes që nuk konfrontohen me burimin epistemologjik hyjnor - revelatën (vahj)."² Dijetarët myslimanë konstatojnë se njeriu mund të arrijë të dijë dhe të njohë edhe nëpërmjet të njohurit dhe fitres (natyrës së pastër), nëpërmjet mendjes dhe të menduarit e të logjikuarit, nëpërmjet fuqisë së brendshme shpirtërore, inspirimit dhe shpalljes.³ Përkrahësit e shkollës pragmatike janë racionalë, kur pohojnë në pafuqinë e mendjes për të kuptuar të vërtetën, por ata e reduktojnë fuqinë e mendjes vetëm në njohjen e mjeteve për të arritur qëllimet.⁴ Ndërkaq, aftësia e mendjes së njeriut ndonëse është më shumë se kaq, megjithatë ajo është e limituar

² Ahmet Davutogllu, *Vetpërceptimet e qytetërimeve*, Prishtinë, 2002, f. 87.

³ Dr. Jusuf Kardavi, *Të ekzistuarit e Allahut*, Prishtinë, 2002, f. 88, 89.

⁴ Muhamed Gazali, *Besimi i Muslimanit*, Shkup, 1421/2001, f. 56.

dhe nuk mund ta kuptojë të vërtetën rreth botës metafizike. Njeriu arrin të mësojë të vërtetën për Zotin vetëm nëpërmjet shpalljes, duke e përdorur mendjen. Me metodat shkencore nuk mund të fiksohet as ekzistenca e as mos-ekzistenca e Zotit. Ndërmjet shkencës dhe fesë, midis racionale dhe besimit nuk ekziston fërkim ose konflikt, por përkundrazi mund të bëhet fjalë. Për tema studimi, shkenca merr vetëm fenomenet e observueshme, ndërsa subjektet, të cilat nuk mund të vrojtohen i lë jashtë fokusit të hulumtimit. Disa sisteme mendimore, të cilat nuk bazohen në shkencë, si darvinizmi, bihejviorizmi, psiko-analiza frejdiane, materializimi, pozitivizmi etj., të cilat kanë dhënë kontributin e tyre në formimin e modernizmit, janë refuzimi i fesë me burim nga revelata, si dhe i urdhëresave dhe i ndalesave të Zotit.⁵ Dialogu tolerant ndërmjet shkencës dhe religjionit duhet bërë patjetër, pra, duhet zënë fill në supozimin themelor, edhe shkenca, por edhe religjioni. Ato duhet të vihen në pozitë të barabartë dhe paraprakisht, asnjërës nuk guxon t'i mohohet racionaliteti dhe funksionaliteti. Shkenca si zëvendësim i religjionit, dhe arsyeja si zëvendësim i fesë, gjithnjë janë shkatërruar.⁶ Forca Absolute e ka sjellë në ekzistencë një botë të tillë, kaq të përsosur e të llogaritur mirë, ka ditur e ka mundur të fus në të mekanizmin i cili shpie në organizimin e rregullt dhe në zhvillimin automatik të saktë. Është e çuditshme se pjesa dërmuese e shkencëtarëve laikë tregohen mospërfillës dhe skeptikë ndaj

⁵ Jillmaz Ozakpinar, *Kultura dhe qytetërimi*, Shkup, 2003., shih f.141 & f.142.

⁶ Gjuro Shushnjq, *Fuqia dhe pafuqia e shkencës në kritikën e religjionit*, Prizren, 2000, f. 9-10 & f. 34.

çdo gjëje që ka të bëjë me botën përtej botës lëndore. Sipas tyre, e gjithë ajo që nuk mund të studiohet nëpërmjet shkencës bashkëkohore, është jo ekzistente dhe ekzistenca e saj mohohet në mënyrë objektive. Kjo do të ishte sikur një audiencë e njerëzve të shurdhër në një koncert, të pohonin se ata nuk kanë dëgjuar kurrfarë muzike, kurse unanimitetin e opinionit të tyre ta marrin si vërtetim të objektivitetit. Duhet të tregohemi të vëmendshëm, ngase shumë teori, vlerat e të cilave nuk janë vënë në diskutim në epokën tonë, kanë dalë të gabuara në të ardhmen.

Qëndrimi i dijetarëve rreth ajeteve kuranore që flasin për fenomenet natyrore

Sa i përket kësaj teme, kemi qëndrime të dy palëve diametralisht të kundërta. Njëra palë thotë: Meqenëse Kurani është libër fetar dhe qëllimi i tij është që njeriut t'ia tregoi të vërtetën për Krijuesin, ai nuk ka të bëjë aspak me shkencë. Sipas këtyre, duke bërë interpretim shkencor të disa vargjeve kuranore, me zhvillimin e mëtutjeshëm të shkencave natyrore, mund të vjen deri te vërtetimi i pasaktësisë së shumë teorive shkencore dhe rrjedhimisht hedhja poshtë e tyre. Kështu që, nëpërmjet një interpretimi të tillë të vargjeve kuranore, do të ishim shkaktar për një gabim të pafalshëm ndaj njollosjes së Kuranit, duke vënë në pikëpyetje autenticitetin e Kuranit të shenjtë. Ndërkaq, pala tjetër thotë: Çdo gjë që zbulohet nga shkenca bashkëkohore mund të gjendet në Kuran, madje pohon se Kurani është libër shkencor. Padyshim, Kurani është fjala e Zotit, është libër adhurimi, program dhe sistem

jete. Ai nuk është libër shkencor, që të ketë nevojë për ta vërtetuar shkenca.⁷ Sa i përket kësaj çështje, e vërteta qëndron aty diku në mes, ngase Kurani edhe pse është libër hyjnor dhe ka për qëllim udhëzimin e njerëzve, kjo s'do të thotë që Kurani të mos ketë vargje të cilat përmbajnë të vërteta rreth botës lëndore. Por, është gabim të pretendojmë se Kurani është një vepër - enciklopedi shkencore. Madje, sipas Garodit, do të ishte një punë fëmijërore të konsiderohej Kurani si enciklopedi që na liron nga mundimet e rënda gjatë gjurmimeve shkencore dhe teknike, të cilat botën islame e bënë qendër të kulturës botërore në kohën e Universitetit të Kordovës.⁸ Nuk është qëllimi që nëpërmjet zbulimeve moderne shkencore, të cilat shumë shpejt mund të tregohen të pavërteta, të vërtetohet madhështia e ajeteve kuranore në parashikimin e këtij apo atij zbulimi të fizikës ose të biologjisë. Nuk duhet pretenduar që të vërtetohet saktësia e vargjeve kuranore nëpërmjet të arriturave shkencore, ngase një gjë e tillë është jashtë çdo diskutimi. Por, të mundohemi që të kuptojmë më mirë vargjet kuranore që flasin rreth dukurive natyrore dhe të bëjmë të qartë, ashtu siç kanë konstatuar dijetarët islam, se shpallja hyjnore nuk mund të bie ndesh me të vërtetat e pakontestueshme shkencore,⁹ e as të vërtetat shkencore nuk mund të bien ndesh me vargjet kuranore të cilat kanë të bëjnë me dukuritë natyrore. Njeriu është i lidhur me natyrën, kurse kjo lidhje, duke pasur parasysh mundësitë që ofron dhe

⁷ Muhamed Mureveli esh Sharavi, *Mrekullitë e Kuranit*, Prishtinë, 2001, f. 94.

⁸ Rozhe Garodi, *Gjallërimi Islamik*, Gjakovë, 1991, f. 7.

⁹ Abdul Mexhid ez Zendani, *Mrekullitë shkencore në Kuran*, 2002, f. 10.

meqë lejon kontrollimin e fuqive të natyrës, atëherë duhet të shfrytëzohet, jo në interes të dëshirës së padrejtë për të sunduar, por në interesin më fisnik, për përparim dhe zhvillim të lirë të jetës shpirtërore. Që të arrihet deri te vizioni i plotë i realitetit, duhet që vrojtimet ndijore të përcillen me vrojtimin e asaj që Kurani e quan fuad ose kalb,¹⁰ d.m.th. me vrojtimin e zemrës:

“Ai është që përsosi krijimin e çdo sendi, e krijimin e njeriut e filloi nga balta. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të rrjedhin prej një pike uji të dobët. Madje, Ai e formëson atë dhe nga ana e vet i jep shpirtin atij dhe Ai është që juve ju pajis edhe me dëgjim, me të parit e me zemër, e pak send është ajo që ju falënderoni.” (Es Sexhde, 7-9)

Një “shkencë” e cila është në kundërshtim me Kuranin fisnik është jo e saktë dhe e papranueshme. Shumë dijetarë me famë kanë shkruar dhe vazhdojnë të shkruajnë për mrekullitë shkencore në Kuran. Ata Kuranin e marrin si argument dhe masë për vërtetësinë dhe pavërtetësinë e shkencës. Ndarja e qartë që është bërë ndërmjet tekstit të shenjtë nga njëra anë dhe ekzegjezës (tefsir) e përpjekjes shkencore (ixhtihad) në anën tjetër, ka penguar që devijimet dhe gabimet e mundshme në komentim, të konsiderohen për pjesë të dijes hyjnore. Në këtë mënyrë, në kuadër të mendimit islam, nuk ka lindur ndonjë konflikt ndërmjet dijes hyjnore dhe dijes shkencore të shkencëtarit, por përkundrazi, në plan të parë

¹⁰ Muhamed Ikbali, *Ripërtëritja e mendimit në islam*, Shkup, 2018, f. 30.

kanë dalë përpjekjet për homogjenizim, kohezion vertikal që mbështetet në dallimin e rrafshit epistemologji.¹¹ Të frymëzuar nga mësimet e Kuranit, dijetarët myslimanë arritën që të bëjnë mrekulli në shkencë. Sipas Moris Bukait, shkenca për herë të parë mori karakter ndërkombëtar në fakultetet islamike të mesjetës. Myslimanëve nuk u ka penguar që të jenë në të njëjtën kohë edhe besimtarë edhe shkencëtarë. Shkenca është binjake e fesë islame. Ajo nuk duhet të pushojë të jetë e tillë.¹² Madje, shkencëtarët e ndryshëm gjatë studimeve të tyre të natyrës, edhe sot mund të gjejnë frymëzim dhe mbështetje të fjalës së Krijuesit, të Kurani i shenjtë. Gjatë gjithë kohës, që nga fillimi i shpalljes hyjnore, dijetarët dhe shkencëtarët myslimanë gjejnë frymëzim dhe inspirohen nga fryma e Kuranit. Shkencëtari i madh pakistanez, njëherësh fituesi i çmimit Nobel për kimi, Abduselami, thotë se gjatë studimit të tij ai ishte i frymëzuar nga Kurani. Kjo ndodhi edhe anëtarin e Akademisë së Shkencave Franceze, Moris Bukain, e po ndodhë gjithnjë e më shumë edhe me shkencëtarë të ndryshëm myslimanë. Bukai shpreh: “Kur e ballafaqojmë Kuranin me njohuritë bashkëkohore, si të mos impresionohemi me saktësitë për të cilat nuk mund të supozojmë se janë rezultat i mendjes së një njeriu, i cili ka jetuar para 14 shekujsh.”¹³

Këto fjalë Bukai i kishte shkruar në librin e tij para se ta pranonte Islamin. Është e dhimbshme kur sheh shumë shken-

¹¹ Ahmed Davutogllu, *Vetëperceptimet e Qytetërimeve*, Logos, Prishtinë, 2002, f. 87.

¹² Dr. Maurice Bucaille, *Bibla, Kurani dhe shkenca*, Gjakovë, 2002, f. 135.

¹³ Dr. Maurice Bucaille, *Bibla, Kurani dhe shkenca*, op. cit., f. 187.

cëtarë jomyslimanë që janë në konfuzion dhe që nuk arrijnë ta kuptojnë të vërtetën e amshueshme, Islamin. Kjo ngase, citoj fjalët e Didatit: “Ata në nën dijen e tyre janë të bindur se Muhamedi a.s. e ka trilluar fenë islame, dhe se ai e ka shkruar Kuranin.”¹⁴

Mosha e gjithësisë

“... Allahu me plotë arsye krijoi qiejt e Tokën dhe çka ka ndërmjet tyre në kohë të caktuar...” (*Er Rum*, 8)

Është menduar më herët se gjithësia është e pa krijuar dhe se ka ekzistuar gjithmonë. Ideja mbi “ekzistencën në infinit” (pafundësi) ka hyrë në Perëndim së bashku me filozofinë materialiste, e cila rrënjët i ka te grekët e lashtë. Ata besonin se gjithësia është statike, e pandryshueshme dhe përhershme, ndërkaq kohëve të fundit, shkencëtarët, pas studimeve dhe konkluzioneve të rëndësishme flasin për një moshë të gjithësisë. Sipas tyre, mosha e saj sillet diku në 15 miliardë vjet. Pra, sikurse çdo njeri që kalon nëpër faza të ndryshme, që nga ajo embrionale dhe faza të tjera pas lindjes, ku pas një kohe të caktuar edhe vdes, ashtu edhe gjithësia po kalon në fazat e saj. Çdo gjë në këtë ekzistencë të dukshme e të padukshme, i tërë universi, ka lindjen-fillimin, zhvillimin, plakjen dhe në fund, vdekjen-zhdukjen e tij. Çdo gjë i nënshtrohet lindjes dhe vdekjes së paracaktuar nga Allahu, Krijuesi i çdo gjëje. Pra, ekzistenca lëndore ka një fillim dhe ne kemi ndjesinë e këtij fillimi, të cilin e kuptojmë me gjithë qenien tonë.

¹⁴ Ahmed Deedat, *Kurani Mrekullia më e Përsosur*, Prishtinë, 2001, f. 34.

Ndërkaq, ekzistenca e Krijuesit, Allahut, Zotit Një e të Vetëm, në asnjë mënyrë nuk mund të ketë fillim.¹⁵ Të gjitha llojet e ekzistencës që janë në Tokë e në qiej, të gjitha janë shfaqje e vullnetit të Allahut. Çdo gjë, si në qetësi ashtu edhe në lëvizje, është shenjë e fuqisë së Krijuesit: **“Ai është që krijoi (pa kurrfarë shembulli) qiejt dhe Tokën...”** (*El Enam, 101*); **“Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë.”** (*Dharijat, 47*). Duhet pasur parasysh, ashtu siç thotë Asad, se shkenca do të jetë në gjendje t’i kuptojë fragmentet individuale të jetës, të cilat mund të rriten në numër e qartësi, shpejt apo ngadalë, në harmoni me rritjen e dijes njerëzore mbi natyrën, por megjithatë, ato do të mbesin vetëm fragment, perceptimet e vetë tërësisë do të mbesin jashtë pajisjes metodologjike të arsyes njerëzore. Kjo është rruga, nëpër të cilën ecin shkencat natyrore.¹⁶ Është pranuar se shkenca e cila është e kundërt me fenë, është e mangët dhe e paaftë kur para saj shtrohen çështjet e kuptimit të jetës.¹⁷ Njeriu duhet të bëhet i vetëdijshëm për dimensionin e brendshëm brenda vetes dhe gjithësisë mbi të. Dija fragmentare nuk mund të bëjë tjetër pos të mbetet fragmentare. Meqenëse shkenca merret me studimin e botës lëndore, atëherë nuk mund të presim që ajo të na ofroj përgjigje rreth pyetjes se çfarë ishte para krijimit të gjithësisë, si dhe si të do të jetë e ardhmja, apo çfarë ka përtej botës lëndore. Këto pyetje nuk i përkasin do-

¹⁵ Muhamed Gazali, op. cit., f. 41.

¹⁶ Muhamed Asad, Muhamed Asad, *Islami në udhëkryq*, Prizren, 2002, f. 17-18.

¹⁷ Murad Hoffman, *I shtrirë nga të gjitha anët*, Asr, Tetovë, 2003, f. 17.

menit të saj. Këtu pushon shkenca dhe dija empirike, tani vjen në shprehje dija dhe shpallja e Krijuesit të ekzistencës lëndore. Rreth universit, materialistët kishin dy nocione:

1. Universi ekziston që nga pafundësia, pra, nuk ka as fillim e as fund, ai nuk është i krijuar.
2. Çdo gjë në univers është thjesht fryt i rastësisë dhe jo një plan apo projektim me një vizion të qëllimtë.

Ndërkaq, që nga viti 1920, kishte një mori faktesh që ekzistenca e universit që në infinit (pafundësi) ishte një e pavërtetë. Shkencëtarët tashmë ishin të sigurt për krijimin e tij nga mos ekzistenca e shkaktuar prej një “shpërthimi të madh”. Me fjalë të tjera, universi nuk ka ekzistuar në pafundësi, por është krijuar nga Zoti: ***“Mjafton urdhri i tij, kur do diçka, vetëm t’i thotë “bëhu”, dhe ajo do të bëhet.”*** (Jasin, 82)

Rendi në gjithësi

“I Cili i krijoi shtatë qiejt në kate dhe nuk ka kurrfarë kontrastesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit, pa shiko edhe një herë: sheh ndonjë plasaritje.” (El Mulk, 3)

Në gjithësi sundon rendi i përkryer. Aty çdo gjë funksionon me precizitet dhe çdo gjë është caktuar dhe vendosur çuditërisht në vendin e vet. Ky qiell i lartë me yjet e tij të mrekullueshëm, duke filluar që nga galaktika, e gjer te përbërja e atomeve, çdo gjë dëshmon për një pamje mahnitëse dhe një sistem të përsosur rregulli. Çdo njeri i ndërgjegjshëm kupton se në çdo dukuri të natyrës ka një rregull, gjë që dëshmon për intelekt, plan dhe një qëllim. Pra, kudo në ekzisten-

cë është i dukshëm rregulli, qëllimi dhe se nuk ka rastësi. Çdo atom, ne njerëzve na bën thirrje me gjuhën e vet specifike. Nuk ka, as në tokë e as në qiell, qoftë edhe një atom që ekziston vetvetiu. Asgjë, madje as thërmijat më të imëta nuk ekzistojnë vetvetiu. Është Allahu, Ai që e solli në ekzistencë çdo gjë dhe që ka vendosur forcën e balancimit, madje edhe në mesin e bërthamave të atomit: **“A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në tokë dhe çka krijoi Allahu prej sendeve...”** (Araf, 185)

Kur njeriu fillon të meditoj rreth kësaj, në mendje shkrep-tinë pyetja: Kush e solli jetën në gjithësi? Cili është burimi i milionave veprimtarive jetësore që vihen re te njerëzit, kaf-shët dhe bimët?

Materialistët do të përgjigjeshin se është materia. Ndër-kaq, jobesimtarët do të thonë se çdo gjë ka rrjedhë rastësisht. E ne, do të pyesnim, si ka mundësi që materia të bëj një gjë të tillë kur vetë ajo është e pajetë. Si mund ta siguroi materia e pavetëdijshme, krahas gjithë këtij procesi ndryshimesh, këtë harmoni, këtë precizitet dhe këtë përsosmëri të jashtëza-konshme? Shumë pyetje dhe shumë hamendje për një me-ndje ateiste. Mirëpo, hamendja zhduket para besimit, mendja gjen prehje dhe zemra gjen kënaqësi kur lexon fjalët e Kriju-esit: **“Allahut i takon shembulli më i lartë...”** (Nahl, 60)

Kush është ai që zotëron sistemin e këtyre trupave gjigant dhe kush është ai që i shtynë këta trupa të lëvizin me këtë forcë dhe me këtë shpejtësi marramendëse? A nuk janë këto forca manifestim i forcës së Allahut, ndërkaq të verbrit nuk shohin, të shurdhrit nuk dëgjojnë dhe të marrët nuk logji-kojnë. **“Me të vërtetë, Allahu ruan qiejt dhe Tokën që të mos**

shkatërrohen - çrregullohen. Po nëse çrregullohen, askush tjetër përveç Atij nuk do t'i ndalte...” (*Fatir, 41*)

Me këtë rast, është me rëndësi të theksojmë se energjitë pozitive, negative e neutrale të atomit ekzistojnë dhe kanë vlerë vetëm të lidhura me njëra-tjetrën. Pra, nuk ekziston ndonjë element, ndonjë esencë materiale absolute dhe pandryshueshme që do të mund të konsiderohej si themel.¹⁸ A ka mundësi që një natyrë e verbër, e shurdhër dhe e pavetëdijshme të ketë sjellë këtë balancim magjepsë ndërmjet grimcave? A nuk është Allahu, Ai që udhëheq me të gjitha ligjet e ekzistencës, fuqinë atomike dhe me të gjitha forcat që sundojnë gjithësinë? ***“Allahu është Krijues i çdo sendi dhe Ai është mbikëqyrës ndaj çdo gjëje. Në duart të Tij janë çelësat e qiejve dhe të Tokës...”*** (*Zumer, 62-63*)

Gjithësia nuk është koincidençë

“Ne nuk e krijuam qiellin e as Tokën dhe çka ka në mes tyre pa qëllim (shkel e shko), ai është mendim i atyre që nuk besuan...” (*Sad, 27*)

Kjo gjithësi me gjithçka që ka në të, nuk është tjetër veçse një letër e bardhë - e pastër, në të cilën janë gdhendur cilësitë e këtij Krijuesi të Madhërishëm.¹⁹ Sikurse e thamë edhe më lartë, kohëve të fundit, të gjithë shkencëtarët janë të me-

¹⁸ Prof. dr. Bekir Topaloglu, prof. dr. Jusuf Shevki Javuz dhe doç. Iljas Çelebi, *Bazat e Besimit në Islam*, Prishtinë, 2002, f. 40.

¹⁹ Dr. Muhamed Seid el Buti, *Evropa prej teknologjisë drejt spiritualizmit*, Shkup, 1421/2000, f. 37.

ndimit se ekzistenca lëndore ka një fillim. Pra, krijimi, jeta, ekzistenca, gjithësia, nuk janë koincidence - rastësi. Madje, shkencëtarët tashmë i kanë caktuar një moshë gjithësisë, sikurse përmendëm më lartë. Ndonëse mund të ketë lëvizje sa i përket kësaj moshe, ajo që është me rëndësi të theksohet në këtë rast është se shkencëtarët pajtohet me faktin se gjithësia ka një fillim dhe rrjedhimisht ka edhe një mbarim. Ata më herët kishte besuar se atomi është i pandashëm, për pasojë ai ishte i përhershëm, që nuk ka një fillim. Madje vetë fjala “atom” që rrjedh nga gjuha greke do të thotë i pandashëm. Meqë atomi është i pandashëm dhe i pandryshueshëm, pohuan se edhe bota, meqë përbëhet prej tyre, nuk është e krijuar. Dhe meqenëse bota është e përhershme, atëherë nuk ka Krijues. Prandaj, materialistët duke e pandehur atomin si të tillë (që nuk ndryshon e nuk asgjësohet), atë e vunë në vendin e fuqisë krijuese (Zotit).²⁰ ***“Ata thanë: Nuk ka tjetër veç jetës sonë në këtë tonë, këtu lindemi e këtu vdesim. Asgjë nuk na shkatërron tjetër përveç kohës. Mirëpo, ata nuk kanë asnjë njohuri për këtë përveç një dyshimi e pandehmë.”*** (Xhathije, 24)

Këta njerëz, me bindjet e tyre të palogjikshme, të shtyrë nga kryeneçësia, arritën në një përfundim të tillë dhe në një gabim më shumë se foshnjarak. Përkundër bindjes që ekzistonte rreth atomit gjatë një periudhe të gjatë kohore, madje deri në kohët e vona, ne në Kuranin Fisnik, i shpallur para katërmëdhjetë shekujve, lexojmë: ***“... Atij nuk mund t'i***

²⁰ Prof. dr. Bekir Topaloglu, prof. dr. Jusuf Shevki Javuz dhe doç. Iljas Çelebi, *Bazat e Besimit në Islam*, Prishtinë, 2002, f. 40.

shmanget asgjë, as sa grimca (dherr'rre - atomi), as në qiej, as në tokë, dhe se nuk ka kurrgjë, as më e madhe e as më e vogël se ai, e të mos jetë në Librin e qartë.” (Sebe, 3)

Ajeti kuranor (fjala dherr'rre - arabisht do të thotë atom, e përmendur në këtë ajet është përkthyer në gjuhën shqipe si grimcë) tregon se ka grimca edhe më të vogla se atomi, gjë që aludon në faktin se atomi është i zbërthyeshëm. Padyshim se kjo është një prej mrekullive në oqeanin e pafund të mrekullive kuranore. Me zbërthimin e atomit, tezat e materialistëve dolën boshe: ***“Veprat e atyre që nuk besojnë janë si një brakë në rrafshinë, në të cilën i etshmi kujton se ka ujë, derisa të vjen aty e nuk gjen gjë, por do të gjejë atje Allahun dhe Ai do t’ia paguaj plotësisht llogarinë e tij, sepse Allahu është shumë i shpejtë në llogaritje.”*** (En Nur, 39)

Kështu që, për njeriun i cili posedon logjikë të shëndoshë s’ka rrugë tjetër veçse të pranojë se ekzistenca me tërësinë e saj është manifestim i një Krijuesi të Gjithëfuqishëm, që posedon dije, inteligjencë, urtësi, vullnet, fuqi dhe të gjitha cilësitë më të përkryera në mënyrën absolute. Çdo gjë në gjithësi i nënshtrohet një procesi të vazhdueshëm ndryshimesh lindje-vdekje, ekzistencë-asgjësim. Jofrymorët, bimët, kafshët dhe njerëzit, trupat e ngurtë e të lëngtë si gurët, malet, lumenjtë e kodrat janë të përcaktuara për ndryshim. As yjet, konstelacionet yjore e galaktika nuk mund të dalin jashtë ligjit të lindje-vdekjes. Kjo do të thotë se gjithësia është e krijuar dhe krijohet vazhdimisht.²¹ Nëse do të bënim një krahasim, atë-

²¹ Prof. dr. Bekir Topaloglu, prof. dr. Jusuf Shevki Javuz dhe doç. Iljas Çelebi, po aty, f. 53.

herë do të mund të thoshim se gjithësia është sikurse hija e diçkaje, e cila ekziston në tokë sa ka diell në kupën qiellore. Kur dielli perëndon, edhe hija shuhet. Ekzistenca e universit e ndien nevojën për një ekzistencë tjetër. Gjithësia ekziston me ndihmën e Zotit xh.sh., i Cili furnizon ekzistencën e saj, e kur ky furnizim ndërpritet, atëherë ekzistenca e saj merr fund. Madje edhe grimcat më të imëta, në çdo sekondë, e edhe për më pak se sekonda kanë nevojë për Krijuesin e saj. Në këtë, aludon ajeti kuranor: ***“Atij i luten ata që janë në qiej dhe në tokë, në çdo kohë, çast, Ai është i angazhuar me diçka.”*** (Er Rrahman, 29)

Islami qorton pasivitetin e aftësisë mendore, të cilën Allahu ia fali njeriut për të meditaruar rreth dy librave të Tij, Kuranit dhe universit. Kurani është gjithësia, ku suret – kapitinat e tij janë galaktika, kurse çdo ajet - varg i tij është një yll. Sikurse universi që ka një pamje të mrekullueshme nga galaktikat dhe yjet të cilët natën duken si kandila të ndezur, ashtu edhe kaptinat dhe vargjet bëjnë që Kurani i shenjtë të jetë një libër i përkryer dhe fascionues.

Dëshmitë e dijetarëve rreth besimit në Zotin xh.sh.

Padyshim se sa më shumë që të zhvillohen shkencat pozitive, të cilat studiojnë natyrën, aq më mirë kuptohet mrekullia e ndërtimit dhe funksionimit të universit, madje, aq më tepër shtohet mahnitja e dijetarëve para fuqisë së Zotit xh.sh. Prandaj, çdo mendje e shëndosh pyet, citoj Gazaliun, se a mund të konsiderohet mendim i drejtë se vetëm rastësitë janë ato që rregullojnë gjithësinë? Natyrisht se kjo s’është gjë tje-

tër veçse fjalë boshe e marrëzi. Ateizmi që qarkullon në mesin e një grupimi llafazanësh kryeneçë që vetëm godasin, nuk është bazuar, qoftë edhe në grimcën më të vogël të dijes e të mendimit të shëndoshë.²²

Në vazhdim do të sjell mendimet e disa shkencëtarëve rreth besimit të tyre në Zot:

- Ajnshtajni ka thënë: “Brendësia e bërthamës së ndjenjës fetare është ta kuptojmë se ai që s’kemi mundësi ta dimë esencën e tij, ekziston vërtet dhe na shfaqet me shenjat më të larta të urtësisë dhe me shkëlqimin më të bukur të dritave. Unë nuk e përfytyroj dot, se ka një dijetar të vërtetë që të mos kuptojë se parimet e shëndosha të një bote, e cila ekziston e ndërtuar mbi një urtësi të veçantë, të mos jenë të kuptueshme për mendjen. Shkenca pa besim, çalon në ecjen e saj, por edhe besimi pa dije, i kërkon sendet, ashtu siç i kërkon i verbëri.”²³
- Dijetari i njohur anglez, Lordi Klifen, duke u tallur me ata që mbështesin rastësinë thotë: “Njeriu e ka të pamundur të përfytyrojë fillimin e jetës ose vazhdimësinë e saj pa pasur në të një forcë krijuese e mbizotëruese. Në thellësi të shpirtit tim, unë besoj se disa dijetarë, në studimet e tyre filozofike për kafshët, kanë mbyllur sytë aq shumë, sa të mos kenë konstatuar në këtë gjithësi argumente të pakundërshtueshme. Rreth nesh kemi shumë fakte e argumente shumë të forta dhe tepër të prera, të cilat vërtetojnë për ekzisten-

²² Muhamed Gazali, po aty, f. 33.

²³ Muhamed Gazali, po aty, f. 29-30.

cën e një sistemi të rregulluar dhe që jep kaq mirësi të mëdha. Këto fakte e argumente na tregojnë me anë të natyrës se në të ka shenja dalluese të një vullneti të lirë dhe na mësojnë se të gjitha gjallesat mbështeten mbi një Krijues të vetëm dhe të përhershëm dhe se nuk ka të dytë që t'i ngjajë Atij.”²⁴

- Filozofi i shekullit XVIII, Hersheli thotë: “Sa më tepër që të zgjerohet kuadri i dijeve, aq më tepër do të shtohen argumentet që vërtetojnë ekzistencën e urtësisë krijuese dhe fuqiplote, absolute. Dijetarët që merren me astronomi, dituri natyrore, matematikë etj., me punën dhe zbulimet e tyre përgatitin gjithçka që duhet për të ndërtuar tempullin e dijeve, për lartësimin e fjalës së Krijuesit.”²⁵
- Sokrati, fjalët e të cilit na janë përcjellë sipas Platonit ka thënë: “Bota na shfaqet në atë formë që e përjashton rastësinë në çdo objekt të saj, madje edhe çdo pjesëz nga pjesëzat e botës është e orientuar drejt një qëllimi dhe ky qëllim është i orientuar drejt një qëllimi më të lartë se qëllimi i parë, ja pra kështu, arrihet në qëllimin e fundit, të vetëm dhe unik.”²⁶
- Muhamed Ali Ajni Bek thotë: “... Natyra është një shenjë në të cilën dallohet ai bashkim që tregon se Ky, Ndërtuesi, nuk ka ortak dhe se urdhrat e Tij zbatohen menjëherë dhe pa defekt. Ai është prezent, vullneti i Tij zbatohet gjithmonë, di gjithçka, e megjithatë nuk perceptohet me shqisa,

²⁴ Muhamed Gazali, po aty, f. 29.

²⁵ Muhamed Gazali, po aty, f. 27.

²⁶ Muhamed Gazali, po aty, f. 27.

ashtu sikurse Dielli, që megjithëse e prekin shikimet tona, nuk mund të vështrohet me vëmendje.”²⁷

- Laplasi, duke shpjeguar argumentin e lëvizjes kozmike thotë: “Forca krijuese nxori madhësinë dhe dendësinë e trupave qiellorë që ndodhen në sistemin tonë diellor, vendosi një herë e mirë ekliptikat e tyre, sistemoi lëvizjet e tyre me ligje të thjeshta, por që janë ligje të mbushura me urtësi. Në bazë të këtyre ligjeve janë caktuar koha e rrotullimit të planetëve rreth diellit, gjithashtu është caktuar koha e rrotullimit të satelitëve të planetëve me llogarinë më të përpiktë, si dhe në atë formë që ky sistem do të vazhdojë deri kur Zoti të mos e prekë me ndonjë diçka, e që do të shkaktonte largimin e distancës ndërmjet tyre.”²⁸
- Kamil Flamerion, mohoi judaizmin dhe krishterimin, por, megjithatë nuk arriti që të njoh Islamin, ai arriti ta njoh Zotin Një e të Vetëm (Allahun), në sajë të studimit të vazhdueshëm në fushat e shkencave e të trupave. Në librin e tij “Zoti në natyrë”, shkruan: “Kur kalojmë nga fushat e ndijimeve në fushën shpirtërore, Zoti na shfaqet si një shpirt që gjendet në të vërtetën e të gjitha sendeve. Nuk është fuqi që sundon përmbi qiejt, por është një sistem i vazhdueshëm mbizotërues mbi të gjitha qeniet e gjalla e të ngurta, nuk është një lulishte e mbushur plot e përplot me njerëz të mëdhenj, e me engjëj. Jo, hapësira është e pafundme, është e mbushur me Të. Ai gjendet në çdo pikë të hapësirës dhe

²⁷ Muhamed Gazali, po aty, f. 27-28.

²⁸ Muhamed Gazali, po aty, f. 28.

në çdo fragment të kohës, ose thënë më saktë: Ai është i Përvetshmi që nuk ka fund, i Pastërti që nuk ka nevojë të ketë vend dhe kohë, ose që të nxirret prej diçkaje dhe të ketë qarkullim, pas të cilit të vjen diçka. Kjo fjalë e imja nuk është shprehje doktrinas që lënë vend për dyshime në saktësinë e tyre, lidhur me sendet që ka mbrapa natyrës. Në të kundërtën, është një nga rezultatet e paluajtshme që i kam nxjerr nga ligjet e mirëqena të shkencës, siç janë proporcionaliteti i lëvizjes dhe përhershmëria e ligjeve. Sistemi i përgjithshëm sundues në natyrë, shenjat e urtësisë famëmadhe në të gjitha sendet dhe të shpërndara kudo, si drita e agimit dhe shkëlqimi pas perëndimit, sendet e arsyeshme dhe sendet që ndjehen, sidomos ai unitet që shfaqet me tërë shkëlqimin e tij në ligjin e zhvillimit të përhershëm, të gjitha këto tregojnë se fuqia e Zotit është ruajtësi i vazhdueshëm i gjithësisë, është sistemi i vërtetë, është burimi bazë për të gjitha ligjet e natyrës, me të gjitha format e shfaqjes së saj.”²⁹

Shkenca e vërtetë nuk ka të bëjë asgjë me mashtrimet e ateizmit. Ajo është kundër ligjeve dhe rregullave shterpe të shpikura nga imagjinata e dobët ateiste. Ndërmjet moçalit të hutisë dhe tollovisë së botës mendore dhe fizike, ajo që i duhet njeriut bashkëkohor është porosia Hyjnore dhe ajo mund të silllet në botën e Perëndimit.

²⁹ Muhamed Gazali, po aty, f. 30-31.

*Edhe pse dielli në lindje lind,
Dhe dëfton trimërisht shkëlqimin e vet, pa tis,
Ai bëhet flakë e dritë nga zjarri i brendshëm, vetëm kur,
U ikën verigave të Lindjes e të Perëndimit,
I dehur nga shkëlqimi, ai shfaqet në lindjen e vet,
Që t'i pushojë të gjitha horizontet,
Qenia e tij s'i përket as Lindjes, e as Perëndimit,
Edhe pse nga lindja është.*

Muhamed Ikbali, Xhavid Nama.

Kjo porosi islame, që del nga qendra, që nuk është as e Lindjes e as e Perëndimit, është thirrje drejtuar njeriut për ta kuptuar kush është ai, si dhe për t'u bërë i vetëdijshëm për atë shkëndijë të amshimit, të cilën ai e ka brenda vetes. Për shkak se jemi mësuar me botën e mrekullueshme të krijimit, ne jemi të pavetëdijshëm për shumë gjëra. Ne, zakonisht i marrim për gjëra të mrekullueshme ato gjëra që nuk është mësuar syri ynë t'i shohë. Por, ç' është e vërteta, çdo krijesë është mrekulli në vete dhe shenjë - ajet prej shenjave të Allahut, sikurse edhe vargjet - ajetet kuranore. Kurani bën thirrje që njeriu t'i vështrojë ajetet - shenjat e Zotit në natyrë. Edhe fjalët e Zotit janë ajete - shenja. Siç thamë edhe më lartë, Zoti na i ka dhënë dy libra, një libër që vërtetohet nga libri tjetër dhe një libër që dëshmohej nga libri tjetër, e këta janë Kurani, fjala e Zotit dhe Universi, krijimi i Zotit. Për fund, mund të thuhet se ka po aq arsye dhe argumente për ekzistencën e Zotit, sa janë edhe atomet në gjithësi. Mrekullitë e krijimit të Allahut janë të pakufishme. Prandaj, Allahu i Madhërishtëm në Kuranin Fisnik thotë: ***“Sikur të gjithë lisat në tokë të jenë lapsa, kurse detit t'i shtohen edhe shtatë dete, nuk do të përmblihdeshin dot fjalët e Allahut, Allahu është pa dyshim i Fuqishëm dhe i Urtë.”*** (Llukman, 27)

Sedat G. ISLAMI

LUTJA E ADEMIT A.S.
(Sekretet e pendimit të sinqertë
dhe të pranuar)

RABBENA!, DHALEMNA ENFUSENA VE IN
LEM TAGFIR LENA VE TERHAMNA LE-
NEKUNENNE MIN EL-HASIRINE!

“O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit!”

Hyrje

Kur Allahu e krijoi Ademin a.s., i urdhëroi engjëjt që t'i përkulen (t'i binin në sexhde), në shenjë nderimi. Edhe Iblisi ishte i urdhëruar për t'i rënë në sexhde, por ai refuzoi. Ai e shihte veten më të mirë sesa Ademi a.s., për shkak se ky i fundit ishte i krijuar nga dheu, ndërsa ai ishte i krijuar nga zjarri. Ky refuzim i urdhrit hyjnor nga Iblisi, në fakt shënon fillimin e një beteje ndërmjet tij dhe njeriut, që nuk do të marrë fund deri në kiamet. Është betejë në të cilën djalli përpigjet me çdo kusht ta devijojë njeriun. Për këtë shkak, ai nuk lë rrugë a mënyrë pa vënë në shërbim. Duke na shpalosur

historinë e tij me Ademin a.s., Kurani na shpalos një formë maskimi të tij. Ai paraqitet edhe si këshillues, madje shumë serioz. Ademin a.s., të cilin e përbuzi dhe e nënvlerësoi që nga momenti i parë, e “këshilloi”, që të hante nga pema që e kishte të ndaluar nga Allahu xh.sh., sepse kështu do të përjetësohej dhe do të arrinte pushtet. I betohej se e këshillonte për të mirën e tij. Ademi a.s., u mashtrua dhe e theu urdhrin e Allahut xh.sh.. Me të ngrënë të pemës, ai kuptoi se nuk bëhej fjalë për këshillë, por për mashtrim. Shkaku i fjalëve të djallit, ai kishte thyer urdhrin e Zotit xh.sh.. Ademi a.s., u ndje shumë keq, andaj bashkë me të shoqen, Havanë, nxituan të pendoheshin.¹ Në trajtimin e kësaj çështje, Kurani na rrëfen edhe për një lutje të veçantë, me të cilën ata të dy ishin të inspiruar nga Allahu xh.sh.,² lutje kjo, në të cilën fshihen urtësi dhe mësim me rëndësi.

﴿قَالَ رَبَّنَا ظَلَمْنَا أَنْفُسَنَا وَإِنْ لَمْ تَغْفِرْ لَنَا وَتَرْحَمْنَا لَنَكُونَنَّ مِنَ الْخَاسِرِينَ﴾

الْخَاسِرِينَ

“Ata të dy thanë: “O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.” (Araf, 23)³

¹ Shih: Kurani: 7: 11-22.

² Shih: Kurani: 2: 37.

³ Përkthimi i kuptimeve të ajeteve kuranore është marrë nga përkthimi i Prof. Hasan I. Nahit, botuar nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë 2006.

Ademi a.s. u pendua, ndërsa Iblisi vazhdoi rrugën e mëkatit. Ademi a.s. u mëshirua duke iu pranuar pendimi, ndërsa Iblisi u mallkua dhe u përzu nga qielli. Kjo lutje e Ademit a.s., nuk është thjesht një lutje. Ajo iu shpall nga Allahu xh.sh., dhe që për më tepër, u shpallë edhe në Kuran, që do të lexohet deri në Ditën e Kiametit. Atëherë:

- Cila është rëndësia e saj?
- Çfarë mësimesh fshihen në të?
- Si mund të përfitojmë prej saj, që të na falen mëkatet?

Rëndësia e lutjes së Ademit a.s.

Rëndësia e kësaj lutje qëndron në mënyrën se si parash-trohet kërkesa për falje. Ndonjëherë, mëkatarët janë viktimë, edhe pse nuk dinë të kërkojnë falje ose nuk gjejnë mënyrë se si të arrijnë deri te falja.⁴ Në këtë dua ofrohet një formulim përmbledhës dhe shumë domethënës, i cili ka një rëndësi jetike në pranimin e pendimit. Për këtë shkak, preferohet që kjo lutje të thuhet kështu, tekstualisht siç ka ardhur në Kur-an.⁵ Ndërsa, për kuptimet që bëhen fjalë në këtë do të shohim në vazhdim.

⁴ Argument për këtë kemi hadithin e transmetuar nga Muslimi në të cilin flitet për njeriun që vrau 99 veta. Ai kërkonte pendim, por paria fetare ia kishin mbyllur dyert. Viktima e njëqindtë ishte një prijës fetar që i kishte thënë se për të nuk ka pendim...Dëshmia: mëkatari ishte në kërkim të pendimit dhe kishte vazhduar me krime derisa kishte gjetur udhëzuesin e drejtë që i kishte thënë se ka pendim për të.

⁵ Mahir bin Abdulhamid bin Mukaddem, *Sherhu edduai min el-Kitabi ve es-Sunneh*, op. cit., f. 168.

Kuptimet dhe sekretet e lutjes së Ademit a.s.

1. Shkaku i mëkatit të besimtarit

Në këtë lutje të Ademit a.s., përshkruhet më së miri raporti i besimtarit me mëkatin. Njeriu si qenie njerëzore, që harron dhe gabon, si besimtar që ka frikë Allahun xh.sh., nuk gabon pse shfaq guxim a arrogancë ndaj Allahut xh.sh., por thjesht pse viktimizohet nga epshi. Për dallim nga djalli që refuzoi urdhrin e Zotit me pretekst mendjemadhësie, Ademi a.s. theu urdhrin për shkak se u mashtrua dhe lakmoi në përjetësi e në pushtet.⁶

Këtu duhet të kemi parasysh tri gjëra:

- Duke iu referuar rastit të Ademit a.s. dhe djallit të mallkuar, dijetarët kanë konstatuar se janë tri gjëra që i shtyjnë njerëzit në mëkate, e ato janë: mendjemadhësia, lakmia dhe zilia.⁷
- Po kështu, ata kanë klasifikuar edhe mëkatet sipas shkallës së rrezikshmërisë. Ata kanë shpjeguar se mëkatet që për bazë kanë mendjemadhësinë, e që në fjalorin fetar i quajmë mëkatet e zemrës, janë më të rrezikshme sesa mëkatet që për motiv kanë epshin dhe lakminë, e të cilat ne i quajmë mëkatet të trupit. Për ta thjeshtësuar, njeriu

⁶ Shih: Kurani: 20: 120.

⁷ Muhammed bin ebi Bekr ibën Kajjim el-Xheuzijje, *El-fevaid*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijje, ed. 2, 1973), f. 58.

- që bën rija⁸, është më mëkatar i madh, sesa ai që konsumon alkool, megjithëqë e di se është duke bërë gabim.
- Jo çdo këshillë është e mirë dhe jo çdo këshillues është i sinqertë. Ademi a.s. ra viktimë e djallit që betohej se i këshillonte ata, vetëm pse i donte ata.⁹

2. Perceptimi për mëkatin

Në këtë lutje, mëkati është shpjeguar si padrejtësi. Ademi a.s. kërkoi falje duke pranuar se i kishte bërë vetes padrejtësi kur kishte mëkatur. Mëkatin e quajnë padrejtësi edhe Kurani dhe Suneti.¹⁰ Kjo ngase mëkatet ia mbyllin njeriut derën e mirësive dhe se për to ai nuk duhet të fajësojë askënd pos vetes së tij. Në një hadith kudsij, të shënuar në Sahihun e Muslimit qëndron: “O robërit e Mi! Në të vërtetë, ato janë veprat tuaja, të cilat ua regjistroj për t’iu shpërblyer më pas. Kështu, kush gjen mirë, le ta falënderojë Allahu, e kush nuk e gjen këtë, le të mos e qortojë askënd tjetër përveç vetes së tij.”

⁸ Shtiret para të tjerëve se është i devotshëm, i mirë, ndërsa nuk e kryen punën për hir të Allahut xh.sh.

⁹ Ibën Abbasi r.a., siç shënon Imam Kurtubiu në tefsir, ka thënë: “*Djalli i mallkuar i mashtroi duke u betuar. Ademi a.s., i besoi (dhe rrjedhimisht ra viktimë e tij) sepse besonte që askush nuk betohej rrejtshëm në Allahun.*”. Shih: Muhamed bin Ahmed el-Kurtubi, *El-xhamiu li ahkami el-Kur’an*, (Kajro: Dar el-kutub el-misrije, ed. 2, 1964), 7/180.

¹⁰ Shih: Kurani: 31:13. Shih po kështu edhe hadithin e transmetuar nga Muslimi (nr. 771): “*O Allahu im, Ti je Sunduesi, nuk ka zot tjetër pos Teje, Ti je Zoti im ndërsa unë jam rob i Ti! I kam bërë vetes sime padrejtësi dhe pranoj mëkatin që kam bërë andaj mi fal të gjitha mëkatet sepse askush pos Teje nuk i fal ato!...*”

3. Edhe mëkati i vogël dënohet

Siç e shpjegojnë dijetarët, mëkati të cilin e ka bërë Ademi a.s., është mëkat i vogël,¹¹ megjithatë, Ademi a.s. kërkoi falje. Duke komentuar lutjen në fjalë, Bejdaviu, shpjegon se, nëse mëkatet e vogla nuk falen, atëherë njeriu ndëshkohet për to.¹² Është kjo një thirrje për të braktisur mëkatet, qofshin ato të mëdha apo të vogla. Ndonjëherë, nga mosdija, lëshohemi në mëkatet të vogla, rrezikun e të cilave e nënvlerësojmë. Pavarësisht se Allahu xh.sh. ia fali këtë mëkat, Ademin a.s. prapëseprapë ai vazhdonte ta preokuponte. Madje, siç qëndron në sahihët e Buhariut dhe të Muslimit,¹³ ai do ta preokupojë edhe në Ditën e Llogarisë. Njerëzit do të shkojnë tek ai për të kërkuar ndërmjetësim tek Allahu xh.sh., si babai i njerëzimit që është, por ai do t'iu thotë se mëkati që ai ka bërë, e bën të ndiejë keqardhje të atillë, sa që nuk mund të dalë para Zotit. Pra, kryerja e mëkateve të vogla me arsyetimin se janë të vogla, është gabim. Siç qëndron në Musnedin e Imam Ahmedit, Pejgamberi a.s. kishte shpjeguar në mënyrë figurative rrezikun e mëkateve të vogla, duke marrë shembull një grumbull drurësh që mblidhen një nga një, por që kur ndezën përnjëherë bëjnë një flakë dhe zjarr të madh. Dy këshilluesit e mëdhenj të myslimanëve, Ibën el Xheuzi dhe

¹¹ Ismail Hakki bin Mustafa el-Istanbuli, *Ruh el-bejan*, (Bejrut: Dar el-fikr, p.v.b.), 3/146.

¹² Abdullah bin Omer el-Bejdavi, *Envar et-tenzil ve esrar et-te'vil*, (Bejrut: Dar ihjai etturath el-arabij, 1418 h.), 3/9.

¹³ Shih hadithin 4712 në *Sahihun* e Buhariut dhe hadithin 194 në *Sahihun* e Muslimit.

Ibën Kajimi, kanë marrë nga një shembull interesant sa i përket rrezikut të mëkateve. I pari, rrezikun e tyre e sheh sikur rrezikun e zjarrit të mbuluar me hi, i cili të djegë edhe pa e vënë re.¹⁴ Ndërsa, i dyti, duke iu referuar dijetarëve të mëherëshëm, mëkatet i sheh si postë, e cila të shpie në kufër.¹⁵

4. Ndikimi i pranimit të fajit dhe plotësimit të kushteve të pendimit në pranimin e pendimit

Në këtë lutje të Ademit a.s., fshihet një sekret me rëndësi kyç, sa i përket pranimit të pendimit. Fjala është për pranimin e fajit. Duke shpjeguar këtë lutje, Imam Taberiu thotë: “Në këtë ajet kuranor, Allahu po na rrëfen për Ademin dhe Havanë, se si ata, ndryshe nga djalli i mallkuar, e pranuan mëkatin dhe kërkuan falje. Ata thanë: “O Zoti ynë! Ne duke të kundërshtuar Ty dhe duke thyer urdhrin Tënd në njërën anë, si dhe duke dëgjuar armikun tonë dhe Tëndin në anën tjetër, i kemi bërë vetes sonë keq, ndërsa nuk është dashur ta bëjmë këtë.”¹⁶ Pra, Ademi a.s. nuk deshi të ofronte justifikime të kota për mëkatin, por e pranoi atë, sepse, siç e shpjegojnë dijetarët, pendimi nuk është i plotë përderisa mungon

¹⁴ Abdurrahman bin Ali bin Muhammed el-Xheuzi, *Sajd el-hatir*, (Damask: Dar el-kalem, 2004), f. 206.

¹⁵ Muhammed bin ebi Bekr ibën Kajjim el-Xheuzijje, *Eddau ve eddevau*, (Mekke: Dar Alem el-fevaid, 1429 h.), f. 125.

¹⁶ Muhamed bin Xherir et-Taberij, *Xhamiu el-bejan fi te'vili el-Kuran*, (Bejrut: Muessesetu err-rrisale, 2000), 12/356.

pranimi i fajtit.¹⁷ Në këtë lutje, studiuesit kanë parë të jenë përmbushur edhe kushtet e tjera të pendimit. Më saktë, keqardhja për mëkatin, braktisja e tij dhe vendosmëria për të mos e bërë atë, janë përmbushur plotësisht në lutjen e Adem-it a.s..¹⁸ E përmbushja e tyre, siç e kanë shpjeguar dijetarët, nënkupton edhe pranim të pendimit. Imam Gazaliu ka thënë: “Kush supozon se pendimi (kushtet e të cilit janë plotësuar) vlen, por nuk pranohet, është sikur ai që supozon se dielli lind, ndërsa errësira nuk hiqet.”¹⁹

5. Nxitimi në pendim

Në Ruh el bejan, shpjegohet se Ademi dhe Hava, posa mëkatuan, kuptuan se çfarë kishin bërë, andaj pranuan gabimin dhe nxituan të pendohen.²⁰ Sharavi, këtu e sheh dallimin ndërmjet Adem-it a.s. dhe djallit të mallkuar. Ademi a.s. u pendua menjëherë, ndërsa djalli u justifikua.²¹ Në komentin e

¹⁷ Muhamed Muteveli Sharavi, *Etteubetu*, (Kajro: Mektbetu etturath el-islamij, 2001), f. 35. Pranimi i fajtit vihet re edhe në lutjet e Muhamed-it a.s. P.sh. në një prej lutjeve të tij, Muhamedi a.s. thoshte: “*O Allahu im, Ti je Sunduesi, nuk ka zot tjetër pos Teje, Ti je Zoti im ndërsa unë jam rob i Ti! I kam bërë vetes sime padrejtësi dhe pranoj mëkatin që kam bërë andaj mi fal të gjitha mëkatet sepse askush pos Teje nuk i fal ato!...*” Muslimi, nr. 771.

¹⁸ Mahir bin Abdulhamid bin Mukaddem, *Sherhu edduai min el-Kitabi ve es-Sunneh*, (Rijad: Matbaatu Sefir, p.v.b.), f. 168.

¹⁹ Abdulatif Ashur, *Kitabu et-Teubeh li huxheti el-Islam Ebi Hami del-Gazali*, (Egjipt: Mektebetu el-Kur’an, p.v.b.), f. 44.

²⁰ Ismail Hakki bin Mustafa el-Istanbuli, *Ruh el-bejan*, op. cit., 3/146.

²¹ Muhamed Muteveli Sha’ravi, *Tefsir esh-Sharavi*, (Kajro: Metabiu Ahbar el-jeum, 1997), 7/4088.

ajetit të 37-të, të sures Bekare²², në të cilin përmendet se Ademi a.s. është inspiruar me fjalët e Zotit për t'u penduar, Ibën Abasi thotë: “Ademi a.s. tha: “O Zoti im, a nuk më ke krijuar me dorën Tënde?! A nuk ma ke dhënë shpirtin, më ke dëshiruar mëshirë, kur kam teshtirë?!” “Po” - iu përgjigj. “A nuk tejkalon mëshira Jote hidhërimin Tënd, dhe a nuk ma ke shkruar që ta bëj këtë?!” “Po” - iu përgjigj. Nëse pendohem, a do të më kthesh në xhenet?!” “Po” - iu përgjigj.”²³ Nxitimi për t'u penduar ka rëndësi jetike në pranimin e pendimit. Në Kuran, kur flitet për mëkatarët të cilëve ju pranohet pendimi, pranohet nxitimi në pendim si tipar i theksuar i tyre. Allahu thotë:

﴿إِنَّمَا التَّوْبَةُ عَلَى اللَّهِ لِلَّذِينَ يَعْمَلُونَ السُّوءَ بِجَهَالَةٍ ثُمَّ يَتُوبُونَ مِنْ قَرِيبٍ فَأُولَٰئِكَ يَتُوبُ اللَّهُ عَلَيْهِمْ ۖ وَكَانَ اللَّهُ عَلِيمًا حَكِيمًا﴾

“Allahu është pranues i pendimit vetëm për ata që bëjnë ndonjë të keqe nga padituria dhe pendohen shpejt. Pra, këtyre Allahu ua pranon pendimin. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.” (Nisa, 17)

²² “Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin. Sigurisht, Ai i pranon shumë pendimet, Ai është Mëshirëploti.” [Kurani: 2: 37]

²³ Mustafa Murad, *Duau el-Enbija*, (Kajro: Dar el-fexhr lit turath, ed.2, 2010), f. 19.

6. Frika dhe shpresa në dua

Në lutjen e Ademit a.s., mund të vërejmë përmbajtje të frikës dhe shpresës.²⁴ Ademi a.s. shprehu frikën kut tha t'i kenë bërë vetes padrejtësi me mëkate, si dhe kur përmendi fundin e keq nëse nuk i pranohet pendimi, sikur që shprehu shpresën kur u lut për falje dhe mëshirë. Këto dy elemente kanë rëndësi jetike, jo vetëm për lutjen, por edhe për jetën shpirtërore në tërësi. Është guitë e veprave të besimtarit. Atë nuk duhet ta mashtrojë shpresa e të zhytet në mëkate, sikur që rënia në mëkate nuk duhet ta verbërojë e që të mos shoh dritë të pendimit asgjëkund.

7. Përse u regjistrua rasti i Ademit a.s. në Kuran, nëse veç atij iu fal mëkati?

Imam Maturidiu në komentin e lutjes në fjalë, e më saktë si përgjigje e pyetjes së ngritur, ofron dy përgjigje, të cilat janë përplot urtësi:

- Ademi a.s. ndiente keqardhje të madhe për mëkatin, saqë kur kishte kërkuar falje, kishte kërkuar vetëm faljen e mëkatit, jo edhe të mbulimit para të tjerëve. Pra, kjo paraqet gjendjen e tij shpirtërore, që siç thamë më parë, vazhdon ta mundojë edhe në Ditën e Llogarisë.
- Allahu xh.sh. desh i që rasti i Ademit a.s. të jetë mësim për ne. Pra, nëse peygamberët, me gjithë pozitën që kanë, kërkojmë falje për mëkatet e tyre, atëherë ku jemi ne?²⁵

²⁴ Mahir bin Abdulhamid bin Mukaddem, *Sherhu edduai min el-Kitabi ve es-Sunneh*, op. cit., f. 168.

²⁵ Muhammed bin Muhammed bin Mahmud ebu Mensur el-Maturidi, *Tefsir el-Maturidi*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmijje, 2005), 4/387.

Mësimet që i përfitojmë nga kjo lutje

1. Rreziku i mëkateve, qofshin ato të mëdha apo të vogla, dhe se ajo janë padrejtësia që njeriu ia bën vetvetes.
2. Pranohet pendimi, nëse plotësohen kushtet e tij.
3. Pranimi i fajit dhe keqardhja, çelësat kryesorë të pranimit të pendimit.
4. Përshpejtimi i pendimit.
5. Mëshira e Allahut me robërit, kur këta të fundit mëkatojnë, ndërsa Allahu i falë.
6. Preferohet që lutjet e përmendura në Kuran dhe në hadithe të Pejgamberit a.s., të thuhën tekstualisht, ashtu siç janë. Kjo për shkak të urtësive që fshihen në fjalët me të cilat formulohet. Kjo natyrisht se është edhe thirrje për t'i mbajtur mend këto lutje.
7. Mendjemadhësia, si cilësi e djallit, ndërsa përulësia dhe modestia, si cilësi të besimtarit.
8. Jo çdo këshillë është e mirë dhe jo çdo këshillues është i sinqertë. Djalli u paraqit si këshillues, por i drejtoi në mëkat Ademin a.s. dhe Havanë.
9. Pejgamberët janë shembulli që duhen ndjekur. Nëse Ademi a.s. u pendua dhe ka ndier keqardhje të madhe për vetëm një mëkat që ka bërë, si të mos pendohemi ne dhe të mos ndiejmë keqardhje kur kemi gabime të shumta?!

Prim.dr.med.sc. Ali F. ILJAZI

JETA DHE VDEKJA NGA KËNDVËSHTRIMI KURANOR DHE SHKENCOR

Allahu i Madhërishëm në Kuranin fisnik urdhëron e thotë:

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen...”¹

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen, e Ne, në shenjë sprove, ju sprovojmë me vështirësi e kënaqësi dhe te Ne ju do të ktheheni!”²

“Çdo njeri do ta shijojë vdekjen, e pastaj te Ne do të ktheheni.”³

“Thuaj: “Engjëlli i vdekjes, i cili është caktuar për ju, ua merr shpirtrat, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj.”⁴

“...dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç’ vend (ose kohë) do të vdesë. Allahu është më i Dijshmi, më i Njohuri.”⁵

¹ Ali Imran, 185.

² Enbija, 34-35.

³ Ankebutë, 57.

⁴ Sexhde, 11.

⁵ Llukman, 34.

“Nuk ka dyshim se Ne i ngjallim të vdekurit dhe i shkruajmë veprat e tyre dhe gjurmët e tyre, si dhe gjithçka që Ne kemi shënuar në llogari si dëshmi në Libër të Qartë.”⁶

“Sigurisht se ti (Muhamed) do të vdesësh dhe pa dyshim se edhe ata do të vdesin.”⁷

“Agonia e vdekjes i vjen me atë të vërtetën (i zbulohet çështja e Ahiretit), ajo që ajo prej së cilës doje të shpëtoje.”⁸

“(Do t’u thuhet mëkatarëve) Ti vërtet se ishe i pavëmendshëm për këtë. E Ne ta hoqëm perden tënde dhe i mprehtë është shikimi yt këtë ditë.”⁹

“Kudo që të jeni vdekja do t’ju kapë, po edhe në qofshi në pallate të fortifikuara...”¹⁰

“(Allahu është) Ai i Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t’iu provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Madhështori, Falësi i madh.”¹¹

“Allahu kurrësi nuk ia shtyn askujt afatin për më vonë, kur atij t’i vjen afati i vet (i vdekjes). Allahu hollësisht është i njohur me atë që ju punoni.”¹²

“Mandej atë e bën të vdes dhe atij i bën varr (që të varroset).”¹³

⁶ Jasin, 12.

⁷ Zumer, 30.

⁸ Kaf, 19.

⁹ Kaf, 22.

¹⁰ Nisa, 78.

¹¹ Mulk, 2.

¹² Munafikunë, 11.

¹³ Abese, 21.

Asnjë proces në jetën e kësaj bote nuk ka nxitur aq polemika dhe kundërthënie sesa procesi i jetës dhe vdekjes. Asnjë çështje nuk është ndjekur nga qarqet shkencore me aq manipulime e thashetheme, sesa procesi i jetë dhe i vdekjes, ngase vdekja për ne është një sekret dhe një gjë e pakapshme për shqisat tona. Allahu i Madhërishëm krijoi dy etapa kohe për krijesat e tij: jetën dhe vdekjen, siç thotë ajeti kuranor: ***“Ai, i Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t’iu provuar se cili prej jush është më vepër miri. Ai është Madhështori, Falësi i madh.”***¹⁴

Këto dy etapa, ajo e jetës dhe e vdekjes, i kanë ligjet e veta të cilave iu nënshtrohen. Kur njeriun e zë gjumi, ai transferohet nga një ligj në tjetrin. Në gjendjen e zgjuar, ne i shohim gjërat e materializuara dhe vazhdojmë jetën duke logjikuar mbi gjërat me mendjen tonë. Kjo është bota, të cilën e njohim të gjithë dhe të cilën e ndajmë bashkë. Mirëpo, kur flemë, ne jemi në një botë tjetër, e cila nuk i nënshtrohet as mendjes, as logjikës, e as rregullave të kësaj bote. Vetëm për një sekondë, ne transferohemi prej një ligji në një ligj tjetër natyror, dhe këtë fare nuk e hetojmë. Për këtë, Allahu i Madhërishëm në Kuranin famëmadh na rrëfen: ***“Allahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre (i vdekjes së trupave të tyre), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur, e atij që i është caktuar vdekja e mban (nuk e kthen), e atë tjetrin (që nuk i është caktuar vdekja, por është në gjumë), e lëshon (të kthehet) deri në afatin e caktuar...”***¹⁵

¹⁴ Mulk, 2.

¹⁵ Zumer, 42.

Në fakt, gjatë gjumit ne dalim plotësisht nga ligjet e kohës, nga rrjedhat e ngjarjeve dhe nga ligjet e saj. Shumë hipoteza dhe teori të ndryshme psikologjike u përpoqën që të bëjnë ndonjë koment (shpjegim) mbi atë se çka sheh njeriu kur fle. E tërë ajo çka na dha psikologu në këtë drejtim nuk janë asgjë tjetër veçse parashikime, supozime dhe paragjykitime të thjeshta, që nuk shpijnë kah e vërteta reale dhe definitive. Shkenca konfirmon se kohëzgjatja e angazhimit të trurit të njeriut në ëndërr është vetëm shtatëmbëdhjetë sekonda. Edhe pse koha është kaq e shkurtër, njeriu mund ta komentojë ëndrrën afër një orë, apo edhe më tepër.

Allahu i Gjithëfuqishëm, si gjest mëshire për mendjen e robërve të Tij, deshi të na tregojë se njeriu në gjumë transferohet në botën e vdekjes, kurse pas zgjimit nga gjumi, i Madhi Zot Fuqiplotë e kthen prapë shpirtin e tij në jetë. Ne nuk ishim dëshmitarë gjatë krijimit, mirëpo çdo ditë e shohim vdekjen për të cilën mund të dëshmojmë. Vdekja është e kundërta e jetës, sepse këto dy procese nuk përputhen mes vete. Ashtu siç na mëson Allahu i Madhërishëm, i fundit që hyn në trupin e njeriut është shpirti. Por, ky është i pari që largohet nga trupi pas vdekjes së tij. pastaj, trupi i njeriut shtanget dhe bëhet i ngurtë sikurse dheu i zi i ngurtë, pastaj kalbet duke u shndërruar në baltë. Më vonë, uji i trupit ndahet nga balta. Ujin e pi toka, kurse balta bëhet pluhur dhe shkatërrimi i një sendi është e kundërta e ndërtimit të tij. Kjo është ajo e vërteta, të cilin e ka theksuar Kurani i lavdishëm. Këtë gjë na e dëshmon për çdo ditë vdekja. Në kaptinën El Hixhër, Allahu i Madhërishëm na informon: ***“Dhe (kujto) kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj njeriun nga balta e***

tharë, e zezë dhe me erë. E kur ta përsosë atë (në formën e njeriut) dhe t'i japë atij shpirtin që është krijesë Imja, atëherë ju bini në sexhde atij.”¹⁶

Nëse dëshirojmë ta dimë fshehtësinë e jetës dhe të vdekjes, patjetër që duhet ta marrim atë nga Allahu xh.sh., si burim më të saktë, i Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën. Në rast se meditojmë me vëmendje lidhur me fjalët e Allahut të Madhërishëm: **“Çdo send do të shkatërrohet, përveç Tij.”**¹⁷ Domethënë, çdo send që e krijoj Allahu i Madhërishëm në këtë botë është i gjallë, e pastaj do të shkatërrohet. Nuk shkatërrohet vetëm Qenia e Tij e Madhëruar.

Allahu i Gjithëmëshirshëm i dha gjallëri njeriut duke ia dhuruar shpirtin. Në këtë mënyrë, ia dha njeriut përhershmerinë. Njeriu lind dhe i jeton në këtë botë ditët dhe vitet e tij të caktuara. Pastaj, vdes dhe pas vdekjes ringjallet dhe jeton në jetën e përhershme të Ahiretit. Nëse i ka ndjekur dhe i ka zbatuar urdhrat e Krijuesit, atëherë ai do të jetojë në begati. Por, nëse i ka kundërshtuar ato, atëherë ai do të jetojë në vuajtje e dënim. Këtë e përshkruan shumë bukur Kurani fisnik: **“Kjo jetë e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se dëfrim e lojë, e jetë e vërtetë, pa dyshim se është ajo e botës së ardhme (Ahireti), sikur ta dini.”**¹⁸ D.m.th., jeta e Ahiretit është jeta e vërtetë që do ta jetojë njeriu, ndërsa jeta e kësaj bote është kalimtare, e shkurtër dhe e kufizuar, sado që të jetojmë gjatë në të. Kjo botë është sprovim për njeriun dhe në të nuk jemi të përher-

¹⁶ Hixhr, 28-29.

¹⁷ Kasas, 88.

¹⁸ Ankebutë, 64.

shëm. Njeriu posa të lind dhe ta filloj jetën e tij, në të njëjtin çast starton shigjeta e vdekjes, kështu që vdekja e kërkon vazhdimisht pronarin e saj, derisa të vjen momenti i afatit të caktuar për vdekje dhe e godet atë. Vdekja nuk është e qëndrueshme në gjithësi. Ajo është vetëm udhëtare, kalimtare, e njëjtë me kalimin prej një jete në një jetë tjetër.

Ne, në botën e atomit ishim të vdekur, erdhëm në këtë botë të gjallë që të vdesim përsëri, e pastaj prapë ringjallemi, siç na rikujton verseti kuranor: ***“Si po e mohoni Allahun, e dihet se ju ishit të vdekur e Ai ju ngjalli, mandej ju bën të vdisni e pastaj ju ringjall, e mandej tek Ai do të ktheheni.”***¹⁹

Në Ditën e Gjykimit, do të vjen vdekja, do të merret shpirti dhe do të thërret, siç na rrëfen i Dërguari i Allahut të Madhërishtëm a.s.: *“Në Ditën e Gjykimit, do të vjen vdekje në formë të një dashi të bardhë dhe do të thërret, pastaj një thirrës nga ana e Allahut xh.sh., thërret: “O ju banorë të xhenetit, amshim dhe përhershëmëri pa vdekje dhe o ju banorë të xhehenemit, amshim dhe përhershëmëri pa vdekje.”* Pra, edhe vdekja paska mbarimin e saj. I Plotfuqishmi në shpalljen hyjnore, në Kuran, për banorët e xhenetit thotë: ***“Aty nuk do ta përjetojnë vdekjen, përveç asaj të parës në dynja. Ata i shpëtoi (Allahu) prej vuajtjeve të xhehenemit.”***²⁰

Pra, kështu mësojmë dhe njihemi me atë se vdekja e ka mbarimin e saj, kurse jeta është ajo që do të mbetet përgjithmonë e amshueshme. Vetëm jeta është e qëndrueshme në

¹⁹ Bekare, 28.

²⁰ Duhan, 56.

këtë gjithësi, kurse vdekja është kalimtare dhe e përkohshme në të.

Andaj, vdekja është vetëm një transferim prej një ligji natyror në ligjin tjetër. Njeriu gjatë jetës së tij bartë një barrë materiale në trupin e tij, kurse pas vdekjes, ngase trupi është prej dheut, kthehet përsëri në tokë, që pastaj të rikthehet te pronari i vet në Ditën e Gjykimit. Pra, vdekja fillon kur vjen momenti i dorëzimit të shpirtit.

Njeriu gjatë jetës së tij ka mundësi të zgjedh. Ai e ka mendjen, e cila e dallon të mirën nga e keqja. Mirëpo, në momentin e dorëzimit të shpirtit, kjo etapë e zgjedhjes me dëshirë përfundon (etapë kjo që ishte një lloj testimi dhe sprovimi për njeriun në këtë botë) dhe fillon një etapë tjetër e re, në të cilën nuk ka mundësi të zgjedh, por është i nënshtruar (nuk ka të drejtë zgjedhje). Në momentin e dorëzimit të shpirtit, njeriu e ka të qartë se po vdes, ngase e sheh engjëllin (melaken), krijesë e Allahut të Madhërishëm, e sheh atë që deri atëherë ishte abstrakte, e padukshme dhe e pakapshme për shqisat tona. Këtë moment, shkenca nuk ka aftësi ta përshkruajë, e as mjetet laboratorike më precize nuk mund ta regjistrojnë. Për këtë na informon qartë dhe në mënyrë precize Kurani fisnik: *“(Do t’u thuhet mëkatarëve) Ti vërtet se ishte i pavëmendshëm për këtë. E Ne ta hoqëm perden tënde dhe i mprehtë është shikimi yt këtë ditë.”*²¹

Siç na e përshkruan Kurani hyjnor, çasti apo momenti i vdekjes heq perden, ngrit mbulesën dhe i kthjellon sytë, duke

²¹ Kaf, 22.

i zbuluar dhe duke i bërë të dukshme të gjitha ato gjëra që ishin sekrete, të fshehta dhe të pakapshme për shqisat tona dhe për mikroskopët më precizë. Këtë na e argumenton edhe Kurani i lavdishëm: **“Përse, pra kur arrin shpirti në fyt. E ju në atë moment shikoni (se ç’po i ngjet). E Ne jemi më afër tej ai se ju, po ju nuk shihni.”**²²

Në këtë moment fillon çasti i parë në botën tjetër, fillimi i jetës së amshuar, sepse ai që vdes e sheh menjëherë vendqëndrimin e tij të ardhshëm. Ai që vdes dëgjon, por nuk mund të përgjigjet. Shikon, mirëpo nuk mund të tregojë se ç’është duke parë. Të vdekurit dinë sikur që dinë të gjallët. Muhamedi a.s. na këshillon dhe thotë: “Kur t’i vizitoni varrezat, përshëndetni banorët e tyre duke thënë: Shpëtimi i Zotit qoftë mbi ju, o banorë të shtëpive të popullit besimtar.”

Pra, banorët e varreve janë të vetëdijshëm se dikush ka ardhur t’i vizitojë dhe t’i përshëndes. Po kështu ekziston edhe një vetëdije tjetër mendore apo logjike, me anë të së cilës e dallojmë shpresën (optimizmin) prej pesimizmit (humbjes së shpresës), për të cilën flet edhe verseti i Kuranit në vijim: **“O ju që keni besuar, mos u miqësoni me një popull që Allahu ka shprehur hidhërim kundër tij, popull që ka humbur shpresën ndaj botës së ardhshme, ashtu si nuk kanë shpresë jobesimtarët prej të vdekurve (që do të ngjallen) në këtë botë, ose në ringjallje (në botën tjetër).”**²³

²² Vakia, 83-85.

²³ Mumtehinë, 13.

Allahu i Madhërishëm është Ai që krijoi jetën dhe vdekjen. Ai është i Vetmi Fuqiplotë, i Cili njeriun e transferon prej jetës në vdekje dhe prej vdekjes në jetë. Prej emrave të bukur të Allahut xh.sh. janë edhe El Muhij - Ai që ngjall, jep (dhuron) jetë dhe El Mumit - që të bën të vdesësh.

Por, Allahu i Gjithëmëshirshëm e ka lënë të fshehtë afatin e vdekjes sonë. Askush nuk e di kohën e saktë të vdekjes, siç thotë i Lartmadhërishmi: ***“Nuk e di kush pos Tij se çka do të ndodhë (çka do të punojë) nesër, dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç’vend (ose kohë) do të vdes. Allahu është i Dijshmi, më i Njohuri.”***²⁴

Prapa kësaj fshehtësie të Allahu xh.sh. qëndron një urtësi e madhe. E para, se njeriu e paramendon vdekjen në çdo moment, e ky paramendim është shenjë se vdekja do të vjen. Në të njëjtën kohë përgatitemi më shumë për t’u ballafaquar me të në çdo moment, andaj të shpejtojmë në mirësi dhe të largohemi nga mëkatet. Duhet të jemi të bindur se përpos exhelit (afatit) nuk ka shkak tjetër për vdekje. Mos besoni se sëmundja mund të të mbysë, apo plumbat mund të jenë vdekjeprurës, përpos nëse ka përfunduar afati (exheli) yt në këtë botë. Ndodh që njeriu sëmuret, por e merr një aspirinë me një gotë ujë dhe shërohet. Njeriu shërohet, sepse nuk ka ardhur momenti i exhelit të tij. Ai ende ka afat. Në rastin tjetër, i sëmuri transferohet në spital. Atje dhjetëra mjekë e rrethojnë duke i dhënë ndihmën mjekësore, por prapëseprapë ai vdes, sepse vdekjen e ka caktuar Allahu i Madhërishëm. Mos e ha-

²⁴ Llukman, 34.

rro vdekjen, sepse vdekja një ditë do të vjen. Askush nuk mund ta ndalojë atë. Për këtë e kanë pyetur Aliun r.a.: “A nuk i frikësohesh vdekjes?” Ai u përgjigj: “Jo, sepse ditën që është afati i saj për të ardhur, askush nuk mund ta ndalë, e ditën që nuk vjen askush nuk mund ta bjerë atë (vdekjen).”

Shkaqet e vdekjes, që ne i numërojmë si të tilla, si sëmundja, pleqëria e të tjera, në realitet nuk janë shkaqe të vërteta, sepse kur të vjen vdekja nuk ka nevojë për shkaqe. Por, më e drejtë është të thuhet: filani ka vdekur sepse afati (exheli) i tij ka përfunduar (është kryer). Ja se ç’thotë Allahu i Madhërisëm për këtë në Kuranin famëmadh: **“Kudo që të jeni, vdekja do t’ju kapë, edhe në qofshi në pallate të fortifikuara...”**²⁵

Edhe përkundër të gjitha të arriturave kulturore-civilizuese, shkencore e teknologjike në këtë botë, njerëzimi është akoma i paaftë ta ndalë vdekjen.

Pra, çdo gjë që ekziston në këtë gjithësi kalon nëpër etapa të krijimit, vdekjes dhe jetës. Çdo pikë e ujit (spermës) simbolizon një jetë njeriu, në të cilën gjendet shifra sekrete, që përmban në vete fillimin dhe mbarimin e jetës së njeriut, çdo ngjarje që do t’i ndodhë atij, gjininë dhe fatin e tij etj. Po të dinim ta deshifronim çelësin e kësaj shifre sekrete, atëherë për një kohë shumë të shkurtër para vetes do ta kishim në mënyrën precize formën e njeriun, gjininë dhe biografinë e tij. Kjo pikë e spermës së zgjedhur me një precizitet të duhur është ajo që hyn në mitër, ku bën fekondimin e qelizës femërore, dhe pastaj, me lejen e Zotit të Madhërisëm, ndodh

²⁵ Nisa, 78.

shtatzënia. Nga ky çast, çdo gjë shënohet në kodin dhe shifrën sekrete, derisa të vjen çasti i vdekjes, kur shënimet marrin fund. Ja disa hadithe të Muhamedit a.s. për vdekjen:

“Kujtoni shkaktarin e ndërprerjes së kënaqësisë e të gëzimit, kujtoni vdekjen.”²⁶

“O njerëz! Kthehuni te Zoti juaj para vdekjes dhe afrojeni Atij me vepra të mira derisa të keni rast për këtë.”²⁷

“Shikimi i njeriut para vdekjes, ndjek shpirtin e vet që i merret.”²⁸

Duke rënë në shtrat, i Dërguari i Allahut a.s., preferonte këtë lutje të bukur: “Zoti im, Ti e krijove shpirtin tim dhe Ti do ta marrësh, Ty të takon vdekja dhe jeta e tij. Nëse e merr, mëshiroje! Nëse e kthen, ruaje me atë që i ruan robërit e Tu të mirë!” Sa këshilla të bukura nga Muhamedi a.s. Pra, ta presim vdekjen të qetë, me vepra të mira, se vetëm ato na bëjnë të pavdekshëm. Ja edhe disa përkufizime mbi vdekjen që janë bërë nga dijetarët e shquar islamë:

“Vdekja është ndarje e shpirtit nga trupi dhe transferim nga shtëpia e përkohshme në shtëpinë e përhershme. Ne na duke humbje, por në realitet ajo është lindje e dytë. Mu sikur që pëlçet lëvozhga e vesë dhe del zogu, mu ashtu vjen koha e ndarjes së shpirtit nga trupi. Prandaj, vdekja është domos-

²⁶ Tirmidhiu, Ibën Maxheh.

²⁷ Ibën Maxheh.

²⁸ Muslimi.

doshmëri e procesit, kalimit në botën tjetër, në të cilën njeriu nuk arrin lartësimin e tij.”²⁹

“Vdekja është lumturia e shpirtit ndaj trupit, dhe në këtë ndarje shpirtit nuk zhduket, por vetëm trupi.”³⁰

“Vdekja është ndryshim i gjendjes me ç’rast shpirti ndahet nga trupi duke jetuar pa të, ndien (përjeton) kënaqësi po dhimbje. Ndarja e shpirtit nga trupi shkakton ndërprerjen e përdorimit të trupit nga ana e shpirtit, ngase shpirtit ka shikuar me sy, ka dëgjuar me vesh, ka prekur me dorë dhe ka ecur me këmbë, por brendinë e gjërave e ka njohur vetë. Njohuria është veti e posaçme e shpirtit dhe qëndron me shpirtin edhe pas ndarjes nga trupi.”³¹

“Vdekja do të thotë ndarje e shpirtit nga trupi, në të cilën jeta e përbashkët ka qenë e ndjeshme fizike. Ndarja ka ardhur menjëherë, pasi kanë qenë ngushtë të shoqëruar, dhe ai shoqërim ka qenë shkak i jetesës (origj. il-leti hajat).”

Shpirti ka kaluar nga një botë në botën tjetër dhe jeta e tij nuk është ndërprerë. Jetën shpirtërore ne nuk e shohim, pra ndaj edhe nuk e njohim. Për dëshmorët (shehidët) është thënë se janë të gjallë dhe na është ndaluar të themi se kanë vdekur, siç aludon verseti: “E për ata që u mbytën në rrugën e Allahut, mos thoni: **“Janë të vdekur”**. Jo, ata janë të gjallë, por ju nuk kuptoni (gjallërinë e tyre).”³²

²⁹ Ragib Isfahanui.

³⁰ Ibën Sinai.

³¹ El Gazaliu.

³² Bekare, 154.

“I vdekuri ka kaluar, por jeta e tij nuk ka përfunduar. Ka mbetur shërbimi i trupit ndaj shpirtit, sepse trupi me urdhrin e Allahut të Madhëruar i është dhënë në shërbim shpirtit. I vdekuri e dimë se është i gjallë, edhe pse ti për të thua se është i vdekur, ngase ti flet nga aspekti kur ai ka biseduar dhe ka lëvizur para syve të tu. Vdekja është kalim special në mënyrën speciale.”³³

Xhelaludin Rumi (1207-1273), me një bukuri të rrallë e ilustroi vdekjen: “Në ditën e vdekjes sime, kur bartet tabuti (arka) im, mos mendo se ndiej dhimbje për këtë botë. Mos qaj për mua dhe mos thuaj dëm, dëm. Dëm më i madh është kur qumështi digjet. Kur vështron xhenazen time, mos thuaj ndarje, ndarje, sepse mu në atë moment është shikimi dhe takimi im. Kur të më lëshojnë në varr, mos thuaj shkuarje, shkuarje, ngase varri im është napë (perde), pas që cilës është takimi me të Dashurin. Kur sheh se më vendosën në varr, dije se unë nuk zhdukem. Vallë, hëna e dielli a zhduken kur perëndojnë?! Ty të duket perëndim i tyre, por ajo është lindje. Varri na duket si burg i errësuar, por aty është shpirti i liruar. Cila farë nuk mbi (mugullon) kur futet në tokë?! Andaj, përse dyshoni në farën e njeriut?! Cila kovë fundoset në pus, e përplot nuk kthehet? Shpirtin e Jusufit në pus a duhet vajtuar?! Kur njëren anë të gojës e mbyll me gisht, ana tjetër e gojës hapet. Andaj, vajtimi yt është fjalim shterp.”

Rumi, natën e varrit e quan “Shebi-arus” (nata e dhëndërisë), duke bërë një krahasim fenomenal mes konakut në

³³ Muhjiddin ibën Arebiu.

varr, me atë në natën e parë të martesës. Çdo rrugë shpie kah vdekja, çdo përgatitje është për të. Çdo dhimbje jona trupore është një minus nga jeta. Megjithëse, të gjithë besojmë në vdekje, prapëseprapë të gjithë çuditemi kur vjen ajo. Sa më shumë që kalon koha, aq më shumë shkurtohet jeta, kurse ne mendojmë se vdekja nuk vjen kurrë. Çdo ditë jemi dëshmitarë të vdekjes. I përcjellim të afërmit, shokët, miqtë tanë, dhe gjithmonë mendojmë se nuk e kemi radhën ne. Muhamedi a.s. i këshillonte besimtarët: “Bëhuni në këtë jetë si të huaj (jabanxhi) ose si udhëtarë kalimtarë.” D.m.th. mendo për vdekjen dhe konsideroje veten në këtë botë si të mërguar, apo si kalorës që ndalet vetëm një çast për të pushuar nën hije.

Kurani fisnik na rikujton dhe na e tërheq vëmendjen: **“Zoti yt nuk ka nevojë për asgjë, Ai është mëshirues. Nëse do Ai, juve ju zhdruk dhe sjell kë të dojë pas jush, ashtu sikurse ju solli juve nga pasardhësit e atyre që ishin para jush. Ajo që iu kërcënohet (kiameti, ringjallja, llogaria, përgjegjësia) patjetër do të vjen, e ju nuk mund ta pengoni. (Nuk mund ta mënjanoi caktimin e Zotit).”**³⁴

Vallë, përse njeriu gëzohet kur e kalon një vit dhe e pret tjetrin duke iu afruar vdekjes për një shkallë. Qetësi në këtë botë ndien vetëm injoranti dhe njeriu me vetëdije të vdekur. Varrit të vet askush nuk ia ka lakminë. Sot shkruajnë shumë shpesh nëpër revista mbi të ashtuquajturën “vdekje klinike”, gjoja sikur shpirti del nga trupi dhe përjeton gjëra të magjish-

³⁴ En'amë, 133-134

me e fantastike dhe përsëri kthehet në trup. Këto gjëra, islami nuk i pranon dhe kategorikisht i hedh poshtë. Në realitet, sipas mësimit islam, shpirtin të cilin e merr Allahu i Plotfuqishëm nuk kthehet më prapa, siç na mëson verseti i Kuranit fisnik: ***“...E kur t’u vjen afati i tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të për ngutet më parë.”***³⁵

Disa kokëfortë e arrogantë bënë disa polemika vetëm mbi vdekjen. Ato polemika na i sqaron ky ajet: ***“...Kur Ibrahim tha: “Zoti im është Ai që jep jetë dhe vdekje.” Ai tha: “Edhe unë jap jetë dhe vdekje...”***³⁶

Verseti në fjalë na rrëfen dialogun ndërmjet Ibrahimit a.s. dhe mbretit zullumqar të asaj kohe, Nemrudit. Kur Ibrahim a.s. i tha Nemrudit: “Zoti im jep jetë dhe vdekje”, Nemrudi me arrogancë dhe kokëfortësi tha: “Edhe unë jap jetë dhe vdekje.” E solli një prej robërve të tij, e dënoi me vdekje dhe tha: “Këtë e vdiqa”, pastaj e fali dhe tha: “Këtë e ngjalla.”

Shikoni se çfarë naiviteti i njerëzve që nuk dinë të bëjnë dallimin mes vrasjes dhe vdekjes. Dihet se vrasja shkatërron konstruktin trupor të njeriut, me ç’ rast shpirti më nuk ka kurrrfarë kushtesh të qëndrojë edhe më tutje brenda tij, kurse vdekja është dalje e shpirtit nga trupi, pa u prishur apo pa u shkatërruar fare konstrukti trupor. Për këtë arsye, Allahu i Madhërishtëm bëri dallim mes njëres dhe tjetres kur tha në Kuranin fisnik: ***“Muhamedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E***

³⁵ Arafë, 34

³⁶ Bekare, 258

nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm Allahut aspak, kurse Allahu do t'i shpërblejë mirënjohësit.³⁷

Si dhe verseti tjetër: ***“Po edhe nëse vdiqët (në shtrat) ose u vratë, patjetër se do të tuboheni tek Allahu.”***³⁸

Pra, vdekja është kompetencë vetëm e Allahut, ndërkaq vrasja, e cila ndryshon nga vdekja, mund të kryhet edhe nga duart e njerëzve. Allahu është i Vetmi që i vdes njerëzit. Askush nuk mund t'i shpëtojë vdekjes, ngase urdhri i Zotit zbatohet mbi të gjitha krijesat, kurse njeriu nuk është urdhëruar në këtë gjithësi. Nga verseti i cituar më sipër, shohim se “tubimi ynë patjetër është para Allahut Fuqiplotë”. Kjo do të thotë se Allahu do t'i tubojë njerëzit edhe pas djegies së trupave të tyre pas vdekjes, apo pas vdekjes së tyre dhe hedhjes së pluhurit të njerëzve të djegur në kozmos (që është në modë sot). Kjo do të ndodhë, ngase Ai ka fuqi të plotë mbi çdo send. Ta rikujtojmë edhe njëherë versetin kuranor: ***“Ai më bën të vdes e pastaj më ringjall.”***³⁹

Këtu e vërejmë se Allahu i Madhërishëm nuk e ka përdorur fare përemrin vector (huve - Ai) në mënyrë të theksuar, sepse askush nuk guxon t'i bëjë rivalitet Allahut në çështjet e vdekjes dhe të ringjalljes. Prandaj, është e vërtetë e pamohueshme se fillimi, vazhdimi dhe fundi i jetës janë në kompetencën e vetëm të të Plotfuqishmit, Mëshirëplotit dhe të Gjithëdhijshmit - Allahut të Madhërishëm. Andaj, mësimi is-

³⁷ Ali Imran, 144.

³⁸ Ali Imran, 158.

³⁹ Shuaraë, 81.

lam mbi vdekjen, si një fenomen i ligjit të Allahut të Madhërishëm, kërkon nga besimtari meditim kreativ në jetë dhe shfrytëzim maksimal të kohës, duke rikujtuar gjithmonë dhe pa ia nda ajetin e Kuranin famëmadh: ***“(Allahu është) Ai i Cili ka krijuar vdekjen dhe jetën, për t’iu provuar se cili prej jush është më vepërmirë. Ai është Madhështori, Falësi i madh.”***⁴⁰

Allahu i Madhërishëm i drejtohet Pejgamberit të tij në Kuran, duke i thënë: ***“Ti je i vdekur, e edhe ata janë të vdekur.”***⁴¹ Domethënë, ti jeton me ndihmën Time, dëgjon dhe flet me ndihmën Time. Kjo është veçori e çdo njeriu, jeton me ndihmën e Allahut të Madhërishëm, sheh dhe dëgjon me ndihmën e Tij, sepse në qenien e vet është i vdekur. Njeriu nuk jeton me ndihmën e qenies së vet. Të gjithë në jetën e tyre mbështeten te Njëri, tek i Vetmi, i Cili ka krijuar gjithçka, i Cili në Unitetin e Vet është i pavarur nga çka do qoftë.

Në versetet, fjalët “ti je i vdekur” posedojnë gjerësi e cila zgjon ndjenjat. Verseti ia tërheq vërejtjen njeriut duke i treguar se në çfarë gjendje gjenet tani, e jo çfarë gjendje e pret njeriun në të ardhmen. Me të vërtetë, çdonjëri prej nesh e bartë mbi supet e veta barrën e trupit të tij. Në çdo pikë të djer-sës ai lë një pjesë të trupit të vdekur, sikur druri që lë për çdo ditë gjethin e vyshkur dhe të vdekur. Vdekja është prezentë dhe qëndron pezull në çdo moment. Asgjë nuk është vërtet e gjallë, përveç Allahut të Madhërishëm. Ne e kemi huazuar jetën tonë nga Ai, i Cili jeton përherë. Jeta na është dhuruar

⁴⁰ Mulk, 2.

⁴¹ Zumer, 30.

ta shfrytëzojmë për një kohë të caktuar. Në një hadith kudsij, Allahu i Madhërishëm i thotë Muhamedit a.s.: *“Jeto sa të duash, ti je i vdekur. Dua je kënd të duash, një ditë duhet ta braktisë. Kij sa të duash, çdo gjë që posedon i takon tokës. Prano çka të tuaj, puna jote është i vetmi bashkudhëtar.”*

Tërheqja e vërejtjes mbi vdekjen në Kuranin famëmadh është përmendur në shumë vend. Ky është fakt i qartë, megjithatë askush nuk i kushton rëndësi të duhur. Të gjithë sillen sikur do të jetojnë gjithmonë në Tokë. Për këtë shkak, koprraci është dorështrenguar, rrenacaku gënjen, vjedhësi vjedh, vrasësi vret, eksploatuesi ekaploaton, sepse ata mendojnë se janë të sigurt dhe të amshueshëm.

Shpirti nuk vdes me trupin. Ai i cili e mohon këtë, le të na tregojë se ku gjendet njeriu në çastin kur është në gjumë?! Gjatë fjetjes, të gjitha organet dhe proceset fiziologjike funksionojnë edhe më tej, reflekset po ashtu. Zemra rrah, gjëndrat tajitin, mushkëritë kryejnë funksionin respirator. Gjithashtu funksionojnë edhe organet e tjera. Megjithëkëtë, ne jemi në gjendje të ngjashme me natyrën e vdekur. Ku është njeriu? Individ i vdes trupërisht në këtë botë, ndërsa shpirtërisht ekziston, jeton dhe mbetet absolutisht i amshueshëm. Sipas mendimit të disave, shpirti i njeriut është grumbull i reaksioneve, i rrethanave dhe i gjasave. Ai është në shërbim të trupit dhe varet nga ai. Sipas tyre, shpirti është vetëm shtytje e urisë, e seksit, e frikës dhe e ndjenjave të tjera, me ndihmën e së cilave trupi kupton se është i etshëm, i uritur etj.

Mirëpo, ndonjëherë njeriu sakrifikon edhe kafshatën e bukës, shtëpinë dhe shtratin e ngrohtë për qëllime tejet abstrakte, siç është drejtësia, e vërteta dhe liria. Ku janë këto

shtytjet e urisë dhe të seksit? Ky është argument i pakontestueshëm se shpirti është fakt, i cili është përmbi trup, e jo vetëm nevojë e thatë e trupit, e reflektuar nga pasqyra e brendshme. Ky vullnet i madh, i cili ndikon në trup dhe i cili e sakrifikon atë, është fakt që tregon se qëndron përmbi trupin, e dirigjon atë, nuk i nënshtrohet trupit dhe as nuk është shtesë e tij. Shpirti e braktis trupin në gjumë, ashtu siç e braktis edhe te vdekja. Allahu i Madhërishëm e kthen shpirtin kur zgjohet njeriu, siç e konfirmon verseti i Kuranit, i përmendur më sipër, nga surja *Zumer*, 42.

Frika nga vdekja paraqet një ndër çështjet më të vjetra me të cilën është ballafaquar njeriu. Është më se e sigurt se kjo çështje do t'i interesojë njeriut derisa të ekzistojë vetë ai. Dielli dhe vdekja nuk mund të shikohen pa u trembur syri. Shumë sëmundje të organizmit, si p.sh. infarkti, astma bronkiale, sëmundjet kancerogjene etj., shoqërohen nga frika e vdekjes, për të cilën mjekësia bashkëkohore nuk mund të japë shpjegim.

Filozofi i shquar islam, Ebu Ali el Husein ibën Abdullah ibën Sinai - Avicena (980-1037), në librin e tij "Shqyrtimi mbi ilaçin e vdekjes nga frika dhe shërimi nga shqetësimi që sjell ajo", thotë: "Meqenëse frika më e madhe që mund ta kaplojë njeriun është frika nga vdekja, e cila është më e theksuar prej të gjitha frikave që njeriu i përjeton, e konsideroja si obligim timin që ta shpjegoj këtë çështje." Frikë nga vdekja mund të ketë ai që nuk di se ç' është vdekja në esencë, ose nuk di se ku do të shkojë shpirti i tij, apo mendon se kur të priset dhe të shkatërrohet organizmi i tij, do të humbet edhe personi i tij dhe do t'i zhduket shpirti. Pra, të tillët nuk e njo-

hin ekzistencën e shpirtit pas vdekjes dhe jetën e tij të re. Disa të tjerë mendojnë se përveç dhimbjeve të sëmundjes që i paraprijnë vdekjes, vdekja ka dhimbje të rënda.

Shkaktar i frikës mund të jetë edhe ajo se një njeri i tillë beson në dënimin që do të fillojë menjëherë pas vdekjes, ose sepse e ka humbur shpresën dhe nuk di se çfarë do të bëhet me të. Apo ndoshta i dhimbset pasuria, familja, shokët etj. Të gjitha këto mendime janë të pabaza dhe të paarsyeshme. Atij që nuk di se ç' është vdekja do t'ia shpjegoj, se ajo është çasti kur shpirti heq dorë nga përdorimi i veglave të veta. Ato vegla janë pjesët e ndryshme të trupit, të cilat së bashku quhen organizëm. Kur kjo substancë e quajtur shpirt e quajtur shpirt ndahet nga organizmi, ajo edhe më tej do të ekzistojë ashtu si i takon: bëhet e kthjellët dhe pastrohet prej turbullirës fizike, bëhet e gëzuar dhe e përsosur. Ajo as nuk mund të shkatërrohet e të zhduket, sepse substanca e tillë nuk shkatërrohet, as nuk zhduket, as nuk e humb qenien e vet. Zhduken vetëm dukuritë, cilësitë, relacionet dhe lidhjet mes saj dhe trupit. Njeriu i frikësohet vdekjes sepse nuk e di se çfarë do të bëhet me të. Ndoshta sepse ai mendon se kur prishet dhe shkatërrohet organizmi i tij, atëherë me të do të zhduket edhe personaliteti i tij dhe se shpirti i tij do të përfundojë së ekzistuari.

Pra, në këtë rast, padituria është rreziku që e shkakton frikën. Ky fakt i ka shtyrë dijetarët të thellojnë diturinë, ta ngrijnë atë në shkallë më të lartë. Ata vërejtën se qetësia të cilën njeriu e arrin kur lirohet nga padituria është qetësi e vërtetë, ngase padituria është sëmundje shpirtërore.

Për këtë arsye, dijetarët kanë pohuar se ekzistojnë dy lloj vdekjesh: vdekja me kënaqësi dhe vdekja e natyrshme, ashtu siç ekzistojnë dy jetë: jeta me kënaqësi dhe jeta e natyrshme. Me vdekjen me kënaqësi nënkuptojmë zhdukjen e epsheve dhe ndërprerjen e lidhjeve dhe të përkujdesjes ndaj tyre. Ndërsa, me jetën me kënaqësi nënkuptojmë ushqimin, epshtet dhe dëshirat e tjera, të cilat njeriu përpiqet t'i plotësojë në këtë jetë. Me jetën e natyrshme nënkuptojmë qëndrimin e përhershëm të shpirtit në kënaqësi të vazhdueshme, të cilën e arrin me dituri dhe duke e luftuar injorancën. Për këtë, Platoni e porosit njeriun që dëshiron të pajiset me dituri: “Vdis me kënaqësi për të jetuar shpirtërisht (natyrshëm).”

Ai që i frikësohet vdekjes së natyrshme, në të vërtetë i frikësohet asaj të cilën duhet ta dëshirojë. Një gjë e tillë pohohet për arsye se vdekja është nocion i cili e plotëson përkufizimin mbi njeriun. Me fjalë të tjera, njeriu është qenie e gjallë që mendon dhe vdes. Për këtë arsye, nocioni i vdekjes e plotëson dhe e përsos esencën e saj dhe me ndihmën e saj njeriu ngritët në sferat më të larta. Pra, a ka injorant më të madh se njeriu, i cili frikësohet nga ajo që e përbën personin e tij. Kush mund të jetë në gjendje më të vështirë se ai që mendon se zhduket duke jetuar dhe mungohet duke u plotësuar?! Sepse, kur i munguari i frikësohet plotësimit të tij, atëherë ai nuk e njeh vetveten deri në fund. Andaj, shpirti i cili ndahet prej trupit duke i pasur lakmi atij dhe duke iu frikësuar kësaj ndarje është i pafat dhe ndien dhembje të madhe ndaj qenies së vet, shkon në skajin më të largët të vendbanimit të tij të përhershëm dhe gjithnjë kërkon paqe e qetësi në vendbanimin e tij të përkohshëm. Për sa i përket atij që mendon se

vdekja ka dhimbje të madhe, përveç dhimbjes së sëmundjes që mund t'i paraprijë vdekjes, ai ka mendim plotësisht të pabazë dhe të gabuar. Kjo ndodh për arsye se dhembja ndihet me të kuptuar se shpirtit vepron në trup. Por, meqë vdekja është vetëm ndarje e shpirtit nga trupi, trupi nuk mund të ketë fare dhembje pasi ta ketë braktisur shpirti. Nga kjo shihet qartë se vdekja është gjendje e organizmit që pason në sajë të ndarjes së shpirtit prej tij dhe kjo gjendje as nuk mund të jetë e ndjeshme, as nuk dhemb, sepse organizmi ka pasur dhembje dhe ka ndier dhembje përmes shpirtit. Ndërsa, ai që i frikësohet vdekjes për shkak të dënimit, në të vërtetë nuk i frikësohet vdekjes, por dënimit. Dënimi, pra, mund të jetë shkak i asaj që njeriu i vdekur bart me vete edhe pas vdekjes.

Nga kjo rezulton se ai njeri domosdo i pranon mëkatet dhe veprat e liga që i ka bërë, për shkak të së cilave i është caktuar dënimi. Prandaj, ai e pranon Gjykatësin e Drejtë, i Cili i dënon njerëzit për vepra të këqija që i kanë bërë gjatë jetës, e jo për vepra të mira. Veprat e këqija, të cilat me një fjalë quhet mëkate, rrjedhin nga anët e dobëta dhe negative të shpirtit, ndërsa kundrejt këtyre qëndrojnë virtytet e larta shpirtërore. Kush ecën drejt rrugës dhe qëllimit të vërtetë, ato do ta shpijnë në amshim. Këtë siguri dhe lumturi shpirtërore e arrijnë ata që kanë besim të pastër dhe që i përmbahen diturisë.

Kush mendon se nuk i frikësohet vdekjes, por i vjen rëndë që të ndahet nga familja, fëmijët dhe pasuria, atij duhet sqaruar se për një gjë që patjetër do të ndodhë nuk ka dobi nga pikëllimi i ndarjes. Çdo gjë që lindet edhe zhduket, prandaj edhe njeriu bën pjesë në grupin e qenieve që zhduken.

Prandaj, ai që do të dëshironte të mos zhdukej, ai në të njëjtën kohë dëshiron edhe të mos ekzistojë. Kuptohet se kjo është e pamundshme, sepse sikur të ishte e mundur që njeriu të mbetej i përhershëm, atëherë do të kishin mbetur të përhershëm ata që kanë qenë para nesh. Sikur njerëzit të mbeten të përhershëm, toka do të ngushtohej dhe do të bëhej e pamundshme për ekzistencë. Prandaj, urtësia e përsosur hyjnore dhe drejtësia absolute në rregullimin e përsosur do të mbetet siç bën aluzion verseti i Kuranit fisnik: **“... Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur.”**⁴²

Mu për këtë, kush i frikësohet vdekjes i frikësohet drejtësisë dhe urtësisë së Allahut të Madhërishëm, madje i frikësohet edhe mëshirës dhe dhuratës së Tij.

Nga tërë kjo që u cek më lartë, del se vdekja as nuk është e vrazhdë, e as e trishtueshme, por më e trishtueshme është frika nga ajo, ngase ai që i frikësohet vdekjes nuk e njeh veten e as qenien e tij. Lumturinë e vërtetë e arrin shpirti i brumosur me cilësi të lartë të besimit dhe të devotshmërisë. Ky lloj shpirti nuk ka frikë e as nuk brengoset, siç bën aluzion verseti i Kuranit fisnik: **“Ta keni të ditur se të dashurit e Allahut (evliatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje.”**⁴³

Pra, Allahu i Madhërishëm e ka krijuar njeriun të amshueshëm. Pra, secilit që i është dhuruar shpirti (që është frymëzuar me shpirt), që prej Ademit a.s., e deri në momentin e

⁴² Furkan, 2.

⁴³ Junus, 62.

fundit të kësaj bote, Allahu i Madhërishëm i ka dhuruar njëkohësisht edhe amshueshmërinë. Allahu Fuqiplotë bëri që fillimi i etapave të jetë nga vdekja. Në botën e atomit (ezel) erdhëm pas vdekjes. Pastaj, nga vdekja u transferuam në jetë. Këtë nuk mund ta bëjë (realizojë) askush pos Allahut të Madhërishëm, ngase Ai është Krijuesi i vetëm i vdekjes dhe jetës. Mesazhi i Kuranit famëmadh është tejet i qartë për çdo njeri: ***“Secili njeri do ta shijojë vdekjen, e pastaj te Ne do të ktheheni.”***⁴⁴

⁴⁴ Ankebutë, 57.

Literatura:

1. H. Sherif Ahmeti: Kurani - Përkthim me komentim, Prishtinë, 1988;
2. Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi: Kurani dhe shkenca bashkëkohore, Gjakovë, 2000;
3. Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi: Kurani famëmadh nga këndvështrimi shkencor, Gjakovë, 2004;
4. Ibn Kajjim el-Xhevzi: Et-tibb mihrabun lil-iman, 1955;
5. Muhammed Mutevel-li Sha'ravi: Jeta dhe vdekja, Prishtinë;
6. Muhammed Hysejn edh-Dhehebi: Komentimi shkencor i Kuranit, "Dituria Islame", nr. 42, 1992;
7. Dr. Mahmud Nadhim Nesimij: Et tibbun nebevijj fil ilmil hadith, 1984;
8. Nas ucitelj el-Gazali, Sarajevë, 1995;
9. Imam Ebu Hamid el-Gazali: Ihjau ulumid-din, Libri 9, Libri për vdekjen dhe atë çfarë pason pas saj, Gjakovë, 2020;
10. Ibn en-Nefis: Muxhez el kanun, Sarajevë, 1961;
11. Dr. Mustafa Mahmud: Kuran, savremeni pokusaj razumevanja, Sarajevë, 1981;
12. Malik ibn Nebi: Kuranski fenomeni, Sarajevë, 1976;
13. Terry F. Pettijohn: Psikologjia, Prishtinë, 1997;
14. Orhan Bajraktareviq: Ibn Sina - ekzistencija i bit, Takvim, Sarajevë, 1990;
15. Grmek M.D.: Proslava hiljadugodisnjice Avicene, Lijecnicki vjesnik, Zagreb, 1951;
16. Grmek M.D.: Avicena, Medicinska enciklopedija, Beograd-Zagreb, 1967.

Prof. asoc. dr. Fahrush REXHEPI

VLERA E DIJETARËVE DHE POZITA E TYRE NË FENË ISLAME

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Atë e falënderojmë dhe vetëm Atij i kërkojmë ndihmë dhe falje të gjynaheve tona. Allahut i kërkojmë mbrojtje prej së keqes së vetëve (shpirtrave) dhe punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu, nuk ka kush e humb dhe atë të cilin e humb Allahu, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmojmë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, përveç Allahut, Një dhe i Pashoq, si dhe dëshmojmë se Muhamedi a.s., është rob dhe i Dërguari i Tij. Allahu i Madhëruar në Kuranin famëlartë ka thënë: ***“Po, Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët.”***¹ Në një ajet tjetër, Allahu i Madhëruar thotë: ***“Thuaj: I besuat ju atij ose nuk i besuat (atij nuk i bëhet dëm), e atyre që u është dhënë dijeni (nga librat e parë) para tij, kur u lexohet atyre, ata hidhen me fytyra (për dhe) duke i bërë sexhde.”***²

¹ Fatir, 28.

² Isra, 107.

Mirëpo, para se të flasim për vlerën e dijetarëve dhe pozitën e tyre në islam, në hyrje të këtij punimi do ta trajtojmë me pak fjalë vlerën dhe rëndësinë e diturisë në islam. Kur flasim për këtë temë, patjetër se duhet t'iu kthehemi ajeteve kuranore dhe haditheve të pejgamberit a.s., që flasin për vlerën dhe rëndësinë e diturisë në islam, e të cilat janë të shumta. Vetëm në Kuran, gjenden mbi njëqind ajete që flasin për këtë temë. Madje, fjala “ilm” (dituri), së bashku me fjalën “ma’rife” (njohuri), e cila ka domethënie identike me fjalën dituri, në trajta dhe forma të ndryshme, në Kuran është përsëritur më se 811 herë, po aq sa është përsëritur fjala iman (besim).

Është me rëndësi për secilin njeri dhe për secilin besimtar, që të njohë dhe të kuptojë vlerën dhe rëndësinë e diturisë, ngase çdo çështje e njeriut, në çdo fushë të jetës ndërlidhet me mendjen dhe diturinë. Andaj, nëse njerëzit e kuptojnë rëndësinë e diturisë dhe të shkencës në përgjithësi, ata me siguri do t'i qasen kërkimit dhe hulumtimit të saj. Lidhja e njeriut me Krijuesin e Tij, pastaj me shoqërinë, me familjen dhe me rrethin në të cilin jeton, por edhe me traditat, kulturën dhe fenë e tij, bëhet pikërisht përmes diturisë. Për këtë arsye, urdhri i parë në Kuran është që njerëzit të bëhen të ditur. Allahu Fuqiplotë në Kuran thotë: **“Lexo në emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë).”**³ Në një ajet tjetër, betimi i parë i Allahut të Madhëruar në Kuran është betimi në lapsin, penën

³ Alek, 1.

dhe rreshtat e Tij. Në Kuranin famëlartë thuhet: **“Nun! Beto-hem në pendën (lapsin) dhe në atë çka shkruajnë.”**⁴

Në fenë tonë të pastër islame, e kundërta e diturisë është injoranca. Këto janë dy gjëra që dallojnë nga njëra-tjetra, ashtu siç është dallimi ndërmjet dritës dhe errësirës. Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: **“...Thuaj: a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Vërtet, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”**⁵

Në formë përmbledhëse, vlerat dhe begatitë e diturisë mund t'i kuptojmë përmes haditheve të Pejgamberit a.s.. Transmetohet nga Ebu Derda, se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s., duke thënë: *“Kush niset në rrugë për të kërkuar dije, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në xhenet. Vërtet edhe melekët i shtrijnë krahët e tyre në mbrojtje për kërkuesin e diturisë nga kënaqësia për veprën e tij. Për dijetarin kërkon falje çdo gjë në qiej dhe në tokë, madje edhe peshqit në ujë. Vlera e dijetarit ndaj robit të devotshëm është sikurse vlera e hënës ndaj planetëve të tjerë. Vërtet, dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim dinar e as dërrhem, ata vërtet kanë lënë trashëgim dijen, andaj kush e merr, e ka marrë masën (hisen) e mjaftueshme.”*⁶ Po ashtu, transmetohet nga Ibën Abasi, i cili ka thënë: “Sylejmanit a.s. i është parashtruar të zgjedh mes pasurisë, fuqisë apo dituri-

⁴ Kalem, 1.

⁵ Zumer, 9.

⁶ Sunenu et-Tirmidhij, v. 5, f. 40, nr. 2682, Bejrut.

së. Ai e ka preferuar diturinë, e në saje të saj, ai e fitoi postin mbretëror (fuqinë) dhe pasurinë.”⁷

Dijetarët në tokë konsiderohen si yjet në qiell, ngase Allahu i Madhëruar i ka bërë yjet zbukurim për qiellin dhe goditës për shejtanët. Njerëzit orientohen me to në errësirat e tokës dhe në det. Ndërsa, Allahu i Madhëruar i ka bërë dijetarët zbukurues për banorët e tokës dhe gjuajtës të djajve prej njerëzve dhe ka thënë: “Të dashurit e Allahut janë ata, të cilët, kur i shikon, ta rikujtojnë Allahun.”⁸

Allahu i Madhëruar i ka lartësuar dijetarët me dije dhe i ka zbukuruar me të. Nëse i shikon dijetarët, ata ta rikujtojnë Allahun dhe nëse i dëgjon, gjithashtu ta rikujtojnë Allahun. Me anë të tyre dallohet hallalli prej haramit, e vërteta nga e kota dhe e mira nga e keqja. Besimtarët duhet të ruhen nga të folurit keq për dijetarët. I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ka thënë: *“Nuk është prej nesh ai, që nuk e mëshiron të voglin, që nuk e respekton të vjetrin dhe që nuk e njeh vlerën e dijetarit.”*

Imam Ahmed ibën el Edhari ka thënë: “Fjala e keqe për dijetarët dhe sidomos për dijetarët e mëdhenj, është prej gjynaheve të mëdha.” Ikrimeh ka thënë: “Të mjerët ju! Nëse ofendoni dikë prej dijetarëve, në këtë mënyrë keni ofenduar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!)”

⁷ Ihja Ulum ed-Din, Imam Gazaliu, v1, f. 6, botimi i dytë, 1316 h .(1895 m.), botuar në Al-Az’har, Egjipt.

⁸ Sahih Et-Tabarani.

Në lidhje me ajetin: **“Vërtet, ata që i frikësohen më shumë Allahut nga robërit e Tij janë dijetarët”**, shumica e dijetarëve mendojnë se bëhet fjalë për dijetarët e fesë së Allahut dhe jo dijetarët e mjekësisë, gjeografisë, astronomisë, matematikës etj., ani pse Islami nuk i nënvlerëson asnjërën nga këto shkenca. Mbështetur nga “Muhaderatul ilmi ue ehliku ehlihi”, dijetari Salih el Fuzani, në lidhje me këtë ajet ka thënë: “Me dijetarët këtu (në ajet) është për qëllim dijetarët e jurisprudencës islame, të cilët janë trashëgimtarë të profetëve. Ata janë dijetarë të cilët e njohin ligjin e Allahut të Lartësuar, Madhështinë e Allahut dhe çfarë Ai u ka dhënë atyre prej dijes, me të cilën erdhi i Dërguari i Allahut. Pra, ata që më së shumti i frikësohen Allahut janë dijetarët e fesë, e jo dijetarët e fushave të ndryshme në jetën e kësaj bote. Por, nëse te një person bashkohen këto dy gjëra, dija e fesë dhe një prej profesioneve nga dija e kësaj bote, atëherë kjo është diçka shumë e mirë dhe shpërblimi është i madh, nëse me anë të kësaj, ky person nuk ka për qëllim asgjë tjetër vetëm që të arrijë kënaqësinë e Krijuesit, ashtu siç thuhet në hadithin e Pejgamberit a.s.: *“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve.”*”

I Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ka thënë: *“Allahu i Madhëruar ka thënë “Kush armiqëson një të dashur Timin, Unë i kam shpallur luftë atij.”*”⁹

Ndërsa, në hadithin tjetër, Muhamedi a.s., ka thënë: *“Është e mallkuar dynjaja dhe është e mallkuar çka ka të në,*

⁹ Sahihu Buhari, 6137.

përveç përmendjes së Allahut dhe atë që Ai e do, dijetarin dhe nxënësin e dijes.”¹⁰

Po ashtu, transmetohet nga Abdullah bin Amër el Asi, se i Dërguari i Allahut, Muhamedi a.s., ka thënë: *“Allahu i Lartësuar nuk e ngre dijen duke e nxjerrë atë prej njerëzve, por Ai e merr dijen me marrjen e dijetarëve...”* Në hadithin tjetër, Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Vërtet, dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim dinar e as dërhëm, ata vërtet kanë lënë trashëgim dijen, andaj kush e merr, e ka marrë masën (hisen) e mjaftueshme.”* Një burrë e kishte pyetur një herë Seid bin Xhubejrin: *“O Ebu Abdullah, cila është shenja e shkatërrimit të njerëzve?”* Ai tha: *“Nëse vdesin dijetarët, shkatërrohen njerëzit.”*

Këto hadithe sqarojnë vlerën e dijes, nderin, pozitën e dijetarëve dhe vlerën e tyre. Pra, dija ka pozitë shumë të madhe dhe gradë shumë të lartë në fenë islame. Kjo dije është trashëgimia pejgamberike, sepse pejgamberët nuk kanë lënë trashëgim dinar e as dërhëm, por kanë lënë dije, e ai që e merr këtë dije, ai ka marrë hisen më të madhe. Po të mos ishte dija fetare, njerëzit do të bëheshin sikur kafshët, mirëpo Allahu xh.sh. u dërgoi pejgamberë me dije fetare, i nderoi dhe i ngriti mbi krijesat e tjera. Allahu xh.sh. në Kuran ka thënë: ***“Ne vërtet nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit), u mundësuam të udhëtojnë hipur në tokë e në det, i begatuam***

¹⁰ Hasen, Et Tirmidhiu, 2322, Ibën Maxhe, 4112 etj.

me ushqime të mira, i vlerësuam ata (i lartësuam) ndaj shumicës së krijesave që Ne i krijuam.¹¹

Pra, dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve, andaj edhe ata kanë pozitë kaq të lartë në shpirtat e besimtarëve dhe pozita të larta në jetën e kësaj bote. Dijetarët janë udhëzuesit e njerëzimit, ata i orientojnë drejt të mirave të kësaj bote dhe të ahiretit. Dijetarët janë më të dobishëm se baballarët dhe nënat. Dobia e prindërve është e kufizuar në fëmijët e tyre, kurse nga dijetarët kanë dobi mbarë njerëzimi. Disa mund ta konsiderojnë këtë konstatim si të çuditshëm, mirëpo është realitet, nga fakti se prindërit i edukojnë vetëm fëmijët e tyre, kurse dijetarët mbarë botën. Madje, Allahu xh.sh. në Librin e Tij ka ndarë mes dijetarëve dhe të tjerëve, si dhe ka sqaruar se ata nuk janë të barabartë, kur ka thënë në Kuranin famëlartë: ***“...Thuaj: a janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Vërtet, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”***¹²

Nuk ka dyshim se nuk janë të barabartë ata që di dhe ai që nuk di, nuk barazohet i gjalli me të vdekurin, ai që dëgjon me atë që nuk dëgjon, ai që sheh me atë që është i verbër. Sigurisht se ka dallim ndërmjet këtyre kategorive. Dija është dritë me të cilën udhëzohet njeriu dhe del nga errësira në dritë. Me të Allahu i ngritë njerëzit. Dija është shkaku me të cilin njeriu e adhuron Zotin ashtu si duhet dhe është rrugë për ta fituar kënaqësinë e Zotit të Tij. Çdo gjë që e fiton njeriu në

¹¹ Isra, 70.

¹² Zumer, 9.

këtë botë përfundon, kurse dija mbetet derisa të ekzistojë bota.

Për ta kuptuar drejt vlerën e dijetarit, e marrim shembull Ebu Hurejren r.a., i cili ishte i varfër, i uritur, saqë edhe alivanosej nga uria. Sa e përmendin sot myslimanët?! Sa njerëz e tregojnë biografinë e tij, e sa njerëz luten për të?! Tërë kjo ka ndodhur për shkak se i ka ruajtur hadithet e Pejgamberit a.s., e që kjo është dija fetare.

Allahu xh.sh., pas melaqeve i ka marrë dijetarët si dëshmitarë për ekzistimin e Tij. Lidhur me këtë, në Kuran thuhet: ***“Allahu dëshmoi se nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, e dëshmuan edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatuesi i drejtësisë. Nuk ka të adhuruar të vërtetë përveç Tij, Fuqiplotit, e më të Urtit.”***¹³ Pra, Allahu xh.sh. nuk ka thënë për pasanikët e as për pushtetarët, por ka dhënë për dijetarët. Andaj, atij që Allahu ia do të mirën, i jep këtë dije. Pejgamberi a.s., në lidhje me këtë, ka thënë: *“Atij që Allahu ia do të mirën ia mëson fenë.”*¹⁴ Dija është kriter për atë të cilin e do Allahu, e jo interesi i kësaj bote, pasuria dhe fëmijët. Allahu ia jep të mirat e kësaj bote atij që e donë dhe atij që nuk e donë, mirëpo fenë ia jep vetëm atij që e donë. Askujt nuk i lejohet që t'i ketë lakmi dikujt përveç atij që ka dije dhe vepron sipas saj. Pejgamberi a.s. ka thënë: *“Nuk lejohet lakmia përveçse në dy raste, ndaj njeriut që ka pasuri dhe e shpenzon atë për të vërtetë dhe njeriut që Allahu i ka dhënë dije, vepron sipas*

¹³ Ali Imran, 18.

¹⁴ Buhariu dhe Muslimi.

saj dhe ua mëson atë të tjerëve.” Nuk ka dilemë se dija, veçmas ajo fetare, është rrugë e sigurt për në xhenet. Pejgamberi a.s., ka thënë: *“Ai që ecën rrugës për të kërkuar dije, atij Allahu ia lehtëson rrugën e xhenetit.”*¹⁵

Dijetarët kanë pasur respekt dhe pozitë shumë të lartë të myslimanët dhe ashtu duhet të mbetet nëse dëshirojmë suksesin, krenarinë, ngritjen në këtë botë dhe në botën tjetër. Myslimanët e parë i donin, i respektonin dhe i nderonin dijetarët. Rasti konkret është ai i kalifit Abdulmelik ibën Mervanit, i cili kishte hyrë një ditë në harem për të bërë tafav, së bashku me dy djemtë e tij, pastaj erdhi ta pyeste dijetarin e Mekës, A'ta ibën ebi Rebah. U ul para tij dhe filloi ta pyeste, kurse ai përgjigjej. Pasi e kreu dhe doli, iu drejtua djemve të tij dhe u tha: “Bijtë e mi, mësoni dijen, sepse vallahi, asnjëherë nuk do ta harroj uljen para A'ta ibën ebi Rebahut.” A'ta ishte skllav i zi dhe me pamje të rëndë, edhe babai i tij ishte skllav, mirëpo Allahu e ngriti me këtë dije, saqë edhe vetë kalifi vinte tek ai dhe ulej para tij për të marrë fetva prej tij.

¹⁵ Muslimi.

Ramadan SHKODRA

ZHVILLIMI I INSTITUCIONEVE EDUKATIVE-ARSIMORE ISLAME NË KOSOVË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

1.

Sikurse dihet, historia e zhvillimit të shkollave dhe të arsimimit islam në trojet tona, është e hershme dhe fillon që nga shekulli XV e këndej, gjë që ndërlidhet edhe me historinë e ngritjes së xhamive të para, kurse më vonë edhe me hapjen e shkollave fillore - mejtepeve, shkollave të larta - medreseve etj. Medreseja më e vjetër, e ngritur në trojet tona është ajo e Is'hak Beut në Shkup, e hapur para vitit 1411, ndërsa medreseja më e vjetër në Kosovë është ajo e themeluar në Vushtri, brenda viteve 1444-1455 nga Gazi Ali Beu. Pas kësaj, para vitit 1516, në Pejë themelohet medreseja nga Mehmet Beu, pastaj në Prizren, më 1537, themelohet medreseja e Gazi Mehmet Pashës, më pas, më 1566, nga Besharet Begu, në Prishtinë themelohet medreseja e Besharet Begut etj. Pas këtyre, medrese u hapën edhe në qytete të tjera, ashtu që në shek. XVIII, sipas të dhënave që na ofron udhëpërshkruesi i njo-

hur, Evlija Çelebiu, në trojet shqiptare, numri i medreseve ishte shtuar aq sa kishte qytete me më shumë se një medrese. Në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, në Kosovë ekzistojnë 16 medrese: katër në Prizren, dy në Prishtinë, dy në Gjakovë, dy në Pejë, dy në Vushtrri, një Mitrovicë, një në Gjilan, një në Opojë dhe një në Dobërçan. Në këto medrese mësimet i vijonin një numër i madh i nxënësve nga treva të ndryshme, madje edhe jashtë Kosovës, siç ishte medreseja “Mehmet Pasha” në Prizren, “Medreseja e Madhe” në Gjakovë (e ndërtuar në vitin 1707) etj.¹

Për shqiptarët, një rol të ri dhe me peshë, medresetë marrin pas vitit 1912, kur Kosova okupohet nga Serbia, e më vonë edhe integrohet dhunshëm në atë që njihet si Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene dhe më pas në Mbretërinë Jugosllave. Në këtë periudhë, medresetë në Kosovë udhëhiqeshin e drejtoheshin nga prijës të shquar atdhetarë, të cilët i kishin shndërruar medresetë në vatra e çerdhe të kauzës kombëtare. Një aktivitet i tillë, sigurisht se nuk i shkonte përshtati pushtetit të kohës, i cili na vazhdimësi ndërmernte masa nga më të ndryshmet ndaj medreseve, drejtuesve të tyre dhe strukturave të Komunitetit Mysliman.

Qëndrimi ndaj medreseve i autoriteteve të Jugosllavisë borgjeze më së miri shihet nga shkresa e ministrit të fesë, dërguar Këshillit Kryesor të Ministrisë së Arsimit në Beograd, e datës 7 shtator 1923, ku pos të tjerash thuhet: “Në

¹ Më gjerësisht për medresetë në Kosovë shih, Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë (1830-1912)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019, f.231-277.

Kosovë, çështja e arsimit fetar të myslimanëve është shumë e komplikuar... Në këto vise ka afro 50 myftinj dhe 600 imamë, prej të cilëve asnjëri nuk e njeh si duhet gjuhën serbe, të gjithë janë të edukuar në frymën armiqësore ndaj shtetit tonë.”² Më tutje, në këtë shkresë thuhet: “Në to (medrese - R.SH.) nuk mësohet asgjë tjetër, pos si të urrehen sa më tepër ata që nuk janë myslimanë. Për ta evituar rrezikun që mund të rrjedh prej tyre, duhet që sa më parë medresetë të futen nën kontrollin e plotë të shtetit, në të vërtetë, së pari të mbyllet, e më vonë në vend të tyre të hapet një medrese.”³ Në medresetë tonë janë shkruar, kopjuar, komentuar e krijuar vepra të shumta, fushash e disiplina të ndryshme fetare, shkencore e letrare, përfshirë edhe letërsinë alamiado shqipe, e cila ka dhënë shumë efekte pozitive në zhvillimin kulturor të masave popullore shqiptare edhe jashtë objekteve të medresetesë. Në këto institucione arsimore zuri fill dhe u intensifikua përpjekja për futjen e gjuhës shqipe në shërbime të fesë islame në xhami dhe jashtë saj, përkatësisht për thellimin e punës në drejtim të shqiptarizimit sa më të plotë të xhamisë dhe të institucioneve të tjera islame. Shumë nga myderrizët dhe nxënësit e medreseve kanë marrë pjesë dhe kanë luajtur rol konstruktiv në të gjitha lëvizjet politike shqiptare, si në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, në Lidhjen e Pejës “Besa - Besë”, kryengritjet e ndryshme etj.⁴

² Dr. Haki Kasumi Kasumi, *Bashkësitë fetare në Kosovë, Instituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1988, f. 117.*

³ Po aty, fq. 118.

⁴ Sadik Mehmeti, *Shkollat...*, po aty, f. 289-290.

Mirëpo, para tetë dekadash, saktësisht në vitin 1948, nga sistemi që po instalohej në Kosovë, me një vendim të paarsyeshëm dhe arbitrar, u mbyllën të gjitha medresetë që vepronin deri atëkohë, pavarësisht traditës dhe kontributit të tyre shekullor. Sigurisht se kjo ishte një goditje për Bashkësinë Islame dhe për myslimanët në Kosovë, si dhe një shenjë që tregonte qartazi për pozitën e tyre juridiko-fetare në kuadër të atij sistemi.

2.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova edhe njëherë padrejhtësisht ndahet nga ama e saj - Shqipëria dhe futet dhunshëm nën administrimin e sajës artificiale të quajtur Jugosllavi. Në këto rrethana, në viset shqiptare dhe sidomos në ato që u aneksuan nga Jugosllavia, u bënë ndryshime të mëdha shoqërore dhe politike, të cilat ushtruan ndikim edhe në veprimtarinë e bashkësive fetare. Në kuadër të riorganizimit, pas miratimit të Kushtetutës së vitit 1947, të Bashkësisë Fetare Islame për RPFJ, me të cilën rregullohej funksionimi i BI, Bashkësia Fetare Islame në Kosovë, bëhet pjesë përbërëse - njësi e BFI-së në Jugosllavi, ndërsa BI e Kosovës u detyrua që të ndërronte qendrën nga Tirana⁵ në Sarajevë. Bazuar në këtë Kushtetutë, bëhet edhe organizimi i paraparë i Bashkësive Islame në nivel republikash. Kuvendi

⁵ Gjatë periudhës 1941-1944, Bashkësia e Fesë Islame të Kosovës me dy Kryemyftinjtë e saj (Kryemyftininë e Prizrenit dhe Kryemyftininë e Prishtinës) do të lidhej me Komunitetin Mysliman me qendër në Tiranë. Organizimi i saj ishte i ndarë në Kryemyftinj dhe Nënmyftinj.

Vakëfnor për RPS, ku përfshihej edhe territori i Kosovës, e rrjedhimisht edhe Bashkësia Islame e Kosovës, ishte konstituuar - themeluar në Beograd, më 20 gusht të vitit 1947.⁶ Ndërkaq, Kryesia Islame në Prishtinë ka nisur më 1 janar 1948.⁷

3.

Hapja e Medresesë në Prishtinë më 1951 - Në këto rrethana, paria e Bashkësisë Islame e asaj kohe, e vetëdijshme për vështirësitë me të cilat përballej me pushtetin serb në rrafshin nacional e etnik dhe me atë ateist - komunist në rrafshin e rregullimit shoqëror e ideologjik në njërën anë, dhe në anën tjetër, po ashtu e vetëdijshme për rëndësinë që kishte hapja e medresesë për Bashkësinë Islame dhe për besimtarët mysliman, atëherë u angazhuan seriozisht që në kuadër të atyre pak mundësive e hapësirave ligjore, të gjenin rrugën që në Kosovë të (ri)hapej një medrese. Në këtë ndërmarrje, duhet përmendur angazhimin e myderrizëve të shquar për hapjen e medresesë. Nga të dhënat e dokumenteve, raporteve dhe kronikave të kohës, shihet se paria e BIK-ut, pas konsolidimit të BIK-ut, çështjen e medresesë, përkatësisht arsimimin e kishte një ndër objektivat më parësore. Për këtë ndërmarrje i gjejmë të angazhuar prijësit e BIK-ut, duke filluar nga hfz.

⁶ Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22. Raport për punën e Kryesisë supreme për RPS në Prishtinë për periudhën nga themelimi i saj, 16 korrik deri më 23 maj 1951. f. 1.

⁷ Po aty f. 2.

Bajram ef. Agani - kryetar i Kryesisë së BI-së, pastaj hfz. Mustafa Canhasi (anëtar i Kryesisë së BI-së),⁸ i cili ka qenë i angazhuar dhe i autorizuar nga Kryesia për përgatitjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e procedurave tek organet kompetente të shtetit, si në nivelin krahinor, ashtu edhe në nivelet më të larta, për hapjen e medresesë në fjalë. Për hapjen e medresesë, kontribut të theksuar kanë pasur edhe myderrizët e tjerë, siç janë hfz. Ismailhaki ef. Ustaibo, hfz. Isak Saidi, Ahmet ef. Mustafa, Hajrullah ef. Zaimi, hfz. Fahri ef. Iljazi, Hasan ef. Nahi, Sheh Hasani, hfz. Shefki ef. Kallaba, hfz. Lutfi ef. Ahmeti, hfz. Abdullah ef. Kaçapori, mulla Rusha ef. Drekoviqi etj.⁹

Pas një sërë shtyrjesh e zvarritjesh, pushteti i atëhershëm monist, pas insistimit të vazhdueshëm të BI-së, Këshilli Ekzekutiv i Këshillit Krahinor për Kosovë e Metohi (siç qohej atëkohë), në qershor të vitit 1949 (me vendimin nr. 29503, të datës 26 qershor 1949),¹⁰ jep pëlqimin për hapjen e Medresesë së Ulët të Prishtinës (e cila atëherë quhej Medreseja e Ultë Shqiptare).¹¹

Leja për hapjen e medresesë nga pushteti i asaj kohe, Bashkësisë Islame të Kosovës, fillimisht i qe dhënë për në qytetin e Pejës, por për shkak të mungesës së objektit, medreseja

⁸ Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22. Raport për punën e Kryesisë supreme për RPS në Prishtinë për periudhën nga themelimi i saj, 16 korrik deri më 23 maj 1951.

⁹ Po aty.

¹⁰ Arkivi i Kosovës, Fondi Bashkësia e Fesë Islame, Kutia nr. 55, vitit 1951.

¹¹ Po aty.

u bart në Prishtinë. Përgatitjet për hapjen e medresesë, Kryesia e BIK-ut i kishte bërë gjatë vitit 1950, e me intensitet më të madh gjatë vitit 1951, kur kishte investuar në rregullimin e objekteve për medresenë në oborrin e xhamisë “Alaudin”, pastaj kishte emëruar për drejtor, mësuesin e pensionuar, Ahmet ef. Mustafën.¹²

Kështu, në vazhden e përgatitjeve për hapjen e medresesë, drejtoria përmes qarkores,¹³ kishte njoftuar Këshillat Vakëfnorë (Këshillat e Bashkësisë Islame), e përmes tyre xhematin dhe të interesuarit për pranimin e nxënësve në medrese. Në qarkore ishin përcaktuar kushtet dhe dokumentacionin që duhej të plotësonin të interesuarit për t’u regjistruar në medrese. Kryesia e BI-së, respektivisht Drejtoria e Medresesë, kishte paraparë që mësimi në medrese të fillonte më 1 shtator 1951, por për shkaqe objektive, mësimi filloi më 1 nëntor 1951.¹⁴

Nga raporti i Drejtorisë së Medresesë për Kryesinë e BI-së, shihet se popullata e Kosovës dhe ajo e Sanxhakut e kishin mirëpritur hapjen e medresesë. Kjo nënkuptohet nga fakti se në konkursin e hapur nga medreseja ishin paraqitur 122

¹² Ahmet ef. Musatafa (1980-1990), drejtor i medresesë është emëruar më 17 qershor 1951. Është drejtori i parë i Medresesë (Shih: Raport mbi punën e Kryesisë së Fesë Islame të RP të Serbisë në Prishtinë, në periudhën prej 15 majit deri më 23 shtator 1951, Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22., f. 6.

¹³ Arkivi i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Kutia nr. 22. Raport mbi punën e Kryesisë së Fesë Islame të RP të Serbisë në Prishtinë, në periudhën prej 15 maj deri më 23 shtator 1951.

¹⁴ Po aty.

kandidatë¹⁵ për të ndjekur mësimet aty, ndërsa ishin pranuar 50 prej tyre, duke marrë parasysh suksesin, moshën dhe rajonin nga vinin. Nga numri i nxënësve të pranuar, 29 ishin nga Kosova, ndërsa 12 nga Sanxhaku.¹⁶

Hapja e Medresesë në Prishtinë ka edhe një rëndësi të veçantë për popullatën shqiptare dhe jo vetëm në Kosovë, por kudo që jetonte ajo, qoftë në kuadër të ish-Jugosllavisë Federative, në diasporë apo në Shqipërinë komuniste, për faktin se ishte e vetmja vatrë në të cilën mësim për fenë islame mbahej në gjuhën shqipe, dhe ishte pikërisht medreseja ajo që përgatiti kuadrin për Bashkësinë Islame në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e gjetiu. Kur kësaj i shtohet fakti se Medreseja e nisi punën e saj në rrethana të rënduara politike për popullin shqiptar në ish-Jugosllavi, si dhe në kohën kur po instaloheshin ideologjia moniste në Shqipëri, e cila më vonë, më saktë më 1967, me ligj ndaloi besimin, atëherë hapja e Medresesë në Prishtinë merr një rol dhe rëndësi jetike, sidomos për besimtarët myslimanë shqiptarë. Themi këtë, ngase kemi parasysh faktin se sukcesi i kësaj medreseje hapi udhë për mbarëvajtjen e jetës fetare në terren dhe më vonë hapjen dhe themelimin e institucioneve të tjera në kuadër të BI-së. Medreseja e Prishtinës ishte shkolla e dytë fetare islame në ish-Jugosllavi, pasi Medreseja e Gazi Husrev Begut në Sarajevë i kishte shpëtuar mbylljes nga ish-sistemi. E thamë edhe më parë se, Medreseja e Prishtinës praktikisht e nisi misionin e

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

saj më 1 nëntor 1951 dhe këtë në dy objekte që edhe më herët kishin shërbyer si shkolla, në oborrin e xhamisë “Alaudin”, në lagjen Alaudin, prej nga më vonë e mori edhe emrin medreseja. Lejimi i themelimit të medresesë, e për më tepër funksionalizimi i saj, ishte një e arritur e madhe e parisë myslimanë, e realizuar në kohën e në ditët e vështira për popullin shqiptar, arsimin shqip dhe Kosovën në përgjithësi. Mirëpo, me këtë u arritën disa objektiva që do të jenë determinues për të ardhmen e BI-së, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Me këtë rast duhet përmendur se, me funksionalizimin e medresesë apo rihapjen e saj, përveçse u arrit një e drejtë themelore - e drejta për arsimim, për më tepër, u ruajt edhe vazhdimësia e medreseve historike e shekullore. Kjo u arrit përmes myderrizëve të shquar, të cilët u angazhuan për gjetjen e mundësive për hapjen e medresesë, ndërsa, pasi pushteti dha miratimin, iu përveshën punës dhe funksionalizimin e medresesë, duke bartur përvojën, traditën dhe dijen që kishin marrë nga medresetë e mëhershme. Kështu që, në procesin mësimor, në hapjen e medresesë më 1951, u angazhua vetë kryetari i Kryesisë së BI-së, myderriz Bajram ef. Agani¹⁷ (nga Medreseja e Madhe e Gjakovës), i cili së bashku me myderriz Isak ef. Saidin¹⁸ (nga Medreseja e Pirinazit - Prishtinë), morën përsipër ligjërimin e lëndëve fetare. Më pas, në

¹⁷ *Myderriz Bajram Agani (1881-1962)*, kryetar i Kryesisë së BI të Kosovës (1947-1951); drejtor i Medresesë (1953-1956); Në Medresenë e Ulët ka ligjëruar lëndët: gjuhë arabe, gjuhë turke, akad, ahlak.

¹⁸ *Ishak ef. Saidi (1897-?)*, myderriz i njohur i ish-medresesë “Pirinaz” të Prishtinës, në Medrese e ulët ka mbajtur lëndën e Kuranit.

procesin mësimor në medrese i gjejmë edhe Ismailhaki Ustaibon¹⁹ (nga Medreseja Mehmet Pasha - Prizren), hfz. Muharrem Adilin²⁰ (Medreseja e Pirinazit), pastaj myderriz Rushit Osmanin²¹ (Medreseja e Pirinazit), Hasan ef. Nahi²² (Medreseja e Madhe e Gjakovës), h. Sherif Ahmeti²³ (Medreseja e Pirinazit) dhe myderriz Sadri Prestreshi²⁴ (Medreseja e Pirinazit, përkatësisht e Sulltan Selimit - Prishtinë). Këta myderrizë paraqesin lidhjen ndërmjet medreseve të mëhershme me medresenë e re, por tani të reformuar dhe duke iu përgjigjur kërkesave të kohës. Përveç mësimdhënies, kontributi i tyre për medresenë ishte edhe në përgatitjen e dispensave për lëndët që i mbanin, ku duhet përmendur kontributin e myderriz Sherif Ahmetit (për lëndën e akaidit), myderriz Rashid Osmanit (për lëndën e fikhut) dhe myderriz Sadri ef. Prestreshit (për lëndën e ahlakut).

¹⁹ Hfz. *Ismailhaki Ustaibo (1921-1983)*, kryetar i Kryesisë së BI të Kosovës (1963-1983); drejtor i Medresesë (1960-1966), në Medrese ka mbajtur lëndën e Kuranit.

²⁰ Hfz. *Muharrem Adili (Ramadani), (1919-2013)*, pedagog në medrese, ka mbajtur lëndën e gjuhës arabe, gjuhës turke, histori islame.

²¹ *Myderriz Rushit Osmani (1913-1991)*, drejtor i Medresesë së Mesme (1964-1968), në medrese ka mbajtur lëndën e fikhut.

²² *Myderriz Hasan Nahi (1905-1991)*, i përket brezit të fundit të myderrizëve klasikë. Në medrese merret nga fillimi klasën e tij nga viti i parë deri në të pestën, ku edhe ligjëronte lëndët bazike të fesë. Gjeneratat që ka përgatitur Hasan efendi Nahi njihen si gjenerata të Myderriz Nahit. Gjatë punës së tij në Medrese ka përgatitur 4 gjenerata.

²³ *Myderriz Sherif ef. Ahmeti (1929-1998)*, drejtor i Medresesë (1970-1983), në medrese mbajti lëndën e akaidit e filozofisë islame.

²⁴ *Myderriz Sadri ef. Prestreshi (1917-2002)*, myderriz i njohur i Medresesë, ku mbajti lëndën e ahlakut.

Falë këtij brezi të myderrizëve, medreseja u vu në binarë të shëndoshë, rrugë të cilën e trasuan dhe e ndoqën më pastaj edhe ish-nxënësit e tyre, që u inkuadruan si mësimdhënës në medrese. Të theksojmë këtu edhe faktin se me myderrizët e sipërpërmendur, përfundon edhe epoka e artë e ixhazetlinjve mësimdhënës në medrese. Medreseja e Ulët e Prishtinës si shkollë e ulët vepro plot 10 vjet, deri më 1961, ndërsa atëkohë qe nevoja e Bashkësisë Islame për kuadro me përgatitje solide të cilët do të udhëheqin xhaminë anekënd Kosovës, dhe më gjerë në viset shqiptare të ish-Jugosllavisë. Kjo në një rën anë, ndërsa në anën tjetër, suksesi i nxënësve të cilët kishin mbaruar Medresenë e Ulët, bëri që Medreseja e Ulët të ngritët në të mesmen. Kështu, Medreseja “Alaudin”, si shkollë e plotë e mesme pesëvjeçare filloi punën në vitin shkollor 1962/63, kur ngrihet në rangun e medresesë së mesme, me sistem mësimi 5 - vjeçar.²⁵

Në vitet e '70, të shekullit të kaluar, shkollat që përgatishnin profilin e kuadrit mësimor për shkolla fillore vepronin me kohëzgjatje 5 vjeçare, si Shkolla Normale, Shkolla e Artit Figurativ, Medreseja “Alaudin” etj. Me shuarjen e tyre, si shkollë pesëvjeçare kishte ngelur vetëm medreseja “Alaudin”, andaj në vitin 1983, u bë ndryshimi i plan-programit mësimor dhe medreseja nga 5 vjeçare, do të bëhet katër vjeçare. Medreseja “Alaudin” e Prishtinës ishte dhe deri vonë

²⁵ Ramadan Shkodra, Rrethanat politike pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë dhe roli i myderrizëve në hapjen e Medresesë; në përmbledhjen Medreseja “Alaudin” e Prishtinës, (65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar) Prishtinë, 2018, f.. 28.

mbeti e vetmja shkollë e tillë në të gjitha hapësirat shqiptare, në të cilën përgatitja fetare dhe profesionale bëhej në gjuhën shqipe. Në këtë medrese, mësimet i kanë ndjekur një numër i madh i nxënësve që vinin nga të gjitha trojet shqiptare jashtë Shqipërisë londineze, si dhe nga Sanxhaku e Bosnja. Në vitin 1979, Kryesia e Bashkësisë Islame mori vendin që të ndërtonte një godinë të re, që do të ishte adekuate dhe do t'i plotësonte nevojat dhe kërkesat e një shkolle të mesme. Kjo iniciativë u kurorëzua me sukses në vitin 1984, kur medreseja filloi punën në godinën e re, e cila i plotësonte kushtet për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ndërsa, nga viti shkollor 2012-2013, medreseja në kuadër të reformave në arsimin katër vjeçar bëhet shkollë tri vjeçare. Medreseja ka edhe paralelet e saj në Prizren (1993) dhe në Gjiilan (1994). Gjithashtu në medrese, nga viti 1997, mësimin e rregullt e ndjekin edhe vajzat në klasa të veçanta.²⁶

Medreseja e Prishtinës gjatë dekadave të punës dhe vepërimitarisë së saj, ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të jashtëzakonshëm në përgatitjen e ulemave të rinj, të kuadrit fetar e të drejtuesve shpirtëror të popullit tonë, në formimin e përgjithshëm kulturor të popullit, në edukimin moral, qytetar e atdhetar të brezave të rinj dhe në rrënjosjen e dashurisë për dije e përparim. Këtu u formuan imamët, hatibët, myderrizët, mualimët dhe prijësit islamë, të cilët u vunë në shërbim të jetës fetare islame, jo vetëm në nivel vendi, por edhe më gjerë. Sepse, sikurse dihet, Medresenë e Prishtinës nuk e kanë kryer

²⁶ *Medreseja e mesme Alauddin* (Katalog), Prishtinë, 2017, f. 20.

vetëm nxënës nga Kosova, por aty kanë mësuar edhe nxënës nga Maqedonia, Mali i Zi, Sanxhaku, Kosova Lindore, e më vonë edhe nga Shqipëria. Kurse veprimtarë të jetës fetare e kombëtare nga ish-nxënësit e Medresesë ka gjithandej nëpër trojet tona etnike e të copëtuara shqiptare, në diasporën shqiptare dhe jo vetëm kaq. Medreseja e Prishtinës ishte paraprijëse e denjë e Medresesë së Mesme “Isa Begu” në Shkup, Medresesë së Novi Pazarit dhe Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë.

4.

Fakulteti i Studimeve Islame (FSI) - Prishtinë - Është institucioni më i lartë edukativo-arsimor islam në gjuhën shqipe në Kosovë. U themelua nga Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës, më 15 gusht të vitit 1992.²⁷ Në vendimin e Kryesisë së BI-së për themelimin e FSI-së thuhet:

1. Themelohet Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë.
2. Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë është institucion islam universitar i pavarur.
3. Në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë organizohet dhe zhvillohet veprimtaria arsimore-edukative dhe shkencore në gjuhën shqipe.
4. Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë ka për detyrë zhvillimin e veprimtarisë fetare-islame dhe krijimin e kuadrove islame të nivelit universitar.

²⁷ Shih: Vendimin e Kuvendit të BIK për themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame, nr. 443/92 të datës 15 gusht 1992, që ruhet në Arkivin e Fakultetit.

5. Veprimtaria e Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë financohet nga buxheti i Meshihatit të Bashkësisë Islame për Kosovë, Serbi dhe Vojvodinë në Prishtinë.²⁸

Po ashtu, Kuvendi i BI-së, në këtë mbledhje emëroi edhe Këshillin themelues në këtë përbërje: Rexhep Boja - kryetar, dr. Pajazit Nushi, mr. Ismail Ahmeti, Qemajl Morina, Isa Bajçinca, Jashar Jashari, Miftar Ajdini dhe Naim Tërnavë.²⁹

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, si institucioni më i lartë i arsimimit islam në Kosovë, nisi punën në vitin e parë akademik 1992-93. Me punën filloi më 10 dhjetor 1992³⁰, ku në një ceremoni modeste, fjalën me rastin e fillimit të punës-hapjes e mbajti dr. Rexhep ef. Boja, kryetari i Kryesisë, i cili ishte edhe kryetar i Këshillit themelues dhe tashmë ishte caktuar edhe për të ushtruar detyrën e dekanit. Ndërsa, ligjëratën e parë me studentë e mbajti veterani i arsimit kombëtar dhe islam në Kosovë, haxhi Sherif ef. Ahme-

²⁸ Po aty. Vendimi i Kuvendit të BIK për themelimin e Fakultetit të Studimeve Islame, nr. 443/92 të datës 15 gusht 1992.

²⁹ Elez Osmani, Puna rreth hapjes së Fakultetit po ecën mbarë, "Dituria Islame", nr. 41, f. 35.

³⁰ Revista "Dituria Islame" për datë të fillimit të punës së FSI jep datën 7 dhjetor 1992, (shih: Elez Osmani, Filloi mësimi në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë "Dituri Islame", nr. 44. f. 4); Mirëpo Gazeta "Bujku" e datës 12 dhjetor 1992, botoi informatën: "Dje në Prishtinë filloi punën Fakulteti i Studimeve Islame" ajo që duhet thënë me këtë rast është se gazeta "Bujku" për shkak të rrethanave politike të asaj kohe që mbretëronin në Kosovë është botuar më një ditë vonesë, më 12 dhjetor 1992. Nga kjo e dhënë del që FSI ka nis punë ditën e enjte më 10 dhjetor 1992.

ti.³¹ Në këtë vit, në Fakultetin e Studimeve Islame ligjëratat i ndoqën 30 studentë, 10 prej tyre me korrespondencë.³²

Për drejtues të parë të FSI-së, Kryesia e BIK-ut kishte emëruar dr. Rexhep Boja - u.d. dekan, mr. Qemajl Morina - u.d. prodekan,³³ dhe Sabri Bajgora - u.d. sekretar.³⁴

Në vitin e parë akademik 1992-1993, në FSI, në procesin arsimor ishin të angazhuar këta pedagog: haxhi Sherif Ahmeti (akaid); dr. Rexhep Boja (fikh); prof. Qazim Qazimi (tefsir); mr. Qemajl Morina (gjuhë arabe); prof. Resul Rexhepi (Historia e së drejtës së sheriatit); prof. Sulejman Osmani (hadith); prof. Emin Behrami (Kuran); prof. Isa Bajçinca (gjuhë shqipe); dr. Vesel Nuhiu (gjuhë angleze); prof. Naime Hoxha (gjuhë turke); mr. Ismail Hasani (sociologji e kulturës).³⁵

FSI është institucioni i parë për studime të larta në gjuhën shqipe. Hapja e tij ishte nevojë e kamotshme e popullit shqiptar për një institucion të tillë, si dhe për shkak të kthimit të të rinjve tanë nga bota me një ideologji tjetër nga ajo e islamit tonë tradicional. Studimet në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, që nga fillimi e deri më sot zgjasin katër

³¹ Elez Osmani, Filloi mësimi në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë “Dituri Islame”, nr. 44. f. 4.

³² Po aty.

³³ Po aty.

³⁴ Këtë e konfirmon prof. Sabri Bajgora nga biseda që kam zhvilluar me të në nëntor të këtij viti. Prof. Bajgora dëshmon se detyrën e sekretarit e ka ushtruar deri në vitin 1995. Po ashtu, prof. Sabri Bajgora në FSI ka ligjëruar lëndën e tefsirit - III dhe IV, gjatë viteve 1995-2005 dhe 2010-2011.

³⁵ Sipas bisedës dhe shikimit të Indeksit të kolegut tim, studentit të brezit të parë të FSI-së, Sadik Mehmetit (nëntor 2020).

vite akademike, respektivisht tetë semestra.³⁶ Pas përfundimit të provimeve të parapara me Statutin e Fakultetit, studenti përgatit diplomën, të cilën e mbron para komisionit përkatës. Në Fakultetin e Studimeve Islame mësohet kryesisht lëndët fetare, si Kuran, tefsir, hadith, fikh, akaid, usuli fikh, qytetërim islam, filozofi islame, gjuhë shqipe, arabe, angleze, turke etj., por edhe lëndët bashkëkohore.³⁷ Aty ndjekin studimet studentë të rregullt dhe ata me korrespondencë nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare, si nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Lugina e Preshevës dhe nga diaspora. Fakulteti posedon një bibliotekë të pasur me libra.³⁸ Në vitin akademik 2015-2016, Fakulteti i Studimeve Islame është akredituar edhe në programin master për Teologji Islame.³⁹

Si përfundim, mund të themi se zhvillimi i institucioneve edukative-arsimore islame në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore, duhet të vështrohet në kuadër të rrethanave shoqërore - politike që e karakterizuan këtë periudhë. Dekadat e para të pasluftës, për shkak të arsyeve që dihen, ishin jashtëzakonisht të vështira, jo vetëm për institucionet islame dhe mbarëvajtjen e jetës fetare islame në Kosovë, por edhe për gjithë popullatën dhe aspektet e jetës në atë kohë. Me një fjalë, zhvillimi dhe fati i institucioneve islame ishte i ngjashëm dhe i lidhur ngushtë me fatin nëpër të cilin kalonte popullata shqiptare përgjatë gjithë këtyre dekadave e deri më sot.

³⁶ Fakulteti i Studimeve Islame i Prishtinës (katalog), Prishtinë, 2012, f. 4.

³⁷ Po aty, f. 40.

³⁸ Po aty, f. 40.

³⁹ Fakulteti i Studimeve Islame (Monografi me rastin e 25 vjetorit të themelimit), Prishtinë, 2017, f.48.

Sadik MEHMETI

SHKOLLAT E MESME (MEKTEBET RUSHDIJE) NË KOSOVË me vështrim të veçantë Rushdija e Prizrenit dhe e Prishtinës

Në kuadër të reformave arsimor në Perandorinë Osmane, të cilat u bënë pas dekadës së pestë të shek. XIX dhe të cilat dhanë rezultate mjaftë pozitive, në perandori ekzistonte një rrjet i gjerë i shkollave. Kurse në vitin 1869 u nxor edhe Rregullorja e Arsimit të Përgjithshëm, sipas së cilës shkollat publike në gjithë perandorinë ndaheshin në: 1. *Shkolla fillore* (ibtidâi mektebleri), 2. *Shkolla të mesme të ulëta* (rushdije), 3. *Shkolla të mesme të larta* (shkollat idâdije), 4. *Shkolla sultanije* (sultânije) dhe 5. *Shkollat e larta* (mekâtib-i âlije), ku hynin: *Shkollat e larta pedagogjike* (dârulmuallimîn).¹

¹ Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde sultaniler ve idâdiler*, (Yüksek Lisan Tezi), Ondokuz Mayıs Üniversitesi, Samsun 2007, f. 15; Necati Demir, *Education in Kosovo among 1877-1912 according to the Prime Ministry Ottoman Archives*, në: "Zeitschrift für die Welt der Türken", vëll. 2. Nr. 3 (2010), f. 9; Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në: Historia e Shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman, vëll. II, AIITC, Tiranë, 2009, f. 458; Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Koso-*

Në territorin e Kosovës në këtë kohë, përveç *mektebeve klasike dhe medreseve*, - kanë ekzistuar: *mektebet ibtidâije, shkollat rushdije, shkollat idâdije dhe shkollat dâarulmuallimîn*, kurse *shkolla sulltânije* nuk kishte. Mirëpo shumë nxënës nga Kosova mësimet do t'i kenë ndjekur në sulltanijet që ishin hapur në qendra të tjera, si në Selanik, Shkup dhe, natyrisht, në vetë kryeqendrën e Perandorisë - në Stamboll.

Këto shkolla ishin me karakter laik dhe nuk ishin ekskluzivisht shkolla fetare, dhe arsimit në ato shkolla i kushtohej një kujdes shumë serioz, kurse mësimin në to e mbanin mësimdhënës të aftë dhe, për sa u takon përmbajtjes dhe metodave, këto shkolla kanë qenë mjaft të perfeksionuara, kurse nga pikëpamja materiale dhe e kuadrit, kanë qenë shumë të siguruara.² Nga fundi i shek. XIX dhe sidomos pas vitit 1908 numri i këtyre shkollave në Kosovë ishte shtuar shumë. Kurse me largimin e Perandorisë Osmane nga trojet tona (1912) këto shkolla pushojnë së funksionuari.

Rushdijet konsideroheshin si një lloj shkollash të ndërmjetme, meqenëse vinin pas atyre fillore. Ishin institucione përgatitore për shkollën e mesme dhe pas vitit 1869, shiheshin si shkolla me një nivel më të lartë se filloret, por më të ulët se gjimnazet *idâdije*.³ Me një fjalë, sipas nivelit, *rushdijet* mund të thuhet se u përgjigjeshin shkollave të ulëta të mesme ose progjimnazeve të sotme.

vu od kraja XVIII stoleća do 1918 godine, Zajednica Naučnih Ustanova SAP Kosova, Prishtinë, 1974, f. 15.

² Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu...*, po aty, f. 14-15.

³ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institutionet...*, po aty, f. 450.

Koha e ciklit arsimor në rushdije ka njohur disa ndryshime gjatë zhvillimit historik të tyre. Në vitin 1850, *rushdijet* zgjatnin 6 vjet, në vitin 1863 qenë shndërruar në shkolla 5-vjeçare, kurse në vitin 1869 rushdijet përfundimisht u bënë shkolla 4-vjeçare⁴. Nxënësit që përfundonin rushdijen do të pranoheshin në shkollat *idâdije* (në gjimnaz) pasi të kishin kaluar me sukses një provim.⁵ Ata, gjithashtu, mund të regjistroheshin edhe në *medrese* dhe në shkollat e larta pedagojike (*dâru l'muallimîn*).

Nxënësit që mbaronin rushdijen mund të punësoheshin si nëpunës të ulët në administratë, por ata mund të punësoheshin edhe në punë shtetërore ose të vazhdonin shkollimin⁶, në mënyrë që të mund të arrinin detyra të rëndësishme shtetërore.

Në këto shkolla pranoheshin fëmijët që kishin mbaruar shkollën fillore (*sibjân*, përkatësisht *iptidâi mektebin*), dhe që ishin të aftë të lexonin dhe të shkruanin.

Deri në fund të epokës osmane, arsimi në mektebe dhe medrese ishte ai më i privileguari për myslimanët e Vilajetit të Kosovës. Dhe, në të vërtetë, sipas sallnâmesë të Vilajetit të vitit 1893, numri i shkollave rushdije mbetej më i ulët se ai i medreseve, të cilat frekuentoheshin nganjëherë nga nxënësit pas shkollave rushdije. Zyrtarisht proporcioni i nxënësve të medreseve në raport me nxënësit e rushdijeve (pa numëruar

⁴ F. Reşit Unat, *Türkiye Eğitim Sisteminin Gelişmesine Tarihi Bir Bakış*, Ankara 1964, f. 44.

⁵ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet...*, po aty, f. 451.

⁶ Hajrudin Ćurić, *Muslimansko školstvo u Bosni i Hercegovini do 1918. Godine*, Sarajevë, 1983, f. 136.

rushdijet ushtarake) ishte veçse dy në tre. Por rrejt i rushdijeve nuk i mbulonte të gjitha qendrat e kazasë dhe niveli i arsimit më të lartë, - ai *idâdije* ose *dârulmuallimîn*, - ekzistonte vetëm në kryeqytetet e vilajeteve. Karrierat fetare vlerësoheshin shumë nga myslimanët e këtyre krahinave. Pjesa më e madhe e këtyre ulemave bënë karrierë si myderriz dhe myfti nganjëherë edhe në kryeqytetin osman. Kjo do të thotë se ata specializoheshin në riprodhimin e dijes fetare.⁷

Për nga historiku, sikurse u tha, rushdijet në Perandorinë Osmane janë shkolla të reja. Në sallnâmenë e viti 1870-1871 (1287) thuhet se rushdijet e para janë themeluar në vitin 1847 (1263).⁸ Në pjesën e dytë të shek. XIX i hasim edhe në Kosovë. Mbështetur në burime relevante, *Rushdija e Prizrenit është më e vjetra, e themeluar në vitin 1272/1855-6*.⁹

Moment kthese në historinë e arsimit

Që nga viti 1855-56 edhe në Kosovë, krahas shkollave të mëparshme, u hapën shkolla rushdije dhe sidomos numri i tyre u rrit pas vitit 1869, kur edhe ndryshojnë rrethanat në sferën e shkollave dhe të arsimit në Vilajetin e Kosovës.

⁷ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar (lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë)*, botime “Përpjekja”, përktheu: Artan Puto, Tiranë, 2012, f. 76-77.

⁸ Hajrudin Ćurić, *Muslimansko školstvo*, po aty, f. 136.

⁹ *Tanzimat'tan cumhuriyet'e modernleşme sürecinde eğitim istatistikleri 1839-1924/Education statistics in modernization from the Tanzimat to the Republic/Tarihi İstatistikler dizisi/Historical Statistic series*, Cilt/Volume 6, Hazırlayan Yrd. Doç. Dr. Mehmet Ö. Alkan, Ankara 2000, f. 72.

Zhvillimi i shkollave rushdije pasqyrohet në sállnâmetë e kohës dhe në burime të tjera. Këto burime janë të rëndësishme për të konstatuar se këto shkolla kanë punuar në kontinuitet dhe se nuk kanë përjetuar ndonjë ndryshim thelbësor.

Shkollat rushdije në Kosovë i përmendin dhe i vënë në dukje edhe udhëpërshkruesit e ndryshëm që kishin vizituar Kosovën në gjysmën e dytë të shek. XIX, A. Gilferding¹⁰, E. Viet¹¹ dhe J. G. Von Hahn¹², por pa lënë shënime të hollësishme për to. Shënime për rushdijet e Prizrenit, Prishtinës dhe Gjakovës, përveçse i përmend, nuk jep as Sami Frashëri në enciklopedinë e tij “*Kamûs al-A’lâm*”¹³. Shkollat rushdije, në kuadër të shkollave të tjera në Kosovë, i ka trajtuar J. Rexhepagiqi¹⁴, i cili ka dhënë disa shënime të rëndësishme, po pa përmendur vitet e themelimit të tyre, përveç për rushdijen e Prishtinës. Këto shkolla, më vonë, në studimet e tij kalimthi i përmend edhe H. Koliqi.¹⁵ Por, duke mos qenë të njohur me

¹⁰ Aleksandar F. Gilferding, *Putovanje po Hercegovini, Bosni i Staroj Srbiji*, Sarajevë, 1972.

¹¹ Gjyltekin Shehu, *Pashallëku i Prizrenit, 1866*), sipas konsullit frëng Viet në Shkodër, në: “Gjurmime Albanologjike”, SSHH, nr. X-1980, Prishtinë 1981, f. 51.

¹² Johan Georg von Hahn, *Udhëtim nëpër viset e Drinit e të Vardarit*, përktheu Pjetër Radiqi, Tiranë, 2001.

¹³ Şemsettin Sami Frashëri, “*Kamûs al-A’lâm*”¹³. II, Stamboll, 1889, f. 1496, 1498; kurse zëri për “*Gjakovën*” në vëll. VI, f. 4786.

¹⁴ Jaşar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu...*, po aty; I njëjti, *Razvoj i obelježa...*; I njëjti, *Razvoj prosvete i školstva albanske narodnosti na teritoriji današnje Jugoslavije do 1918. God.*, Prishtinë, 1968.

¹⁵ Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, 2002, f. 186.

veprimtarinë e këtyre shkollave, disa studiues shpesh i ngatërronjë ato me medresetë.

Hapja e rushdijeve dhe mësimi i lëndëve si gjuha frënge, vizatimi, gjeometria, matematika etj., të cilat mësoheshin edhe në shkollat ekuivalente - në gjimnazet e ulëta të Evropës, mund të konsiderohet një moment i rëndësishëm dhe kthese për profilin e arsimit të gjeneratave të reja në Kosovë, ku mësimi deri atëherë kishte karakter më shumë fetar.

Ndonëse rushdijet ishin shkolla laike, megjithatë, një rëndësi e veçantë i kushtohej edhe mësimi të fesë, gramatikës osmane, arabe dhe perse, historisë e aritmetikës dhe, meqenëse përgatitsnin kuadro për administratë, kujdes i ishte kushtuar natyrisht edhe bukurshkrimit (kaligrafisë), sidomos llojit të shkrimit *rik'a* që përdorej përgjithësisht në administratën osmane. Por edhe lëndët tjera nuk qenë lënë pas dore.

Numri i rushdijeve në Kosovë, kishte shënuar një rritje graduale duke arritur në numrin 10.

Kështu shkolla rushdije e Prizrenit është haur në vitin 1855-6, e Prishtinës në vitin 1869, e Vushtrrisë në vitin 1875, e Mitrovicës në vitin 1884-5, e Pejës në vitin 1875, e Gjakovës në vitin 1864, e Gjilanit në vitin 1880, Ferizajt në vitin 1911. Në Prizren dhe në Gjakovë kanë punuar edhe shkollat ushtarake të nënoficerëve (rüşdiye-i askeriye)¹⁶.

Në Kosovë pra kanë vepruar 8 rushdije civile dhe 2 ushtarake, të cilat në një periudhë prej afro katër dekadash sa vepruan këto shkolla, mësimet i kanë vijuar një numër i kon-

¹⁶ Sadik Mehmeti, *Shkollat dhe Arsimi në Kosovë (1830-1912)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2019, f. 143-162.

siderueshëm i nxënësve. Mbi bazën e të dhënave të konsultuara shohim se në rushdijen e Prishtinës kanë mësuar afërsisht 1552 nxënës, në atë të Vushtrrisë 585, të Mitrovicës 300, të Pejës 310, të Prizrenit 639, të Gjakovës 886, të Gjilanit 485. Numri i përafërt i nxënësve që kanë ndjekur shkollat rushdije në Kosovë është 5.000 - 6.000 nxënës¹⁷.

Krahas medreseve, rushdijet kanë ngelur të vetmet shkolla të mesme deri në vitin 1885, kur edhe hapet Shkolla e Mesme e Lartë (Idâdija) e Prishtinës¹⁸, që ishte gjimnazi i parë i plotë në Kosovë.

Shkolla rushdije e Prizrenit

Shkolla rushdije në Prizren, sikurse u tha, është hapur në vitin 1855-6 (1272/H).¹⁹ E konsiderojmë si shkollën më të vjetër të këtij niveli në Kosovë. Më 1863 shkollën rushdije të Prizrenit e përmend edhe udhëpërshkruesi dhe albanologu, J. G. von Hahn, si “*shkollë elementare ushtarake*”²⁰, pa dhënë shënime të tjera. Asnjë nga burimet e tjera të konsultuara nuk vërtetojnë konstatimin e albanologut Von Hahn, se kjo rushdije ishte ushtarake. Rushdijet ushtarake, në Kosovë, hapen më vonë.

¹⁷ Po aty, f. 170.

¹⁸ Derya Demirel, *Osmanli devleti'nde sultaniler ve idâdiler*, po aty, f. 89.

¹⁹ *Tanzimat'tan cumhuriyet'e modernleşme sürecinde eğitim istatistikleri 1839-1924...*, po aty, f. 72.

²⁰ Johan Georg von Hahn, *Udhëtim nëpër viset e Drinit...*, po aty, f. 166.

Sipas gazetës “Prizreni”²¹, nr. 50, të datës 31 korrik 1872, mësojmë se mësuesi më i vjetër njëherësh edhe drejtor i kësaj shkolle, Sulejman efendiu, kishte shkuar në detyrë të re në Selanik, kurse në vend të tij kishte ardhur Salih efendiu. Në vitin 1873 rushdija e Prizrenit kishte 95 nxënës dhe një mësues të parë.²² Në vitin 1883 kjo shkollë numëronte 75 nxënës.²³

Më 1885 kjo shkollë kishte 85 nxënës. Mësues i parë ishte Shefki efendiu, mësues i dytë Aziz efendiu, mësues i tretë Haxhi Osman efendiu dhe mësues i lëndës *rik’a*, Hasan efendiu.

Në vitin shkollor 1893/94 arritën 84 nxënës, të rinj u regjistruan 52 nxënës. Nga ky numër i përgjithshëm, 31 nxënës për arsye të ndryshme e ndërprejnë shkollimin, 9 të tjerë morën diplomën në fund të vitit shkollor 1894-1895, ndërsa 96 vazhduan mësimet. Në këtë vit kjo shkollë kishte 4 mësime-dhënës.²⁴ Në vitin 1896 kishte 119 nxënës dhe katër mësues: Shefki efendiu mësues i parë, Hëzër efendiu, mësues i dytë, haxhi Osman efendiu mësues i tretë dhe Jashar Hysni efendiu mësues i shkrimit *rik’a*.²⁵

Pas tre vjetësh (1900/1) në Prizren vepronte edhe Këshilli Arsimor, në krye me myderriz Abdyl (Halim) efendi Gjergji-

²¹ Gazeta “Prizreni”, nr. 50, dt. 31 korrik 1872, f. 1.

²² *Tanzimat’tan cumhuriyet’e modernleşme sürecinde eğitim istatistikleri 1839-1924...*, po aty, f. 27.

²³ Po aty, f. 40.

²⁴ Po aty, f. 72.

²⁵ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1314 (1896), f. 260.

zin, ndërsa anëtarë të tij ishin: Shefik beu, kryetar i komunës, Rasim efendiu, tagrambledhës dhe personalitete tjera të njohura, si Ramiz Aga, Veli Efendiu, Daut Aga etj. Në këtë kohë rushdija kishte 85 nxënës. Ndërkaq, në vend të dy mësuesve që punonin deri atëherë, tash ishin katër: Xhafer efendiu, mësues i parë, Adem efendiu, mësues i dytë, Musa efendiu, mësues i tretë dhe Hafiz Zeki efendiu, mësues i shkrimit *rik'a*.²⁶ Në vitin 1898 në Prizren përmenden dy rushdije²⁷, njëra mund të ketë qenë “rüşdiye-i askeriye”.²⁸

Godina e parë e rushdijes së Prizrenit ishte rrënuar në vitin 1894²⁹, për t'u rindërtuar e reja në vitin 1896.³⁰ Poeti, intelektuali dhe kronisti i njohur prizrenas, Haxhi Ymer ef. Paçarizi (i cili edhe vet kishte mbaruar rushdijen e Prizrenit më 1887), godinës së re të kësaj shkolle ia ka kushtuar një “Târîh/kronogram” në gjuhën osmane.³¹

Ndërtesa e rushdijes i plotësonte të gjitha kriteret për një shkollë të tillë. Ajo deri vonë i ka shërbyer spitalit të vjetër të Prizrenit, dhe më pastaj qe braktisur dhe deri tash së voni, kur është rinovuar, ka qenë në gjendje të rrënuar dhe pa kurrfarë kujdesi institucional e shtetëror.

²⁶ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova, 1318 (1900)*, f. 754.

²⁷ Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII stoleća do 1918*, Prishtinë, 1974, f. 21.

²⁸ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar...*, op. cit., f. 77.

²⁹ Necati Demir, *Education in Kosovo...*, po aty, f. 17.

³⁰ Shih: Ömer Lütflî Pâçârîzî, *Tevârih*, (dorëshkrim), Arkivi i Kosovës - Prishtinë, f. 193-194.

³¹ Po aty.

Shkolla rushdije e Prishtinës

Në vitin 1869 (1286 H) në Prishtinë u themelua shkolla rushdije.³² Atë e ndërtoi Abdurrahman Pasha i biri i Jashar Pashë Gjinollit.³³ Kjo ishte shkolla e parë moderne publike - laike në Prishtinë. Hapja e saj fillimisht u pa me një farë rezerve nga paria fetare (ulemaja) vendëse, por më vonë u kuptua rëndësia e saj dhe shkolla vazhdoi të punonte normalisht.³⁴

Rushdija në Prishtinë është hapur para shkollës fillore ibtidâije të Prishtinës, e cila u hap në vitin 1883, që d.m.th. një herë është hapur shkolla mesme e ulët (rushdija) e më pastaj shkolla fillore moderne (ibtidâija). Këtë sigurisht e ka kushtëzuar numri i madh i nxënësve që mësonin në shkollat fillore klasike (mektebet sibjân) që punonin në Prishtinë dhe rrethinë.³⁵

³² *Tanzimat'tan cumhuriyet'e modernleşme sürecinde eğitim istatistikleri 1839-1924...*, po aty, f. 72.

³³ *Abdurrahman Pashë Gjinolli* është pinjoll i njëres nga dyert e mëdha të oxhaqeve shqiptare të Kosovës, që ka lënë gjurmë të konsiderueshme në jetën politike, kulturore dhe arsimore të Sanxhakut të Prishtinës dhe më gjerë në dy shekujt e fundit të sundimit osman në Kosovë. Abdurrahman Pasha ka jetuar në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në dekadat e para të shek. XX. Ka qenë deputet i Prishtinës në Parlamentin Osman. Më gjerësisht për Gjinollajt, shih: Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike (studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2010, f. 179.

³⁴ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, Def'a, 4, 1887, f. 88.

³⁵ Svetozar G. Čanović, *Specifični problemi nastave u školama Kosova i Метохије*, Prishtinë, 1967, f. 61.

Në vitin 1873 rushdija e Prishtinës kishte 91 nxënës dhe një mësues³⁶. Në vitin 1879, kishte 65 nxënës, kurse mësimin e mbanin këta mësues: Sabit “Numan” efendiu, mësues i parë, që ishte njëkohësisht edhe drejtor i shkollës dhe myderriz në medrese, Sylejman efendiu, mësues i dytë, Agush efendiu, mësues i tretë dhe Xhenab efendiu, mësues i lartë.³⁷

Më 1882/3 kjo shkollë kishte 105 nxënës. Mësues i parë ishte Sabit-efendiu, mësues i dytë Shaqir-efendiu, kurse mësues i tretë Arif-efendiu dhe mulla Abdyl. ³⁸

Më 1884/5 kishte 147 nxënës dhe përveç mësuesve të sipërpërmendur kishte edhe mësuesin e gjeografisë dhe të matematikës - Ali efendiu dhe mësuesin e shkrimit *rik'a*, Ahmed efendiu dhe të shkrimit thuluth, Agush efendiu.³⁹

Kjo shkollë edhe në vitin 1885 kishte të njëjtat mësues dhe me 147 nxënës.⁴⁰

Në vitin 1886/87 kishte 127 nxënës dhe lëndët e mësimin ishin të njëjta si në vitet e mëparshme, me përjashtim se mësues i shkrimit *rik'a* ishte Abidin efendiu.⁴¹

Në këtë shkollë një vit më vonë (1887/88) erdhi edhe mësuesi i tretë Arif-efendiu. Numri i nxënësve që e vijonin

³⁶ *Tanzimat'tan cumhuriyet'e modernleşme sürecinde eğitim istatistikleri 1839-1924...*, po aty, f. 27.

³⁷ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, Def'a, 1, 1879. Si dhe: Skënder Rizaj, *Prishtina gjatë shekujve XVII-XX (1912)*, në: “Gjurmime albanologjike”, SSHH, nr. 18, 1988, Prishtinë, 1989, f. 98.

³⁸ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1882/3, f. 45.

³⁹ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1302 (1884/5), f. 57.

⁴⁰ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1885, f. 55.

⁴¹ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1886, f. 74.

mësimin këtë viti kishte arritur në 136, mësuesi i ri ishte Vehbi efendiu për lëndën e shkrimit *rik'a*.⁴²

Në vitin 1893 rushdija e Prishtinës numëronte 157 nxënës. Atë vit ishin regjistruar edhe 69 nxënës të rinj. Nga ky numër i përgjithshëm i nxënësve 30 prej tyre, për arsye të ndryshme, e kishin ndërprerë shkollimin. Në fund të vitit shkollor 1894-1895 diplomuan 17 nxënës, ndërsa 179 kishin ngelur për të vazhduar shkollimin.⁴³

Në vitin 1896 kishte 171 nxënës dhe 5 mësimdhënës: Sabit efendiu, Arif efendiu, Ahmed efendiu, Xhemal efendiu (mësues i kaligrafisë) dhe Agush efendiu mësues i shkrimit *rik'a*.⁴⁴

Në vitin 1898, sipas "*Sâlnâme-i nezâreti*", kjo shkollë kishte 196 nxënës dhe 5 mësimdhënës.⁴⁵

Kurse në vitin 1900-1901, kishte 230 nxënës dhe 5 mësimdhënës⁴⁶: Sabit efendiu, mësues i parë, Ahmet efendiu, mësues i dytë, Ramadan efendiu, mësues i tretë dhe Agush

⁴² *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1305 (1887/88), f. 72.

⁴³ *Tanzimat'tan cumhuriyet'e modernleşme sürecinde eğitim istatistikleri 1839-1924...*, vep. cit., f. 72.

⁴⁴ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1314 (1896), Üsküp, f. 183; Necati Demir, *Education in Kosovo among 1877-1912 according to the Prime Ministry Ottoman Archives...*, po aty, f. 17.

⁴⁵ Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta...*, po aty, f. 28.

⁴⁶ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Kosova*, 1318 (1900/01); Skënder Rizaj, *Institucionet arësimore në Vilajetin e Kosovës më 1900/1*, në: "Buletin" i punimeve shkencore të Fakultetit Filozofik-Prishtinë, nr. VII, Bleni A, Prishtinë, 1970, f.357.

efendiu mësues i shkrimit thuluth, Sylejman efendiu, mësues i shkrimit *rik'a* dhe Adil efendiu, portier.⁴⁷

Në vitin 1900/1 në Prishtinë vepronte edhe Këshilli Arsimor, në krye më myftiun Hafiz Mustafa Hamdi efendiu⁴⁸ dhe anëtarët Selim efendiu, Jahja efendiu dhe Abdylgafurr efendiu (këtë të fundit e kishte zëvendësuar haxhi Ymer efendiu).

Deri në vitin 1903 rushdija e Prishtinës kishte dy dhoma mësimi. Në vitin 1887 godina e kësaj shkolle ishte djegur⁴⁹, por me kontributin e djemve të Abdurrhman Pashës së përmendur, Zija beut, Ali Danish beut dhe Fuad beut, godina është rindërtuar.⁵⁰

Plan-programi dhe përpjekjet për mësim në gjuhën shqipe

Planet mësimore të shkollave rushdije kanë njohur disa ndryshime dhe plotësime; në fillim janë mësuar një numër më i vogël i lëndëve, kurse më vonë numri i lëndëve është shtuar. Këto ndryshime duken qartë edhe nga dëftesat dhe diplomat e lëshuara nga rushdijet e Kosovës e që i kemi në dis-

⁴⁷ *Sâlnâme-i Vilayet-i Kosova*, 1318 (1900-1901), f. 547.

⁴⁸ *Haxhi Hafiz Mustafa Hamdi efendiu (? - 1910)*, ka qenë myfti shumëvjeçar i Prishtinës. Ka qenë i kabiles Sopa. Deputet i Prishtinës në Parlamentin Osman së bashku me Hasan Prishtinën deri në vitin 1910, kur edhe ndërroi jetë. Në vendin e tij si deputet erdhi Shaban Pasha nga Prishtina. *Başbakanlık Osmanlı Arşivi, DH. MUI, 58/25; Osmanlı Arşiv Belgelerinde Kosova Vilayeti*, Stamboll, 2007, f. 100-101 dhe 151.

⁴⁹ Branislav Nušić, *Kosovo, vëll. II*, Novi Sad, 1908, f. 14.

⁵⁰ Raif Virmića, *Kosova'da osmanli mimari eserleri*, I, Ankara, 1999, f. 268.

pozicion. Ndryshime të tilla gjejmë edhe në kuadër të së njëjtës rushdije.

Në rushdijen e Shkodrës, f.v. shihet se në fillim janë mësuar më pakë lëndë, kurse më vonë fondi i lëndëve është shtuar. Në këtë rushdije mësimet jepeshin në gjuhën turke, kurse shpjegimet bëheshin më tepër në gjuhën shqipe prej mësuesve shqiptarë të atyshëm⁵¹.

Në vitin 1877/78 u hartua një program i ri për shkollat rushdije⁵², kurse në vitin 1889/1890 (1305 rumî) në sâlnâmë-në e Vilajetit të Manastirit është botuar programi i ri i këtyre shkollave⁵³. Por ky nuk ishte ndryshimi i vetëm që u bë në programet e shkollave rushdije. Më 1 shtator 1892 (1299 H.) u rishikua gjithashtu plani mësimor për shkollat fillore moderne dhe rushdijet (në të cilin qe kujdesur që lëndët në këto shkolla të mos përsëriteshin).

Në vitin e katërt ishte paraparë që të jepej mësim edhe në gjuhën që përdorej në zonën lokale dhe në qytete, si dhe lënda e gjuhës frënge.⁵⁴ Por ndonëse ishte paraparë që të mësohej edhe gjuha lokale më e rëndësishme në rajonin e shkollës përkatëse, zbatimi i saj për shqiptarët haste në pengesa dhe në mënyrë të haptë nuk lejohej nga organet e qeverisë osmane. Në rushdijen e Gjilanit ishin bërë përpjekje që mësimi të zhvillohej edhe në gjuhën shqipe, por kjo nuk qe lejuar.

⁵¹ Më gjerësisht për rushdijen e Shkodrës, shih: Hamdi Bushati, *Shkodra dhe motet*, vëll. II, Shkodër 1999, f. 33.

⁵² *Sâlnâme-i Devlet-i Osmaniye*, 1294 (1877/78), f. 391.

⁵³ *Sâlnâme-i Vilâyet-i Manâstir*, R. 1305/1, f. 156-157.

⁵⁴ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet...*, po aty, f. 451.

Pas Hyrrijetit (1908) nxënësit në rushdijet e Kosovës mund të mësonin, nëse ishin të interesuar, edhe në gjuhën shqipe⁵⁵, por kjo më shumë bëhej në mënyrë individuale, sepse ndihej mungesa e mësuesve në gjuhën shqipe, ngaqë nuk kishte asnjë institucion për të përgatitur mësues për shkollat shqipe dhe kurrfarë shkolle të mesme në gjuhën amtare.⁵⁶

Në rushdijen e Gjilanit, sipas shehâdetnâmesë së Hasan Islam ef. Masuricës, të lëshuar në vitin 1883 dhe të vërtetuar nga 12 mësues dhe anëtarë të komisionit, vërejmë se vlerësimi i nxënësve mbështetej në shkallëzimin pesë shifra, nga gjashtë (6) deri në dhjetë (10) dhe se mësoheshin këto lëndë:

Gjuhë arabe - 10, Gjuha perse- 9, Histori-9, Matematikë-7, Gjeometri-9, Algoritme -8, Gjeografi-9, Shkrim rik'a-10, Drejtshkrim-9.⁵⁷

Ndërkaq, sipas *shehâdetnâmesë* së Ibrahim Osman-Kolçit nga Gjakova, të lëshuar në vitin 1909 vërejmë se rushdija e Gjakovës asokohe kishte një program më të gjerë mësimesh dhe me një personel më të plotësuar. Lëndët mësimore në rushdijen e Gjakovës kanë një diferencë të dukshme nga ajo e Gjilanit, sepse në atë të Gjilanit kishte mësim më të pakta, të kufizuara në pak lëndë, kurse në atë të Gjakovës punohej në bazë të programit të vënë për shkollat rushdije në nivel qendror të kohës. Vlerësimi i nxënësit në këtë shehâdetnâme

⁵⁵ Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu ...*, po aty, f. 30.

⁵⁶ Hysni Myzyri, *Arsimi kombëtar shqiptar (1908-1912)*, Prishtinë 1996, f. 216.

⁵⁷ Kadrush Sylejmani, *Hasan Masurica - hoxhë e inovator*, Prishtinë, 1993, f. 17-18.

është bërë më shkallëzimin: *shumë mirë, mesëm, mirë* dhe *mjaftueshëm* dhe me shifra nga gjashtë (6) deri në dhjetë (10):

Kurani me texhvid -9, Shkencat fetare -10, Etikë-10, Sintaksë dhe gramatikë osmane -6, Ortografi-9, Drejtshkrim dhe lexim-10, Gjuhë arabe-9, Gjuhë perse-6, Agronomi -10, Matematikë-6, Gjeometri-6, Gjeografi-9, Histori-10, Higjiennë/mbrojtje e shëndetit-10, Vizatim-i panotuar, Kaligrafi-9⁵⁸.

Të njëjtat lëndë si në rushdijen e Gjakovës në vitin 1909 mësoheshin edhe në rushdijet e tjera të Kosovës.

Ish-nxënësit, iniciatorë për hapjen e shkollave shqipe

Duke e përmbyllur këtë pjesë të shqyrtimit, mund të konstatojmë se themelimi i shkollave të mesme të ulëta (rushdijeve) në Kosovë paraqet fillimin e një periudhe të re të zhvillimit të arsimit dhe edukimit të popullsisë së saj.

Në këto shkolla, në kushtet e atëhershme të vendit tonë, u përgatit një plejadë e tërë intelektualësh të fushave të ndryshme, të cilët, pas shkollimit të tyre, treguan përgatitje të mjaftueshme për të ndjekur studimet larta në çdo shkollë tjetër jashtë vendit tonë; disa do të vazhdonin shkollimin e tyre në idâdijet dhe medresetë e Vilajetit të Kosovës dhe në Stamboll dhe në shkollat dâruimuallimîn të Shkupit, Prishtinës dhe Prizrenit, po edhe në Normalen e Elbasanit, në të cilën, për-

⁵⁸ Diploma mbi kryerjen e shkollës rushdije në Gjakovë nga Ibrahim Osmani-Kolçi. Arkivi i Kosovës, *Koleksioni i Ibrahim Kolçit* (dorëshkrim), kutia nr.1.

gjatë vitit të parë shkollor të saj, ishin regjistruar 50 nxënës nga Kosova (nga Prishtina, Prizreni, Peja, Gjakova, Mitrovica, Vushtrria dhe Shkupi)⁵⁹ dhe ndonëse ata kishin ndjekur shkolla në gjuhë të huaja (rushdije dhe idâdije), ata dinin në përgjithësi të shkruanin e të lexonin shqip, të cilën ata e kishin mësuar zakonisht fshehurazi.⁶⁰

Nga këto shkolla dolën kuadro të shquara, të cilat krahas profesionit të tyre primar, luajtën rol të rëndësishëm në aspektin e emancipimit dhe ngritjes së vetëdijes kombëtare. Shumë studentë të rushdijeve më vonë do t'i gjejmë si studentë në gjimnaze (idâdije), e më pastaj si mësues dhe iniciatorë për hapjen e shkollave shqipe gjithandej Kosovës.⁶¹ Nga ai numër i madh i nxënësve që kanë mbaruar shkollat rushdije në Kosovë, për të vazhduar studimet në shkolla të tjera, e që më pastaj janë shquar dhe kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, në hapjen e shkollave shqipe dhe në veprimtarinë arsimore, veçohen: Hasan Prishtina⁶², Hoxhë Kadri Prishtina⁶³, Qamil Bala⁶⁴,

⁵⁹ "Dielli", nr. 60, Boston, 20 maj 1910, f. 4; Hysni Myzyri, *Arsimi...*, vep.cit, f. 225.

⁶⁰ Hysni Myzyri, *Arsimi...*, po aty, 229.

⁶¹ Në leksikonin "Emra që nuk harrohen (arsimtarët veteranë 1941-1951 dhe arsimi shqip në Kosovë)", vëll. I-II, Prishtinë 1994 dhe 1996, të autorit Tahir Z. Berisha, kanë zënë vend edhe dhjetëra mësues të cilët kishin mbaruar shkollat rushdije, idâdije ose dâru muallimîn.

⁶² *Hasan Prishtina* (u lind në Vushtrri, më 27 shtator 1873 - u vra në Selanik më 14 gusht 1933). Deputet, aktivist, patriot e demokrat revolucionar i shquar që luftoi për lirinë e pavarësinë e atdheut, për demokratizimin e jetës së vendit, për çlirimin e Kosovës nga zgjedha serbomadhe dhe bashkimin e saj me shtetin shqiptar. Mësimet e para (mejtëpin) dhe rushdijen i mbaroi në Vushtrri, me sukses të shkëlqyeshëm. Shkollimin e vazhdoi në gjimnazin

grek të Selanikut ku do ta mësonte edhe gjuhën frënge e do të njihej me veprat e iluministëve francezë. Shkoi në Stamboll, ku u diplomua në Fakultetin e Drejtësisë, përkatësisht në Fakultetin e Shkencave Politike - Juridike. Dha, përveç tjerash, një kontribut të madh për arsimin kombëtar. Me theks të veçantë në hapjen e shkollave shqipe, si dhe në hapjen e Shkollës Normale të Elbasanit më 1909, ku do të dërgonte djem nga Kosova e Dibra. Tahir Avdyli, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare Demokratike Shqiptare (1908-1933)*, Prishtinë, 2003.

⁶³ *Kadri Prishtina* (1878-1925). Një nga figurat më të shquara kombëtare, klerik, dijetar, atdhetar, politikan, diplomat, publicist dhe jurist. Themelues dhe udhëheqës i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës. Shkollën ibtidaije e kreu në Prishtinë, ku kreu edhe shkollën rushdije. Ndërsa gjimnazin idadije e kreu në Shkup. Studimet i vazhdoi në Stamboll, në shkollën e quajtur “Dâr-ut-Tedrîs”, që ishte Shkollë e Lartë Pedagogjike. Atëherë, menjëherë, u regjistrua në Medresenë e famshme “Fatih”, ku edhe aty diplomoi me rezultat të shkëlqyeshëm. Eqber Skëndi, *Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina)*, Prishtinë, 1992, f. 10-12; Qemajl Morina, *Hoxhë Kadri Prishtina-mendimtar islam*, Prishtinë, 2000, f. 8-9.

⁶⁴ *Qamil Bala* (1878-1933), Veprimtar i Lëvizjes Kombëtare dhe i arsimit shqip. Lindi në Gjilan. Mektebin ibtidai dhe shkollën rushdije i kreu në Prishtinë, shkollën idadije (gjimnazin) në Manastir, ndërsa shkollën e lartë normale në Stamboll. Punoi në shkollën turke në Gjilan, ku nxënësve ua mësonte fshehurazi edhe gjuhën shqipe. Për këtë arsye u përdoq nga pushteti osman dhe u detyrua ta lëshoj vendlindjen. Që nga viti 1900 ishte profesor në gjimnazet (idadijet) në Janinë, Manastir dhe në Selanik. Ishte drejtor i gjimnazit në Jerusalem, kurse më 18 gusht 1909, mori mendimin (lajmin) se ishte emëruar drejtor i Normales së Elbasanit, por nuk arriti ta merrte detyrën sepse xhonturqit e ndaluan në Selanik dhe nuk e lejuan të shkonte në Elbasan. Ishte drejtor i përgjithshëm i arsimit në Bagdad, inspektor i përgjithshëm i arsimit në Damask. Në Shqipëri kthehet më 1920, ku kreu disa funksione; ishte mësues, pastaj inspektor i arsimit për qarkun Elbasanit, anëtar i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, deputet i Kosovës në Parlamentin Shqiptar, pjesëmarrës në Kongresin arsimor të Tiranës, drejtor i Medresesë së Lartë në Tiranë etj. Më gjerësisht, Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit...*, po aty, f. 368-369; *Fjalor enciklopedik shqiptar*, vëll. I, Tiranë, 2008, f. 159-160.

Ibrahim Kolçi⁶⁵, Ibrahim Fehmiu⁶⁶, Jonus Blakçori⁶⁷, Selim Drejta, Haxhi Ymer Lutfi Paçarizi, Hysen Statovci⁶⁸, Ahmet Mustafa⁶⁹ etj.

⁶⁵ *Ibrahim Kolçi* u lind në Gjakovë më 1888. Shkollën fillore mektebin ibtidâi e kreu në Gjakovë më 1905. Më pas regjistrohet në shkollën rushdije të Gjakovës, të cilën e mbaroi më sukses të shkëlqyeshëm më 1908. E regjistroi shkollën Normale të Shkupit (Dâruimuallimîn) të cilën e përfundoi më 1910. Kontaktet e shpeshta me Bajram Currin dhe me patriotët të tjerë si me Niman Ferizin, Sali Morinën, Ferid Imamin, Sali Kolgecin, Iljaz Prishtinën, Ibrahim Fehmiun, Ahmet Gashin, Riza Spahiun etj., bënë që edhe I. Kolçi të inkuadrohej në Lëvizjen gjithëshqiptare për shkollën dhe arsimin shqip. Më 1911-1912 e gjejmë mësues në Kala të Dodës, më 1914 në Krumë, pastaj në Pejë, Gjakovë. Pas ripushtimit të Kosovës nga Mbretërisë SKS, I. Kolçi e lëshon Kosovën dhe kalon në Shqipëri. Më 1921-1922 ishte mësues në shkollën e Kryqit të Kuq Amerikan të drejtuar nga Hary Fultz. Midis periudhës 1911-1950, I. Kolçi do të jetë mësues në më se njëzet shkolla të ndryshme në Kosovë dhe Shqipëri, nga Veriu e deri në Himarë. Vdiq më 7 nëntor 1960 në vendlindjen e tij Gjakovë. Shih: *Arkivi i Kosovës, Fondi: Ibrahim Kolçi, kutia. Nr. 1*; Abdullah Vokri, *Mësues në Kosovë e në Shqipëri (personalitete të shquara të arsimit tonë kombëtar)*, Prishtinë, 2008, f. 125-136.

⁶⁶ *Ibrahim Fehmiu* (1892-1951). Mësues dhe veprimtar i arsimit kombëtar. Lindi në Gjakovë ku kreu shkollën fillore (ibtidâije) dhe atë rushdije. Pas kryerjes së idadijes në Shkup, u kthye në vendlindje, ku filloi t'u mësonte fshehtas të rinjve shqiptarë lexim e shkrim shqip. Punoi si kryemësues në Gjakovë dhe bëri përpjekje për hapjen e shkollave shqipe në Junik, Voksh e Rëznik. Pas ripushtimit të Kosovës nga trupat serbo-malazeze (dhjetor 1918), u detyrua të largohej nga Gjakova për të punuar si mësues në Tropojë, Kavajë, Krujë e Krumë (drejtor i internatit "Kosova"). Pas kthimit në Gjakovë, autoritetet jugosllave e internuan në Valevë. Në vitet e Luftës II Botërore punoi mësues në shkollat ë Burrelit e Shkodrës, inspektor i arsimit dhe mësues në gjimnazin e Prizrenit (1941-1948). Më 1948, autoritetet jugosllave e burgosën për shkaqe politike. Pas daljes nga burgu vazhdoi punën në shkollën fillore "Bajram Curri" në Prizren, ku pas një viti vdiq. Shih: *Fjalori enciklopedik shqiptar*, vëll. I, Tiranë, 2008, f. 655; Abdullah Vokri, *Mësues në Kosovë e në Shqipëri...*, vep. cit., f. 113-123.

⁶⁷ *Jonus Blakçori* u lind në Brojë të Drenicës më 15 maj 1895. Mektebin ibtid-
 âi me sukses të shkëlqyeshëm e kreu në Pejë. Po në Pejë me sukses të plotë
 mbaroi edhe shkollën rushdije. Më pastaj u regjistrua në idâdijen e Shkupit.
 Ku qëndroi vetëm dy vjet, të cilat patën një rëndësi të madhe në formimin
 dhe edukimin e tij patriotik. Me t'u hapur Shkolla Normale e Elbasanit, lar-
 gohet nga Shkupi dhe regjistrohet atje. Pas mbylljes së Normales së Elbasa-
 nit nga xhonturqit, sërish kthehet në Shkup për të vazhduar idâdijen deri më
 1912. Më pas mbaron edhe Normalen e Elbasanit. Ishte pjesëmarrës aktiv
 në Lëvizjen Patriotike atdhetare të rinisë shkollore. Mësues në shumë mje-
 disë shqiptare, qoftë në Shqipëri, qoftë në Kosovë. Abdullah Vokrri, *Më-
 sues në Kosovë e në Shqipëri...*, vep. cit., f. 145-152; Iljaz Gogaj, *Punëtorë
 të shquar të shkollës shqipe*, Tiranë, 2001, f. 185-193.

⁶⁸ *Hysen S. Statovci* u lind në Batllavë të Podujevës më 1897, kurse vdiq në
 Prishtinë më 6.10.1982. Poet, mësues e patriot, i cili angazhimin e vet ko-
 mbëtar e zhvilloi me veprimtari konkrete në arsim, në poezi e në fushën po-
 litike, përherë i përndjekur nga regjimet jugosllave antishqiptare, diti të
 luftojë edhe me armë në dorë. Kreu mejtepin dhe rushdijen në Prishtinë.
 Nga 1 shkurti 1919 deri më 30 dhjetor 1920 veproi ilegalisht si mësues i fëm-
 mijëve shqiptar në fshatin e tij të lindjes. Vetë i vazhdoi studimet në Me-
 dresenë "Pirinazir" të Prishtinës tek myderrizi e patrioti Faik ef. Maloku. Si
 nxënës i dalluar, u ndalë në medrese për t'u dhënë mësim klasave të ulëta.
 Mirëpo meqë Medreseja e Prishtinës, si vatër e përhapjes së arsimit shqip,
 ra në sy të pushtetit serb dhe nën presionin e madh që u zhvillua ndaj saj
 nga ky pushtet, u mbyll. Më 1927 e rifilloi punën në Podujevë, me drejtor
 Faik efendiun dhe mësimdhënësin Hysen Statovcin. Ka dhënë mësim feje në
 shkollën fillore shtetërore në Podujevë. Në vitin 1930 për herë të parë në
 kuadër të pushtetit serb, mbajti predikimin e parë në gjuhën shqipe në xha-
 mi. Gjatë viteve 1941-1944 u angazhua për hapjen e shkollave shqipe në ra-
 jonin e Podujevës. Pas luftës udhëhoqi kurset kundër analfabetizmit për të
 rriturit në Prishtinë dhe u angazhua për hapjen e shkollave shqipe dhe sigu-
 rimin dhe shkollimin e kuadrove për shkolla. Është autor i shumë poezive
 në gjuhën shqipe. Vjersha "Oj Kosovë, o kofsh beku", u këndua si himn në
 vijën e frontit të mbrojtjes kombëtare dhe vetë i priu njësitit "Llapi" me dy-
 qind luftëtarë në mbrojtje e vendit nga çetnikët. Në vitin 1943, si delegat i
 Llapit, mori pjesë në Kongresin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit.
 Tahir. Z. Berisha, *Emra që nuk harrohen...*, vëll. II, vep.cit., Prishtinë,
 1996, f. 439-440.; Abdullah R. Vokrri, *Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndër-
 mjet dy luftërave botërore (1918-1941)*, Prishtinë, 1990, f. 78-82.

Mësimi i gjuhëve të huaja të Perëndimit e të Lindjes, në këto shkolla, kanë shërbyer si mjete studimi, komunikimi e kontakti kulturor me vendet të ndryshme dhe si mundësi për të vazhduar me lehtësi studimet e larta në këto gjuhë dhe si mundësi e njohjes me kulturat e popujve që flisnin këto gjuhë.

Këto shkolla krijuan një profil të moderuar të intelektualëve shqiptarë me orientim kah Evropa dhe idetë e saj.

Mësuesit në rushdije kryesisht kanë qenë vendës dhe me përgatitje përkatëse profesionale që kishin mbaruar studimet në Stamboll dhe në vend, siç ishte p.sh. mësuesi i parë i rushdijes së Prishtinës *Sabit "Numan" efendiu*, që ishte edhe myderriz shumëvjeçar në Medresenë "*Pirinazir*" të Prishtinës⁷⁰, *Rexhep Remzi efendiu*⁷¹ etj.

⁶⁹ *Ahmet Mustafa* (1880-1990) u lind në Mitrovicë. Mejtepin dhe rushdijen i kreu në Mitrovicë, kurse shkollën normale (Dârulmuallimîn) në Shkup. Së bashku me veteranin e arsimit shqiptar, Ferid Bajramin, hapën shkollën shqipe në Mitrovicë. Në kohën midis dy luftërave botërore ishte mësues feje në shkollat shtetërore në gjuhën serbe, por Ahmet ef. nxënësve shqiptarë ua mësonte fshehtas edhe shqipen dhe u shpërndante fshehtas abetare e libra që silleshin ilegalisht nga Shqipëria. Në vitet 1941-1944 ishte inspektor i shkollave shqipe dhe u angazhua shumë për hapjen e shkollave shqipe. Edhe pas luftës u angazhua për organizimin e arsimit shqip dhe një kohë ishte drejtor i shkollës fillore shqipe e mandej edhe kryetar i Kuvendit të Qytetit të Mitrovicës. Më 1948 doli në pension, e kur në vitet 1950 filluan të hapeshin shkollat në gjuhën turke organet e pushtetit bënë presion që të punonte në shkollat turke, por nuk pranoi. Ndërkaq kur u hap Medreseja e Ulët Shqiptare në Prishtinë, dy vjet ishte drejtor i saj dhe u angazhua për hartimin dhe sigurimin e teksteve mësimore për këtë shkollë. Tahir. Z. Berisha, *Emra që nuk harrohen...*, vëll. I, po aty, f. 376-377.

⁷⁰ Sadik Mehmeti, *Medreseja "Pirinaz" në Prishtinë dhe aktiviteti i saj 1935-1945*, në "Buletini" i Fakultetit të Studimeve Islame-Prishtinë, nr. 2, Prishtinë 2012, f. 255-277.

⁷¹ *Rexhep Remzi efendiu (Abdullahu)* ka qenë mësues shumëvjeçar në rushdijen e Vushtrisë, kurse nga viti 1936-1940 ka qenë profesor i gjuhës arabe

Krahas themelimit të rushdijeve në Kosovë, me financimin e shtetit dhe me të hyra të tjera të brendshme, qenë ndërtuar edhe godinat, që i plotësonin kushtet për shkolla të tilla.

Por pavarësisht se rushdijet ishin të vendosura në objekte cilësore sa i përket anës arkitektonike (ku vërehet qartë depërtimi dhe ndikimi i arkitekturës evropiane perëndimore), sot ekziston vetëm godina e rushdijes së Prishtinës dhe është në gjendje të mirë.⁷² Pas vitit 1912 godinat e rushdijeve të Kosovës kanë ndryshuar destinimin, ose kanë shërbyer si shkolla fillore (Mitrovicë), ose shkolla të mesme (Prishtinë, Gjilan) ose spitale (Prizren, Prishtinë) dhe, përveç asaj të Prishtinës, më pastaj janë shkatërruar nga plane të ndryshme urbanistike.

në Medresenë e reformuar “Gazi Isa Begu” në Shkup, pastaj nga viti 1942-1945 kryemyfti i Kryemyftinisë së Prishtinës, ithtar, përkrahës dhe bashkëpunëtor i ngushtë i rilindësit dibran Said Najdenit dhe Hasan Prishtinës, kurse më pas edhe i Ferat Bej Dragës dhe Sheh Mehmet Sezait të Prishtinës. Ka qenë nervi mendor i Organizatës Politike Kombëtare shqiptare “Xhemijeti”, në vitet 1919-1925 dhe veprimtar i Komitetit të Kosovës para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Është autor i disa artikujve të botuar në revistën sarajevase “Glasnik” midis viteve 1935-1940.

⁷² Ndodhet në afërsi të xhamisë “Sulltan Fatih” ose “Xhamisë së Madhe”. Sot në të punon Shkolla e Mesme Teknike e Prishtinës. Nga viti 2008-2010 aty ka qenë i vendosur edhe Arkivi i Qytetit të Prishtinës.

Islam HASANI

KONTRATAT HIBRID NË SISTEMIN FINANCIAR ISLAM

Hyrje

Zhvillimi i hovshëm i industrisë së bankimit dhe financave islame nga dita në ditë duhet të ofrojë produkte dhe shërbime konkurruese, në mënyrë që t'i përgjigjen kërkesave të biznesit dhe të tregtisë. Tani që jetojmë në kohën e transaksioneve elektronike, kërkohet edhe me shumë risi dhe produkte bashkëkohore. Kjo nënkupton se kontratat e tanishme janë më të komplikuar sesa ato të mëhershmet, dhe lënë të kuptohet se me rritjen e numrit të produkteve të reja dhe shërbimeve bashkëkohore do të përdoren më shumë se një kontratë në një transaksion të vetëm. Disa hulumtues të kësaj fushe kanë ekzaminuar konceptin e kontratave hibrid (të kombinuara) në sistemin financiar islam, dhe aplikimin e tyre për zhvillim të produkteve të bankimit islam. Prandaj, nevoja për studimin e kësaj teme është më se e nevojshme, si nga këndi sheriatik, ashtu edhe nga ai ekonomik, që produktet të cilat zhvillohen t'i plotësojnë kriteret e kërkuara nga aspekti i she-

riatit, dhe në të njëjtën kohe të jenë konkurrencte nga aspekti ekonomik dhe financiar.

Ky studim fokusohet në diskutimin e parametrave sheriatikë në kontratat hibrid-të kombinuara, me qëllim të përdorimit të tyre në një transaksion të vetëm, gjithmonë nga këndvështrimi i jurisprudencës islame. Gjithashtu, këtu diskutohet edhe të kuptuarit e kontratave të ndaluara, të cilat edhe bien ndesh me ligjin mbi transaksionet. Dihet se baza e muamelatit (jurisprudenca mbi transaksionet) është se çdo gjë është e lejuar, përderisa nuk gjendet një evidence apo dëshmi që tregon se ajo është e ndaluar, apo nuk ekziston ndonjë element që e bën të ndaluar. Nga ky parim, të gjitha transaksionet janë të lejuara, përderisa nuk gjendet ndonjë element që e bën të ndaluar, dhe si duhet të hulumtohet nëse gjendet ndonjë element i tillë. Mirëpo, kontrata hibrid është një çështje kontroverse, deri në njëfarë shkalle, për shkak se ekziston një hadith që i ndalon “dy kontrata në një kontratë”. Dhe interpretimi joadekuat i këtij hadithi potencialisht mund të çojë në ndalimin e zhvillimit të kontratave që kanë për bazë kombinimin e kontratave në përgjithësi, pa bërë dallim për nga natyra dhe veçoritë e këtyre kontratave.

Zhvillimi historik i kontratave në ligjin komercial islam

Gjatë kohës së Pejgamberit, a.s., dhe shokëve të tij, për çdo transaksion është përdorur vetëm një kontratë. Ekzistojnë raste të shumta të përmendura gjatë historisë që dëshmojnë ekzistimin e koncepteve të ndryshme të financimit e të cilat janë pajisur me kontrata, pra në konceptin e tregtisë,

partneritetit, qiradhënies etj. Po ashtu ekzistojnë edhe evidencat e shumta në burimet e sheriatit, dhe nuk ka nevojë për ndonjë interpretim rreth tyre.

Që nga shekulli i 19-të juristët myslimanë kanë filluar të merren me zhvillimin e kontratave të kësaj natyre, duke pasur për qëllim plotësimin e kushteve për të dy palët kontraktuese, si dhe kërkesat e një tregu global.

Në ditët e sotshme, në kohën e zhvillimit teknologjik e me një infrastrukturë moderne dhe komplekse, si dhe në kohën e zhvillimit të nevojave të shumta të njerëzve, kontratat në *muamelat* kërkojnë kombinimin e disa kontratave të bashkuara në një transaksion të vetëm, në mënyrë që të plotësuar dhe të lehtësohen kërkesat e tregut. Ky kombinim i kontratave, të njohura si kontrata hibrid, është diskutuar prej shumë dijetarëve dhe ekonomistëve bashkëkohorë nga vende dhe institucione të ndryshme¹.

Definimi dhe urtësia e kontratave hibrid

Në literaturën klasike të *Fikhut* nuk ka ndonjë definicion konkret në lidhje me kombinimin e kontratave. Mirëpo, është e qartë se termi *kontrata hibrid* ka për qëllim bashkimin e dy apo më shumë kontratave në një transaksion të vetëm. Pra, është një marrëveshje në mes të dy palëve, për të ndërmarrë një transaksion të specifikuar, i cili në përbërje ka dy apo më

¹ Muhammad Iman Sastra Mihajat, "Hybrid Contract in Islamic Banking and Finance: A Proposed Shari'ah Principles and Parameters for Product Development". *EJBM-Special Issue: Islamic Management Business*. Vol. 2, No. 2 (Special Issue) 2014.

shumë kontrata. Për shembull, kombinimi i kontratës së shitjes me atë të qirasë-qiramarrje me qëllim të blerjes në fund të periudhës së qirasë, e të ngjashme. Kështu që, të gjitha pasojat ligjore nga kombinimi i kontratave, me të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ato konsiderohen si një entitet i vetëm që nuk mund të ndahet. Domethënë, në fillim të marrëveshjes janë pajtuar për disa marrëveshje (dy e me shumë) në një transaksion të vetëm, e që ato kontrata e plotësojnë njëra-tjetrën, dhe që janë të kushtëzuara dhe nuk mund të ndahen.

Sipas AAOIFI² (standardi 25/2008), kontrata hibrid është kombinimi i kontratave si “një proces i cili bëhet në mes të dy apo më shumë palëve, dhe sjell përfundime të njëkohshme të më shumë se një kontrate. Kombinimi i kontratave mund të bëhet në disa lloje:

- I. Të kombinuarit e më shumë se një kontrate, duke mos imponuar ndonjë kushtëzim në palën tjetër, dhe pa ndonjë marrëveshje paraprake për të vepruar ashtu;
- II. Të kombinuarit e më shumë se një kontrate, duke imponuar disa kushtëzime në palën tjetër, pa ndonjë marrëveshje paraprake për të vepruar ashtu;

² AAOIFI (Accounting and Auditing Organization for Islamic Financial Institutions) Organizata për Kontabilitet dhe Auditim të Institucioneve Financiare Islame, është e themeluar në vitin 1990, për të promovuar dhe rregulluar standarde të bazuara në shariat, e të cilat rregullojnë aspektin e kontabilitetit, etikës, qeverisjes, investimit dhe transaksioneve për Institucionet Financiare Islame. Para se të aprovohet një produkt apo shërbim i ri, duhet marrë aprovimin nga kjo organizatë.

- III. Të kombinuarit e më shumë se një kontrate, të kush-tëzuar me një marrëveshje paraprake, mirëpo pa im-ponuar asgjë nga ajo marrëveshje si kushte për palën tjetër; dhe
- IV. Të pajtuarit për ta përmbyllur marrëveshjen përmes njërit nga modelet e kontraktimit, ashtu siç do të ve-ndoset në të ardhmen.”

Urtësia për të pasur bashkim të kontratave, nga perspek-tiva e Fikhut, është nga nevoja për t’u larguar nga transaksi-onet që bartin kamatë, për shembull, te kombinimi i shitjes së bashku me këmbimin e valutave të huaja, për të eliminuar transaksion kamatar, si dhe për të plotësuar kërkesën ekono-mike, apo edhe për të plotësuar ndonjë aktivitet ekonomik. Apo, për shembull, shitja e valutës euro së bashku me një produkt në dollar amerikan me pagesë të vonuar.

Një shembull tjetër mund të jetë edhe shitja e dy shtëpive nga shitësi te blerësi përmes dy kontratave. Pra, shtëpia e pa-rë është përmes kontratës së shitblerjes, kurse shtëpia e dytë përmes kontratës së Ixharah (qiradhënie që përfundon me blerje). Këtu janë kombinuar shitje dhe qiradhënie në të njëj-tën kohë. Në këtë rast nuk ka ndonjë kushtëzim të përfitimit nga situata, por ka lehtësim për të dy palët, dhe kontratat plotësojnë njëra-tjetrën në mënyrë progresive.³

³ Saiful Azhar Rosly, *Critical Issues on Islamic Banking and Financial Mar-kets: Islamic Economics, Banking & Finance, Investments, Takaful and Fi-nancial Planning* (Kuala Lumpur: DINAMAS, 2005) f. 313.

Kombinimi i kontratave dallon nga lidhja e një kontrate që imponon një kontratë tjetër e cila është e ndryshme nga e para dhe që nuk ndihmon në plotësimin e të parës, por që kushtëzon diçka tjetër për të përfitur njëra palë, e cila gjë është e ndaluar sipas ligjit islam, dhe njihet si ‘bej’atejn fi bej’ah’. Një shembull tipik i kësaj kategorie është “ta shes ty shtëpinë time për 100,000 euro me pagesë të shtyre (apo veresi, siç njihet në vendin tonë), me kusht që ti ta blesh veturën time për 80,000 euro”, ose kur blerësi i shtëpisë kushtëzohet të shesë diçka me një çmim të caktuar, gjë që e bën shitësin e shtëpisë të përfitojë nga situata, për shkak se ka mundësi të pritjes për pagesë.

Llojet e kontratave hibrid në aplikimin bashkëkohor të bankimit islam

Kontratat hibrid të rekomanduara

Aktualisht në praktikën e bankave dhe institucioneve financiare islame ekzistojnë shumë lloje të kontratave hibrid. Një shembull shumë i njohur dhe shumë i përdorur nga bankat islame në ditët e sotshme është edhe *Musharakah Mutenakisah*, që në përkthim do të thotë “Partneritet me Zvogëlim”, për shembull, pronësie.

Musharaka Mutenakisah është një formë e partneritetit e cila është zhvilluar në vitet e fundit për t’iu përshtatur produkteve bankare, dhe kryesisht përdoret për financim të patundshmërive. Sipas këtij koncepti, financuesi/banka dhe klienti së bashku marrin pjesë në pronësi të përbashkët të një pasu-

rie apo pajisjeje, apo të në ndonjë projekti komercial. Ky koncept është partneritet në të cilin banka islame pranon të transferojë gradualisht partnerit tjetër nga pjesa që e ka në pronësi, kështu që pronësia e bankës zvogëlohet, ndërsa pronësia e partnerit tjetër rritet në mënyrë graduale, deri kur personi të bëhet pronar i vetëm i asetit të financiar. Pjesa që i takon financuesit ndahet në numër të njësive, dhe është e qartë se klienti do t'i blejë ato një nga një, dhe kjo duhet të ndodhë për një interval kohor deri kur personi t'i blejë të gjitha njësitë dhe të bëhet pronar i vetëm i pasurisë apo projektit komercial.⁴

Ky partneritet mund të marrë forma të ndryshme, varësi-sht nga transaksionet, por, në vijim do të merret vetëm një shembull që ka të bëjë me financim/blerje të patundshmërive, sa për ilustrim të konceptit.

Përdorimi i këtij modeli për financim të shtëpive/apartamenteve për banim. Klienti dëshiron të blejë një apartament për të cilën nuk ka para të mjaftueshme. Ai kërkon mbështetje financiare nga banka, e pasi e banka kupton kërkesën e tij, i sugjeron që të bëhen partnerë në financimin e shtëpisë. Partneriteti do të jetë në këtë mënyrë: për shembull, një apartament mesatar në Prishtinë kushton 50,000 euro. Klienti ka mundësi participimi vetëm 10,000 euro, kurse banka duhet ta plotësojë shumën tjetër, në vlerë të 40,000 eurove. Të dy partnerët (banka dhe klienti) formojnë një fond të përbashkët, i

⁴ Abdulkader Thomas, "Real Estate", *Structuring Islamic Finance Transactions*, eds. Abdulkader Thomas, Stella Cox & Bryan Kraty, (London: Euromoney Books, 2005) f.129

cili është i nevojshëm për ta arritur vlerën për blerjen e apartamentit. Partneriteti mes tyre, sipas participimit në blerje të apartamentit, është 80% me 20% në favor të bankës, dhe në të njëjtën kohë, sipas marrëveshjes, klientit i mundësohet që ta blejë përqindjen tjetër nga banka në mënyrë graduale. Mirëpo, përderisa të blejë përqindjen që gjendet në pronësi të bankës klienti duhet të paguajë qira për shfrytëzimin e apartamentit për përqindjen që është në pronësi të bankës. Për shembull: nëse qiraja mesatare mujore për një apartament të tillë është 300 euro, ai paguan 80% të asaj qiraje, e që i bie 240 euro, ndërsa për 20% (60 euro) nuk paguan qira, sepse për atë pjesë është pronar (pra, për atë përqindje). Ky çmim është në fillim të marrëveshjes, por me kalimin e kohës, kur klienti blen përqindje të pronësisë nga banka, qiraja zvogëlohet. Sipas marrëveshjes, çdo 10% e blerë nga klienti do të thotë 10% e çmimit të qirasë që do të zbritet për klientin. Kështu vazhdohet deri kur të arrihet në fund, kur klienti e bën edhe pagesën e fundit për blerjen e 10% të fundit. Interesi ekonomik për partneret është si në vijim: interesi ekonomik/financiar për bankën është se do të marrë qiranë mujore si fitim për vete deri kur klienti ta blejë pjesën e cila është financuar nga banka sipas vlerës së blerë në fillim. Kurse interesi ekonomik për klientin është se do ta shfrytëzojë apartamentin dhe, në të njëjtën kohë, do t'i mundësohet ta blejë atë apartament në mënyrë të pjesshme dhe në mënyrë graduale, për një interval kohor që është i caktuar nga banka në fillim të marrëveshjes, pa u brengosur për kamata apo ndëshkime të tjera. Gjithashtu, duhet të theksohet se lidhja mes klientit dhe bankës është lidhje partneriteti e jo kredidhënësi

dhe kredimarrësi. Nëse vjen deri te shkëputja e kontratës për arsye solide, atëherë marrëveshje ndërpritet sipas konceptit të partneritetit: apartamenti shitet përmes ankandit apo kanaleve të tjera, dhe çmimi i shitur ndahet në mes të partnerëve, sipas përqindjes që ata kanë në kohën kur shitet apartamenti.

Kjo kontratë në vetvete përbëhet nga disa kontrata në një transaksion, si, për shembull, kontratë për pronësi të përbashkët (banka dhe klienti janë partnerë në pronësi të shtëpisë), kontrate për shitblerje (klienti e blen nga banka përqindjen që nuk e ka në pronësi), kontratë për qiradhënie dhe qiramarrje (klienti paguan qiranë për pjesën që nuk është pronar), si dhe kontratë e transferimit të pronësisë (në momentin e plotësimit të blerjes së përqindjes nga klienti, banka ia kalon klientit pronësinë 100%).⁵

Ekzistojnë edhe lloje të tjera të kontratave të kombinuara, e që janë shumë të nevojshme për plotësimin e transaksioneve dhe lehtësimin e blerjeve online, shitjes, qiradhënies, kursimeve dhe investimeve, mirëpo me kusht që kontratat nuk janë të kundërta diametralisht, por që plotësojnë njëra-tjetrën dhe janë të së njëjtës natyrë, sikurse shembulli që u përmend më lart.

Kontratat hibrid të ndaluara

Në kategorinë e kombinimit të ndaluar janë ato kontrata që janë në kundërshtim nga natyra e tyre, dhe janë diametralisht të kundërta. Në vijim po i përmendim disa shembuj, sa për ilustrim:

⁵ Ibid.

Për shembull, kombinimi i kontratës së shitjes dhe dhënies së një huaje (kredi pa kamatë) në një transaksion. Në rastin e huadhënies pa kamatë, e cila është kushtëzuar që huamarrësi të blejë një produkt nga huadhënësi me çmim më të lartë sesa një çmim i zakonshëm në treg, kjo e bën këtë kontratë të ndaluar, sepse kushtëzimi ka ndodhur për ta plotësuar fitimin e lënë në kredinë që është dashur të jetë pa kamatë. Dhe, është shumë e sigurt që klienti nuk do ta kishte blerë atë produkt me çmimin e ofruar, sikur mos të ishte marrje e kredisë/huasë, dhe në të njëjtën kohë edhe huadhënësi nuk do t'i jepte hua nëse huamarrësi nuk do ta blinte produktin në fjalë me atë çmim të kushtëzuar.

Një shembull tjetër është kombinimi i huazimit me qiradhënien në të njëjtin transaksion, apo edhe kombinimi i huadhënies/huamarrjes me premtimin për shpërblim/dhuratë nga huamarrësi në kohën e kthimit. Sipas shpjegimit të hulumtuesve, këto kontrata janë të ndaluara të kombinohen në një transaksion të vetëm. Sipas këtij argumenti, palët kontraktuese përfitojnë nga shitja, në vend se të përfitojnë nga huaja. Domethënë, kompensojnë në shitje atë që nuk kanë mundur ta fitojnë nga huaja/kredia⁶. Një shembull i kësaj kategorie, kombinimit të shitjes dhe huas/kredisë në një transaksion është edhe kur një person fizik apo juridik i thotë tjetrit “ma huazo një shumë të caktuar për një kohë të caktuar, për shembull, 10,000 euro, dhe unë po e blej nga ti telefonin tënd

⁶ Asyrah Wajdi Dusuki, Commodity Murabahah Programme (CMP): An innovative Approach to Liquidity Management. *Journal of Islamic Economics, Banking and Finance*, Volume 3. No. 1, 2007.

për 1000 euro” e që në realitet vlera e atij telefoni nuk është 1000, por këtu njëra palë dëshiron t’i bëjë palës tjetër një favor për të arritur deri të shuma e synuar. Apo, shembull tjetër: nëse një person kërkon hua, dhe në të njëjtën kohë premtun se në kthim do të paguajë më shumë, në formë dhurate për huadhënësin. Pra, që të dy kontratat, sipas shembujve të marrë më lart, janë të ndaluara, për shkak se premtimi për shpërblim është bërë pjesë e marrëveshjes.

Metoda e kombinimit të disa kontratave në një transaksion duhet të bëhet një karakteristikë e veçantë e sistemit financiar islam në çdo vend të botës edhe për zhvillim të produkteve të reja. Në realitet kjo duket se është bërë një domosdoshmëri për t’iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave në vazhdimësi të njerëzve, për t’i mbështetur aktivitetet ekonomike dhe kërkesat e tyre.

Qëndrimet e dijetarëve në lidhje me kontratat hibrid

Shumica e dijetarëve që të gjitha shkollave të njohura juridike janë të mendimit se kontratat hibrid janë të vlefshme dhe të lejuara në jurisprudencën islame, në aspekt të përgjithshëm, mirëpo duhet gjykuar individualisht përmbajtjen e secilës kontratë. Argumentimi për lejimin e kësaj kontrate bazohet në maksimat ligjore *kawaid fikhij*, ku rregulli i përgjithshëm në lidhje me transaksionet biznesore është lejueshmëria, e që do të thotë se çdo gjë është e lejuar përderisa nuk ekziston ndonjë argument për ta bërë të ndaluar. Prandaj, është e lejuar edhe të kombinohen disa kontrata në një transaksion, me kusht që secila kontratë t’i plotësojë kriteret e le-

jueshmërisë. Përveç nëse kombinimi i dy kontratave çon në kamatë ose diç të ngjashme me të, siç është kombinimi i kontratës së huazimit me kontratën e shitjes në një transaksion, edhe pse këto kontrata, nëse shikohen ndaras, që të dyja janë të lejuara. Ngjashëm me këtë është edhe kombinimi i pagesës me këste mujore për një periudhë kohore të caktuar dhe pagesës me një këst të vetëm në fund të periudhës, nëse këto bashkohen në një transaksion në kontratën e shitjes pa e specifikuar se për cilën janë pajtuar palët atëherë kjo paqartësi e bën kontratën të ndaluar edhe pse që të dyja janë të lejuara nëse palët pajtohen se për cilën janë pajtuar.⁷ Ngjashëm me këtë është edhe *Bej el-inah* (Shitja dhe blerja prapë e të njëjtit mjet/gjësënd) në një transaksion. Ky koncept (shitje dhe blerje prapë i të njëjtit objekt) në fillim është praktikuar nga disa banka islame por është anuluar më vonë. Qëllimi i këtij transaksioni ka qenë që të arrihet deri te paratë kesh (të gatshme); pala që e ka shitur mjetin me pagese të vonuar p.sh me çmim në vlerë prej 1000 euro e ka blerë prapë prej klientit me para kesh dhe për një çmim më të ulët p.sh 900 euro. Pra, klienti i ka marrë paratë e gatshme 900 euro, kurse ka vazhduar të paguajë borxhin me këste, borxh i dalë nga marrëveshja e parë në vlerë 1000 euro. Modeli i *bej el-ineh* është kritikuar, dhe tani është ndaluar së praktikuari, për shkak se të dy kontratat kanë qenë të kushtëzuara në një transaksion, dhe sikur mos të ishte e aranzhuar nga banka blerja prapë e mjetit të kontratës, pala nuk do ta kishte blerë mjetin nga

⁷ Ibid

banka, sepse nuk ka qenë qëllimi i blerjes dhe posedimit. Sipas shpjegimeve të dijetarëve, lejimi i këtyre transaksioneve është një lloj manipulimi për ta legalizuar kamatën, ndërsa në të vërtetë nuk ka ndonjë transaksion real në këtë kontratë, por vetëm plotësim dokumentesh.

Sa për qartësim, nëse kjo ka ndodh pa qenë e kushtëzuar, duke qenë të lira të dy palët, si, për shembull, pasi blerësi ka marrë në posedim mjetin e blerë, ai mund të vendosë nëse dëshiron ta shesë, dhe pala tjetër ta blejë, pa qenë kusht i marrëveshjes, në këtë rast nuk ka ndonjë problem. Kjo mund të ndodhë edhe në jetën e përditshme, kur personat juridikë apo fizikë blejnë me huazim (pagesë të shtyrë-veresi) me një çmim më të lartë, dhe shesin atëherë kur iu duhet, me një çmim më të ulët, si pjesë e strategjisë së tyre për të ardhur deri te paraja e gatshme, mirëpo, në të njëjtën kohë duke u larguar nga marrja e kredive me kamatë. Megjithatë, në asnjë mënyrë nuk duhet të këtë marrëveshje me shitësin (bankën) për ta blerë të njëjtin mjet pa e lëvizur nga vendi objektin e shitjes, pra vetëm duke plotësuar dhe nënshkruar dokumente pa e parë fare mjetin e tregtuar.

Parametrat ligjorë për lejimin e kontratave të kombinuara

Ligjshmëria e kontratave të kombinuara për qëllim të instrumenteve dhe produkteve të bankimit dhe financave islame duhet të formohet në atë mënyrë që nuk bie në kundërshtim me principet bazë të shariatit. Me fjalë të tjera, një produkt i strukturuar në modelin e kontratave hibrid nuk ka për qëllim të legalizojë një transaksion të ndaluar, siç janë kamata dhe

bixhozi. Parametrat sheriatikë, apo kufizimet sheriatike, janë aplikuar edhe nga Institucioni Ndërkombëtar për Standarde, siç është AAOIFI, duke bërë kufizime në produkte dhe shërbime, për t'i bërë të vlefshme kontratat hibrid. Sipas këtyre standardeve, të gjitha marrëveshjet që kanë për bazë kontratat hibrid janë të lejuara, duke u siguruar se secila kontratë është e lejuar në vetvete, përveç kombinimit të kontratës së shitjes me kontratën e huadhënies (kredidhënies) në një transaksion. Dhe, ka vendosur kriteret si në vijim:

1. Kombinimi i kontratave nuk mund të përfshijë edhe kontrata që shumë qartë janë të ndaluara sipas sheriatit si, për shembull, kombinimi i kontratës së shitjes me atë të kredi dhënies.
2. Kombinimi i kontratës nuk mund të përdoret si një mashtrim për ta arsyetuar kamatën si, për shembull, shitja dhe blerja prapa e të njëjtit mjet, sikurse në rastin e bej el-inah.⁸
3. Kombinimi i kontratave nuk mund të përdoret si një mjet për kamatë, si, për shembull, kur kredituesi jep para hua në mënyrë që të përfitojë ndonjë dhuratë në fund, apo për përfitime të tjera, siç është akomodimi falas në banesën e tij, etj.

⁸ Te kontrata në të cilën aranzhohet shitja dhe blerja prapa e të njëjtit produkt klienti ka nevojë për para të gatshme, prandaj edhe e blen nga banka një produkt me pagese të vonuar (pagesë me këste), dhe të njëjtin produkt ia shet bankës me para të gatshme, por për një çmim më të lirë. Ky produkt është kritikuar nga shumica e dijetarëve, duke e konsideruar si të paligjshëm.

4. Kombinimi i kontratave nuk duhet të jetë në kundërshtim me esencën e marrëveshjes, si, për shembull, në *kontratën e mudarabas* (partneritetit), nuk mund të garantohet fitimi për njëren palë duke e përdorur *kontratën e hibah* (dhuratës).

Përfundim

Kontratat e biznesit dhe të tregtisë duhet patjetër t'i plotësojnë kriteret e sheriatit, e që do të thotë se duhet të mënjanojnë çështjet e ndaluara dhe duhet të sigurojnë se secila kontratë i përmbush elementet kryesore dhe kushtet e kërkuara. Mendimet e atyre që e lejojnë këtë koncept të kontratave shkojnë nga ajo se është i pranueshëm dhe i nevojshëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të bankimit dhe për të mirën e përgjithshme, por që duhet të plotësohen edhe kriteret që u përmenden më lart. Gjithashtu, rregulli i përgjithshëm në sferën e transaksioneve thotë se çdo gjë është e lejuar, derisa të gjendet një argument që e ndalon. E, ky është një motivim dhe siguri për zhvillim të sistemit financiar. Prandaj, kontratat hibrid rezultojnë të jenë të lejuara, përveç atyre që u përmenden në mënyrë të drejtpërdrejt, ngase kombinimi i tyre në një transaksion të vetëm është më i dëmshëm për njeriun. Dhe, pikërisht për këtë edhe është i ndaluar.

Mr. Elmir KARADŽI (PHDc)

FAMILJA KOSOVARE DHE SFIDAT E JETËS BASHKËKOHORE

Hyrje

Familja është një prej institucioneve më të rëndësishme sociale si dhe një agjensi kryesore e socializimit të individit në kohën e fëmijërisë së tij. për një shoqëri të qëndrueshme, parakushti kryesor është familja e shëndoshë. Një anëtar i ri i shoqërisë, brenda familjes formohet, rritet dhe zhvillohet. Familja siguron socializimin, riprodhimin, edukimin fizik, shpirtëror, emocional dhe mendor, pra nuk është vetëm “një fabrikë që prodhon personalitete njerëzore”, siç thotë sociologu amerikan T. Parsons, por në të përvetësohen edhe njohuri themelore të mirësjelljes, dashurisë, besimit, moralit, etikës, respektit për autoritetin e prindërve, të moshuarit, ruajtjen e farefisnisë dhe vlerave të tjera tradicionale shoqërore. Pra, familja është një “fidanishte e karakterit njerëzor”,¹ siç thotë Charles Cooley, një sociolog tjetër amerikan. Perceptu-

¹ Ali Pajaziti (2009), *Fjalor i sociologjisë*, Logos-A, Shkup, fq. 168.

ar nga ky këndvështrim, ajo është një institucion i pazëvendësueshëm dhe për këtë arsye rëndësia e saj është universale. Por, përballë tendencave globalizuese të modernitetit, individualizmit, pluralizmit dhe të transformimit të intimitetit,² si dhe adaptimit global të formave dhe të filozofive të reja të jetës, parashtrohet sfida e kultivimit dhe e ruajtjes së këtyre modaliteteve tradicionale të ngritura mbi etikën dhe traditën islame. Këto e kanë dalluar me shekuj familjen kosovare, mbi të gjitha solidariteti, homogeniteti dhe primordialiteti moral, përballë sfidave apo alternativave “jo-tradicionale” dhe mjaft kontradiktore, për të cilat do të bëhet fjalë më vonë. Ndryshimet strukturale të shoqërisë moderne kanë tronditur fuqishëm formën tradicionale të familjes në mbarë botën moderne. Familja kosovare në pjesë të madhe është de-traditionalizuar dhe “ka pësuar shndërime të thella, sikurse janë shënuar ndryshime në botëkuptim, në kriteret e vlerësimit të njeriut, të qëllimit të jetës, në kuptimin mbi martesën, lumturinë, mirëqenien etj.”³ Ajo edhe në vetë formën dhe ekonominë e saj ka pësuar ndryshime. Me numrin e anëtarëve është zvogëluar.⁴ Më nuk është ekskluzivisht burri si burim i parë i

² Anthony Giddens (2013), *Pasojat e modernitetit*, Uetpress, Tiranë, fq. 114.

³ Lekë Sokoli (2006), *Analiza sociologjike*, IS&Rinia, Tirana, fq. 7.

⁴ Sipas një hulumtimi, numri mesatar i anëtarëve të familjes kosovare është 5.7 anëtarë. Kjo tregon se familja kosovare ende është e madhe, por për dallim nga e kaluara, mesatarja është në rënie. “Zakonisht familjet konsistojnë nga tre breza, pasi në përgjithësi gjyshërit jetojnë me prindërit dhe fëmijët, duke ndarë përgjegjësinë e rritjes së fëmijëve.” Shih: *Studimi për rininë - Kosovë 2018/2019*, Friedrich-Ebert-Stiftung Kosovo, Prishtinë, 2019., fq. 29-30.

të ardhurave dhe autoriteti i pakontestueshëm. Pastaj, ka humbur edhe në stabilitetin, ngase shkalla e divorceve është për çdo vjet në rritje, ndërsa në martesë hyhet në vitet e tridhjeta ose edhe më vonë. Por, si sfidë kryesore mund të cilësohet “kriteri moral” dhe “kohabitacioni” apo bashkëjetesa pa lidhje martesore. Ky punim nuk synon të kontekstualizoj format tradicionale të familjes kosovare, e as shndërrimet e strukturës së saj apo llojet e ndryshme që janë paraqitur në të kaluarën. Qëllimi i tij është analizimi dhe elaborimi i gjendjes faktike, si dhe zbulimi i disa sfidave të cilat rrezikojnë vlerat tradicionale, me theks të veçantë të vlerave morale. Kjo edhe për faktin se shumë filozofë të kthjelltë alarmojnë për rënien morale të njeriut modern, e që hyn në krizën më të thellë të moralit pas popullit të pejgamberit Lut a.s.. Pra, në këtë vërsulje të ideologjive të ndryshme, familja është e para që goditet, dhe si e tillë, ani pse gëzon një shkallë më të ulët të autonomisë, i kanoset seriozisht rreziku, rrëshqitja morale dhe dezorientimi shoqëror.⁵ Kësaj duhet shtuar edhe faktin se gjysma e popullsisë së Kosovës është nën moshën 25 vjeçare, që e rëndit atë me popullatën më të re në Evropë. Ky fakt detyrimisht imponon nevojën për krijimin e një perspektive ndryshe, për një institucion kaq të rëndësishëm siç është familja, por edhe krijimin e parakushteve ekonomike, sociale, arsimore dhe të tjera. Përndryshe, e ardhmja e shoqërisë kosovare do të jetë shumë e pasigurt.

⁵ Elizabet Rudinesko (2012), *Porodica u rasulu*, Akademska knjiga, Novi Sad.

Kurani për familjen

Kurani për familjen flet në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ai nuk i drejtohet racës, gjinisë, fisit, kastës apo klasës, e as formacioneve moderne shoqërore siç është kombi, por i drejtohet drejtpërsëdrejti familjes: **“O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri...”** (*Et-Tahrim, 6*). Shoqëria kosovare është religjioze dhe çmon lart martesën dhe vlerat familjare dhe morale. Islami inkurajon hyrjen në martesë dhe krijimin e familjes. Ajeti kuranor: **“Dhe martoni të pamar-tuarat (të pamartuarit)...”** (*En-Nur, 32*), tregon qartë se krijimi i familjes është një obligim i përgjithshëm shoqëror. Për nga numri i anëtarëve, familja është grupi më i vogël shoqëror, por për nga rëndësia dhe roli shoqëror është në vendin e parë, për arsye se bashkësia njerëzore përbëhet nga familjet dhe anëtarët e saj.⁶ Në fenë islame, martesë është diçka e shenjtë, e bekuar, në të cilën pjesëtarët e saj arrijnë lumturinë, dashurinë, paqen shpirtërore dhe stabilitetin psikologjik. Madje, ajo paraqet “gjysmën e besimit”⁷ dhe si e tillë është një mekanizëm që përveç që mbron nga promiskuiteti, amoraliteti dhe homoseksualiteti, dukshëm ndihmon edhe në përsosmërinë e njeriut. Këtë gjë e vërteton edhe Kurani: **“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka ar-**

⁶ Ahmet Yaman (2012), *Legjislacioni familjar islam*, Diyanet, Prizren, fq. 3.

⁷ Pejgamberi, a.s., ka thënë: “Kur njeriu martohet, plotëson gjysmën e besimit, kurse për gjysmën tjetër le të ketë frikë Allahut.” (Tirmidhi).

gumente për njerëzit që mendojnë.” (*Er-Rum, 21*). Në vokabularin tonë të përditshëm, termat si “edukimi familjar” dhe “sjellje familjare”⁸ janë shumë të pranishëm, dhe kjo në mënyrë të drejtpërdrejt na tregon se sa familja merr pjesë në formimin e një personaliteti dhe përgatitjen e tij për të jetuar një jetë të dinjitetshme.

Martesa dhe familja - diferencim terminologjik

Nocionet si martesa dhe familja nuk kanë kuptim identik dhe nuk definohet njëjtë në shkencat shoqërore dhe jurispru-dencën islame. Në shkencat shoqërore, martesa nënkupton një lidhje të njohur dhe të lejuar ndërmjet dy të rriturve të gjinisë së kundërt,⁹ ndërsa familja mund të definohet si “një grup shoqëror të cilin e karakterizon bashkëjetesa e përbashkët, bashkëpunimi ekonomik dhe riprodhimi. Ajo përfshinë të rriturit e të dy gjinive, të paktën prej të cilave kanë një marrëdhënie seksuale të pranuar shoqërore, plus një ose më shumë fëmijë, të vet apo të adoptuar.”¹⁰ Në të drejtën islame, martesa përkufizohet si “kontrata e marrëdhënies së lejuar martesore - seksuale ndërmjet mashkullit dhe femrës, si dhe jeta e përbashkët, mirëmbajtja e ekonomisë familjare, rritja e

⁸ Ahmet Yaman (2012), *Legjislacioni familjar islam*, fq. 4.

⁹ Antoni Gidens (2007), *Sociologjia*, Ekonomski fakultet, Beograd, fq. 187.

¹⁰ Haralambos, Holborn (2002), *Sociologjia - teme i perspektive*, Golden marketing, Zagreb, fq. 504.

pasardhësve, krijimi dhe ruajtja e lidhjeve familjare.”¹¹ Nga përkufizimet e cituara mund të vërejmë se koncepti islam i martesës është shumë më i gjerë se ai shoqëror dhe ka më shumë pika prekëse me konceptin shoqëror të familjes.

Sfidat e modernitetit¹² para familjes kosovare

Observimet që pasojnë, në përgjithësi kanë të bëjnë me familjen në botën moderne, dhe në veçanti me jetën familjare të kosovarëve në fillim të shekullit XXI. Në periudhën e pasluftës, që korrespondon me fillimin e mileniumit të tretë, shoqëria kosovare po përballlet me disa fenomene që ishin të panjohura për baballarët dhe gjyshërit tanë. Në fazën e tranzicionit, në të cilën aktualisht po kalojmë, shoqëria kosovare po përballlet me disa situata kaotike të jetës shoqërore (vetë-vrasjet, prostitucioni, dhuna familjare, korrupsioni, krimi i organizuar, nepotizmi).¹³ Përderisa, në shoqërinë tradicionale, agjenci ekskluzive e socializmit ishte familja dhe deri diku shkolla, në shoqërinë (post)moderne hapësirë të madhe kanë

¹¹ Ibrahim Džananović (2004), *Primjena šerijatskog porodičnog prava kroz praksu Vrhovnog šerijatskog suda 1914-1946.*, FIN, Sarajevë, fq. 42.

¹² Moderniteti nënkupton “praktikë shoqërore krejtësisht të ndryshme nga ajo e traditës, që përfaqëson një strukturë shoqërore e cila nuk e organizon jetën sipas ndonjë doktrine të shenjtë. Në këtë kontekst, moderniteti është mënyrë e jetesës specifike perëndimore, e shfaqur në Evropë në periudhën e iluminizmit dhe që më vonë ka ndikuar në tërë botën.” (Ali Pajaziti (2009), *Fjalor i sociologjisë*, fq. 419.).

¹³ Shih: Fadil Maloku (2014), *Paradigma sociologjike e tranzicionit shqiptar*, Logos-A, Shkup.

masmediat dhe mjetet e komunikimit, grupet e bashkëmoshatarëve, vendi i punës dhe institucionet shoqërore, politike, kulturore, fetare etj. Kjo është arsyeja pse ne besojmë se institucioni i familjes kosovare, në periudhën e tranzicionit nëpër të cilin po kalon shoqëria jonë, është i ekspozuar ndaj transformimeve dhe sfidave të mëdha, të cilat na i sjell procesi universal i globalizmit. Nga shumë sfida, veçojmë:

a) Rritje e lehtë e shkallës së divorcit. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, të vitit 2019, janë lidhur 17.577 martesë të reja para autoriteteve kompetente dhe 815 çifte janë shkëputur. I njëjti studim tregon se vitet e para pas martesës janë më kritike për qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e martesës. Ajo që është një lloj satisfakcioni është fakti se numri më i madh (74.5%) i çifteve të shkëputura nuk kanë fëmijë.¹⁴ Megjithatë këto të dhëna për shkallën e divorcit, nuk janë në nivelin e vendeve perëndimore, janë alarmante për rastin e Kosovës, sepse janë vazhdimisht në rritje dhe urgjentisht duhet të hulumtohen shkaqet e divorceve. Martesa lidhet lehtëazi, qiftet janë të papërgatitura për të pranuar detyrat dhe barrën e jetës bashkëshortore, ndërsa nga ajo dilet edhe më shpejt, pa bërë as përpjekjen minimale për ta shpëtuar atë, ashtu

¹⁴ Statistikat e Shkëputjeve 2019, Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/media/5516/shkurezimet-2019.pdf>; Statistikat e Kurorëzimeve 2019, Agjencia e Statistikave të Kosovës, <https://ask.rks-gov.net/media/5495/statistikat-e-kuror%C3%ABzimeve-2019.pdf> (qasur më: 02.11.2020.).

siç na udhëzon Kurani.¹⁵ Nuk është e tepërt që të përmendet se martesat tradicionale të paraardhësve tanë kanë qenë më të qëndrueshme dhe më afatgjata, ndërsa divorci ka qenë thjesht një raritet. Martesat mbijetuan edhe me koston e mungesës së tërheqjes intime, dashurisë ose vuajtjes së dhunës dhe abuzimit. Thjesht, është besuar në shenjtërinë e martesës. Në Islam, divorci është opsioni i fundit që vjen në konsideratë pasi që të jenë shterur të gjitha alternativat e mundshme. Pejgamberi a.s. ka thënë *se “divorci është hallalli më i urryer.”* (Ebu Davudi). Pra, divorci është një “e keqe e domosdoshme” që nuk i sjell mirë askujt dhe fëmijët janë viktimat më të mëdha të tij. Shumë herë është provuar se lë pasoja të rënda në personalitetin, karakterin dhe integrimin e tyre në shoqëri.

b) Shkalla e ulët e natalitetit (lindja e fëmijëve). Tradicionalisht, familja kosovare ka qenë e njohur për përqindjen e lartë të lindjeve. Edhe pse nuk posedojmë të dhëna të sakta empirike, nga përvoja para disa dekadash, është e njohur që një nënë kosovare në jetën e saj kishte lindur deri në dhjetë fëmijë. Nga paslufta e këndej, shoqëria kosovare po përballlet me rënien e vazhdueshme të natalitetit. Të dhënat për vitin 2003 tregojnë se një grua kosovare lind mesatarisht tre fëmijë. Për një dekadë më vonë, qysh në vitin 2014,

¹⁵ “*Nëse i frikësoheni përçarjes mes tyre (burrit dhe gruas), dërgoni një gjykses të drejtë nga familja e tij dhe një gjykses të drejtë nga familja e saj. Nëse ata të dy (ndërmjetësuesit) kanë për qëllim pajtimin, Allahu ju mundëson afrimin mes tyre (burrit e gruas). Allahu është i Gjithëdijshëm, është Njohës i mirë.*” (En-Nisa, 35).

pjellshmëria ka rënë në dy fëmijë për një grua,¹⁶ gjë që është brengosëse, posaçërisht nëse kësaj ia shtojmë edhe problemin e theksuar të kohëve të fundit, atë të emigrimeve masive të popullatës së re kosovare. Rënia e trendit të lindjeve arsyetohet me arsimimin dhe emancipimin e grave, kushteve të vështira ekonomike, planifikimit familjar, ligjin e lehonisë, por edhe me mosekzistimin e politikave për stimulimin e natalitetit nga institucionet shtetërore.¹⁷ Megjithëqë ende nuk jemi të kërcënuar nga murtaja e bardhë, është e domosdoshme që autoritetet përkatëse të marrin masat e duhura, ngase popullsia kosovare nga periudha e pasluftës është në kontinuitet në pakësim dhe plakje.

c) Kujdesi ekskluziv për mirëqenien materiale. Për disa prindër, sigurimi i mirëqenies materiale për fëmijët e tyre është obsesion jetësor. Njëkohësisht, ata kalojnë aq shumë kohë në punë dhe larg fëmijës, saqë pjesën më të madhe të socializimit dhe edukimit, fëmijët e tyre e marrin në shkollë, çerdhe, por edhe nga media dhe rruga. Edhe atëherë kur fëmijët shprehin gatishmërinë për komunikim dhe vëmendje të prindërve, atyre shpesh u thuhet: “Merrni të holla, blini çfarë të doni, më lini të pushojë.” Pëlqimi i materiales në kurriz të potencialit fizik, shpirtëror, moral dhe

¹⁶ *Gratë dhe Burrat në Kosovë, 2014-2015*, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Prishtinë, 2016., <https://ask.rks-gov.net/media/2581/grate-dhe-burrrat-shqip-2014-2015.pdf>, (qasur më: 11.11.2020.).

¹⁷ <https://www.koha.net/arberi/193164/bie-nataliteti-ne-kosove-mbi-30-per-qind/>, (qasur më: 11.11.2020.).

intelektual të fëmijëve, më së miri përshkruhet nga thënia e njohur: “Ka shumë fëmijë të varfër, të cilëve prindërit nuk u kanë dhënë asgjë tjetër përpos parave.”

d) Autoriteti i prindit në sytë e fëmijëve. Ne jetojmë në një kohë të shfuqizimit dhe përmbysjes së çdo lloj autoriteti. Martesa, familja dhe prindërit janë nën sulmin e ideologjive totalitare, ateiste, neoliberale dhe të tjera. Autoriteti i babait në shoqërinë hipermoderne perëndimore është degraduar deri në atë masë, sa që disa filozofë dhe psikoanalistë (J. Lacan, M. Recalcati, E. Rudinesco) pohojnë se jemi duke jetuar një epokë të “babait të avulluar” ose “babait të vrarë”. Ai është aty, fizikisht i pranishëm në familje, por autoriteti i tij është degraduar. Roli i tij është simbolik. Ai është reduktuar në një “babush” që sillet në nivelin e fëmijës. Kjo është arsyeja pse ata me të drejtë pyesin “çfarë ka mbetur nga babai?”¹⁸ dhe parashikojnë që parimi i autoritetit të babait të tillë nuk mund të rehabilitohet.¹⁹

e) Kohabitacioni - bashkëjetesa. Kohabitacioni në kohën bashkëkohore paraqitet si një alternativë apo sfidë për martesën konvencionale, ku partnerët “rrojnë së bashku në marrëdhënie seksuale me njëri-tjetrin pa qenë të martuar.”²⁰ Kjo formë e organizimit të jetës bashkëshortore dikur është konsideruar si sjellje devijante, ndërsa sot me të madhe përhapet në shoqëritë e industrializuara, gjegjësisht

¹⁸ Masimo Rekalkati (2014), *Šta ostaje od oca? Očinstvo u hipermodernom dobu*, Akademska knjiga, Novi Sad, fq. 73.

¹⁹ Elizabet Rudinesco (2012), *Porodica u rasulu*, fq. 106.

²⁰ Anthony Giddens (2007), *Sociologija*, Qabej, Tiranë, fq. 396.

në kulturën e artistëve, sportistëve, biznesmenëve dhe një-rëzve me famë mediale, të cilët parapëlqejnë “lirinë” para martesës, lidhjes me dikë për tërë jetën. Qiftet e tilla, lindjen dhe rritjen e fëmijëve e konsiderojnë si barrë, dhe për atë arsye shumë rrallë ose aspak nuk lindin fëmijë.²¹ Shikuar nga perspektiva religjioze, kohabitacioni konsiderohet si lidhje jashtëmartesore dhe është rreptësisht i ndaluar (haram), si në islam ashtu edhe në krishterim. Në shumicën e vendeve të botës ka status ilegal ose gjysmë ilegal. Edhe pse në Kosovë mungojnë hulumtimet për këtë fenomen, por supozohet se është në zhvillim e sipër, ndërsa në vendet perëndimore ky fenomen është në rritje, sidomos te të rinjtë dhe studentët, të cilët jetën studentore e kalojnë në kohabitacion dhe martohen pas një kohe ose kur bëhen me fëmijë. Thjesht, kjo merret si një fazë eksperimentuese përpara martesës.

f) Shtyrja e martesës. Të rinjtë kosovarë kryesisht martohen në moshën 30 vjeçare,²² gjë që pritet me pakënaqësi nga shumë prindër të cilët dinin të krijonin martesë shumë më herët. Ky “konflikt brezash” është deri diku i arsyeshëm, pasi që në rrethanat e sotme preferenca i jepet arsimimit dhe krijimit të karrierës, veçanërisht te gratë. Pikërisht tek

²¹ Ali Pajaziti (2009), *Fjalor i sociologjisë*, fq. 61.

²² Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, mosha mesatare e të martuarve gjatë vitit 2019 ishte 29.5 vjeçare. Prej tyre, mosha mesatare e meshkujve ishte 31 vjeç, ndërsa mosha mesatare e femrave ishte 28 vjeçe. <https://ask.rks-gov.net/media/5495/statistikat-e-kuror%C3%ABzimeve-2019.pdf> (qasur më: 07.11.2020.).

ata, të cilave dikur padrejtësisht u është mohuar e drejta e arsimimit, sot është në skenë një rilindje e vërtetë arsimore, ku vetëm në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” ka mbi 6.000 studente femra më tepër se meshkujt. Disa teoricienët këtë transformim e kualifikojnë si “feminizmi i arsimit”.²³ Përveç arsimit dhe karrierës, në shtyrjen e krijimit të familjes, sociologët identifikojnë edhe faktorë të ndryshëm, si gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale, shkalla e lartë e papunësisë, varfëria, si dhe mungesa e perspektivës për të rinjtë.²⁴

g) Globalizmi dhe komunikimet masive. Proceset dinamike të zhvillimit të hovshëm të modernitetit, globalizimit, inovacionet teknologjike dhe komunikimet masive kanë ndikuar fuqishëm edhe në familje. Sa më shumë që këto procese na hapën mundësi dhe perspektiva të reja, po ashtu na ekspozuan ndaj rreziqeve dhe anktheve të reja, veçanërisht në sferën e jetës familjare. Këto procese kanë prekur jo vetëm familjen, por edhe ekonominë, politikën, kulturën dhe mbi të gjitha teknologjinë dhe komunikimet masive, të cilat e kanë bërë jetën tonë jashtëzakonisht dinamike.²⁵ Këtë e cekëm ngase, krahasuar me vendet rajonale dhe ato të zhvilluar evropiane, Kosova është ndër të parat për nga

²³ Ulrih Bek, (2001), *Rizično društvo: u susret novoj moderni*, Beograd, Filip Višnjić, fq. 178.

²⁴ <https://www.koha.net/arberi/78797/lindjen-ne-kosove-ne-trend-te-renies/> (qasur më 07.11.2020.)

²⁵ Shih më gjerë: Entoni Gidens (2005), *Odbegli svet*, Stubovi kulture, Beograd.

përdorimi i internetit dhe i teknologjive moderne. Është interesant fakti se 93.6% të popullsisë së Kosovës përdor internetin, për dallim nga mesatarja 89.4% e 27 shteteve të Bashkimit Evropian. Ky lloj komunikimi, në mënyrë rrënjësore ka ndryshuar mënyrën e interaksionit dhe ndërveprimit ndërmjet njerëzve dhe organizatave, duke krijuar kështu një formë të re komunikimi. Pikërisht në të ashtuquajturën “botën virale”, nëpërmjet rrjeteve sociale, në dekadën e fundit, një numër i madh i martesave është mbyllur, pa u takuar fizikisht më parë. Përpos internetit, botës virtuale dhe rrjeteve sociale, në transformimin dhe degradimin e familjen ndikon edhe spektakli, simulacioni dhe hiper-realiteti shoqëror. (Jean Baudrillard), i cili zakonisht shfaqet në formë të telenovelave dhe “reality show” të ndryshme televizive, të cilat zgjojnë kureshtjen e publikut dhe manipulojnë me emocionet e tyre, por mbi të gjitha abuzojnë me vlerat kulturore, tradicionale dhe familjare.

Përmbyllje - perspektiva e familjes kosovare

Familja kosovare dikur karakterizohej për nga solidariteti shoqëror, organizimi, struktura e qëndrueshme, kolektiviteti dhe homogeniteti, tipare këto që ngadalë po zbehen në periudhën e pasluftës, në kushtet e rritje së individualizmit, demokracisë, barazisë dhe lirisë. Sot, familja është shumë më e fragmentarizuar, anëtarët e saj janë më të tjetërsuar dhe emocionalisht më të larguar nga njëri-tjetri, ndërsa për rëniet morale shfaqen qëndrime më liberale. Lidhjet farefisnore

shkëputen, ndërsa të drejtat e të afërmeve nuk respektohen. Të gjitha këto kriza, më parë imanente për shoqëritë perëndimore, nuk duhet të justifikohen me nevojën e modernizmit dhe të zhvillimit ekonomik. Sidomos kur dihet se është e mirënjohur se në fillim të shekullit XXI, shumë shtete në zhvillim e sipër kanë gjetur mënyrën për zhvillimin e ekonomisë, kapitalizmit dhe të teknologjisë informative, njëkohësisht duke ruajtur strukturën tradicionale të familjes dhe vlerave morale të saj.²⁶ Por, megjithëqë familja kosovare është duke kaluar një krizë shumëdimensionale sikurse edhe vetës shoqëria, krahasuar me familjet perëndimore të cilat kalojnë një gjendje të përgjithshme degradimi, ajo ende është një institucion i qëndrueshëm dhe kultivues i vlerave kryesore. Ajo mbetet një agjens i rëndësishëm i socializimit, pak a shumë patriarkal dhe ende në udhëkryqin e traditës dhe të modernitetit. Ajo është akoma e aftë të gjenerojë dhe të transmetojë vlerat që e kanë personifikuar prej kohësh, ngase është “institucioni më i vjetër shoqëror që asnjëherë nuk vjetrohët”,²⁷ dhe mu për këtë arsye, individi duhet t’ia nënshtrojë dëshirat e veta një institucioni të tillë.²⁸

²⁶ Martin Segalan (2009), *Sociologjia porodice*, Beograd, Clio, fq. 486.

²⁷ Ali Pajaziti (2009), *Fjalor i sociologjisë*, fq. 168.

²⁸ Në gjetjet e disa hulumtimeve për *Familjen dhe shoqërinë* në Kosovë theksohet se “në shoqërinë kosovare, familja konsiderohet tradicionalisht si një nga vlerat më të rëndësishme... Familja në Kosovë është ende e fortë nuk ka pësuar transformime si në vendet e tjera. Kosova është një fortesë e pastër e familjes, ku përparësia e interesave familjare është shumë më e rëndësishme se interesat individuale.” *Studimi për rininë - Kosovë 2018/2019*, fq. 29.

Krejt në fund, duhet cekur se qëllimi primar i këtij punimi ishte të vë në pah disa aspekte të krizës nëpër të cilën po kalon familja bashkëkohore, të mobilizojë organet përkatëse përmes prezantimit të të dhënave empirike, si dhe të inkurajojë marrjen e masave të caktuara për t'i ruajtur vlerat universale dhe specifike të familjes kosovare, të trashëguara nga shoqëria jonë për shekuj me radhë. Në këtë kuptim, rekomandojmë dhe konsiderojmë se do të ishte e nevojshme, që 1. të rishikojmë konceptin e prindërisë dhe cilësinë e edukimit familjar; 2. të zhvillojmë një politikë sociale e cila do të ngrit shkallën e natalitetit përmes benifiteve të ndryshme për nënat me dy ose më shumë fëmijë; 3. përveç mbështetjes materiale, të sigurojmë edhe edukim intelektual, psikologjik, emocional, shpirtëror dhe fizik për fëmijë; 4. t'i edukojmë të rinjtë në frymën e vlerave morale, ngase “bashkëjetesa” dhe liria seksuale nuk mund të jenë alternativa të duhura të martesës, e cila nënkupton edhe marrjen e detyrave ndaj njëri-tjetrit dhe lindjen e fëmijëve të cilët nuk janë barrë, por dhuratë dhe amanet i të madhit Zot; si dhe 5. të hulumtohen shkaqet e divorceve të shpeshta dhe të ofrohen zgjidhje racionale për t'i minimizuar ato, sikur që do të ishte një metodë e pajtimit, e iniciuar nga familjet e akterëve dhe e mbështetur nga ekspertë të ndryshëm socialë (psikologu, pedagogu, sociologu, teologu). Në fund të fundit, martesa është e shenjtë dhe të gjitha burimet njerëzore duhet të investohen në ruajtjen e saj.

“...Zoti ynë, na bëj që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe të pasardhësve tanë, e neve na bëj shebull për të devotshmit.” (El-Furkan, 74)

Literatura:

1. Ahmet Yaman (2012), *Legjislacioni familjar islam*, Diyanet, Prizren.
2. Ali Pajaziti (2009), *Fjalor i sociologjisë*, Logos-A, Shkup.
3. Anthony Giddens (2007), *Sociologjia*, Qabej, Tiranë.
4. Anthony Giddens (2013), *Pasojat e modernitetit*, Uetpress, Tiranë.
5. Elizabet Rudinesko (2012), *Porodica u rasulu*, Akademski knjiga, Novi Sad.
6. Entoni Gidens (2005), *Odbegli svet*, Stubovi kulture, Beograd.
7. Entoni Gidens (2007), *Sociologjia*, Ekonomski fakultet, Beograd.
8. Fadil Maloku (2014), *Paradigma sociologjike e tranzicionit shqiptar*, Logos-A, Shkup.
9. Ibrahim Džananović (2004), *Primjena šerijatskog porodičnog prava kroz praksu Vrhovnog šerijatskog suda 1914-1946.*, FIN, Sarajeva.
10. *Kur'ani fisnik* (1436 h.), përktheu dhe komentoi H. Sherif Ahmeti, Medina.
11. Lekë Sokoli (2006), *Analiza sociologjike*, IS & Rinia, Tirana.
12. Martin Segalan (2009), *Sociologjia porodice*, Clio, Beograd.
13. Masimo Rekalkati (2014), *Šta ostaje od oca? Očinstvo u hipermodernom dobu*, Akademski knjiga, Novi Sad.
14. Michael Haralambos, Martin Holborn, (2002), *Sociologjia - teme i perspektive*, Golden marketing, Zagreb.
15. *Studimi për rininë - Kosovë 2018/2019* (2019), Friedrich-Ebert-Stiftung - Kosovo, Prishtinë.
16. Ulrih Bek (2001), *Rizično društvo: u susret novoj moderni*, Filip Višnjić, Beograd.
17. <http://ask.rks-gov.net>
18. <http://www.internetworldstats.com/europa2.htm>

Dr. Violeta SMAJLAJ

BARAZIA GJINORE NË MARRËDHËNIET PASURORE BASHKËSHORTORE

Hyrje

Ky punim shqyrton parimin e barazisë gjinore në rregullimin e marrëdhënieve pasurore që krijohen ndërmjet bashkëshortëve në martesë. Ndryshe nga e drejta sendore, këto marrëdhënie janë të rregulluara me dispozita të veçanta nga Ligji për Familje i Kosovës, për shkak të specifikave që ka marrëdhënia bashkëshortore, si përkujdesje për jetëgjatësinë e familjes. Meqë në Ligjin për Familjen i Kosovës (LFK) njihet mundësia e lidhjes së martesës edhe në formën fetare, atëherë lind nevoja e shqyrtimit të kësaj marrëdhënie jo vetëm sipas të drejtës pozitive në Kosovë, por edhe sipas të drejtës fetare. Në këtë rast, krahasimi bëhet me të drejtën islame. Punimi ka për synim të japë një vështrim krahasues, që të shërbejë si mjet vetëdijesimi për gratë, organizatat joqeveritare, si dhe për shoqërinë në përgjithësi. Punimi është organizuar në tri pjesë:

- Teoria legjislative;
- Praktika gjyqësore;
- Perspektiva islame.

Rëndësia e temës del në pah edhe më shumë nëse marrim parasysh të dhënat shqetësuese që ka mbledhur USAID-i në Kosovë, e të cilat theksojnë se: 73% e qytetarëve nuk kanë njohuri themelore për të drejtat e tyre pronësore; vetëm 3% e grave në Kosovë trashëgojnë pronën e paluajtshme nga prindërit e tyre; vetëm 19% e grave në Kosovë posedojnë pronë të paluajtshme në emër të vet.¹

1. Shqyrtimi legjislativ

Pas luftës, ndryshimet në shoqërinë kosovare kanë prekur të gjitha sferat e jetës, përfshirë edhe martesën. Më parë, marrëdhëniet pasurore martesore rregulloheshin me “Ligji për Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare” (LMMF), kurse sot rregullohen me “Ligji për Familjen i Kosovës” (LFK).² Ligji i tanishëm, i publikuar në gazetën zyrtare, në vitin 2006, është një përpjekje shtetërore për të krijuar një bazë të re ligjore, që respekton parimet bazë të standardeve ndërkombëtare në rregullimin e marrëdhënieve familjare. Marrë parasysh faktin se, marrëdhëniet personale ndërmjet bashkëshortëve mund të jenë të qëndrueshme vetëm duke pasur marrëdhënie të shëndosha pasurore midis tyre, si dhe mes tyre dhe palëve

¹ Communication for Social Development (CSD), E drejta pronësore e grave në një shoqëri demokratike, fq.4. Shih online:

<http://csdkosovo.org/wp-content/uploads/2019/07/Imovinsko-pravo-%C5%BEena-u-demokratskom-dru%C5%A1tvu-ALB.pdf>.

² Ligji nr: 2004/32 për Familjen i Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 20 janar 2006, ka hyrë në fuqi me datën 16 shkurt 2006, Gazeta zyrtare e RK, nr. 4/2006, 01.09.2006.

të treta.³ Kjo sepse, ekonomia familjare ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e familjes, por edhe të vetë çiftit. Në Ligjin për Familjen i Kosovës, ndikimi që ka parimi i barazisë morale dhe ligjore mes bashkëshortëve është faktorizuar që në nenin 3, paragrafi 1, ku kjo konsiderohet themeli i rregullimit të marrëdhënieve pasurore midis bashkëshortëve, si dhe siguron mbrojtjen e dinjitetit të secilit nga diskriminimi në martesë. Çfarëdo marrëveshje ndërmjet çiftit, në të cilën njëri bashkëshort pranon pabarazinë, ligjërisht është krejtësisht e pavlefshme. Paragrafi 1, i nenit 42, në LFK, përkufizojnë barabarësinë e bashkëshortëve në marrëdhëniet personale dhe pasurore, duke i rregulluar ato mbi këtë parim.⁴ Barabarësia e bashkëshortëve në marrëdhëniet martesore hyn në grupin e të drejtave, për të cilat bashkëshortët nuk mund të merren vesh ndryshe, vetëm nga si parashihen me ligj, për shkak se janë të rregulluara me norma të karakterit imperativ. Në rast të mungesës së barabarësisë ndërmjet çiftit, si sanksion, ligji tërheq të drejtën e shkurorëzimit.⁵ Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve në martesë janë të rregulluara nga një sërë dispozitash ligjore, kryesisht me LFK, Kapitulli IV, nenet 45-57. Vlen të theksohet se, regjim pasuror martesor

³ Gashi, Haxhi dhe Aliu, Abdulla dhe Vokshi, Adem, Komentari Ligji Nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, Prishtinë: GIZ, 2012, fq. 119. URL: <http://jus.igjk.rks-gov.net/605/>.

⁴ Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>; Gashi, Aliu dhe Vokshi, Komentari i Ligjit për Familjen i Kosovës, fq. 117-118

⁵ Gashi, Aliu dhe Vokshi, Komentari i Ligjit për Familjen i Kosovës, fq. 106 dhe 107

quhet: Tërësia e normave ligjore me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet pasurore ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet tyre dhe të tjerëve.⁶

Në të drejtën familjare, llojet e regjimit të pasurive të bashkëshortëve klasifikohen sipas disa kriterëve. Në bazë të kriterit të burimit, regjimet ndahen në:

- Regjim ligjor, që do të thotë se dispozitat të cilat i rregullojnë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve para-shihen nga ligji, si dhe zbatohen nga data e lidhjes së martesës, pavarësisht nga vullneti i bashkëshortëve. Për nga natyra e dispozitave urdhëruese apo lejuese të tij, ky lloj regjimi ndahet në:⁷ regjim ligjor obligativ, nëse ligji e parasheh si regjim të vetëm që rregullon marrëdhëniet martesore, siç është në të drejtën tonë pozitive; regjim ligjor fakultativ, nëse ligji ua mundëson bashkëshortëve të zgjedhin me marrëveshje regjimin pasurore, kurse e zbaton regjimin ligjor pas lidhjes së martesës, vetëm nëse bashkëshortët nuk kanë të caktuar me kontratë një tjetër regjim pasuror.

⁶ Oruçi, Gani, E drejta familjare (Ligjërata të autorizuar), Prishtinë: Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 1994, fq. 66; Podvorica, Hamdi, E drejta Familjare, bot. IV, Prishtinë: Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2011, fq. 243; Gashi, Haxhi dhe Aliu, Abdulla dhe Vokshi, Adem, Komentari Ligji Nr. 2004/32 për familjen i Kosovës, Prishtinë: GIZ, 2012, fq. 119; Bahtiri, Bedri, Aspektet nacionale dhe ndërkombëtare të regjimit pasuror martesor të bashkëshortëve, Prishtinë: Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, 2018, fq.266

⁷ Omari, Sonila, E drejta familjare, Tiranë: Fakulteti Juridik i Universitetit të Tiranës, 2010, fq. 84.

- Regjim kontraktor, që nënkupton se dispozitat të cilat rregullojnë pasurinë e fituar gjatë martesës përcaktohen me kontratë, nëpërmjet së cilës, bashkëshortët zgjedhin sipas vullnetit të tyre, se cili regjim martesor do t'i nënshtrohet pasuria e tyre e fituar gjatë martesës.⁸ Ky lloj regjimi lejohet në Francë, Gjermani, Belgjikë, Zvicër, e vende të tjera perëndimore, ndërsa nuk parashihet në LFK. Por, sipas rregullave të së drejtës sonë të detyrimeve, bashkëshortët mund të lidhin kontratë lidhur me pasurinë e tyre të veçante të fituar para martesës. Sipas LFK-së, bashkëshortët mund të bëjnë kontratë edhe në pasurinë e përbashkët, por vetëm lidhur me administrimin, disponimin dhe pjesëtimin e saj,⁹ e jo në shmangie të regjimit ligjor.

Ndërsa, sipas kriterit të strukturës, regjimet ndahen në:¹⁰

- Regjim i pasurive të veçanta, sipas së cilit, secili bashkëshort ruan të drejtën mbi pasurinë që e fiton edhe pas lidhjes së martesës; dhe
- Regjim i pasurive të përbashkëta, i cili do të shqyrtohet më vonë.

Pasuria e veçantë dallohet nga pasuria e përbashkët përmes dy kriterëve: i pari është koha e krijimit të pronës, para

⁸ Podvorica, E drejta Familjare, p. 254

⁹ Podvorica, E drejta familjare, fq. 254 dhe 255.

¹⁰ Omari, E drejta familjare, fq. 84-85; Oruçi, E drejta familjare, fq. 66; Podvorica, E drejta Familjare, fq. 243

apo pas martesës; i dyti, mënyra e krijimit të pronës, me apo pa kontribut. Përkundër veçorive të ndryshme, regjimet kanë edhe tipare të përbashkëta, ngase secili regjim rregullon tri çështje me rëndësi të jetës bashkëshortore: identifikon pasuritë, ndanë të drejtat dhe përcakton detyrimet.¹¹

Sipas LFK-së, neni 45, në regjimin pasuror bashkëshortor parashihet “pronësia e përbashkët e pronës së fituar pas lidhjes së martesës”.¹² Pra, regjimi i pronësisë së përbashkët në Kosovë, është institucioni ligjor obligativ, që rregullon trajtat e detyrueshme të pasurisë së bashkëshortëve. Për t’u krijuar “pasuria e përbashkët” nevojiten dy kushte:¹³ jetesa e përbashkët bashkëshortore dhe kontributi i përbashkët bashkëshortor.

- *Jetesa e përbashkët bashkëshortore* - Këtu përfshihet edhe rasti, kur në bazë të marrëveshjes bashkëshortët jetojnë të ndarë për shkak të punës, studimit ose specializimit, për aq kohë sa ekziston martesë dhe lidhja emocionale ndërmjet tyre.
- *Kontributi i përbashkët* - Këtu përfshihen të ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, pasuria e fituar bashkërisht, ndihma e bashkëshortit ofruar për bashkëshortin tjetër, siç është kujdesi për fëmijët,

¹¹ Xhafaj, Pranvera, Evoluimi i regjimeve Pasurore Martesore në të drejtën Shqiptare: Rezultate dhe objektiva, Tiranë: punim i pa publikuar, 2010, fq. 47. <https://doi.org/10.13140/rg.2.2.25039.28322>.

¹² Ligji nr: 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>.

¹³ Gashi, Aliu and Vokshi, Komentari i Ligjit për Familjen i Kosovës, fq. 127; Podvorica, E Drejta Familjare, fq. 246.

udhëheqja e punëve të shtëpisë, si dhe çfarëdo forme tjetër e punës, lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.

Pra, kontributi në fitimin e pasurisë së përbashkët mund të jetë direkt, siç është fitimi nga marrëdhënia e punës, ose indirekt, siç është kujdesi ndaj fëmijëve dhe shtëpisë. Në bazë të këtij vlerësimi, çdo gjë që fitohet pas martesës, me kontributin e njërit apo të dyte, detyrimisht përbën pasuri të përbashkët. Kështu që, legjislacioni i ka dhënë vlerë materiale kontributit të gruas në shtëpi, duke e konsideruar si të barabartë me atë të burrit, që siguron të ardhura materiale.

Kjo gjë ka rëndësi të veçantë nëse marrim në konsideratë faktin se, në Kosovë vetëm 13.3% e grave janë të punësuarra,¹⁴ e që është përqindja më e ulët në Evropë.¹⁵ Por, sa ka gjetur aplikim kjo teori në praktikën gjyqësore? Kjo është pikë e dytë që do ta shqyrtojmë në vazhdim.

¹⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2009, fq. 14, online në:
<http://ask.rks-gov.net/media/4854/anketa-e-tregut-te-punes-tm1-2019.pdf>

¹⁵ Initiative for Justice and Equality (INJECT), Pasuria e Përbashkët dhe mbajtja financiare: ligji dhe praktika, Prishtinë 2019, fq.12, e disponueshme online në nyjën:
<https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2019/09/Pasuria-e-Perbashket-dhe-mbajtja-financiare-ALB-Web.pdf>

2. Praktika gjyqësore

Në Raportin e Progresit për Kosovën, të Bashkimit Evropian, në vitin 2018,¹⁶ theksohet se, përkundër kornizës ligjore me standarde ndërkombëtare, problemi në Kosovë është implementimi efektiv i ligjeve në praktikën gjyqësore. Gjatë rasteve të divorceve, duke u bazuar në raportet të ndryshme, është vërejtur tendenca nga ana e gjykatave për ta minimizuar vlerën e punës së grave në shtëpi.¹⁷ Deri më tani, nuk ekziston asnjë rast i njohur, në të cilin gjykata ka ndarë pasurinë e përbashkët në pjesë të barabarta, nëse njëri prej bashkëshortëve nuk është pajtuar me ndarje të barabartë. Çuditërisht, rasti i vetën kur Gjykata e ka ndarë pasurinë e përbashkët në pjesë të barabarta, pa kërkuar dëshmi materiale, ka qenë atëherë, kur ajo e drejtë është ndarë në favor të burrit, në vitin 2013, në Prishtinë. Deri më sot, asnjë grua nuk e ka fituar gjysmën e pasurisë së përbashkët në këtë mënyrë.¹⁸

¹⁶ Raporti i Progresit për Kosovën 2018, fq.25, online: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>.

¹⁷ Drenusha Morina, “Kur vjen puna te ndarja - Amvisëria nuk njihet si punë,” Periskopi, 2018, marrë nga, <https://www.periskopi.com/kur-vjen-puna-te-ndarja-amviseria-nuk-paguhet-e-spo-njihet-si-pune/>.

¹⁸ Initiative for Justice and Equality, Pasuria e përbashkët dhe mbajtja financiare, fq. 50, 51, 52 dhe 53. Online në: <https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2019/09/Pasuria-e-Perbashket-dhe-mbajtja-financiare-ALB-Web.pdf>.

3. Perspektiva islame

Në të drejtën islame, barazia është kauza e drejtësisë për ta shmangur diskriminimin ndërmjet njëri-tjetrit dhe është në rangun e domosdoshmërive fetare, e që quhet darurijat, nga të cilat individi nuk ka drejt të heqë dorë, siç mund të bëjë me disa prej të drejtave personale.¹⁹ Juristi i njohur, Ibën Ashuri thotë: “Barazia dhe liria janë ndër qëllimet madhore të ligjit islam.”²⁰

Nëse në rrethana të caktuara, barazia nuk e realizon drejtësinë, kjo tregon se parimi është duke u zbatuar keq. Në lidhje me këtë kuptim, Ibën Ashuri thotë: “Barazia të cilën e kërkon ligji islam është barabarësi e kufizuar nga kushtet në të cilat zbatohet barazia, e jo absolute në të gjitha rrethanat, ngase vetë krijimtaria e njerëzve është e ndryshme në prirje.”²¹ Pra, barazia nuk është domosdoshmëri e njëtrajtshme në aspektin e aplikimit. Ajo mund të jetë absolute ose e drejtpeshuar. Barazia e drejtpeshuar respekton dallimet ndërmjet bashkëshortëve, në prirje dhe rrethana, si dhe në përcaktimin e të drejtave dhe të detyrave. Kurse, barazia absolute është diskriminim që e vë barazinë në kontradiktë me vetveten, në

¹⁹ Uthman, Dr. Muhamed, Hukukul-insan bejnesh-sheriatil-islamijeti uel-fikril-kanunil-garbi (Të drejtat e njeriut ndërmjet të drejtës islame dhe të drejtës perëndimore), bot.1, Kairo: Darush-shurukë, 1982, fq.20-21; Imare, Dr. Muhamed, Hukukul-insani daruratun la hukuk (Të drejtat e njeriut janë domosdoshmëri e jo thjesht të drejta), Kuvajt: Alemul-ma’rife, 1985, fq. 14-17.

²⁰ Ibën Âshurë, Muhamedtâhir, Mekasidush-sheriatil-islamijje (Qëllimet e ligjit islam), Muhamedulhabib ibnul Havxhe (red.), Doha: Ministria e vakëfeve dhe çështjeve fetare, 3/371.

²¹ Ibën Âshurë, Mekasidush-sheriatil-islamijje (Qëllimet e ligjit islam), 3/371.

të drejta dhe detyrime, në kushte dhe prirje të barabarta. Prandaj, në bazë të këtij parimi, ligji mund t'i dallojë në mënyrë pozitive grupet e privuara në baza gjinore, me disa të drejta që të tjerët nuk i kanë, derisa qytetarët të nivelohen barabartë. Në marrëdhëniet bashkëshorte, e drejta islame nuk paraqet regjim të caktuar pasuror, por vetëm efekte juridike si rrjedhojë e lidhjes së martesës. Meqenëse sot, dallohen dy lloje efektesh të aktit martesor, personale dhe pasurore, mund të themi se sipas kësaj të drejte, akti i vlefshëm martesor shkakton vetëm efekte personale ndërmjet bashkëshortëve. Ato efekte rregullojnë të drejtat dhe detyrimet që lidhen me statusin bashkëshortor të çifti, siç janë bashkëjetesa, besnikëria, trajtimi i mirë etj. Mirëpo, ka edhe disa efekte personale të natyrës pasurore, siç është dhënia e mehrit (dhuratë martesë) gruas dhe mbajtja financiare e familjes. Si rrjedhojë, bëhet e qartë se, e drejta islame nuk i ka rregulluar ndryshe pasuritë e personave të martuar, prej atyre të pamartuar, qofshin ato pasuri e luajtshme apo të paluajtshme, si në aspektin e pronësisë, ashtu edhe në atë të administrimit e disponimit. Kështu që, secili bashkëshort mund të lidh të gjitha llojet e ligjshme të kontratave në pasurinë e vet me kë të dojë, përfshirë edhe me bashkëshortin tjetër. Prandaj, regjimi obligativ i pasurisë së përbashkët është një çështje e huaj për të drejtën islame, pasi që kushtëzimet në martesë, duhet të jetë në përputhje me natyrën juridike të aktit martesor, siç paraqitet me Kuran dhe me Sunet.²² Andaj, secili nga bashkë-

²² Ebu Zehre, Muhamed, El-Ahvalush-Shahsijje (E drejta familjare), bot.1, Kajro: Darul fikril arabi, 1950, fq. 156.

shortët vazhdon të mbetet titullar i vetëm në pasurinë e tij, edhe pas lidhjes së martesës. Çdonjëri nga bashkëshortët ka autonomi të pavarur nga tjetri në pasurinë e vet. Në Kuran thuhet: “Burrave ju takon hise nga jo që fituan ata dhe grave gjithashtu ju takon hise nga jo që fituan ato.”²³ Ky ajet, ndër shumë të tjerë, ka lënë të kuptohet se bashkëshortja është po sikur bashkëshorti, dhe secili prej tyre gëzon autoritet të plotë në pasurinë e vet brenda kufijve ligjorë. Në lidhje me këtë, Akademia Ndërkombëtare e të Drejtës Islame, ka miratuar një vendim, ku thuhet:

“Gruaja është plotësisht e kualifikuar në aspektin pasuror dhe ka autoritet të plotë financiar (sikurse burri). Ajo ka të drejtën absolute në gjithçka që e fiton me punën e saj. Ka pasurinë e vet të veçantë, të drejtën e pronësisë dhe të drejtën për të disponuar me pronë. Burri nuk ka autoritet mbi pasurinë e gruas dhe ajo nuk ka nevojë për lejen e burrit për të pasur pronë apo për të disponuar me atë.”²⁴

Mirëpo, sipas të njëjtës Akademi, bashkëshortët mund të bien dakord në lidhje me pasuritë e tyre të fituara gjatë martesës:

²³ Kurani, kaptina En-Nisa (Gratë): Ajeti 32.

²⁴ Akademia ndërkombëtare e të drejtës Islame, Vendime dhe Rekomandime të Akademisë ndërkombëtare të së drejtës islame, vendimi nr. 144 (2/16) lidhur me mospajtimet e bashkëshortit dhe bashkëshortes punonjës, seanca e gjashtëmbëdhjetë, Dubai, periudha prej 9-14 prill 2005. Shih online: <http://www.iifa-aifi.org/2174.html>.

“Nëse bashkëshortët me pëlqimin e tyre vendosin t’i bashkojnë pasuritë, nuk ka kurrfarë pengese fetare për këtë, por nuk lejohet t’ju imponohet me përcaktim të detyrueshëm.”²⁵

Pra, nuk përjashtohet mundësia që të parashihen me ligj regjime fakultative, jo obliguese, pasi që autonomia e kontraktimit në pasuri është mjaft e gjerë. Sidomos, kur dihet se metafora kuranore i përshkuan bashkëshortët se janë petk për njëri-tjetrin, në kuptimin e asaj se ka një lloj uniteti jeta e përbashkët martesore, sikur njëra jetë e vesh jetën tjetër në udhëtimin bashkëshortor. Kështu që, si rregull, e drejta islame parasheh regjimin e pasurive të ndara, në bazë të së cilit, secili bashkëshort ruan të drejtën mbi pasurin e vet, por bashkëshortëve u lejohet që të bëjnë marrëveshje me kontratë lidhur me rregullat dhe detyrimet pasurore, të cilave do t’u nënshtrohen pasuritë e tyre brenda limiteve ligjore. Së këndejmi, dallimi kryesor mes së drejtës sonë pozitive dhe të drejtës islame, është dhënia ose jo e mundësisë së kontraktimit të lirë ndërmjet dy bashkëshortëve në lidhje me pasuritë e tyre të fituara gjatë martesës. Gjegjësisht, e drejta e këtij lloj kontraktimi jepet në jurisprudencën islame, por tashmë jepet edhe në Shqipëri, si dhe në shumë vende evropiane, si në Gjermani, Francë, Austri, Zvicër etj. Ndërkohë që me ndryshimet e reja të legjislacioneve familjare, ky regjim është

²⁵ Akademia ndërkombëtare e të drejtës Islame, Vendime dhe Rekomandime të Akademisë ndërkombëtare të së drejtës islame, vendimi nr. 227 (11/23) lidhur me ndikimin e aktit martesor mbi pronën e bashkëshortëve, seanca e njëzet e tretë, Medine, periudha prej 28 tetor deri 1 nëntor 2018. Shih online: <http://www.iifa-aifi.org/4899.html>.

përcaktuar edhe në shumicën e shteteve të ish-kampit socialist (Republika e Kroacisë, Serbisë, Shqipërisë etj.). Këto legjislacione kanë siguruar një hapësirë të gjerë të lirisë së kontraktimit, me anë të së cilës, bashkëshortët rregullojnë marrëdhëniet pasurore me kontratë martesore. Ndërkaq, Republika e Maqedonisë dhe e Kosovës nuk kanë lënë hapësirë për vullnetin e lirë të bashkëshortëve në përzgjedhjen e regjimit pasuror, pasi që bashkëshortëve iu ofrohet vetëm regjimi pasuror ligjor.

Përfundimi

Në përfundim të gjithë asaj që u tha, mund të dalim me disa konkluzione:

- Në të drejtën kosovare dhe në atë islame, marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve bazohen në parimin e barazisë gjinore, mirëpo kanë bërë një ndërlidhje edhe me parimin e autonomisë së vullnetit, si dhe me parimin e përparësisë së marrëdhënieve personale ndaj atyre pasurore. Kjo ndërthurje ndërmjet këtyre parimet është bërë për ta ruajtur natyrën juridike të lidhjes martesore, duke vënë në harmoni interesat e bashkëshortëve si individ, me interesat e tyre ai anëtarë në familje.
- Parimi i barazisë është në themelor në LFK, ndërsa parimi i autonomisë është më themelor në të drejtën islame dhe merr kuptimin e barazisë së drejtpeshuar, në bazë të prirjeve dhe rrethanave, e nuk është barazi e njëtrajtshme.

Sipas LFK-së, lidhja e martesës ka efekte juridike në pasurinë e bashkëshortëve, pasi që të fituarat me punë gjatë jetës martesore të secili bashkëshort janë pronësi e përbashkët e të dyve. Ndërsa, në të drejtën islame, secili nga bashkëshortët vazhdon të mbetet titullar i vetëm në pasurinë e tij, por edhe në pjesën që e fiton vetë pas martesës, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe.

Kjo do të thotë se, dispozitat të cilat i rregullojnë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve parashihen nga ligji dhe zbatohen nga data e lidhjes së martesës, pavarësisht nga vullneti i bashkëshortëve. Ndërkaq, në të drejtën islame nuk parashihet ndonjë regjim obligues dhe regjim pasuror. Edhe pas martesës, pasuria vazhdon të mbete e veçantë, mirëpo nuk përjashtohet mundësia që ligji të ofrojë një regjim fakultativ dhe t'ju lë bashkëshortëve të zgjedhin rregullat të cilat do t'u nënshtrohen pasuritë e tyre, nëpërmjet marrëveshjes me kontratë, siç është rasti në Shqipëri dhe në disa vende evropiane (të cilat u cekën më lartë).

Ejmen SHABAN

VIRUSI KORONA - KËSHILLA DHE MËSIMET

Hyrje

Metodologjia kuranore dhe udhëzimi profetik udhëzojnë për edukim përmes ndodhive e ngjarjeve, si dhe përfitim prej këtyre rasteve për ngritjen e ambicieve dhe mbjelljen e vlerave, për korrigjim të kuptimeve dhe ngulitje të imanit, për marrje të këshillave e mësimet dhe përdorimin e tyre për orientimin dhe rregullimin e gjendjes njerëzore, për lidhje të vetvetes me veprën e jo me rezultatet dhe për preokupimin me zgjidhjen dhe frytet e jo me shkaqet dhe pasojat.

Virusi Korona (sëmundja Covid-19) është një virus i cili këto ditë është përhapur jashtë mase ndër njerëz. Ky virus, i cili nuk shihet me sy, ka bërë ndryshime drastike në jetën e njerëzve dhe ka shkaktuar panik dhe frikë. Madje, për shkak të tij, janë zbatuar vendime dhe procedura të rrepta, si mbyllja e shkollave, e universiteteve, e aeroporteve dhe e vendeve të grumbullimit të njerëzve, madje janë mbyllur edhe xhamitë dhe faltoret. Sfidat po vazhdojnë ende, ndërkohë që shifrat dhe lajmet po e mbajnë gjallë këtë krizë.

Virusi Korona është shndërruar në bisedë ditore kudo, në programet televizive dhe në rrjetet sociale. Por, janë dy pyetje tejet të rëndësishme që parashtrohet prore: A mjafton që ne të jemi vetëm bartës së lajmeve dhe të analizave?, si dhe: A ka gjëra më të rëndësishme dhe më madhështore nga të cilat duhet të marrim mësim, këshilla e urtësi?

Nuk ka dyshim se, në krijesat e Zotit, në ndryshimin e ndodhive dhe të ngjarjeve, ka këshilla për ata që dëshirojnë t'i marrin ato, ka nxitje për rikujtim dhe vigjilencë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Dhe, në këtë, me të vërtetë, ka mësim për ata që shohin.”** (Nur, 44)

Besimtari duhet që t'i shikojë ngjarjet me precizitet, thellësi dhe këshillë. Marrja e mësimave dhe këshillave është edhe prej suneteve të braktisura dhe në të njëjtën kohë është edhe adhurim madhor. Ebu Derda thotë: “Të meditosh një orë është më e mirë sesa të falesh natën.”

Myslimani para se të fundoset dhe të preokupohet me lajme, shkaqe, shifra dhe preventiva materiale për këtë sëmundje dhe të tjera, ai duhet të marrë mësim dhe këshilla prej ndodhive dhe sprovave.

KËSHILLA E PARË - Zoti yt është i Plotfuqishëm

Allahu xh.sh.¹ në Kuran thotë: **“Ata nuk e njohin Allahun si duhet.”** (En'amë, 91)

Ky virus, kjo krijesë e dobët që shihet vetëm përmes mikroskopit, ka shkaktuar panik dhe frikë në pjesën më të madhe

¹ Në arabisht *xhel-le xhelaluhu*, në gjuhën shqipe përkthimi është *madhëruar qoftë!*

të botës. Kjo njëherazi është edhe fakt për madhësinë e Zotit dhe dobësinë e njerizimit, i cili edhe pse ka arritur zhvillim në industri, teknologji, ushtri e mjekësi, nuk del nga rrethi i dobësisë dhe i paaftësisë njerëzore. Zoti është i Plotfuqishëm dhe forca i takon madhërisë së Tij në tërësi. Argument për këtë janë fjalët e Tij: **“... kurse juve ju është dhënë fare pak dije.”** (*Isra*, 85); **“Ata nuk e çmojnë Allahun me vlerën e vërtetë, se Allahu është njëmend i Fortë, e i Plotfuqishëm.”** (*Haxh*, 74)

KËSHILLA E DYTË - Merrni mësim!

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“... pra, merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes.”** (*Hashr*, 2)

Nuk ka gjë më të turpshme dhe më zhgënjyese në momentet kur zbresin belatë dhe sprovat, sesa që njerëzit të preokupohen me përhapjen e lajmeve dhe ndjekjen e zhvillimeve të reja, pa u ndalur që të marrin mësim nga këto ndodhi për të tashmen dhe të nesërmen.

Disa prej belave dhe sprovave janë falje gabimesh, pasi që njeriu ka nevojë për besim, bindje, durim dhe stabilitet, ose mund të jenë rikujtim i kërkuar për t’u kthjellur nga pakujdesia dhe plogështia. Disa prej tyre mund të jenë edhe dënim, i cili patjetër që kërkon prej nesh pendim, kthim te Zoti, shtim të adhurimeve dhe të veprave të mira.

Dijetari Ibën Bazi (Zoti e mëshiroftë!), ka thënë: “Prej shenjave të zemrës së ngurtë dhe të vulosur nga të këqijat (Zoti na ruajt nga kjo gjendje!), janë kur njerëzit dëgjojnë argumente dridhëse dhe këshilla të karakterit kritikues e qor-

tues, prej të cilave do të frikësoheshin edhe kodrat, sikur të logjiknin, e më pas vazhdojnë me tirani dhe me mëkate, duke qenë të luhatur në rrugën e Zotit, të përkushtuar pas pasioneve dhe epsheve, pa qenë të vetëdijshëm për dënimin ose kërcënimin e mundshëm që i pret.”

KËSHILLA E TRETË - Allahu është Krijuesi

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“Allahu është Krijues i çdo sendi.”** (Zumer, 62)

Pavarësisht nga pritjet, analizat dhe shkaktarët pas përhapjes së këtij virusi të rrezikshëm, që shihet vetëm me mikroskopë precizë, larg thirrjeve dhe pasojave kastastrofike negative, ekonomike dhe të tjera, ky virus mbetet krijesë prej krijesave të Zotit, që i sprovon robërit e Tij, për të dalë në shesh dobësia, paafërsia dhe injoranca njerëzore përballë përsosmërisë së forcës, dijes dhe fuqisë së Zotit. Ai është Allahu i Madhërishtëm, që këtë krijesë të dobët e vuri përballë një krijese më të fortë se ajo, e që është njeriu. Allahu është i Plotfuqishëm për t'i prishur shkaqet dhe për të gjetur krijesë pa shkak që i përngjan Isait, birit të Merjems, që lindi pa baba. Zoti ynë është i Plotfuqishëm, i Cili mund t'i neutralizojë rezultatet me gjithë ekzistimin e shkaqeve, si një mrekulli që nuk flet, ashtu siç nuk pati mundësi të fliste Zekrijai a.s., ani pse gjuha e tij ishte e shëndoshë. A e kemi ndier madhështinë e Allahut, se Ai është Krijuesi i çdo gjëje, Krijuesi i shkaqeve, i shkaktarëve, i rezultateve dhe i të gjitha veprave?! Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“Allahu është Krijues i çdo sendi. Ai është i vetmi ngadhënjyes.”** (Rad, 16)

KËSHILLA E KATËRT - Ti je rob i Allahut

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“...ashtu që të përulen...”**
(En’amë, 42)

A e kemi treguar bindjen, varfërinë, dobësinë, nevojën dhe përuljen tonë për hir të Zotit si në këto momente? Prej mësimëve madhore dhe urtësive të mrekullueshme në raste sprovash është realizimi i robërisë, nevojës dhe përuljes në të drejtën e të Madhit Zot, ashtu siç na e tregon në Kuran: **“E pse të mos përuleshin kur u erdhi atyre dënimi Ynë? Por, zemrat e tyre ishin ngurosur, por edhe djalli ua hijeshoi atë që bënin.”** (En’amë, 42)

Komentuesi i njohur i Kuranit, Ibën Kethiri, për ajetin në fjalë thotë: “Ky ajet ka kuptimin: atëherë kur ata sprovohen, i përulen Zotit dhe kërkojnë strehim tek Ai. Pjesa: “... por, zemrat e tyre ishin ngurosur...”, do të thotë që as nuk janë zbutur e as nuk janë frikësuar. Kurse pjesa: **“...por, edhe djalli ua hijeshoi atë që bënin”**, nënkupton shirkun dhe mëkatet.”

Ibën Kajimi lidhur me këtë çështje ka thënë: “Allahu nuk e sprovon njeriun që ta shkatërrojë, por e sprovon atë që ta testojë durimin dhe dëgjueshmërinë e tij. Ubudije, siç quhet në gjuhën fetare dëgjueshmëria ndaj Zotit, është tre llojesh: në vështirësi, në gjëra që njeriu i urren dhe në gjëra të tjera që ai i do. Shumica e njerëzve reflektojnë në ubudije (të qenët rob i Zotit), në atë që njeriu e do, por çështja qëndron se si reflekton ai (njeriu) ndaj asaj që e urren. Thjesht, këtu është testi.”²

² El-vabil es-sajjib, f. 11.

KËSHILLA E PESTË - T'i kthehemi vetes

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“... ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija)...”** (Shura, 30)

Vetëpëlqimi më i madh që njeriu shfaq, është kur ndihet i sigurt se atë nuk e kaplon dënimi i Zotit, kur ai beson se është imun ndaj fatkeqësive dhe sëmundjeve. Gjëja e fundit për të cilën mendon ai është ekzistenca e lidhjes së fortë ndërmjet fatkeqësive dhe sëmundjeve.

Në fakt, kjo është një nga gjërat e ditura në Kuran, të cilën, Allahu xh.sh. e ka konfirmuar në shumë ajete, si në ajetin, ku u drejtohet njerëzve më të mirë pas pejgamberëve, shokëve të Pejgamberit Muhamed a.s.: **“E kur juve u goditi një dështim (në Uhud), e që ju ia patët dhënë atë dyfish (armikut në Bedër), thatë: “Prej nga kjo?” Thuaj: “Ajo është nga vetë ju!” S’ka dyshim se Allahu është i Plotfuqishëm për çdo send.”** (Ali Imran, 165)

Përkritazi me kuptimin e këtij ajeti, Sadi ka thënë: “E kur grindeni mes jush dhe mëkatoni, pasi ju mundësuam ta shihnit atë që donit (fitoren), kthejuni vetes suaj ta qortoni. Kini kujdes nga shkaqet e liga!”³

Në lidhje me këtë çështje, Ibën el Xhevziu, shkruan: “Fatkeqësia më e madhe është vetëkënaqësia e qenies njerëzore dhe bindja ndaj njohurive të veta. Kjo është një sprovë që ka goditur shumë njerëz.”⁴

³ Tefsiru el-Kelami el-Mennan, f. 156.

⁴ Sajd el-hatir, f. 470.

Ibën Abasi, kushëriri i Pejgamberit Muhamed a.s., lutej me këto fjalë: “O Zot! Asnjë fatkeqësi nuk ka zbritur prej qielli, përveçse për shkak të mëkatit dhe asgjë nuk e largon fatkeqësinë përveçse pendimi!”

KËSHILLA E GJASHTË - Zoti yt është i Butë

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“Allahu është shumë barmirës për robërit e Vet.”** (Shura, 19)

Kur vijnë fatkeqësitë, të cilat përcillen me kriza, manifestohet butësia e Allahut mbi besimtarët, si dhe mbikëqyrja a Tij ndaj tyre, duke i ruajtur ata nga çdo e keqe dhe duke ua larguar atë me të cilën përballën të tjerët. Ai i pajis me durim dhe kënaqësi ndaj sprovave. E, sikur të mos ishte butësia e Zotit, që reflekton edhe si emër edhe si cilësi, atëherë zemrat do të mbusheshin me vetmi, panik e frikë. Në komentin e ajetit: **“Zoti im, me mjeshtëri e butësi e realizon dëshirën e Vet për çdo do.”** (Jusuf, 100), Sadi ka thënë: “Butësia e Zotit, barmirësia e Tij, shfaqet në një kohë kur njeriu nuk e pret.”

KËSHILLA E SHTATË - Ne kemi nevojë për Allahun

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“O njerëz, ju jeni të varfër tek Allahu.”** (Fatir, 15)

Ndoshta, njëra prej praktikave e adhurimeve të braktisura, veçanërisht në kohë fatkeqësish e sprovash, është edhe shfaqja e nënshtrimit, përlules, varfërisë për Allahun e Lartmadhëruar, e qetësisë dhe e përthyerjes. Robi i Zotit është çdoherë i nënshtruar, i varfër te Zoti në çdo situatë, në begati dhe në fatkeqësi, në të mirë dhe në të keq, në lehtësi dhe në

vështirësi. Këto fatkeqësi i shpalosin këto kuptime dhe e manifestojnë provimin e vërtetësisë së imanit dhe bindjes së njeriut. Le të meditojmë për pasqyrimin e varfërisë që pati pejgamberi Zekerija a.s., para madhërisë së Allahut dhe për ndjenjën e dobësisë brenda vetes dhe shfaqjen e saj për Zotin, kur ai u lut që Zoti t'i dhuronte një fëmijë të mirë. Zoti xh.sh. na tregoi me gjuhën e pejgamberit Zekerija a.s.: ***“Tha: “Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më janë përhapur thinjat në kokën time, e me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar.” (Merjem, 4)***

Ibën Rexhepi ka thënë: “Nuk lejohet të nënshtrohesh dhe të ndihesh i varfër përveçse përballë madhërisë së Allahut. Ai është i vetmi që meriton të adhurohet dhe ky është realiteti i adhurimit.”

KËSHILLA E TETË - Adresa Hyjnore

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: ***“Ai (Jakubi) tha: “Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut.” (Jusuf, 86)***

Prej shenjave të besimit të dobët janë ankesat e shumta drejtuar njerëzve, inatosja dhe indinjata që na kaplon, a thua se shkaqet materiale janë mekanizmi që i lëviz ato. Kush i ankohet Zotit, ai e ka gjetur rrugën e duhur, kurse ai që ankohet nga Zoti, e ka humbur atë rrugë. Le ta kujtojmë se çfarë i ndodhi pejgamberit Jakub a.s., për shkak të humbjes së birit të tij, Jusufit dhe vëllait të tij më të vogël, e më pas edhe vëllait të madh të tyre. Ai humbi shikimin, e kaploi pleqëria dhe u godit nga sëmundje dhe sprova të njëpasnjëshme, por

ishte i qëndrueshëm dhe duroi. Allahu na e përshkruan këtë gjendje në Kuranin famëlartë: **“Ai (Jakubi) tha: “Unë hidhërimin tim dhe pikëllimin tim ia parashtroj Allahut, e unë e di për Allahun, atë që ju nuk e dini.” (Jusuf, 86)**

Ibën Kajimi ka thënë: “Ankesa drejtuar Zotit, nuk do të thotë se mohon durimin e bukur, por është distancim total i njeriut nga ankesat drejtuar njerëzve, për t’iu drejtuar vetëm Allahut, e që nënkupton durim. Allahu e sprovon robin e Vet, që ta dëgjojë nga ai ankesën, përlulen dhe lutjen e tij. Zoti i ka qortuar ata që nuk i përlulen Atij në kohë fatkeqësish e sprovash.”⁵

Gjithashtu, ai ka thënë: “Allahu e urren atë që ankesën fillimisht ua drejton njerëzve dhe e do atë që ankesën ia drejton Atij. I është thënë dikujt: “Si i ankohesh Atij (Allahut) që nuk i fshihet asgjë?” U përgjigj: “Zoti e do kur robi i Tij i nënshtrohet.”

KËSHILLA E NËNTË - Çdo gjë e ka një fund

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“... e çdo gjë, madje, është e caktuar.” (En’amë, 42)**

Prej ligjeve të Zotit te krijesat e Tij, është se çdo gjë ka fillim dhe mbarim. Nuk ka dyshim se edhe kjo pandemi do të zhduket, do të kalojë. Kjo mbjell qetësi, rehati dhe gëzim në zemrat e besimtarëve. Ky është përgëzimi i përfundimit të mirë për besimtarët dhe fitore kundër kësaj fatkeqësie, me le-

⁵ Udet As-Sabirin, f. 63.

jen e Allahut. Allahu xh.sh. thotë: **“Çdo lajm e ka kohën e vet, të caktuar.”** (*En’amë, 67*)

Sadi, në tefsirin e tij thotë: “Pra, kohën kur do të ekzistojë lajmi dhe ajo kohë për të, as nuk shtohet e as nuk pakësohet.”

Ky është një realitet i ngulitur, të cilin Kurani e konfirmon në disa vende, si në ajetin: **“Për secilin afat ekziston evidencë e caktuar.”** (*Rad, 38*)

Në tefsirin “Fet’hul Bejan”, 7/68, në komentimin e këtij ajeti thuhet: “Për çdo gjë, Allahu ka shkruar afat të caktuar, kohë të ditur. Qëllimi me fjalën “afat i caktuar” është koha e ekzistimit, sepse, çdo gjë e gjallë e ka kohën e vet të caktuar kur do të jetojë e ekzistojë, as nuk i shtohet ky afat, e as nuk i pakësohet.”

KËSHILLA E DHJETË - Durimi i mirë

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“... durim i mirë** (*pa ankesë*).” (*Jusuf, 18*)

Gjëja më madhështore që e ndihmon njeriun që t’i tejkalojë sprovat dhe fatkeqësitë është pajisja me durim dhe forcë vullneti, ngase ky është morali i të mëdhenjve. Ekzistojnë faktorë psikikë që e shtyjnë njeriun drejt frikës, të cilët kanë fuqi varësisht nga fuqia e të sprovuarit dhe faktorë shpirtërorë që e shtyjnë njeriun drejt durimit dhe të qenët i kënaqur me caktimin e Zotit. Kur njeriu kërkon ndihmë nga Zoti për durim, me të vërtetë faktorët shpirtërorë do të triumfojnë, që ai të pajiset me durim të bukur.

Durimi i mirë është ai durim apo sabër që nuk shoqërohet me indinjatë ndaj caktimeve të Zotit, as me kundërshtim ndaj vendimeve hyjnore, as me shkëputje nga adhurimi i Allahut, as me ankesë te dikush tjetër po Zotit, as me zemërim, as me pikëllim, as me lodhje kur vijnë fatkeqësitë. Duke këshilluar krijesën më të mirë, peygamberin Muhamed a.s., Allahu thotë: **“Ti, pra, duro me një durim të mirë (pa ankesë).”** (*Mea-rixh, 5*)

Kurse për peygamberin Jakub (paqja qoftë mbi të!), pasi që e kishin kapluar sprovat, Allahu xh.sh. na tregon në Kuran të shprehurit e tij: **“Halli im është durimi i mirë (pa ankesë). Allahu është nga i Cili kërkohet ndihmë për këtë që e përkruani ju.”** (*Jusuf, 18*)

Allahu ju mëshiroftë! Dijeni se ai që e ka humbur këtë shans, ka humbur shumëfish më tepër edhe mirësitë që e përcjellin durimin, si kënaqësia, gëzimi dhe shpërblimi. Le të meditojmë pak për atë që thotë Ibën Haxheri: “Durimi përballë sprovave të dynjasë trashëgon xhenetin.”

KËSHILLA E NJËMBËDHJETË – Optimizmi është besim

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“E, mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut.”** (*Jusuf, 87*)

Krahas durimit, obligohemi që në kohë fatkeqësish të mos e humbim shpresën dhe angazhimin me vetveten, sepse kjo lind zellin dhe na jep bindje ndaj Zotit. Duhet ta njohim rëndësinë e optimizmit, të largimit nga pikëllimi, dëshpërimi dhe pesimizmi, e kjo të jetë e vazhdueshme, sepse një vështirësi nuk i mund dy lehtësime. Allahu xh.sh. thotë: **“E, pa**

dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi.” (Sherh, 5-6)

Le të meditojmë se si Jakubi a.s., ka bashkuar durimin e mirë, pa ankesa, me shpresën dhe optimizmin në një kohë të vështirë, duke filluar të bashkëveprojë me logjikë për gjendjen dhe jo për problemin, duke vepruar shkaqet e mundshme. Kurani na e përshkruan këtë realitet: **“Por, ai (Jakubi) tha: “O bijtë e mi, mos hyni (në Egjipt) për një derë, por hyni nëpër dyer të ndryshme.”** (Jusuf, 67)

Megjithatë, i këshilloi dhe i ktheu bijtë e vet të parimi madhor, që është besimi në kader, mbështetja te Zoti dhe kthimi tek Ai. Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“Unë nuk mund të largoj prej jush asnjë send nga caktimi i Allahut, vendimi nuk është i tjetërkujt, vetëm i Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm Atij le t’i mbështeten ata që besuan.”** (Jusuf, 67)

Me vazhdimin e fatkeqësisë, Jakubi a.s. mbeti optimist, jetoi me shpresë dhe tha: **“(Jakubi u tha bijve të vet) O bijtë e mi, shkoni dhe hulumtoni (në Egjipt) për Jusufin dhe vëllanë e tij, e mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut, pse vetëm populli jobesimtar e humb shpresën në Allahun.”** (Jusuf, 87)

Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., ua mësonte shokëve të tij këto kuptime madhore dhe i mbillte në shpirtat e tyre. Siç shënojnë Buhariu dhe Muslimi, i Dërguari Muhamed a.s., ka thënë: **“Nuk ka sëmundje ngjitëse dhe as nuk ka ‘zog ham’ (që paralajmëron të keqen). Më pëlqen optimizmi.”** I thanë: **“Çfarë është optimizmi?”** Tha: **“Fjala e mirë!”**

KËSHILLA E DYMBËDHJETË - Bindja ndaj Zotit

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“Dhe ndaj argumenteve Tona ishin të bindur.”** (Sexhde, 24)

Besimi në Allahun, mbështetja dhe autorizimi i çështjeve tona tek Ai, janë rrugët më të mira për tejkalimin e fatkeqësive dhe sfidave, ashtu si bindja (arab. jekin) që ndihma e Allahut do të vjen pa dyshim, dhe se pas vështirësisë vjen lehtësimi, janë shkaqet më të qarta të lehtësimit të sprovave. Kur forcohet bindja në Zotin, njeriu është më afër durimit, kënaqësisë dhe dorëzimit para Zotit. Pejgamberi Muhamed a.s., sa herë që ngrihej nga mexhlisi, lutej me fjalët: *“Dhe na jep atë bindje, e cila na i lehtëson fatkeqësisë e kësaj jete.”*⁶

Kur besimtarëve u rëndohet sprovat, bindja e tyre te Zoti forcohet, nuk dobësohet, sepse kjo kategori nuk e njeh dëshpërimin. Njerëzit më të durueshëm në sprovat dhe fatkeqësi kanë bindjen më të madhe, kurse ata që më së shumti janë të indinjuar e të hidhëruar në sprovat, kanë më pak bindje në Zotin. Zemra e besimtarit është e bindur si një kështjellë e fortë që nuk e tronditin furtunat e fatkeqësive, madje ato veç ia shtojnë fuqinë.

Siç përmendet në librin “El Jekin”, të Ibën ebi Dunjasë, në faqen 42, Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!), ka thënë: “Me të vërtetë, freskimi dhe shpëtimi janë në bindje dhe kënaqësi, ndërsa brenga dhe mërzia janë në dyshim dhe hidhërim.” Në librin “Esh Shukru”, të Ibën ebi Dunjasë, në

⁶ Shënon Tirmidhiu, shkalla e hadithit është hasen.

faqen 24, shënohet se ai ka thënë: “Bindja në Zotin (jekin) dhe imani janë së bashku.”

Në “Hiljet el Evlija”, 7/9, Sufjan eth Thevriu, ka thënë: “Bindje (jekin) është të mos e akuzosh Zotin tënd për çdo gjë që të godet dhe të sprovon.”

Në “Medarixh es Salikin”, 2/374, Ibën Kajimi, ka thënë: “Bindja në Zot (jekin) është shpirti i veprave të zemrave, që janë shpirtirat e veprave të gjymtyrëve, ajo është realiteti i sinqeritetit.”

KËSHILLA E TREMBËDHJETË - Bëhuni syçelë!

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “**Bëhuni syçelë.**” (*Nisa*, 71)

Veprimi i shkaqeve materiale legjitime të mundshme është prej ligjeve kozmologjike. Kjo, gjithashtu, ishte veçori e të dërguarve, e të devotshmëve dhe bazë e realizimit të adhurimit, e plotësimit të bindjes në Zotin. Allahu i Lartësuar në shumë ajete kuranore na është drejtuar që të t’i veprojmë shkaqet si në rastin e Merjemes, nënës së Isait a.s., kur Zoti e urdhëroi atë që ta shkunde trupin e palmës që të binin hurmat, edhe pse gjendja e saj ia pamundësonte një gjë të tillë, për shkak se ishte në momentet e lindjes së Isait, e dobët për ta bërë një gjë të tillë. Megjithatë, ky hap ishte një veprim i shkaqeve të duhura në momentin e duhur (që të binin frutat e hurmave, të cilat ishin ushqim që do ta forconin atë fizikisht).

Realiteti i mbështetjes te Zoti (arab. tevekkul) është mbështetja e zemrës tek Allahu me kryerjen e shkaqeve. Mbështetja tek Allahu dhe kundërshtimi i veprimit të shkaqeve

është diskreditim në shariatën islame dhe mangësi logjike, ndërsa e kundërta e saj, veprimi i shkaqeve dhe anashkalimi i mbështetjes së zemrës tek Allahu është mangësi e teuhidit (të adhuruarit vetëm Allahun) dhe shirk (ortaki, rivalitet) në shkaqe.

Në “Medarixhu Salikini”, 2/120, Ibën Kajimi (Allahu e mëshiroftë!), ka thënë: “Mbështetja te Zoti është një nga shkaqet më madhore, që përmes saj realizohen kërkesat e mira dhe largohen të këqijat. Ai që mohon shkaqet, nuk e ka kuptuar mbështetjen në Zotin (nuk është në rrugën e duhur), pasi prej plotësimit të mbështetjes (tevekulit) është mos përfundim totalë ndaj shkaqeve dhe ndërprerja e zemrës me mbështetje në Zotin.”

KËSHILLA E KATËRMBËDHJETË - Çfarë halli ke?

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “**Allahu është më i miri** (në të shpërblyer) **dhe më i përjetshmi** (në të dënuar).” (Ta Ha, 30)

Sot, myslimanët janë të ngjashëm me të tjerët, të gatshëm dhe vigjilentë si individ, shoqëri, shtete, institucione, përmes rrjeteve sociale dhe programeve televizive me masa preventive dhe fortifikime të fuqishme përballë këtij virusi (Korona), i cili i tronditi të gjithë, edhe pse kjo është çështje instinkti, natyrshmëri që ndodh, sepse ruajtja e jetës është nga objektivat e shariatit dhe domosdoshmëri madhore.

Por, nga ana tjetër, çuditësh kur sheh ftohtësi dhe ngurtësi, indiferencë dhe mungesë vigjilence për fatkeqësinë e fesë në nivelin individual, ymeti, që kërcënojnë besimin, parimet, moralin, shenjtërinë, madje edhe ekzistencën tonë.

Pejgamberi a.s., në lutjen e tij thoshte: *“Mos na sprovo në fenë tonë, mos e bëj dynjanë brengën tonë më të madhe dhe as kufirin tonë të dijes!”*⁷ Fatkeqësia në fe është fundi i humbjes, i cili nuk është fitimprurës. Të kuptuarit e drejtë të fesë është në atë se çdo sprovë, përveç sprovës së fesë është tejkaluese. Realiteti i hidhur qëndron në atë se çdo fatkeqësi që lidhet me këtë botë ngjall zgjim dhe vigjilencë për të, ndërsa fatkeqësitë fetare, sikur të jenë një ujë i ftohtë, që nuk ngjallin interesim. Junus bin Ubejdi, në “El Hilje”, 3/9, ka thënë: “Ç’është puna me mua, më humbet një pulë dhe mër-zitem, më humb një namaz dhe nuk mër-zitem?!”

Në “Elhija”, 1/149, Hatim el Esemi, ka thënë: “Më ka ikur namazi një herë dhe nuk më ka ngushëlluar përveç Ebu Is’hak el Buhariu. E, sikur të më vdiste im bir, do të më shprehnin ngushëllime më shumë se dhjetë mijë veta, sepse fatkeqësia e fesë sot është bërë më e lehtë se fatkeqësia e dynjasë.”

Betohemi në Allahun se, është fatkeqësi e madhe që të përdhoshet nderi i myslimanëve në çdo vend, sot nuk lëvizë askush në këtë drejtim, që të ngjallë interesim apo vigjilencë në këto çështje. Kush i jep përparësi dynjasë para fesë, vetëm se është sprovuar me një fatkeqësi të madhe. Allahu xh.sh. thotë: ***“Pse në të vërtetë sytë nuk verbërohen, por verbërohen zemrat në kraharorë.”*** (Haxh, 46)

⁷ Mos na bëj nga ata që mendojnë vetëm për këtë botë, por na bëj edhe nga ata që mendojnë edhe për botën tjetër!

KËSHILLA E PESEMBËDHJETË - Nëse do Zoti, do të bëhet mirë

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “... **ju mund ta urreni një gjë, por ajo është e mirë për ju...**” (Bekare, 216)

Ndoshta njeriu demoralizohet ose e godasin brengat, hall-et, mërzia nga caktimet e hidhura dhe fatkeqësitë e dhimbshme dhe sëmundjet shkatërruese, sidomos kur vijnë befasi, pa paralajmërim, në një kohë ku mbizotërojnë siguria dhe qetësia. Por, besimtari është i bindur në kaderin e Allahut, urtësinë, mëshirën, butësinë e Tij, e di që kjo është pastrim për zemrat dhe tërheqje e vërejtjes nga pakujdesia për ta shndërruar sprovën në mirësi dhe belanë në dhuratë.

Nëse ndalemi dhe i shikojmë dobitë, frytet, përfitimet që kthehen te njeriu në fenë, imanin, zemrën, sjelljen dhe të gjitha çështjet e tij gjatë vështirësive të sprovave që e kanë goditur, ai bindet se ajo që e ka përzgjedhur Allahu për të, në atë që ai e urren është më e mirë sesa ajo që ka përzgjedhur ai për vetveten nga ajo që dëshiron.

Siç shënon Muslimi në Sahihun e tij, pejgamberi Muhamed a.s., ka thënë: “*Është e çuditshme puna e besimtarit. E gjithë jeta e tij është dobi. Nëse atij i vjen një punë e mirë, ai e falënderon Zotin dhe merr shpërblim për këtë gjë. Nëse atij i bie një fatkeqësi, ai duron për hir të Zotit dhe përsëri shpërblehet për këtë gjë. E kjo gjë ndodh vetëm me besimtarin.*”

Në librin “Tarih”, 14/298, Hatib el Bagdadi, ka përmendur: “Është sëmurë Fadl bin Sehl dhu Rejastin me një sëmundje në Horasan, e më pas u shërua dhe shkuan njerëzit për ta vizituar. Ata biseduan dhe ai iu drejtuar duke iu thënë: “Në sëmundje ka begati që njerëzit e mençur duhet t’i dinë, si

pastrimi nga mëkatet, shpërblimi për durimin, zgjimi nga pakujdesia, rikujtimi i begatisë në kohë të shëndetit, ftesa për pendim dhe inkurajimi për lëmoshë.”

KËSHILLA E GJASHTËMBËDHJETË - Qielli është afër

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“... Unë jam afër...”** (*Bekare, 186*)

Lutjes së sinqertë i hapen dyert e qiellit, i largohen pengesat, i shkurtohen distancat dhe afrohet afër Mëshirbërësit. **“Kur besimtarët e Mi të pyesin për Mua, (thua ju): “Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit...”** (*Bekare, 186*)

Hasan el Basriu ka thënë: “Çelësi i qiellit është lutja.”

Enes bin Maliku r.a. ka thënë: “Me të vërtetë, Allahu e sprovon zemrën me lutje.”

Veheb bin Munbihi ka thënë: “Bie sprovë e del lutja.”

Buhariu ka shkruar kapitullin “Lutja e cila largon epideminë dhe dhembjen.” Gjithashtu, Nesaiu ka shkruar një kapitull “Lutja e largon epideminë.”

Lutja është një adhurim madhështor, ashtu siç është saktesuar nga Pejgamberi a.s., e cila më së shumti ka dobi dhe ndikim kur del nga sinqeriteti, nga reflektimi i varfërisë njerëzore karshi madhërisë hyjnore, nga përlujta, nga mendimi i mirë për Allahun dhe bindja për përgjigjen e lutjes. E gjitha kjo, duhet të jetë me vazhdimësi dhe pa ngutje.

KËSHILLA E SHTATËMBËDHJETË - A ia vlen barra qiranë?!

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: **“... me të vërtetë, jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi e përkohshme...”** (Gafir, 39)

Meditoni për këtë virus kaq të vogël, një krijesë e dobët që nuk shihet me sy, e cila u prish njerëzve begatitë, kënaqësitë, sigurinë dhe stabilitetin e jetës. Një botë që kthehet kundër jush, ju tradhton, ndryshon, asnjëherë nuk rri e njëjtë. A i ka hije një njeriu të mençur, e të mos flasim për besimtarin, që të marrë për atdhe dhe vendbanim, të rrijë i qetë e të luftojë për të, të garojë për të?!

Kush nuk merr mësim nga realiteti i kësaj bote me dëshirën e tij, do ta mësojnë caktimet, sfidat e fatkeqësitë, që të marrë atë mësim me detyrim. Kjo botë nuk i jep mundësi të pasurit që çdo herë të jetë i pasur, të shëndetshmit që çdoherë të jetë i shëndetshëm, sepse kjo botë është e neveritshme, e vdekshme, e pavlerë.

Allahu xh.sh. thotë: **“E, çka mendon ti, nëse Ne u japim atyre, që të kënaqen disa vite, e pastaj t’i godasë ata ajo që u është premtuar (dënimi), nuk do t’u vlejë asgjë atyre ajo me të cilën janë kënaqur.”** (Shuara, 205-207)

Të ndalemi pak dhe me kujdes të shohim se çfarë tha ai që nuk flet nga hamendja për realitetin e kësaj bote. Muhamedi a.s., ashtu siç përmendet në Sahihun e Muslimit, ka thënë: **“Betohem në Allahun se dynjaja përballë ahiretit nuk është vetëm se si, shembulli i atij që e fut gishtin tregues në det dhe shikon se çfarë po merr.”**

Më e madhe se kjo, është fjala e Allahut: **“Jeta në këtë botë është vetëm një kënaqësi e rrejshme.”** (Hadid, 20)

I është thënë Hakimit: “Si është shembulli i kësaj bote?” Ai tha: “Ajo është më e paktë sesa të merret për shembull.”

Prej porosive të Mesihut për pasuesit e tij ishte: “Kaloni nëpër këtë dynja e mos jetoni në të.” Siç përshkruhet edhe në librin “Zuhd”, të Ahmedit, faqe 53, Mesihu shpesh thoshte: “Me të drejtë ju them juve: Ai që më së shumti e do këtë botë, ai më së shumti do të ketë dhembje dhe fatkeqësi.”

KËSHILLA E TETËMBËDHJETË -

Nga puna ndalemi vetëm kur të hyjmë në xhenet

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “... *dhe nuk lypni ta ndërrojnë me asgjë tjetër...*” (*Kehf, 104*)

Njeriu në këtë botë jeton mes së mirës dhe së keqes, mes begative dhe fatkeqësive, mes shëndetit dhe sëmundjes. Ajo që besimtarit ia lehtëson fatkeqësitë e dhimbjet dhe ia pakëson mërzinë dhe sëmundjet, është bindja se në xhenet nuk ka pakënaqësi, të vogla apo të mëdha. Xheneti është vend i pëjetësisë, i paqes, i begative të përjetshme që nuk përfundojnë. Në të ka lumturi, gëzim e dashuri.

Ajo që më së shumti ua prish begatitë njerëzve në këtë dynja është vdekja dhe mërzia, të cilat nuk gjenden në xhenet. Allahu për kënaqësitë e banorëve të xhenetit thotë: “*Aty do të qëndrojnë përgjithmonë dhe nuk lypin ta ndërrojnë me asgjë tjetër.*” (*Kehf, 104*)

Përjetësimi në xhenet i shpëton, vdekja nuk ka mundësi t’ua prishë kënaqësinë në të, nuk i kaplon mërzia e as që kanë nevojë për ndonjë ndryshim, sepse nuk shohin kënaqësi më të madhe se ajo që kenë. Mutraf bin Sheuhejri ka thënë:

“Me të vërtetë, vdekja ua prish njerëzve kënaqësitë e kësaj bote. Kërkoni kënaqësi që nuk njeh vdekje.”

Prej këshillave që na jep kjo sprovë (virusi Korona) është që i mençuri të durojë për të arritur rehati të përhershme që nuk përfundon, të jetë aktiv, që nefsi i tij të përmllohet për botën tjetër, xhenetin.

KËSHILLA E NËNTËMBËDHJETË - Ki frikë Zotin!

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: “... **por Mua mu frikësoni, nëse jeni besimtarë të vërtetë!**” (*Ali Imran, 175*)

Nuk ka dyshim se Covid-19 është prej fakteve kozmologjike, me të cilat Allahu i frikëson robërit e Tij për t’i këshilluar dhe për të marrë mësim që të ngjallin frikë respektin në raportin me Allahun dhe faktet e Tij në këtë kozmos. Allahu xh.sh. thotë: “... **Ne nuk dërgojmë fakte (mrekulli) vetëm se për t’i frikësuar njerëzit.**” (*Isra, 59*)

Në tefsirin e Ibën Kethirit, në vëllimin V, faqe 91, Kata-de, thotë: “Allahu i frikëson njerëzit me atë që do nga faktet (argumentet) e Tij, ndoshta që të marrin mësim, të rikujtojnë e të kthehen (në rrugën e Zotit).”

Vënia në funksion e frikë respektit është respektim i Allahut dhe është nga udhëzimet profetike. Enesi në “Sahihul Buhari” ka thënë: “Kur frynte era e fortë, kjo vërehej në fytyrën e pejgamberit Muhamed a.s.”

Ndonëse atij i qenë falur gjynahet, megjithatë frika e kaplonte të Dërguarin e Zotit. E, si është gjendja me ne që jemi neglizhues?! Më e çuditshme është gjendja e disa myslimanëve, të cilët, me gjithë përhapjen e këtij virusi janë të preo-

kupuar me anekdota, tallje, shaka, qeshje e lojëra. Hutohen nga blerja dhe grumbullimi i ushqimeve duke qenë neglizhuar, injorojnë urtësitë hyjnore në sprovat dhe fatkeqësitë me të cilat Zoti i sprovon robërit e Tij. Pejgamberi Muhamed a.s., shpesh lutej me këtë lutje: *“O Zoti ynë, na jep, na begato me frikë, aq sa frika të nga pengojë nga mëkatet!”*

E lusim Zotin që mëshira e Tij t’i përfshijë robërit e Tij, që të largojë prej nesh çdo brengë e telashe dhe ta largojë nga njerëzimi tërë këtë virus - bela! Amin!

KËSHILLA E NJËZETË - Koha është vetë jeta

Allahu xh.sh. në Kuran thotë: ***“E kur të kesh mbaruar (obligimin), atëbotë mundohu me adhurim (ndaj Allahut).”*** (Sherh, 7)

Koha është materia e jetës, kapitali i myslimanit në këtë jetë. Koha është më me vlerë se pasuria, më e shtrenjtë se çdo çmim. Për shkak të rëndësisë së saj, Allahu është betuar në kohën. Buhariu shënon nga Pejgamberi a.s., se ka thënë: *“Në dy gjëra janë të mashtruar shumica e njerëzve, shëndeti dhe koha e lirë.”*

I mençur, syçelë, është ai që çdoherë e shfrytëzon kohën e tij dhe kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kohë krizash, sprovash, sepse ato e afrojnë njeriun te Zoti dhe nuk e humb kohën kot. Është thënë se “kush e shet të vlefshmen pa çmim, do ta blejë të lirën me çmim më të shtrenjtë.”

Ibën Kajimi në “El Favaid”, faqe 31, ka thënë: “Humbja e kohës është më e rëndë sesa vdekja, sepse humbja e kohës

të ndan nga Zoti, ndërsa vdekja të ndan nga jeta e kësaj bote dhe nga banorët e saj.”

Komentuesi i Kuranit, Shinkiti, në “Edvaul Bejan”, vëllimi VIII, faqe 579, në lidhje me ajetin kuranor: “E kur të kesh mbaruar (obligimin), atëbotë mundohu me adhurim (ndaj Allahut)”, thotë se “kjo është zgjidhje e problemit të kohës së lirë që i ka preokupuar njerëzit dhe që nuk ka lënë hapësirë për myslimanin që të ketë kohë të lirë. Myslimani ose është i angazhuar me punë të kësaj bote, ose me punë të botës tjetër.”

Abdullah bin Mesudi ka thënë: “Unë e urrej njeriun që nuk e shoh duke qëndruar i paangazhuar në asgjë, qoftë nga punët e kësaj jete apo të botës tjetër.”

Të parët tanë, na kanë dhënë modele konkrete se si i kanë shfrytëzuar krizat për të bërë vepra të mira.

Serahsiju ka shkruar librin e tij “El Mabsut”⁸ me pesëmbëdhjetë vëllime, duke ua diktuar nxënësve të tij teksa ishte i burgosur.

Ibën Ethiri ka shkruar librat “Xhami el Usul” dhe “En Nihaje fi Garibil el Hadith” kur ishte i paralizuar.

Ibën Tejmije pjesën më të madhe të librit “Fetava” e shkroi kur ishte i burgosur.

Përshtati në shqip:
Mr. Rashit Zylfiu

⁸“El Mabsut” është libër bazë në medhhebin hanefij.

KALOI NË AHIRET ALIMI YNË I SHQUAR DHE AUTORI I “TAKVIMIT” HAJRULLAH EF. HOXHA

Më 1 dhjetor 2020, në Prishtinë, në moshën 81 vjeçare, ndërroi jetë Hajrullah ef. Hoxha - autori i “Takvimit” të parë në gjuhën shqipe për besimtarët myslimanë shqiptarë në ish-Jugosllavi, veterani i literaturës islame, imami shumëvjeçar dhe udhëheqësi e drejtuesi i periodikut të Bashkësisë Islame të Kosovës.



*Hajrullah ef. Hoxha
(1939-2020)*

Hajralluah efendiu i përket gjeneratës së ulemave, të cilët pas Luftës së Dytë Botërore hodhën themelet e literaturës islame në gjuhën shqipe në ish-Jugosllavi.

Hajrullah efendiu, në këtë rrafsh e gjejmë të angazhuar në fund të viteve ‘60 të shekullit të shkuar, kur në “Buletinin Informativ”, që asokohe botohej nga Shoqata e Ylemave, filloi me kontributet e tij të para nga fusha e historisë islame, përkatësisht me shkrimin kushtuar Pejgamberit Muhamed

a.s.. Po në këtë fund vit, Hajrullah efendiu hartoi dhe përgatiti “Takvimin” e parë për territorin e Kosovës në gjuhën shqipe dhe, të njëjtin, për vitin 1970 e botoi Shoqata Ylema-ve të BI të Kosovës.

Botimi i “Takvimit” në gjuhën shqipe qe një sukses i madh, sepse me këtë edhe vihen themelet për nxjerrjen e një publikimi vjetor, i cili, përpos pjesës kalendarike dhe takvimit për kohët e namazit, festave fetare dhe evidentimit të netëve të mëdha, aty u botuan edhe tema për njohuritë themelore islame, gjë që shpejtë u bë një botim i rëndësishëm në gjuhën shqipe për besimtarët myslimanë. Kjo ndodhi edhe për faktin “Takvimi” shtypej në shumë ekzemplarë dhe ishte pjesë e shumicës së familjeve shqiptare të besimit islam.

Literatura islame në gjuhën shqipe në Kosovë, zë fill në vitet e ‘60 të shekullit XX, ndërsa merr formë e trajtë në vitet ‘70, në të cilën një kontribut të madh e ka dhënë edhe Hajrullah efendi Hoxha, fillimisht në “Takvim”, e më pastaj edhe në revistën “Edukata Islame”, e cila nisi së botuari në vitin 1970.

Periodiku i Bashkësisë Islame të Kosovës (“Takvimi”, “Edukata Islame” dhe “Dituria Islame”), që nga zanafilla e deri më sot bartin në vete edhe kontributin e Hajrullah efendi Hoxhës, qoftë si autor a përkthyes, e qoftë edhe si drejtues e redaktor. Përderisa për “Takvimin” është nismëtar dhe për një kohë të gjatë edhe e udhëhoqi dhe arriti ta bënte një nga botimet më të kërkuara dhe më serioze, Hajrullah efendiu po aq kontribut ka dhënë edhe në rritjen dhe zhvillimin e revistës “Edukata Islame”, ku së bashku më Haxhi Sherif ef. Ahmetin janë bartësit kryesorë të rrugëtimit të saj. Madje, Hajrullah

efendi, për një kohë që edhe kryeredaktor i revistës "Edukata Islame".

Po ashtu, kontribut të çmuar që nga vitet '90 të shekullit të kaluar e kënde, Hajrullah efendi ka dhënë edhe në revistën e përmuajshme "Dituria Islame", ku ka botuar një sërë temash e trajtesash nga disiplina të ndryshme të islamologjisë.

Nëse e vështrojmë me vëmendje zhvillimin e periodikut të Bashkësisë Islame të Kosovës, do të shohim se bashkëpunëtori më jetëgjatë me kontribute të prekshme në disiplinat islame, në disa prej tyre edhe nismëtar, është pikërisht Hajrullah efendi Hoxha.


Që nga numri i parë i vitit viti 1970 e deri tek botimi i "Takvimit" që e kemi në duar Hajrullah efendi ka përgatitur pjesën kalendarike të tij. Për këtë numër të fundit, ai ishte duke e përgatitur edhe një temë, por të cilën nuk arriti ta përfundonte duke e lënë në gjysmë të dorëshkruar në tavolinën e punës së tij. Përveç kësaj, Hajrullah efendi ka qenë bashkëpunëtor që nga numri i parë i revistës "Edukata Islame" e deri tek numri i fundit kur edhe e ka botuar shkrimin e fundit të tij.

Gjithashtu, edhe në revistën "Dituria Islame", Hajrullah efendiun ka një sërë kontributesh, qoftë autorial, qoftë të përkthyer. Natyrisht, në një rast përkujtimor si ky, nuk mund t'i numërojmë gjithë kontributet e tij dhe as të japim bibliografinë e tij, por konstatojmë me gojën plotë se Hajrullah efendi është kontribuuesi më jetëgjatë, plotë 50 vjet, në periodikun e Bashkësisë Islame të Kosovës, pra që nga nisma e këtij periodiku e deri në ditët e sotme.



Kontributet e Hajrullah efendiut në Periodikun e Bashkësisë Islame janë të fushave e disiplinave të ndryshme, duke nisur nga historia islame, ku është shquar për shkrimet e tij kushtuar Pejgamberit Muhamed a.s., të botuara në disa vazhdimë në revistën “Edukata Islame”, më pastaj nga fusha e etikë islame, besimit islam etj..

Për vlerën, rëndësinë, sasinë dhe disiplina me të cilat është marrë Hajrullah efendiu, sigurisht që kërkohet një studim më i thellë, i cili do të vinte në pah gjithë kontributin e tij në fjalën e shkruar islame shqiptare, e që shpresojmë se në një kohë të afërme studiues të fushave të ndryshme do t’i qasen jetëshkrimit dhe kontributit të Hajrullah efendi Hoxhës, i cili jetoi e veproi me shumë zell e përkushtim në kohë jo shumë të favorshme për fenë islame në hapësirat tona.



*Dorëshkrimi i fundit në përgatitje për Takvimin 2021
nga Hajrullah ef. Hoxha*

Përveç kontributit të tij aktiv në periodikun e Bashkësisë Islame, Hajrullah efendiu ka qenë një përkrahës dhe mbështetës i të rinjve për t'u marrë me shkrime; me dëshirë e entuziazëm i lexonte shkrimet e bashkëpunëtorëve të rinj, bisedonte me ta, i këshillonte e debatonte me modesti gjithnjë duke argumentuar e duke marrë për referencë mësimet e ulemave të mëhershëm dhe përvojën e tij të begatshme. Por ajo që e veçonte Hajrullah efendiu, ishte qasja kritike me qëllim të ngjitjes së nivelit profesional.

U gëzohej arritjeve të bashkëpunëtorëve të rinj, por këmbëngulte që të botoheshin sa më shumë shkrime që janë në përputhje me doktrinën tonë hanefite e maturidite dhe me traditën e kultivuar ndër shekuj te ne.

Hajrullah efendiu jetoi me periodikun e Bashkësisë Islame, kontribuoi për të pa kursyer asgjë, qe udhëheqës e drejtues i tij, njohu e përjetoi rritën dhe sukseset e tij, e për këtë të fundit shpeshherë edhe thoshte “E kemi pasur ëndërr një gjë të tillë. Shyqyr që Zoti na e bëri nasip që ta jetësojmë në realitet”.

Hajrullah efendiu më caktimin e Zotit të tij, më 1 dhjetor 2020, kaloi në Ahiret, por kontributi i tij në periodikun e BI të Kosovës, do të mbetet një trashëgimi e begatë për gjeneratat dhe brezat që vijnë, një trashëgimi që ka për t’u studiuar e për t’u vlerësuar.

Me kalimin në Ahiret të Hajrullah efendi Hoxhës, “Takvimi” mbeti pa hartuesin e nismëtarin e tij, periodiku islam mbeti pa një ndër themeluesit e tij, ndërsa lexuesi mysliman shqiptar mbeti pa veteranin e literaturës islame në gjuhën shqipe.

Zoti e mëshiroftë Hajrullah efendi Hoxhën dhe e gradoftë në Xhenetin Firdevs!

Jetëshkrim i shkurtër i Hajrullah efendi Hoxhës

Hajrullah Hoxha u lind në vitin 1939 në fshatin Korroticë e Epërme, komuna e Drenasit. Shkollën fillore katërvjeçare e kreu në Korroticë të Ulët, ndërsa gjimnazin e ulët në Komoran. Medresenë e ulët e kreu në Prishtinë, kurse të mesmen dhe kualifikimin e lartë profesional në Sarajevë. Në vitin 1964 u punësua imam në Deçan, kurse në vitin 1969 u transferua për imam dhe referent fetaro-arsimor në Mitrovicë. Në vitin 1979 u emërua administrator në Kryesinë e Shoqatës së Ylemave në Prishtinë, ku punoi deri në vitin 1998, pastaj

ai kaloi në Kryesinë e Bashkësisë Islame dhe u emërua sekretar i Redaksisë për Botime Islame. Këtë detyrë e kreu deri në vitin 2005, kur edhe u pensionua. Hajrullah ef. Hoxha është autor i “Takvimit” dhe bashkëpunëtor i rregullt i revistës “Edukata Islame” dhe i “Diturisë Islame”. Për disa numra ka qenë korrektues i “Edukatës Islame”, një mandat katërvjeçar kryeredaktor i saj, ndërsa nga numri 55/1992 e deri 100/2012 sekretar i Redaksisë. Përveç kësaj, ka qenë edhe anëtarë i redaksisë së këtyre revistave. Ka marrë pjesë në tryeza, konferenca, simpoziume e sesione shkencore të organizuara nga Bashkësia Islame e Kosovës, si dhe ka qenë redaktor i monografive të bashkëpunëtorëve dhe kolegëve të tij.

Ramadan Shkodra

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

TAKVIM
1442-1443
KALENDAR
2021

JANAR I / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e premte	17	Viti i Ri 2021, e xhuma, Xhumadel-Ula 1442 V.H.
2	e shtunë	18	
3	e diel	19	
4	e hënë	20	
5	e martë	21	
6	e mërkurë	22	
7	e enjte	23	
8	e premte	24	e Xhuma
9	e shtunë	25	
10	e diel	26	
11	e hënë	27	
12	e martë	28	
13	e mërkurë	29	
VI - Xhumadel-Uhra 1442 V.H.			
14	e enjte	1	Hëna e re
15	e premte	2	e Xhuma
16	e shtunë	3	
17	e diel	4	
18	e hënë	5	
19	e martë	6	
20	e mërkurë	7	
21	e enjte	8	
22	e premte	9	e Xhuma
23	e shtunë	10	
24	e diel	11	
25	e hënë	12	
26	e martë	13	
27	e mërkurë	14	Hëna e plotë
28	e enjte	15	
29	e premte	16	e Xhuma
30	e shtunë	17	
31	e diel	18	Hamsini

JANAR I / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e premte	5:21	7:03	11:44	14:05	16:21	18:00	9:18
2	e shtunë	21	03	45	06	21	18:00	19
3	e diel	20	02	45	06	22	18:00	20
4	e hënë	20	02	45	06	23	18:01	21
5	e martë	20	02	45	07	24	02	22
6	e mërkurë	20	02	46	08	25	03	23
7	e enjte	20	01	46	08	26	04	25
8	e premte	5:20	7:01	11:46	14:09	16:27	18:05	9:26
9	e shtunë	20	01	47	10	28	06	27
10	e diel	19	7:00	47	11	29	07	29
11	e hënë	19	7:00	47	12	30	08	30
12	e martë	19	7:00	48	13	31	09	31
13	e mërkurë	5:19	7:00	11:48	14:14	16:33	18:10	9:33
VI - Xhumadel-Uhra 1442 V.H.								
14	e enjte	5:19	7:00	11:49	14:15	16:34	18:11	9:34
15	e premte	5:19	7:00	11:50	14:16	16:35	18:12	9:35
16	e shtunë	19	6:59	50	17	36	13	37
17	e diel	18	59	50	18	37	14	38
18	e hënë	18	59	51	19	39	15	40
19	e martë	18	58	51	20	40	16	42
20	e mërkurë	18	58	52	21	41	17	43
21	e enjte	17	57	52	22	42	18	45
22	e premte	5:17	6:56	11:52	14:23	16:44	18:19	9:48
23	e shtunë	17	55	52	24	45	20	50
24	e diel	16	54	53	25	46	21	52
25	e hënë	15	53	53	26	47	22	54
26	e martë	14	52	53	27	49	23	57
27	e mërkurë	14	51	54	29	50	24	9:59
28	e enjte	13	50	54	30	51	25	10:01
29	e premte	5:12	6:49	11:54	14:31	16:53	18:27	10:04
30	e shtunë	12	48	54	32	54	28	06
31	e diel	5:11	6:47	11:54	14:33	16:55	18:29	10:08

SHKURT II / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e hënë	19	Xhumadel-Uhra 1442 V.H.
2	e martë	20	
3	e mërkurë	21	
4	e enjte	22	
5	e premte	23	e Xhuma
6	e shtunë	24	
7	e diel	25	
8	e hënë	26	
9	e martë	27	
10	e mërkurë	28	
11	e enjte	29	
12	e premte	30	e Xhuma
VII - Rexheb 1442 V.H.			
13	e shtunë	1	Hëna e re
14	e diel	2	
15	e hënë	3	
16	e martë	4	
17	e mërkurë	5	Dita e Pavarësisë së Kosovës
18	e enjte	6	Nata e Regaibit
19	e premte	7	e Xhuma, Xhemra I në ajër
20	e shtunë	8	
21	e diel	9	
22	e hënë	10	
23	e martë	11	
24	e mërkurë	12	
25	e enjte	13	Xhemra II në ujë
26	e premte	14	e Xhuma, Hëna e plotë
27	e shtunë	15	
28	e diel	16	

SHKURT II / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	lkindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e hënë	5:10	6:46	11:54	14:34	16:57	18:30	10:11
2	e martë	09	45	54	35	58	31	13
3	e mërkurë	08	44	54	36	16:59	32	15
4	e enjte	07	43	54	37	17:00	33	17
5	e premte	5:06	6:42	11:54	14:38	17:02	18:34	10:20
6	e shtunë	05	41	54	39	03	35	22
7	e diel	03	39	54	40	04	36	25
8	e hënë	02	38	54	41	05	37	27
9	e martë	5:01	37	54	42	07	39	30
10	e mërkurë	4:59	36	54	43	08	40	32
11	e enjte	58	35	54	44	10	42	35
12	e premte	4:57	6:33	11:54	14:45	17:11	18:43	10:38
VII - Rexheb 1442 V.H.								
13	e shtunë	4:56	6:32	11:54	14:46	17:13	18:45	10:41
14	e diel	55	31	55	48	14	46	44
15	e hënë	54	29	55	49	16	48	47
16	e martë	53	28	55	50	17	49	49
17	e mërkurë	51	27	55	51	18	50	51
18	e enjte	50	25	54	51	19	51	54
19	e premte	4:49	6:23	11:54	14:52	17:21	18:52	10:58
20	e shtunë	48	22	54	53	22	53	11:00
21	e diel	46	20	54	54	23	54	11:03
22	e hënë	44	18	54	55	25	56	07
23	e martë	43	17	54	56	26	57	10
24	e mërkurë	41	15	53	57	27	58	12
25	e enjte	40	13	53	57	28	58	15
26	e premte	4:39	6:11	11:52	14:58	17:29	18:59	11:18
27	e shtunë	37	08	51	58	30	19:00	22
28	e diel	4:36	6:06	11:51	14:59	17:31	19:01	11:27

MARS III / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e hënë	17	Rexheb 1442 V.H.
2	e martë	18	
3	e mërkurë	19	
4	e enjte	20	
5	e premte	21	e Xhuma, Xhemra III në tokë
6	e shtunë	22	
7	e diel	23	Dita e mësuesit
8	e hënë	24	
9	e martë	25	
10	e mërkurë	26	Nata e Miraxhit
11	e enjte	27	
12	e premte	28	e Xhuma
13	e shtunë	29	
VIII - Sha'ban 1442 V.H.			
14	e diel	1	Hëna e re
15	e hënë	2	
16	e martë	3	
17	e mërkurë	4	
18	e enjte	5	
19	e premte	6	e Xhuma
20	e shtunë	7	
21	e diel	8	Pranvera
22	e hënë	9	
23	e martë	10	
24	e mërkurë	11	
25	e enjte	12	
26	e premte	13	e Xhuma
27	e shtunë	14	Nata e Beratit, Hëna e plotë
28	e diel	15	Llogaritja e kohës verore +1 orë
29	e hënë	16	
30	e martë	17	
31	e mërkurë	18	

MARS III / 2021								
Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e hënë	4:34	6:04	11:51	14:59	17:33	19:03	11:29
2	e martë	33	03	50	15:00	34	05	31
3	e mërkurë	31	02	50	01	36	07	34
4	e enjte	29	01	50	02	37	08	36
5	e premte	4:27	6:00	11:50	15:02	17:38	19:09	11:38
6	e shtunë	25	5:58	50	03	39	10	41
7	e diel	23	56	50	03	40	11	44
8	e hënë	21	55	50	04	42	13	47
9	e martë	20	53	50	05	43	14	50
10	e mërkurë	18	51	50	06	44	15	53
11	e enjte	16	49	50	06	45	16	11:56
12	e premte	4:15	5:47	11:49	15:07	17:47	19:18	12:00
13	e shtunë	4:14	5:46	11:49	15:08	17:48	19:19	12:02
VIII - Sha'ban 1442 V.H.								
14	e diel	4:13	5:44	11:49	15:08	17:49	19:20	12:05
15	e hënë	11	42	49	08	50	21	08
16	e martë	09	40	49	08	51	22	11
17	e mërkurë	08	38	48	09	52	23	14
18	e enjte	06	36	48	09	53	25	17
19	e premte	4:04	5:35	11:48	15:10	17:55	19:26	12:20
20	e shtunë	02	33	48	11	56	27	23
21	e diel	4:00	31	48	12	57	28	26
22	e hënë	3:57	29	47	12	17:58	30	29
23	e martë	55	27	47	13	17:59	31	32
24	e mërkurë	53	25	46	13	18:00	32	35
25	e enjte	51	24	45	14	18:02	34	38
26	e premte	3:49	5:22	11:45	15:15	18:03	19:35	12:41
27	e shtunë	3:46	5:20	11:45	15:15	18:04	19:36	44
28	e diel	4:44	6:18	12:45	16:16	19:05	20:37	47
29	e hënë	41	16	44	16	06	38	50
30	e martë	39	14	44	17	07	40	53
31	e mërkurë	4:37	6:13	12:43	16:17	19:08	20:41	12:55

PRILL IV / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e enjte	19	Sha'ban 1442 V.H.
2	e premte	20	e Xhuma
3	e shtunë	21	
4	e diel	22	
5	e hënë	23	
6	e martë	24	
7	e mërkurë	25	
8	e enjte	26	
9	e premte	27	e Xhuma
10	e shtunë	28	
11	e diel	29	
12	e hënë	30	Nata e Ramazanit - teravia e parë

IX - Ramazan 1442 V.H.

13	e martë	1	Dita e parë e Ramazanit, Hëna e re
14	e mërkurë	2	
15	e enjte	3	
16	e premte	4	e Xhuma
17	e shtunë	5	
18	e diel	6	
19	e hënë	7	
20	e martë	8	
21	e mërkurë	9	
22	e enjte	10	
23	e premte	11	e Xhuma
24	e shtunë	12	
25	e diel	13	
26	e hënë	14	Hëna e plotë
27	e martë	15	
28	e mërkurë	16	
29	e enjte	17	Dita e fitorës në Bedër
30	e premte	18	e Xhuma

PRILL IV / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e enjte	4:35	6:11	12:43	16:17	19:09	20:42	12:58
2	e premte	4:34	6:09	12:43	16:18	19:10	20:44	13:01
3	e shtunë	32	07	42	18	12	46	04
4	e diel	31	06	42	19	13	47	07
5	e hënë	29	04	42	19	14	48	10
6	e martë	27	02	42	20	15	50	13
7	e mërkurë	25	6:01	41	20	16	51	15
8	e enjte	22	5:59	41	20	17	52	18
9	e premte	4:20	5:57	12:40	16:21	19:18	20:54	13:21
10	e shtunë	18	56	40	21	20	56	24
11	e diel	16	54	40	22	21	57	27
12	e hënë	4:14	5:52	12:40	16:22	19:22	20:58	13:30

IX - Ramazan 1442 V.H.

13	e martë	4:12	5:51	12:39	16:22	19:23	21:00	13:32
14	e mërkurë	10	49	39	22	24	01	35
15	e enjte	08	48	39	22	25	02	37
16	e premte	4:06	5:46	12:38	16:22	19:26	21:03	13:40
17	e shtunë	05	44	38	22	27	05	43
18	e diel	03	42	38	22	28	06	46
19	e hënë	4:01	40	37	22	29	08	49
20	e martë	3:59	39	37	23	31	10	52
21	e mërkurë	57	38	37	24	32	12	54
22	e enjte	55	36	37	24	33	13	57
23	e premte	3:52	5:35	12:37	16:25	19:34	21:15	13:59
24	e shtunë	50	33	36	25	35	17	14:02
25	e diel	47	31	36	25	36	18	05
26	e hënë	45	30	36	26	37	20	07
27	e martë	43	29	36	26	38	22	09
28	e mërkurë	41	28	36	27	40	24	12
29	e enjte	39	27	36	28	41	25	14
30	e premte	3:37	5:26	12:36	16:29	19:42	21:27	14:16

MAJ V / 2021			
Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e shtunë	19	Ramazan 1442 V.H., Festa e punës
2	e diel	20	I'tikjafi - Dita e çlirimit të Mekës viti 630
3	e hënë	21	
4	e martë	22	
5	e mërkurë	23	
6	e enjte	24	
7	e premte	25	e Xhuma
8	e shtunë	26	Nata e Kadrit*
9	e diel	27	
10	e hënë	28	
11	e martë	29	
12	e mërkurë	30	Nata e Fitër Bajramit
X - Shevval 1442 V.H.			
13	e enjte	1	Dita e I e Fitër Bajramit, Hëna e re
14	e premte	2	Dita e II e Fitër Bajramit, e xhuma
15	e shtunë	3	Dita e III e Fitër Bajramit
16	e diel	4	
17	e hënë	5	
18	e martë	6	
19	e mërkurë	7	
20	e enjte	8	
21	e premte	9	e Xhuma
22	e shtunë	10	
23	e diel	11	
24	e hënë	12	
25	e martë	13	
26	e mërkurë	14	Hëna e plotë
27	e enjte	15	
28	e premte	16	e Xhuma
29	e shtunë	17	
30	e diel	18	
31	e hënë	19	

* Dhënia e Sadekatul-fitrin, është më e pëlqyeshme të bëhet prej Natës së madhe të Kadrit e deri në mbrëmje të Natës së Bajramit.

MAJ V / 2021								
Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e shtunë	3:35	5:25	12:36	16:29	19:43	21:28	14:18
2	e diel	33	24	36	30	44	30	20
3	e hënë	31	22	36	30	45	31	23
4	e martë	29	20	35	30	46	32	26
5	e mërkurë	27	18	35	30	47	33	29
6	e enjte	25	17	35	31	48	35	31
7	e premte	3:23	5:15	12:35	16:31	19:49	21:36	14:34
8	e shtunë	21	14	35	31	50	37	36
9	e diel	19	13	35	31	51	38	38
10	e hënë	17	12	35	31	52	40	40
11	e martë	15	10	34	31	53	41	43
12	e mërkurë	3:13	5:09	12:34	16:32	19:54	21:43	14:45
X - Shevval 1442 V.H.								
13	e enjte	3:11	5:08	12:34	16:32	19:55	21:45	14:47
14	e premte	3:09	5:07	12:34	16:32	19:56	21:46	14:49
15	e shtunë	07	06	34	32	57	48	51
16	e diel	06	05	34	33	58	50	53
17	e hënë	04	04	34	33	19:59	51	55
18	e martë	02	03	34	34	20:00	53	14:57
19	e mërkurë	3:01	02	34	34	02	55	15:00
20	e enjte	3:00	5:01	35	35	03	57	15:02
21	e premte	2:59	5:00	12:35	16:36	20:04	21:58	15:04
22	e shtunë	57	4:59	35	36	05	22:00	06
23	e diel	56	58	35	36	06	22:02	08
24	e hënë	55	57	35	37	07	03	10
25	e martë	54	57	35	38	08	05	11
26	e mërkurë	52	56	35	38	08	06	12
27	e enjte	50	55	35	38	09	07	14
28	e premte	2:48	4:55	12:35	16:38	20:10	22:09	15:15
29	e shtunë	47	54	35	39	11	10	17
30	e diel	45	54	36	39	12	12	19
31	e hënë	2:44	4:53	12:36	16:40	20:13	22:13	15:20

Namazi i sabahut ditën e Fitër Bajramit falet në orën: 4:38 min.

Namazi i Fitër Bajramit falet në orën: 5:53 min.

QERSHOR VI / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e martë	20	Sheval 1442 V.H.
2	e mërkurë	21	
3	e enjte	22	
4	e premte	23	e Xhuma
5	e shtunë	24	
6	e diel	25	
7	e hënë	26	
8	e martë	27	
9	e mërkurë	28	
10	e enjte	29	
XI - Dhul-Ka'de 1442 V.H.			
11	e premte	1	e Xhuma, Hëna e re
12	e shtunë	2	
13	e diel	3	
14	e hënë	4	
15	e martë	5	
16	e mërkurë	6	
17	e enjte	7	
18	e premte	8	e Xhuma
19	e shtunë	9	
20	e diel	10	Dita më e gjatë e vitit: 15:35 min.
21	e hënë	11	
22	e martë	12	Vera
23	e mërkurë	13	
24	e enjte	14	Hëna e plotë
25	e premte	15	e Xhuma
26	e shtunë	16	
27	e diel	17	
28	e hënë	18	
29	e martë	19	
30	e mërkurë	20	

QERSHOR VI / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e martë	2:43	4:53	12:36	16:40	20:13	22:14	15:20
2	e mërkurë	42	52	36	40	14	15	22
3	e enjte	41	52	36	40	15	16	23
4	e premte	2:40	4:51	12:36	16:40	20:15	22:17	15:24
5	e shtunë	38	51	36	40	16	18	25
6	e diel	37	50	36	40	16	19	26
7	e hënë	36	50	36	40	17	20	27
8	e martë	35	49	37	40	17	21	28
9	e mërkurë	34	49	37	40	18	22	29
10	e enjte	2:34	4:48	12:37	16:41	20:18	22:23	15:30
XI - Dhul-Ka'de 1442 V.H.								
11	e premte	2:33	4:48	12:37	16:41	20:19	22:24	15:31
12	e shtunë	33	48	37	41	19	24	31
13	e diel	32	48	37	41	20	25	32
14	e hënë	32	48	38	42	21	25	33
15	e martë	32	49	38	43	22	26	33
16	e mërkurë	32	49	39	44	23	27	34
17	e enjte	32	49	39	44	23	28	34
18	e premte	2:32	4:50	12:40	16:44	20:24	22:29	15:34
19	e shtunë	33	50	40	45	24	30	34
20	e diel	33	50	40	45	25	31	35
21	e hënë	33	51	40	46	25	32	34
22	e martë	33	51	41	46	25	32	34
23	e mërkurë	33	51	41	46	25	32	34
24	e enjte	34	51	41	46	25	32	34
25	e premte	2:34	4:52	12:42	16:46	20:26	22:33	15:34
26	e shtunë	35	52	43	47	26	32	34
27	e diel	36	52	43	47	26	32	33
28	e hënë	36	53	43	47	25	31	32
29	e martë	36	53	43	47	25	31	32
30	e mërkurë	2:37	4:53	12:43	16:47	20:25	22:31	15:32

KORRIK VII / 2021			
Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e enjte	21	Dhul-Ka'de 1442 V.H.
2	e premte	22	e Xhuma
3	e shtunë	23	
4	e diel	24	
5	e hënë	25	
6	e martë	26	
7	e mërkurë	27	
8	e enjte	28	
9	e premte	29	e Xhuma
10	e shtunë	30	
XII - Dhul-Hixhxe 1442 V.H.			
11	e diel	1	Hëna e re
12	e hënë	2	
13	e martë	3	
14	e mërkurë	4	
15	e enjte	5	
16	e premte	6	e Xhuma
17	e shtunë	7	
18	e diel	8	
19	e hënë	9	Nata e Kurban Bajramit*
20	e martë	10	Dita e I e K. Bajramit
21	e mërkurë	11	Dita e II e K. Bajramit
22	e enjte	12	Dita e III e K. Bajramit
23	e premte	13	Dita e IV e K. Bajramit, e Xhuma
24	e shtunë	14	Hëna e plotë
25	e diel	15	
26	e hënë	16	
27	e martë	17	
28	e mërkurë	18	
29	e enjte	19	
30	e premte	20	e Xhuma
31	e shtunë	21	

* Pas çdo farzi të namazit këndohen Tekbiret, duke filluar nga sabahu i natës së Bajramit deri me Ikindi të ditës së katërt të tij.

KORRIK VII / 2021								
Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
1	e enjte	2:38	4:54	12:43	16:47	20:25	22:30	15:31
2	e premte	2:39	4:54	12:43	16:47	20:24	22:29	15:30
3	e shtunë	39	54	43	47	24	29	30
4	e diel	40	55	43	47	24	28	29
5	e hënë	41	55	43	47	23	27	28
6	e martë	42	56	43	47	23	27	27
7	e mërkurë	43	57	43	47	23	26	26
8	e enjte	44	57	43	47	22	25	25
9	e premte	2:45	4:58	12:43	16:47	20:22	22:25	15:24
10	e shtunë	2:47	4:59	12:44	16:47	20:22	22:24	15:23
XII - Dhul-Hixhxe 1442 V.H.								
11	e diel	2:49	5:00	12:44	16:48	20:21	22:23	15:22
12	e hënë	50	5:00	44	48	21	22	21
13	e martë	51	5:01	44	48	20	21	19
14	e mërkurë	52	01	44	48	19	19	18
15	e enjte	53	01	44	47	18	18	17
16	e premte	2:55	5:02	12:44	16:47	20:18	22:17	15:16
17	e shtunë	2:57	03	44	47	17	16	14
18	e diel	2:59	04	44	47	16	14	12
19	e hënë	3:00	05	44	46	16	13	11
20	e martë	3:02	06	44	46	15	12	09
21	e mërkurë	04	06	44	46	14	10	08
22	e enjte	05	07	44	45	13	09	06
23	e premte	3:06	5:08	12:44	16:45	20:12	22:07	15:04
24	e shtunë	08	09	44	45	11	05	02
25	e diel	09	10	44	44	10	04	15:00
26	e hënë	11	12	44	44	09	02	14:58
27	e martë	12	13	44	44	09	01	56
28	e mërkurë	14	15	45	44	08	22:00	53
29	e enjte	16	16	45	44	07	21:58	51
30	e premte	3:18	5:17	12:45	16:44	20:06	21:57	14:49
31	e shtunë	3:20	5:18	12:45	16:43	20:05	21:55	14:47

Namazi i sabahut ditën e Kurban Bajramit falet në orën: 4:36 min.

Namazi i Kurban Bajramit falet në orën: 5:51 min.

GUSHT VIII / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënimet të tjera astronomike
1	e diel	22	Dhul-Hixhxe 1442 V.H.
2	e hënë	23	Aligjyni
3	e martë	24	
4	e mërkurë	25	
5	e enjte	26	
6	e premte	27	e Xhuma, Gjysma e verës
7	e shtunë	28	
8	e diel	29	
I - Muharrem 1443 V.H.			
9	e hënë	1	Viti i Ri sipas Hixhretit 1443, Hëna e re
10	e martë	2	
11	e mërkurë	3	
12	e enjte	4	
13	e premte	5	e Xhuma
14	e shtunë	6	
15	e diel	7	
16	e hënë	8	
17	e martë	9	
18	e mërkurë	10	Dita e Ashureve
19	e enjte	11	
20	e premte	12	e Xhuma
21	e shtunë	13	
22	e diel	14	Hëna e plotë
23	e hënë	15	
24	e martë	16	
25	e mërkurë	17	
26	e enjte	18	
27	e premte	19	e Xhuma
28	e shtunë	20	
29	e diel	21	
30	e hënë	22	
31	e martë	23	

GUSHT VIII / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e diel	3:22	5:19	12:45	16:43	20:04	21:54	14:45
2	e hënë	24	20	45	43	03	52	43
3	e martë	26	21	45	42	02	50	41
4	e mërkurë	28	23	45	42	20:01	49	38
5	e enjte	30	24	45	42	20:00	47	36
6	e premte	3:32	5:25	12:45	16:42	19:58	21:45	14:33
7	e shtunë	33	26	45	41	57	44	31
8	e diel	3:35	5:27	12:45	16:41	19:56	21:43	14:29
I - Muharrem 1443 V.H.								
9	e hënë	3:37	5:28	12:45	16:40	19:55	21:41	14:27
10	e martë	39	29	45	40	53	39	24
11	e mërkurë	40	30	45	39	52	38	22
12	e enjte	42	31	45	39	50	36	19
13	e premte	3:43	5:32	12:45	16:38	19:49	21:34	14:17
14	e shtunë	45	33	45	37	47	32	14
15	e diel	47	34	44	36	46	30	12
16	e hënë	49	35	44	35	44	28	09
17	e martë	50	36	43	34	43	26	07
18	e mërkurë	52	37	43	33	41	24	04
19	e enjte	53	38	42	32	40	22	14:02
20	e premte	3:55	5:39	12:42	16:31	19:38	21:20	13:59
21	e shtunë	57	40	42	30	36	17	56
22	e diel	3:59	41	41	29	35	15	54
23	e hënë	4:01	42	41	28	33	13	51
24	e martë	03	43	41	27	32	11	49
25	e mërkurë	05	44	41	27	30	09	46
26	e enjte	06	45	41	26	28	07	43
27	e premte	4:07	5:46	12:41	16:25	19:27	21:05	13:41
28	e shtunë	09	48	41	25	25	03	37
29	e diel	10	49	40	24	24	21:01	35
30	e hënë	11	50	40	24	22	20:59	32
31	e martë	4:12	5:51	12:40	16:23	19:21	20:58	13:30

SHTATOR IX / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e mërkurë	24	Muharrem 1443 V.H.
2	e enjte	25	
3	e premte	26	e Xhuma
4	e shtunë	27	
5	e diel	28	
6	e hënë	29	
7	e martë	30	
II - Safer 1443 V.H.			
8	e mërkurë	1	Hëna e re
9	e enjte	2	
10	e premte	3	e Xhuma
11	e shtunë	4	
12	e diel	5	
13	e hënë	6	
14	e martë	7	
15	e mërkurë	8	
16	e enjte	9	
17	e premte	10	e Xhuma
18	e shtunë	11	
19	e diel	12	
20	e hënë	13	
21	e martë	14	Hëna e plotë
22	e mërkurë	15	
23	e enjte	16	Vjeshta
24	e premte	17	e Xhuma
25	e shtunë	18	
26	e diel	19	
27	e hënë	20	
28	e martë	21	
29	e mërkurë	22	
30	e enjte	23	

SHTATOR IX / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e mërkurë	4:14	5:52	12:40	16:23	19:19	20:56	13:27
2	e enjte	16	53	40	22	18	54	25
3	e premte	4:18	5:55	12:40	16:21	19:16	20:52	13:21
4	e shtunë	19	56	40	20	14	50	18
5	e diel	20	57	39	19	12	47	15
6	e hënë	21	58	38	18	10	45	12
7	e martë	4:23	5:59	12:38	16:17	19:08	20:43	13:09
II - Safer 1443 V.H.								
8	e mërkurë	4:24	6:00	12:37	16:16	19:07	20:41	13:07
9	e enjte	26	01	37	15	05	39	04
10	e premte	4:27	6:02	12:37	16:14	19:03	20:37	13:01
11	e shtunë	28	03	37	12	19:01	35	12:58
12	e diel	29	04	36	11	19:00	33	56
13	e hënë	30	05	36	10	18:58	31	53
14	e martë	31	06	36	09	56	29	50
15	e mërkurë	32	07	35	08	54	27	47
16	e enjte	34	08	35	07	53	25	45
17	e premte	4:36	6:09	12:35	16:06	18:51	20:23	12:42
18	e shtunë	38	10	34	05	49	21	39
19	e diel	40	11	34	03	47	19	36
20	e hënë	41	12	33	02	45	17	33
21	e martë	42	13	33	16:00	44	16	31
22	e mërkurë	44	14	33	15:59	42	14	28
23	e enjte	45	15	32	58	40	12	25
24	e premte	4:46	6:16	12:31	15:56	18:38	20:10	12:22
25	e shtunë	47	17	31	55	36	08	19
26	e diel	48	18	30	53	35	06	17
27	e hënë	49	20	30	52	33	04	13
28	e martë	50	21	30	51	31	02	10
29	e mërkurë	51	22	29	50	29	20:00	07
30	e enjte	4:52	6:23	12:28	15:48	18:27	19:58	12:04

TETOR X / 2021			
Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e premte	24	Safer 1443 V.H., e Xhuma
2	e shtunë	25	
3	e diel	26	
4	e hënë	27	
5	e martë	28	
6	e mërkurë	29	
III - Rebiul-Evvel 1443 V.H.			
7	e enjte	1	Hëna e re
8	e premte	2	e Xhuma
9	e shtunë	3	
10	e diel	4	
11	e hënë	5	
12	e martë	6	
13	e mërkurë	7	
14	e enjte	8	
15	e premte	9	e Xhuma
16	e shtunë	10	
17	e diel	11	Nata e Mevludit
18	e hënë	12	Ditëlindja e Muhamedit a.s. viti 571 e.r.
19	e martë	13	
20	e mërkurë	14	Hëna e plotë
21	e enjte	15	
22	e premte	16	e Xhuma
23	e shtunë	17	
24	e diel	18	Dita e OKB-së
25	e hënë	19	
26	e martë	20	
27	e mërkurë	21	
28	e enjte	22	
29	e premte	23	e Xhuma
30	e shtunë	24	
31	e diel	25	Llogaritja e kohës dimërore -1 orë

TETOR X / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	lkindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e premte	4:52	6:24	12:28	15:47	18:25	19:56	12:01
2	e shtunë	53	25	28	46	23	54	11:58
3	e diel	53	26	28	45	22	52	56
4	e hënë	54	28	28	44	20	50	52
5	e martë	55	29	27	43	18	48	49
6	e mërkurë	4:56	6:30	12:27	15:42	18:17	19:47	11:47
III - Rebiul-Evvel 1443 V.H.								
7	e enjte	4:58	6:32	12:27	15:41	18:16	19:46	11:44
8	e premte	5:00	6:33	12:27	15:41	18:14	19:44	11:41
9	e shtunë	5:01	34	26	40	12	42	38
10	e diel	03	35	26	39	11	41	36
11	e hënë	05	36	26	38	09	40	33
12	e martë	06	37	26	37	08	38	31
13	e mërkurë	08	38	26	36	06	36	28
14	e enjte	09	39	26	35	05	35	26
15	e premte	5:10	6:41	12:26	15:34	18:03	19:33	11:22
16	e shtunë	11	42	25	32	18:01	31	19
17	e diel	12	43	25	31	17:59	29	16
18	e hënë	13	45	25	29	58	28	13
19	e martë	14	47	25	28	56	26	09
20	e mërkurë	15	48	25	27	55	25	07
21	e enjte	16	50	25	26	53	23	11:03
22	e premte	5:17	6:51	12:25	15:25	17:51	19:22	11:00
23	e shtunë	18	52	25	24	49	20	10:57
24	e diel	19	53	24	22	48	19	55
25	e hënë	20	55	24	21	46	17	51
26	e martë	21	56	24	20	45	16	49
27	e mërkurë	23	57	24	19	43	15	46
28	e enjte	24	6:58	24	18	42	14	44
29	e premte	5:25	7:00	12:24	15:17	17:41	19:13	10:41
30	e shtunë	5:26	7:01	12:24	15:16	17:39	19:11	10:38
31	e diel	4:27	6:02	11:24	14:15	16:38	18:10	10:36

NËNTOR XI / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e hënë	26	Rebiul-Evvel 1443 V.H.
2	e martë	27	
3	e mërkurë	28	
4	e enjte	29	
5	e premte	30	e Xhuma
IV - Rebiul-Ahir 1443 V.H.			
6	e shtunë	1	Hëna e re
7	e diel	2	
8	e hënë	3	
9	e martë	4	
10	e mërkurë	5	
11	e enjte	6	
12	e premte	7	e Xhuma
13	e shtunë	8	
14	e diel	9	
15	e hënë	10	
16	e martë	11	
17	e mërkurë	12	
18	e enjte	13	
19	e premte	14	e Xhuma, Hëna e plotë
20	e shtunë	15	
21	e diel	16	
22	e hënë	17	
23	e martë	18	
24	e mërkurë	19	
25	e enjte	20	
26	e premte	21	e Xhuma
27	e shtunë	22	
28	e diel	23	Dita e Flamurit kombëtar
29	e hënë	24	
30	e martë	25	

NËNTOR XI / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatësia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e hënë	4:28	6:04	11:24	14:14	16:36	18:08	10:32
2	e martë	29	05	24	13	35	07	30
3	e mërkurë	30	07	24	12	34	06	27
4	e enjte	31	08	24	11	33	05	25
5	e premte	4:33	6:09	11:24	14:10	16:31	18:04	10:22
IV - Rebiul-Ahir 1443 V.H.								
6	e shtunë	4:34	6:10	11:24	14:09	16:30	18:03	10:20
7	e diel	36	11	24	08	29	02	18
8	e hënë	37	13	24	07	28	18:01	15
9	e martë	38	14	24	06	26	17:59	12
10	e mërkurë	39	15	24	05	25	58	10
11	e enjte	40	16	24	04	24	57	08
12	e premte	4:41	6:17	11:24	14:03	16:23	17:57	10:06
13	e shtunë	42	18	25	02	22	56	04
14	e diel	43	20	25	02	21	55	10:01
15	e hënë	44	22	25	14:01	20	54	9.58
16	e martë	45	24	25	14:00	20	54	56
17	e mërkurë	47	26	26	14:00	19	53	53
18	e enjte	48	27	26	13:59	18	53	51
19	e premte	4:49	6:28	11:26	13:58	16:17	17:52	9:49
20	e shtunë	50	29	26	58	16	51	47
21	e diel	51	30	26	57	16	51	45
22	e hënë	52	32	27	57	15	51	43
23	e martë	53	33	27	56	15	51	42
24	e mërkurë	54	34	27	56	14	50	40
25	e enjte	55	35	27	55	14	50	39
26	e premte	4:56	6:37	11:28	13:55	16:13	17:49	9:36
27	e shtunë	57	38	28	55	13	49	35
28	e diel	58	39	29	55	13	49	34
29	e hënë	4:59	40	29	55	12	49	32
30	e martë	5:00	6:41	11:29	13:54	16:12	17:49	9:31

DHJETOR XII / 2021

Data sipas kal. botëror	Ditët e javës	Data sipas Takvimit	Festat fetare dhe shënime të tjera astronomike
1	e mërkurë	26	Rebiul-Ahir 1443 V.H.
2	e enjte	27	
3	e premte	28	e Xhuma
4	e shtunë	29	
V - Xhumadel-Ula 1443 V.H.			
5	e diel	1	Hëna e re
6	e hënë	2	
7	e martë	3	
8	e mërkurë	4	
9	e enjte	5	
10	e premte	6	e Xhuma
11	e shtunë	7	
12	e diel	8	
13	e hënë	9	
14	e martë	10	
15	e mërkurë	11	
16	e enjte	12	
17	e premte	13	e Xhuma
18	e shtunë	14	Hëna e plotë
19	e diel	15	
20	e hënë	16	
21	e martë	17	Dita më e shkurtër e vitit, 9:14 min.
22	e mërkurë	18	Arbaini, Dimri
23	e enjte	19	
24	e premte	20	e Xhuma
25	e shtunë	21	
26	e diel	22	
27	e hënë	23	
28	e martë	24	
29	e mërkurë	25	
30	e enjte	26	
31	e premte	27	e Xhuma

DHJETOR XII / 2021

Data	Ditët e javës	Imsaku dhe kohët e namazit						
		Imsaku	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia	Gjatesia e ditës
		o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.	o.m.
1	e mërkurë	5:01	6:42	11:30	13:54	16:12	17:49	9:30
2	e enjte	02	43	30	54	12	49	29
3	e premte	5:03	6:44	11:31	13:54	16:11	17:49	9:27
4	e shtunë	5:04	6:45	11:31	13:54	16:11	17:49	9:26
V - Xhumadel-Ula 1443 V.H.								
5	e diel	5:05	6:46	11:31	13:54	16:11	17:49	9:25
6	e hënë	06	47	32	54	10	48	23
7	e martë	06	48	32	54	10	48	22
8	e mërkurë	07	49	32	54	10	48	21
9	e enjte	08	50	33	54	10	48	20
10	e premte	5:09	6:51	11:33	13:54	16:10	17:48	9:19
11	e shtunë	10	6:52	34	55	11	49	19
12	e diel	11	53	35	56	11	49	18
13	e hënë	12	54	35	56	11	50	17
14	e martë	12	54	36	56	11	50	17
15	e mërkurë	13	55	36	56	12	51	17
16	e enjte	14	56	37	57	12	51	16
17	e premte	5:15	6:56	11:37	13:57	16:12	17:51	9:16
18	e shtunë	15	57	38	58	13	52	16
19	e diel	16	58	39	59	13	52	15
20	e hënë	17	6:59	39	13:59	14	52	14
21	e martë	18	7:00	40	14:00	14	53	14
22	e mërkurë	18	7:00	40	14:00	14	53	14
23	e enjte	18	7:00	40	14:00	15	54	15
24	e premte	5:19	7:01	11:41	14:01	16:16	17:55	9:15
25	e shtunë	19	01	42	02	16	55	15
26	e diel	19	01	42	02	17	56	16
27	e hënë	19	01	42	02	17	56	16
28	e martë	19	01	42	02	18	57	17
29	e mërkurë	20	02	43	03	19	58	17
30	e enjte	20	02	44	04	19	58	17
31	e premte	5:20	7:02	11:44	14:04	16:20	17:59	9:18

PËRMBAJTJA

NË VEND TË PARATHËNIES	5
Naim ef. TËRNAVA ARGUMENTE QË VËRTETOJNË EKZISTIMIN E ALLAHUT, XH.SH.	9
H. Sherif ef. AHMETI FE DO TË THOTË: BESIM DHE VEPRIM	43
Sabri BAJGORA KOMENTIMI I KAPTINËS “ET-TIN”	55
Hajrullah ef. HOXHA BINDJA DHE DASHURIA NDAJ ZOTIT XH.SH. DHE MUHAMEDIT A.S.	75
Resul ef. REXHEPI RUAJTJA E TRADITAVE TONA NË RAMAZAN DHE NË BAJRAME	91
Ajni SINANI KURANI, SHKENCA DHE GJITHËSIA.....	125
Sedat G. ISLAMI LUTJA E ADEMIT A.S. (Sekretet e pendimit të sinqertë dhe të pranuar)	145
Prim.dr.med.sc. Ali F. ILJAZI JETA DHE VDEKJA NGA KËNDVËSHTRIMI KURANOR DHE SHKENCOR.....	157
Prof. asoc. dr. Fahrush REXHEPI VLERA E DIJETARËVE DHE POZITA E TYRE NË FENË ISLAME	183

Ramadan SHKODRA

ZHVILLIMI I INSTITUCIONEVE EDUKATIVE-ARSIMORE ISLAME NË KOSOVË PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE.....	193
---	-----

Sadik MEHMETI

SHKOLLAT E MESME (MEKTEBET RUSHDIJE) NË KOSOVË (me vështrim të veçantë Rushdija e Prizrenit dhe e Prishtinës).....	209
--	-----

Islam HASANI

KONTRATAT HIBRID NË SISTEMIN FINANCIAR ISLAM...	231
---	-----

Mr. Elmir KARADŽI (PHDc)

FAMILJA KOSOVARE DHE SFIDAT E JETËS BASHKËKOHORE	247
---	-----

Dr. Violeta SMAJLAJ

BARAZIA GJINORE NË MARRËDHËNIET PASURORE BASHKËSHORTORE	263
--	-----

Ejmen SHABAN

VIRUSI KORONA - KËSHILLA DHE MËSIMET	277
KALOI NË AHIRET ALIMI YNË I SHQUAR DHE AUTORI I “TAKVIMIT” HAJRULLAH EF. HOXHA	301
TAKVIM 1442-1443 / KALENDAR 2021 - (SHTOJCË).....	309
PËRMBAJTJA	335